

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave shoqërore

Viti XL (60)

2010

Shkodër, 2010

REDAKSIA

Prof. dr. Tomor OSMANI (kryeredaktor)
Prof. as. dr. Tefë TOPALLI (sekretar shkencor)
Prof. dr. David Luka, prof. as. dr. Fatbardha HOXHA,
prof. dr. Romeo GURAKUQI, MA Nevila DIBRA,
Meri GJELUCI (anëtarë)

DREJTOR I REVISTËS

Prof. dr. Artan HAXHI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: *Arta Bajrami*

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave Shoqërore
Tel/fax: ++399 22 43747

PASQYRA E LËNDËS

Artan HAXHI

Familjet e gjuhëve në botë

Families of languages in the world.....7

Remzi PËRNASKA

Gabriel Anseja për lashtësinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar

Gabriel Anseja on the anciency of the Albanian people and

their language.....33

Orjeta BAJA

Rreth *temës* dhe *fokusit*, si përbërës kryesorë informativë të kumtimit

Le thème et le focus, des principaux éléments de la proclamation.43

Qemal MURATI

Dukuri dhe nocione sociolinguistike të komunikimit

Sociolinguistic phenomena and notions of communication.....51

Merita HYSA

Planifikimi gjuhësor dhe efektet e globalizmit në gjuhën shqipe

Linguistic planning and the impact of globalization on the Albanian

language.....55

Anisa KOSTERI

Fjalësi i Bogdanit në Fjalorin e “Bashkimit”

Bogdani’s lexicon in the Dictionary “Bashkimi”65

Aida URUÇI

Vështrim rreth ligjërimit artistik dhe ngjyresave të mjedisit tek romani “Rrathë” i Martin Camajt.

A survey on the artistic speech and environmental coloring of the

Novel “Rrathë”, by Martin Camajt.....83

Rezearta MURATI

Mendimi i Faik Konicës për një gjuhëtë përbashkët

*The idea of Faik Konica for a common albanian language.....*93

Irida HOTI

Vështrim mbi një disiplinë të re gjuhësore

*A new linguistic discipline.....*99

Besarta QALLIAJ

Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore (sintaksore) shqipe gjatë shekullit XX

The development of the Albanian linguistic terminology (syntax) during

*the twentieth century.....*107

Alfred ÇAPALIKU

Riardhja në kohë e një libri poetik të Pipës

Updating Pipa's poetical work123

Agron XHAGOLLI

Trashëgimia folklorike shqiptare në kontekst evropian

Albanian folk heritage in European context.....127

Vinçens MARKU

Mjeshtëri përkthimore në shqip e vargut aleksandrin nga Prokop Gjerko

përmes veprës *Arti Poetik* të Nikola Bualosë

Prokop Gjerko's proficiency in translating the Alexandrian lines of the

Poetic Art, by Niccolo Bualo.....137

Valbona KARAKAÇI

Antologji e Lirikës Shqiptare, një histori e poezisë shqipe në miniaturë

Anthology of Albanian Lyric, A History of Albanian Poetry in miniature.....145

Arben PRENDI

Romaneskja e Kongolit ndërmjet estetikës realiste, moderne dhe postmoderne

The Romanesque of Kongoli between the realistic, modern and postmodern

aesthetics.....153

Alva DANI

Konotacioni dhe denotacioni në gjuhën e Camajt
në procesin e shqipërimit të disa poezive të Xhuzepe Ungaretit
*Connotation and denotation during the process of translating some poems
from Camaj by the Italian poet Ungaretti.....*167

Gëzim PUKA

Ironi postmoderne përmes ndërtekstorësisë dhe imazheve steriotipe
në dramën “Çmurosjë” të Serafin Fankos
*Postmodern irony in the inter-textual and stereotypical images of the
drama “Çmurosjë” by Serafin Fanko.....*177

Ardita HYSA

Efekti bindës i medias tek publiku
*The persuasive effect of media to the public.....*185

Pranvera SKANAJ

Problematika e pasqyrimit të lajmit fetar në të përditshmet tona
*Issues of religious news coverage in our dailies.....*193

Ardian HOTI

Një vështrim gjuhësor për median shqip në Mal të Zi
*An overview of Albanian language media in Montenegro.....*199

Sokol AXHEMI

Aspekte të zhvillimit të popullsisë së Shkodrës.
*Aspects of development of the population of Shkodra.....*207

Zemaida (KASTRATI) MOZALI

Pse duhet ta njohim dhe studiojmë bashkimin dhe integrimin evropian
*Why do I need to know and study the unification and European
Integration.....*217

Sereta KOPERAJ

Reagimet e vendeve të Ballkanit ndaj pushtimit të Shqipërisë nga Italia
(1939), në dritën e dokumenteve britanike
*Reactions of the Balkan countries to the invasion of Albania by Italy (1939), in
light of British documents.....*225

RECENSIONE:

- Anila OMARI:** Kolec Topalli, Sistemi rasor i emrave të shqipes.
Kolec Topalli, the system of noun cases in the Albanian Language.....235
- Fatbardha FISHTA:** Personaliteti dhe vepra e Mjedës në një serial monografik.
Mjeda's work and personality in a monographic serial.....241
Edhe një antologji për Ulqinin, "*Ulqin, ti kala*".
Even an anthology of Ulqin, "Ulqin, ti kala".....248
- Alfred ÇAPALIKU:** Kulturat si ura komunikimi.
Alma Hafizi. "Letërsia e kufijve". (Përqsasja
Magris - Camaj). Botimet "Camaj-Pipa". Shkodër,
2008. 184 f.
Cultures as Communicative Bridges.....252
- Tomor OSMANI:** Fletët e jetës, histori pedagogjike ndër vite,
shkruar nga Fiqiri Hoxha, Shtëpia botuese
"Camaj Pipa, Shkodër, 2010, 354 f.
*Sheets of life, teaching history over the years, written by Fiqiri
Hoxha*.....254

JETA SHKENCORE

- I. Veprimtari dhe aktivitete shkencore
Scientific activities.....257
- II. Promovim librash
Work promotions..... 267
- III. Jepet titulli "Mirënjohja e qytetit"
Given the title "Recognition of the city".....269
- IV. Leksione jashtë vendit
Lectures abroad..... 271
- V. Botime të reja të Universitetit tonë
New editions of our University Publications.....273
- VI. Shkrime të pedagogëve që janë botuar jashtë shtetit
Publications abroad.....275

Artan HAXHI

FAMILJET E GJUHËVE NË BOTË

Progreset e gjuhësisë, shoqëruar me ato të arkeologjisë e të gjenetikës, na lejojnë të japim një shpjegim më të plotë lidhur me ekzistencën e një numri kaq të madh gjuhësh në botë e kaq të ndryshme ndërmjet tyre. Studimi sistematik i gjuhëve dhe ballafaqimi i tyre ka çuar në idenë që gjuhë e grupe gjuhësh mund të kenë prejardhje nga një gjuhë stërgjyshore e përbashkët. Kësaj lidhjeje farefisnore i është dhënë emri i *familjes gjuhësore*.

Kërkimet e karakterit gjenetik të bëra mbi popullata të ndryshme nga e gjithë bota kanë çuar së fundmi në hartimin e një skeme të popullsive njerëzore duke u bazuar në të dhëna të përgjithshme. Kjo skemë është gjerësisht e krahasueshme me një skemë analoge të ndërtuar vetëm mbi të dhëna gjuhësore. Nga ana tjetër kërkimet paleoantropologjike të lidhura me origjinën e species *homo sapiens* dhe ato arkeologjike të lidhura me ndryshimet kulturore apo me migracionin, të mbështetura nga metoda të sakta të përcaktimit të kohës, kanë nxjerrë në dritë elemente të rëndësishme që bëjnë të mundur hartimin e një skeme të përgjithshme të shpërndarjes së gjuhëve në botë.

Përcaktimi i përkatësisë së gjuhëve në të njëjtën familje gjuhësore është detyrë e gjuhësisë krahasuese. Gjuhët simotra paraqesin lidhje gjenetike ose gjenealogjike ndërmjet tyre, prandaj përfshihen në të njëjtën familje gjuhësore. Nga ana tjetër familja mund të ndahet më tej në degë e grupe gjuhësh. *Përkatesia në një degë apo grup brenda të njëjtës familje gjuhësore përcaktohet duke u nisur nga risitë e përbashkëta të shfaqura në gjuhë të ndryshme. Për shembull, gjuhët e degës gjermanike kanë të përbashkëta disa tipare gramatikore dhe leksikore, të cilat mendohet që janë të ndryshme nga ato të gjuhëve proto-indoevropiane. Këto tipare mendohet të jenë risi që u realizuan në gjuhët e kësaj dege.*

Ngjashmëritë ndërmjet gjuhëve të ndryshme i kanë shtyrë gjuhëtarët të pranojnë që ato janë vazhdim i një gjuhe të vetme të përbashkët parahistorike. Kërkimet sistematike të ngjashmërive ndërmjet këtyre


gjuhëve përmes metodave krahasuese lejojnë të rindërtohen pjesët kryesore të gramatikës dhe të leksikut të kësaj protogjuhe.

Ne do të mundohemi të paraqesim një klasifikim të gjuhëve të botës (në familje gjuhësore, degë, grupe e nëngrupe gjuhësore). Hartat dhe klasifikimi i mëposhtëm bazohen mbi një literaturë të bollshme, kryesisht mbështetur në autorë prestigjiozë, si: Merritt Ruhlen, Joseph Greenberg, (Merritt Ruhlen, “*Një udhëzues i gjuhëve të botës*”, shtëpia e botimit të Universitetit Stanford, 1987) (Joseph Greenberg, *The Languages of Africa*. Indiana University, 1966), Enciklopedia britanike etj.

Nisur nga studimet në fushë të gjuhësisë krahasuese, mund të themi se gjuhëtarët kanë arritur të identifikojnë **20** familje të mëdha gjuhësore, të cilat ndahen më pas në degë e këto me pas në grupe gjuhësh, në nëngrupe e deri në gjuhë të veçanta (5 të tilla).

FAMILJA E GJUHËVE INDOEVROPIANE

Familja e gjuhëve *indoevropiane* është e përbërë nga gjuhë dhe dialekte të lidhura nga pikëpamja e gjenezës. Ajo përfshin gjuhët më kryesore të Evropës, të Iranit, të Indisë dhe gjithashtu është mbizotëruese në zonat e Anatosisë (Anadollit) dhe në Azinë Qendrore. E njohur që në periudhën e bronzit (në formën e *greqishtes mikeniane* dhe të gjuhëve *anatoliane*), ajo është mjaft domethënëse për gjuhësinë historike, pasi, pas familjes së gjuhëve *afroaziatike*, ajo është familja gjuhësore e dokumentuar më herët.



Familja e gjuhëve indoevropiane

Sipas vlerësimit etnologjik të vitit 2005, familja e gjuhëve *indoevropiane* përbëhet nga 449 gjuhë e dialekte, ku afro gjysma e tyre (rreth 219) i përkasin degës së gjuhëve *indoariane*. Gjuhët e kësaj familjeje fliten nga rreth 3 miliard folës (numri më i madh i folësve i njohur për familjet gjuhësore). Ndër 20 gjuhët bashkëkohore më të përdorura në botë, sa u takon folësve autoktonë, 12 i përkasin familjes gjuhësore *indoevropiane*. Aty bëjnë pjesë gjuhë të tilla, si: *angleze, spanjolle, hindu, portugeze, bengali, ruse, gjermane, marathi, franceze, italiane, punjabi* dhe *urdu*, duke numëruar mbi 1.8 miliard përdorues, p.sh. :

- *hindu* dhe *urdu* përdoren nga rreth 400 milion folës,
- *spanjolle* përdoret nga rreth 300 milion folës,
- *ruse* përdoret nga rreth 300 milion folës,
- *bengali* përdoret nga rreth 200 milion folës,
- *portugeze* përdoret nga rreth 200 milion folës,
- *frënge* përdoret nga rreth 100 milion folës,
- *gjermane* përdoret nga rreth 100 milion folës,
- *angleze* përdoret nga rreth 400 milion folës në Evropë dhe në Amerikë.

Ndërsa në të gjithë botën mund të thuhet se anglishten e përdorin si gjuhë të parë përafërsisht 1 miliard njerëz.

Nga kjo familje dijetarët me të drejtë kanë përjashtuar gjuhën *baske, burushaski* dhe *nahali*, të cilat, ndonëse përdoren brenda këtij territori, konsiderohen si gjuhë të veçuara dhe pa lidhje gjenetike me gjuhët e tjera indoevropiane.

Kjo familje gjuhësore përbëhet nga 10 degë:

1. Dega e gjuhëve *anatolike*. I përkasin kësaj dege disa gjuhë të përdorura në zonat e Anatólisë (Anadollit) në kohë shumë të vjetra, si: *hetitishite, luvio* (e shkruar me shkrimin kuneiform dhe atë hieroglifik), *palaike, licio, pisidiane, lidio, kario*. Është dega më e hershme e vërtetuar me shkrim. Ekzistojnë dokumente të veçuara nga burimet e vjetra asiriane, që datojnë aty nga shekulli XIX para erës sonë apo disa tekste *hitite* të shekullit XVI para erës sonë¹. Kjo zonë në kohën e Aleksandrit të Madh u pushtua dhe u helenizua tërësisht, çka bëri që deri aty nga shekulli I para erës sonë gjuhët amtare të folura në këto territore të zhdukeshin tërësisht, si: *palaike* (shuar në shekullin XIII para erës sonë), *kariane* (shuar në shekullin III para erës sonë), *licio* dhe *lidio* (të shuara në

¹ Le lingue indoeuropee, Mulino, f. 197.

shekullin I para erës sonë). Kjo është dega e parë e njohur gjuhët e së cilës janë zhdukur.



Perandoria Hittite në shtrirjen e saj më të madhe nën sundimin e Suppiluliumës I (c.1350-1322) dhe Mursilit II (c.1321-1295).



Zona ku flitej gjuha luvio



Zona ku u folën gjuhët anatoliane më të vona

2. Dega e gjuhëve **helenike (greke)**. Është dega më e njohur dhe e dyta për nga vjetërsia (pas degës *anatolike*). Është e dokumentuar në shkrim

që herët. Kemi fragmente të regjistruara në *greqishten mikeniane* (me shkrim silabik Linear B) nga fundi i shekullit XV - fillimi i shekullit XII para erës sonë apo traditat homerike, që datojnë në shekullin VII para erës sonë. Sipas klasifikimeve më tradicionale, ajo është degë e familjes gjuhësore *indoevropiane* që përfshin vetëm gjuhën greke² (në kontekste të tjera "*helenik*" dhe "*grek*" janë përdorur si sinonime). Por nga disa dijetarë në këtë grup është propozuar të jetë edhe gjuha e lashtë *maqedonase*, njohuritë për të cilën janë tepër të pakta (prandaj edhe shkalla e afritë së saj me greqishten nuk është e njohur mirë). Në këtë kontekst sugjerimi i një grupi "*helenik*" me dy degë mbështet idenë se *maqedonishtja e lashtë* nuk ishte thjesht një dialekt grek, por një "*gjuhë motër*" jashtë grupit të dialekteve të njohura të kësaj gjuhe³. Gjë që mbetet për t'u vërtetuar.

3. Dega e gjuhëve *indoiraniane*. Gjuhët e kësaj dege janë të folura në një hapësirë të gjerë që përfshin Iranin, Afganistanin e Taxhikistanin, si dhe në disa zona ku banojnë pakica gjuhësore (në disa pjesë të Jugut të ish-Bashkimit Sovjetik, të Turqisë, Sirisë, Irakut, Pakistanit, në disa territore të vogla të Omanit dhe të Kinës perëndimore). Studiuesit mendojnë se gjuhët e kësaj dege kanë prejardhje të përbashkët nga gjuha *proto-indoiraniane*. Gjuhët më të njohura e më të vjetra janë *avestishtja*, *persishtja e vjetër* (që dokumentohen me pak shkrime dhe që përdorin një sistem shkrimi kuneiform, përkatësisht një alfabet shumë të përpunuar, thuajse fonetik) dhe *indishtja antike* (gjuha *vedike*, *sanskritishtja* dhe gjuhët *prākṛiti*⁴), që shoqërohet me një korpus letrar të gjerë e të shumëllojtë, shkruar me një shkrim të qartë thuajse fonologjik.

² **Browning** (1983), *Medieval and Modern Greek*, Cambridge: Cambridge University Press.; **Joseph, Brian D.** and **Irene Philippaki-Warburton** (1987): *Modern Greek*. London: Routledge, f. 1.

³ **B. Joseph** (2001): "Ancient Greek". In: J. Garry et al. (eds.) *Facts about the World's Major Languages: An Encyclopedia of the World's Major Languages, Past and Present*. ([Online Paper](#)).

⁴ *prakṛiti* - (sanskrit: प्राकृत *prākṛta*) është emri i një grupi gjuhësh *indoariane*, që rrjedhin nga dialekte të vjetra *indike*. Kjo fjalë, që rrjedh nga rrënja indiane "*parikrit*", në vetvete ka një përkufizim fleksibël, ndonjëherë të ngjashëm me domethënien "*origjinal, i natyrshëm, normal, i zakonshëm*" apo edhe "*gjuhë e folur*" e ndonjëherë me domethënien "*që rrjedh nga diçka origjinale*". *Prakṛiti* u bë gjuhë letrare, përgjithësisht e mbrojtur nga mbretërit dinastisë Kshatriya. Dokumenti më i hershëm i shkruar është korpusi me shkrime të Asoka-s (perandor i Indisë).

Gjuhët *indo-iraniene* bashkëkohore formojnë degën që ka numrin më të madh të folësve në familjen e gjuhëve *indoevropiane* (me më shumë se një miliard folës) dhe, në të njëjtën kohë, është edhe një nga degët me shtrirjen më të madhe gjeografike, duke shkuar nga Evropa (Rumani) dhe Kaukazi (Oseti) deri në Xinjiang dhe Asam në lindje dhe në jug deri në Sri Lanka. Në një vlerësim të vitit 2005 janë numëruar rreth 308 gjuhë e varietete gjuhësh. Gjuhët më të mëdha sa u takon folësve nativë janë: gjuhët *hindustani* (*hindu* dhe *urdu*, me 540 milionë përdorues), *bengali* (me 260 milionë përdorues), *punjabi* (me 100 milionë përdorues), *marathi* dhe *perse* (me nga 100 milionë përdorues secila), *guxharati* (me 45 milionë përdorues), *kurdish* (me 40 milionë përdorues), *pashto* (me 35 milionë përdorues), *orija* (me 30 milionë përdorues), *sind'hi* (me 20 milionë përdorues) dhe *maithili* (me 15 milionë përdorues).

Përbëhet nga disa grupe:


- a. Grupi i gjuhëve *iraniene*, janë gjuhë të folura nga banorët e Iranit. Gjuhët më të vjetra të dokumentuara me shkrim janë *persishtja e lashtë* (janë disa mbishkrime të gjetura në Behistun, që datojnë aty nga viti 520 para erës sonë) dhe *avestishtja* (disa mbishkrime të vitit 1000 para erës sonë). Mund të numërohen 87 gjuhë që i përkasin këtij grupi, me rreth 150 - 200 milionë përdorues. Kështu, *persishtja* ka rreth 65 milionë folës nativë, gjuha *pashto* ka rreth 40 milionë, gjuha *kurde* rreth 40 milionë, gjuha *lurish* rreth 3.3 milionë dhe gjuha *baluchi* rreth 7



milionë⁵.

⁵ **Gordon, Raymond G., Jr.** (2005). "Report for Iranian languages". *Ethnologue: Languages of the World* (Dallas: SIL International).

- b. Grupi i gjuhëve *indoariane*, të vërtetuara aty nga fundi i shekullit XV dhe fillimi i shekullit XIV para erës sonë me disa tekste *mitanni*,⁶ që tregojnë gjurmët e gjuhëve *indoariane*, me mbishkrime nga shekulli III para erës sonë në formën e *prākritit* (dekrete e ashoka), me disa *rigveda*⁷ që mendohet të jenë ruajtur si regjistrime të paprekura në gjuhën e folur, që datojnë rreth gjysmës së mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, të shkruara në gjuhë *vedike* (gjuhën e vedave). Rreth viteve 500 para erës sonë u kodifikuan në gramatikën e Pāninit, si *sanskritishte* klasike. Në një studim të vitit 2005 janë numëruar një total prej rreth 209 gjuhësh e varietetesh që përbëjnë këtë grup me një numër total prej më shumë se 900 milionë folës. Gjuhët me numrin më të madh të folësve nativë ka rezultuar të jenë: gjuhët *hindustani* (*hindi standard* dhe *urdu* me rreth 540 milionë), *bengali* (me rreth 260 milionë), *punjabi* (rreth 100 milionë), *marathi* (rreth 100 milionë), *guxharati* (rreth 45 milionë), *orija* (rreth 30 milionë), *nepali* (rreth 20 milionë), *sind'hi* (rreth 20 milionë), *sinhala* (rreth 16 milionë), *saraiki* (rreth 14 milionë) dhe *asameze* (rreth 14 milionë).



⁶ *mitanni* - një shtet i organizuar në mbretërinë e quajtur Mitanni në Mesopotaminë veriore (e shtrirë në hapësirën ndërmjet Sirisë veriore dhe Anolisë jug-lindore), i populluar nga një popullsi të quajtur *hurrian* (*khurrites*) aty nga 1500 p.e.s. - 1300 p.e.s.. **Hurrian** është edhe emri tradicional për gjuhën e kësaj popullsie.

⁷ *rigveda* - është një koleksion i lashtë i shkrimeve të shenjta indiane (himneve vedike sanskrite). Radhitet ndërmjet katër shkrimeve të shenjta kanonike (*śruti*) të hinduizmit, të njohura si veda.

- c. Grupi i gjuhëve **dardike**, përbëhet nga gjuhë të folura në Veri të Pakistanit, në Lindje të Afganistanit dhe në rajonet veriperëndimore të Indisë (Jammu e Kashmir). Krijimi më i vjetër letrar që përmendet është ai i poetit mistik të shekullit XIV, Lallesvari, nga Kashmiri. Ky grup gjuhësh tradicionalisht ka pësuar një ndikim të fortë nga gjuhët *nuristani* dhe nga disa gjuhë të tjera të folura në Iranin lindor, gjë që i ka shtyrë disa studiues që të besojnë se gjuhët *nuristani* (një grup i gjuhëve që fliten në verilindje të Afganistanit), duhen përfshirë në grupin e gjuhëve **dardike**. Megjithatë mendimi më i përgjithshëm është se kemi të bëjmë me një grup të pavarur ⁸, i cili ka këto nëndarje:

- Gjuhët **pashai** (që përfshin vetëm gjuhën *pashai*);
- Gjuhët **kunar** (që përfshin gjuhët *gavar-bati*, *dameli*, *shumashti*, *nangalami* dhe *grangali*);
- Gjuhët **çitral** (që përfshin gjuhët *khovar* dhe *kalasha*);
- Gjuhët **kohistani** (që përfshin gjuhët *kalami*, *torvali*, *kalkoti*, *indus kohistani*, *bateri*, *çilisso*, *govro*, *votapuri-katarqalai* dhe *tirahi*);
- Gjuhët **shina** (që përfshin gjuhët *shina*, *brokskad*, *ushojo*, *domaaki*, *palula* dhe *savi*);
- Gjuhët **kashmiri** (që përfshin gjuhët *kashmiri*, *poguli*, *rambani* and *kishtvari*).

Me përjashtim të gjuhës *kashmiri*, e cila është gjuha më e njohur e këtij grupi, me një traditë të konsoliduar letrare dhe e njohur zyrtarisht si gjuhë kombëtare e Indisë, të gjitha gjuhët e tjera **dardike** janë gjuhë të vogla, gjuhë të pakicave, të cilat nuk janë studiuar sa duhet, mbasi në shumë raste ato janë folur në zona të vështira (për shkak të terrenit malor apo konflikteve të armatosura në rajon).

- d. Grupi i gjuhëve *nuristani*. Gjuhët e këtij grupi janë përdorur nga banorë të fiseve të ndryshme kryesisht në një rajon të izoluar e tejet malor të Hindukushit (zonë e vendosur përgjatë kufirit verilindor të Afganistanit) dhe në një pjesë në veriperëndim të Pakistanit. Emri i vjetër për rajonin ishte Kafiristan dhe gjuhët quheshin ndryshe edhe *kafiri* ose *kafiristani*.

Gjuhët e këtij grupi nuk kanë gjetur vëmendjen e gjuhëtarëve perëndimorë për t'u bërë objekt studimi nga ana e tyre, ato nuk janë

⁸ **Morgenstierne, G.** Die Stellung der Kafirsprachen. In Irano - Dardica, Wiesbaden, Reichert, 1975, f. 327-343.

përmendur në literaturën shkencore deri në shekullin XIX, duke munguar edhe një klasifikim i tyre. Edhe klasifikimet e bëra më vonë mbetën në kuadrin e hipotezave dhe më tepër mbështeteshin në argumente dhe të dhëna gjeografike, se sa në argumente gjuhësore, duke i klasifikuar gjuhët *nuristani* herë në grupin e gjuhëve *dardike* dhe herë në grupin e gjuhëve *iraniane*. Ndërsa, pas studimeve të Georg Morgenstierne (1973, 1975)⁹, ato konsiderohen si një grup më vete në degën e gjuhëve *indoiraniane*.

Grupi i gjuhëve *nuristani* numëron pesë gjuhë në përbërjen e tij, si: *askunu* (ose *ashkun*, me rreth 2 000 folës), *kamkata-viri* (ose *bashgali*, që përfshin dialektet *kata-vari*, *kamviri* dhe *mumviri* dhe përdoret nga rreth 24 200 folës), *vasi-vari* (ose *prasuni*, me rreth 2 000 folës), *tregami* (ose *gambiri* me rreth 1 000 folës), *kalasha-ala* (*vaigali*, me rreth 2 000 folës). Të gjitha këto gjuhë janë të rrezikuara me zhdukje, mbasi shumë folës të tyre po përdorin përherë e më shumë në jetën e tyre të përditshme gjuhë të tjera, si: *pashto*, *persiane* (dy gjuhët zyrtare të Afganistanit) dhe *çitrali* (në Pakistan), shpesh duke bjerrë traditat dhe gjuhën amtare.



Afganistani (me të kuqe Nuristani)

⁹ **Morgenstierne, G.** Irano-Dardica. Wiesbaden 1973; Morgenstierne, G. Die Stellung der Kafirsprachen. In Irano-Dardica, f. 327-343.

4. Dega e gjuhëve **italike**, në të cilën bëjnë pjesë *latinishtja* (*latinishtja arkaike* dhe *falisko*¹⁰, vërtetuar me shkrim që nga shekulli VI – III para erës sonë) e më pas me një krijimtari të bollshme në latinishten klasike dhe në gjuhët e tjera italice (të dokumentuara përmes përshkrimeve të shkurtëra të Poggio Sommovilla-s që nga shekulli VII para erës sonë). Vijuese të latinishtes së folur janë të ashtuquajturat gjuhë *romanze* (*romane*) *mesjetare* dhe *moderne*, që fliten në një territor të gjerë, nga Portugalia deri në Rumani. Këtu mund të përfshihen gjuhë (apo dialekte) të tilla, si: gjuhët *italo-romanze* (*italiane, emiliano-romanjole, friuliane, istriane, napoletane, siciliane, venete*), gjuhët *galo-romanze* (*ligure, lombarde, franceze, franko-provenzale, piemonteze, reto-romançe*), gjuhët *ibero-romanze* (*aragonese, asturiane, estremadurese, spanjole kastiliane, katalane, guaskone, oçitane, galiciane, portugeze, mozarabike*), gjuhët *korsikane, sarde* dhe *ajo rumune*.



5. Dega e gjuhëve **kelte** (shqiptohet /kɛltɪk/ ose /sɛltɪk/), përfshin gjuhë që rrjedhin nga proto-keltishtja. Termi “kelt” është përdorur për herë të parë nga Edward Lhuyd më 1707. Gjuhët e këtij grupi fliteshin në një hapësirë të gjerë të Evropës në mijëvjeçarin e parë para erës sonë, nga Gadishulli Iberik, përmes Gjermanisë jugore në luginën e lumit Po dhe në Austri deri në ultësirën danubiane, bile edhe në

¹⁰ *falisko* - gjuhë që flitej nga një popullsi antike italice që banonte pranë maleve Cimini, ndërmjet territorit të etruskëve dhe latinëve. Sot i përket zonës së Montefiascone-s (qytezë në provincën e Viterbo-s).

Anatolinë qendrore. Këto gjuhë janë të dokumentuara aty nga fillimi i shekullit VI para erës sonë (të njohura mbishkrimet *gaulish/galike*¹¹). Sot ato kanë një përhapje të kufizuar në disa zona në periferi të Evropës perëndimore, sidomos në Uells, Skoci, Irlandë, Gadishullin Brittany (në Francë), në Cornwall dhe në Ishullin Man (Isle of Man). Flitet edhe në vende të ndryshme të Amerikës veriore e të asaj jugore nga emigrantët që i përdorin këto gjuhë. Në të gjitha këto zona, gjuhët *kelte* tani fliten vetëm nga pakicat dhe në shumë vende kemi situata bilinguizmi, si: në Patagoni dhe në Argjentinë (*galikja / spanjishtja*) apo në Skocinë e re në Kanada (*galikja skoceze / anglishtja*) etj.. Dallohen dy grupe kryesore :

- a. Grupi i gjuhëve *kelte kontinentale* (shekulli III para erës sonë – shekulli III pas erës sonë) me disa mbishkrime në gjuhën *galike, lepontike, keltiberike* etj.
- b. Grupi i gjuhëve *kelte ishullore*, që përfshin gjuhët e folura në ishujt britanikë dhe ndahet në dy nëngrupe:
 - Nëngrupi *galik* (ndryshe *goidelik* ose *irlandez*), ku përfshihen gjuha *irlandeze* që flitet në Irlandën perëndimore, gjuha *galike* e Skocisë, e folur kryesisht në Skocinë perëndimore dhe gjuha *manks*, një gjuhë galike e përdorur në Ishullin Man (tashmë e vdekur);
 - Nëngrupi *britonik (britanik)*, që përfshin gjuhët e folura në Britaninë e Madhe dhe në Bretaninë (gjuhët *galeze, bretone* dhe *kornike* - e shuar).
6. Dega e gjuhëve *gjermanike* (që rrjedhin nga *proto-gjermanishtja*, e njohur edhe si gjermanishtja e përbashkët, e folur afërsisht aty nga gjysma e mijëvjeçarit të parë para erës sonë në Epokën e Hekurit të Evropës veriore. Këto gjuhë dëshmohen relativisht herët përmes mbishkrimeve të hershme *runike* (shekulli III i erës sonë), tekstet në gjuhën *gotike* në përkthimet e Biblës (shekulli IV i erës sonë), dorëshkrimeve në gjuhën e vjetër *angleze* (shekulli 8 i erës sonë) etj.. Kjo degë ndahet në tre grupe kryesore, nga të cilët njëri rezulton tashmë i zhdukur:
 - a. Grupi i gjuhëve *gjermanike veriore* (ose *skandinave*): *daneze, norvegjeze (bokmal, nynorsk), suedeze, islandeze e feringio*;

¹¹ *gaulish* - (ndryshe edhe *gal*) është një gjuhë e zhdukur e degës kelte e përdorur nga Galët nga epoka e hekurit deri në periudhën romake. Ajo ishte folur historikisht në territoret ku shtrihet sot Franca, Zvicra, Belgjika lindore, Luksemburgu dhe Gjermania perëndimore, para se të zëvendësohej me latinishten vulgare dhe gjuhët gjermanike.

- b. Grupi i gjuhëve **gjermanike perëndimore**: *angleze, frisiane, hollandeze e gjermane*;
- c. Grupi i gjuhëve **gjermanike lindore**, grup i përbërë nga gjuhë tashmë të shuara, si: *gotishtja* (gotët¹² emigruan aty nga fillimi i erës së re nga Gadishulli Skandinav drejt kontinentit) apo gjuhët e përdorura nga tribu me prejardhje nga pjesa jugore e Gadishullit Skandinav, si: *erulët, burgundët, vandalët, gepidët*, të cilët emigruan drejt zonave jugperëndimore në shekujt e parë të erës sonë.



Gjuhët gjermanike veriore

- Skandinave lindore;
- Skandinave perëndimore;
- Vija ndarëse në mes të gjuhëve gjermanike veriore dhe atyre perëndimore.

Gjuhët gjermanike perëndimore

- Dutch (daç, hollandisht) - frankoniane e ulët, gjermanike perëndimore;
- Gjermanishte e ulët - gjermanike perëndimore;
- Gjermanishte qendrore - gjermanishte e lartë, gjermanike perëndimore;

¹² *got* - nga toponimi suedez *Göta – land* dhe emri i ishullit *Got-land* në Balltik.

- █ Gjermanishte e epërme (gjermanishte e lartë, gjermanike perëndimore);
- █ Anglisht – anglo-frisiane, gjermanike perëndimore;
- █ Frisiane - anglo-frisiane, gjermanike perëndimore.

7. Dega e gjuhëve **armene** (shqiptohet në armenisht: [h a j ε r ε n]-*hayeren*), përbëhet vetëm nga *armenishtja*, gjuhë e folur nga populli armen. Ajo është gjuha zyrtare e Republikës së Armenisë dhe flitet gjithashtu edhe në rajonin e Nagorni-Karabak, në disa territore të Turqisë apo në një enklavë gjuhësore në Iranin veriperëndimor. Për shkrimin e kësaj gjuhe përdoret alfabeti armen. Studimi i saj paraqet interes të veçantë, sidomos sa u takon zhvillimeve fonologjike si gjuhë indoevropiane¹³.

Është një gjuhë e dokumentuar në shkrim relativisht herët, që nga fillimi i shekullit V të erës sonë me përkthimin në *armenishten klasike* të Biblës e më pas të teksteve të tjera ekleziastike apo shkollore siriane dhe greke.

Leksiku i kësaj gjuhe është ndikuar më shumë nga disa gjuhë *iraniane të mesme* (veçanërisht gjuha *parthiane*) dhe në një masë më të vogël nga gjuha *greke, latine, frëgjishtja e vjetër, persishtja, arabishtja, turqishtja* etj..

Armenishtja e sotme ka dy forma të standardizuara (*armene lindore* dhe *armene perëndimore*), së bashku me disa dialekte bashkëkohore, të cilat janë reciprokisht të kuptueshme.

Mendimi më i përgjithshëm i gjuhëtarëve ka qenë se gjuha armene përbën një familje më vete. Disa të tjerë, mendojnë se *armenishtja, greqishtja, frigishtja* dhe gjuhët e grupit *indoiranian*, meqenëse (sidomos *armenishtja* dhe *greqishtja*) paraqesin një numër të madh risish, duhet të përfshihen në të njëjtë familje gjuhësore. Ndërsa, kohët e fundit, disa studiues kanë propozuar edhe një lloj grupimi tjetër, që sheh në të njëjtën familje gjuhën *greke, shqipe, frigiane* dhe atë *armene*¹⁴. Gjithsesi këto janë mendime që kanë mbetur në nivelin e hipotezave.

8. Dega e gjuhëve **tokariane** (*tokarishtja*, në greqishten e lashtë: *τόχαροι, τόκharoi*) është një degë e shuar e familjes gjuhësore indoevropiane e përbërë nga dy gjuhë (emrat e të cilave, në mungesë të emërtimeve

¹³ Benjamin W. Fortson, John Wiley and Sons, (2009), *Indo-European Language and Culture: An Introduction*, f.383

¹⁴ *po aty*, f. 383.

originale, dijetarët i kanë shënuar konvencionalisht *tokarishte A* dhe *tokarishte B*). Kjo degë gjuhësore e ka marrë emrin nga një popullsi që banonte në pellgun e lumit Tarim në Azinë qendrore, në atë zonë ku aktualisht është rajoni kinez i Xinjiangut. Popullsia që i fliste këto gjuhë është identifikuar (ndoshta edhe gabimisht) me emërtimin *tokaroi*, sipas burimeve greke (shih Straboni te *Gjeografia* dhe Ptolemeu - VI, 11, 6), apo edhe me emrin *ithagurë*, *yuezhi* apo *kushans*. Ndërsa termi *Tokaristan* (emërtimi për vendin) zakonisht i referohet mijëvjeçarit të parë për vendin e quajtur Baktria ¹⁵.

Ekzistenca e tokarishtes u zbulua rastësisht aty nga fillimi i shekullit XX gjatë gërmimeve arkeologjike të bëra nga dijetari Aurel Stein në



Baseni ujëmbledhës Tarim

qytetet Turfan dhe Karasahr (të njohura më parë si Agni) që ndodheshin në pjesën lindore të rajonit. Aty u zbuluan fragmente dorëshkrimesh të shkruara (aty nga shekulli VII e VIII, ndoshta disa edhe më të vjetra) mbi fletë palme, tabela druri ose letër kineze në një gjuhë deri atëherë të panjohur, por që sipas studimeve të mëvonshme rezultoi të ishte një degë e familjes indoevropiane, quajtur *tokarishte* (*tokarishtja A*). Alfabeti i përdorur ishte i afërt me alfabetin silabik indiano-verior

¹⁵ *Bakria* - Rajon historik në Azinë Qendrore, i vendosur ndërmjet vargmaleve të [Hindu Kush](#) dhe [Amu Daryas](#)

brahmi (quajtur "*brahmi obliquo*"), ndonëse ndeshen edhe disa dorëshkrime të shkruara me alfabetin *manik*¹⁶.

Shpejt u vu re që një pjesë e madhe e dorëshkrimeve ishin përkthime nga *sanskritishtishtja* të veprave budiste të njohura (mendohet se tokarët i përkisnin fesë budiste), bile disa prej këtyre dorëshkrimeve ishin edhe bilingue (dygjuhëshe), çka lehtësoi përkthimin e tyre. Kurse interpretimi u bë nga dy dijetarë, Emil Sieg e Wilhelm Siegling (në vitin 1908), të cilët vërtetuan se ndodheshim në prezencën e dy gjuhëve indoevropiane që i përkasin dy drejtimeve të ndryshme të saj, gjuhës *sanskrite* (satem) dhe asaj *tokarike* (kentum).

Kurse dorëshkrimet në *tokarishte B* (vepra me karakter fetar, por edhe dokumente administrative) u gjetën si në qytetet lindore, ashtu edhe në qytetin e Kushës, të vendosur në pjesën perëndimore të rajonit (prandaj nga studiuesit ajo quhet ndryshe edhe *tokarishte perëndimore*).

Tokarishtja mendohet të jetë shuar aty rreth viteve 840, kur ujurët¹⁷ të dëbuar nga Mongolia prej kirgizëve, u tërhoqën dhe pushtuan zonat përreth brigjeve të lumit Tarim të banuara nga popullsia tokare. Sundimi ujur solli asimilimin e popullsisë tokare dhe shuarjen e *tokarishtes*, duke e zëvendësuar me *tuqishten e vjetër (uighur khaganate)*¹⁸.



¹⁶ Daniels, Peter (1996) *The Worlds Writing Systems*, f. 531. - Campbell, George (2000) *Compendium of the Worlds Languages Second Edition: Volume II Ladkhi to Zuni*, f. 166.

¹⁷ *Perandoria Uighure* ose *Ujgure* ishte një perandori që u zhvillua për rreth një shekull (shekulli VIII – IX). Emërtimi për këtë perandori vjen nga gjuha kineze dhe do të thotë "nëntë klanet".

¹⁸ Le lingue indoeuropee, Mulino, f. 50.

*Tabletë druri me një mbishkrim në tokarishten B në formën e saj Brahmike, shekulli V-VIII
(Tokio - Muzeu Kombëtar)*

9. Dega e gjuhëve **balto-sllave**, për të cilën pjesa më e madhe e indoevropianistëve mendon se formon një pjesë filogjenetike. Gjuhët e kësaj dege fliten nga rreth 240 milionë njerëz, sidomos në Evropën qendrore, lindore dhe atë jugore. Gjuhët **balltike** dhe ato **sllave** bashkëndajnë shumë karakteristika të përbashkëta (qoftë leksikore, qoftë morfosintaksore), çka i ka bërë shumë dijetarë t'i grupojnë në të njëjtën degë. Shumë gjuhëtarë kanë shprehur opinione të ndryshme lidhur me burimin e këtyre karakteristikave. Disa prej tyre (August Schleicher, Oswald Szemerényi dhe pasues të tyre) janë të mendimit që këto karakteristika të përbashkëta duhet ta kenë burimin tek një paraardhës i njëjtë i këtyre gjuhëve, *proto-balto-sllavishtja*. Disa të tjerë (Antoine Meillet dhe pasuesit e tij) besojnë se këto karakteristika të përbashkëta duhet të jenë pasojë e kontakteve intensive ndërmjet gjuhëve të të dy grupeve në një periudhë që përkon me ndarjen e tyre nga indoevropianishtja e përbashkët.

Dega e gjuhëve **balto-sllave** është një degë hipotetike e rindërtuar, e cila përbëhet nga dy grupe: grupi i gjuhëve **balltike** dhe grupi i gjuhëve **sllave**.

a. Grupi i gjuhëve **balltike**, përbëhet nga gjuhë që fliten kryesisht në lindje dhe juglindje të Detit Balltik në Evropën veriore (ka edhe gjuhë të tilla si: gjuha *estone* dhe ajo *livone*, që ndonëse fliten në rajonet e Balltikut, nuk i përkasin këtij grupi, por janë gjuhë *ungro-fine*). Ato janë të vërtetuara në shkrim që nga shekulli XIV pas erës sonë në formën e *prusishtes antike* (e vdekur), që ndiqet më pas nga dy gjuhë të Balltikut lindor (*lituanishtja* e *letonishtja*) të dokumentuara në shekullin XVI. Dokumenti më i vjetër i njohur deri tani është epigrami i Basileusit – 1369 (dy rreshta të shkruara në gjuhën antike *prusiane*). Po kështu në *prusishten antike* është edhe Fjalori i Elbing-ut (mendohet të jetë i fundit të shekullit XIII e fillimit të shekullit XIV). Gjuhët e këtij grupi zotërojnë tipare arkaike të pazakonta, të cilat studiues të ndryshëm ua atribuojnë veçorive përkatëse të *proto-indoevropianishtes*. Ndahet në dy nëngrupe:

- Nēngrupin e gjuhëve *balltike perëndimore*, që përmbajnë vetëm gjuhë të vdekura, (*prusishten e vjetër*, *galindio*, *jatvingio* (ndryshe *sudave*) dhe *skalvike*).
- Nēngrupin e gjuhëve *balltike lindore*, që përmban disa gjuhë të shuara (*kurone e vjetër*, *selonike*, *semigalike*) dhe disa gjuhë të

gjalla, si: *lituanisht* (me afërsisht 3.9 milionë folës, me një dialekt të quajtur *samogizio*) dhe *letonisht* (2 milionë folës, me një dialekt të quajtur *latgalian*), por edhe gjuhën *kurlandeze moderne* që është një gjuhë në zhdukje e sipër (më 2004 kishte vetëm 8 folës).

Shumica e këtyre gjuhëve mendohet të jenë shuar aty rreth shekujve XVI dhe XVII.

Edhe pse të lidhura gjenetikiisht gjuhët e këtij grupi (sidomos *lituanishtja*, *letonishtja* dhe *prusishtja e vjetër*), kanë ndryshime të thella mes tyre (sidomos në fushë të leksikut) dhe nuk janë reciprokisht të kuptueshme. *Prusishtja e vjetër* (tashmë e zhdukur), është konsideruar si gjuha *balltike* më arkaike, ndërsa nga gjuhët e gjalla, mendohet që *lituanishtja* të jetë një nga më arkaiket dhe më konservatoret në familjen e gjuhëve *indoevropiane*. Ajo është shumë më arkaike se *letonishtja*, e cila ka pësuar ndikime të shumta nga *gjermanishtja* apo nga gjuhët *skandinave* dhe ajo *ruse*.



Shpërndarja e gjuhëve balltike



Fiset balltike në vitin 1200 pas erës sonë

- b. Grupi i gjuhëve *sllave*, (rrjedhin nga *proto-sllavishtja*) përbëhet nga gjuhë që fliten nga më shumë se 300 milion njerëz që jetojnë në Evropën qendrore e atë lindore dhe në Ballkan, si dhe nga një grup i madh emigrantësh në botë. Disa prej këtyre gjuhëve kanë në përdorim alfabetin latin të plotësuar me shenja diakritike (nëngrupi i gjuhëve *sllave përëndimore*, gjuha *sllovene* dhe ajo *kroate*), të tjera gjuhë përdorin alfabetin cirilik (nëngrupi i gjuhëve *sllave lindore*, *serbishtja* dhe *bullgarishtja*), me ndryshime të vogla në mes tyre.



Harta e gjuhëve sllave në Evropë

Gjuhët e këtij grupi janë vërtetuar me shkrim aty nga shekulli IX pas erës sonë përmes teksteve të hershme kishtarë sllavë (shkruar me shkronjat e alfabetit të lashtë sllav), në një gjuhë të njohur ndryshe edhe si *sllavishtja e lashtë ekleziastike* (gjuha e kishës ortodokse sllave). Mbivendosja e kësaj sllavishteje shpesh bëhej në kurriz të dialekteve lokale. Lockwood, një indoevropianist i shquar, pohonte :

*"sllavishtja e lashtë ekleziastike ka mbetur në përdorim deri në kohët moderne, por ka qenë e ndikuar gjithnjë e më shumë nga gjuhët e gjalla dhe në evolucion e sipër, në mënyrë që të mund të dallohen varietetet bullgare, serbe dhe ruse. Përdorimi i një mjete të tillë të komunikimit pengoi zhvillimin e gjuhëve lokale për qëllime letrare dhe përpjekjet e para u bënë në një stil të përzier."*¹⁹

Pavarësisht pse sllavishtja e lashtë ekleziastike thuhet se kishte mbytur letërsinë gojore popullore, nga ana tjetër ajo favorizoi aktivitetin letrar sllav dhe promovoi pavarësinë gjuhësore nga ndikimet e jashtme të gjuhëve të tjera. Vetëm tradita letrare gojore kroate u përafraua në atë kohë me *sllavishten ekleziastike*. Kjo traditë filloi me të ashtuquajturin Kodi Vinodol dhe ka vazhduar gjatë periudhës së Rilindjes deri në kodifikimin e gjuhës kroate më 1830, edhe pse një pjesë e madhe e literaturës ndërmjet viteve 1300 dhe 1500 është shkruar në të njëjtin stil të përzier që mbizotëronte në

¹⁹ **W.B. Lockwood** (1969), Indo-European philology: *Historical and comparative* (Hutchinson univ. library: Modern languages), f. 193.

Rusi dhe në vendet e tjera. Dokumenti më i rëndësishëm i fillimeve të letërsisë kroate është pllaka e Bashkas²⁰ (fundi i shekullit XI).

Edhe pse gjuhët sllave rrjedhin nga një proto-gjuhë e përbashkët (proto-sllavishtja), ka dallime të mjaftueshme në mes të dialekteve dhe gjuhëve të ndryshme sllave, saqë shpesh është shumë i vështirë komunikimi midis folësve të tyre. Brenda gjuhëve të veçanta, dialektet mund të ndryshojnë pak (dialektet e *rusishtes*) ose të paraqesin ndryshime të mëdha (dialektet e sllovenishtes).

Gjuhët e këtij grupi ndahen më tej në nëngrupe gjuhësore:

- Nëngrupi i gjuhëve *sllave lindore*, me gjuhë të tilla, si: *ruse*, *bjelloruse*, *ukrahinase* dhe *rutene*²¹;
- Nëngrupi i gjuhëve *sllave perëndimore*, që përbëhet nga gjuhët: *çeke*, *sllovake*, *lekitike* (përfaqësuar nga gjuha *polake*, *kashiubo* dhe *polabe* - shuar në vitet 1700); *sorabe* (*inferiore* e *superiore*) dhe *slovinze* (shuar në fillimet e 900-ës);
- Nëngrupi i gjuhëve *sllave jugore*, me gjuhë të tilla, si: *sllovene*, *serbe*, *kroate*, *malazeze*, *maqedone* dhe *bullgare*.

10. Dega e gjuhës *shqipe*, përbëhet vetëm nga gjuha *shqipe*. Ajo është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit, por e vërtetuar në shkrim relativisht vonë. Dokumenti i parë i takon shekullit XV (*Formula e Pagëzimit – 1462*), ndërsa libri i parë daton në shekullin XVI ("*Meshari*" i Gj. Buzukut – 1555). Është një gjuhë që flitet nga mbi 7 milionë njerëz kryesisht në Shqipëri, në Kosovë, në Mal të Zi, në Maqedoni, por ka edhe komunitete etnike shqiptare në rajonet e tjera të Evropës dhe të pjesëve të Ballkanit, si: në Greqi, Turqi, Bullgari apo edhe grupet e diasporës në Itali (Arbëreshë) etj.. Ka hipoteza të ndryshme lidhur me prejardhjen e saj. Dijetarë të ndryshëm janë të prirur ta shohin këtë gjuhë edhe si pasardhëse të *trakishtes* apo të *dakomizishtes* (një gjuhë e rindërtuar e hapësirës ballkanike lindore)²². Ndërsa, deri më sot, teza

²⁰ *pllaka e Bashkas* - është një tabelë e madhe guri e gjetur në kishën e vogël të Shën Luçisë në ishullin e Veglias (sot në Kroaci), që përmban një tekst të shkruar kryesisht në dialektin *čakav* (një dialekt i gjuhës kroate) me alfabetin glagolitik kroat.

²¹ *Gjuha ruten*, e quajtur ndryshe edhe "*russin*" (русин, Rusin) bën pjesë në nëngrupin e gjuhëve sllave lindore (së bashku me gjuhën *ruse*, *bjelloruse* dhe *ukrahinase*) dhe paraqet afri me gjuhën e *ukrahinase*. Kjo ka bërë që të ketë polemika ndërmjet gjuhëtarëve nëse kjo gjuhë është një gjuhë më vete apo thjesht një variant i gjuhës *ukrahinase*.

²² **Sh. Demiraj**, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 147.

më e pranueshme nga studiuesit është ajo e Gustaw Mayer-it²³, sipas së cilës gjuha *shqipe* paraqet një fazë të evoluar të *ilirishtes antike* ose më saktësisht të një prej dialekteve antike *ilire*.

Përveç këtyre 10 degëve të gjuhëve të renditura më sipër, studiuesit theksojnë se kanë ekzistuar edhe disa gjuhë pak të njohura, tashmë të zhdukura, si:

- Gjuha *ilire* – është një gjuhë *indoevropiane* e folur në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik nga fiset ilire deri aty nga fillimi i mijëvjeçarit të parë pas erës sonë. Dëshmitë për këtë gjuhë janë të pakta, çka ka sjellë vështirësi në klasifikimin dhe në përcaktimin e lidhjeve të saj me gjuhë të tjera. Sot, burimi kryesor i informatave të besueshme në lidhje me gjuhën *ilire* përbëhet nga një pjesë të vogël e fjalëve *ilire* të cituara në burimet klasike dhe në disa mbishkrime (edhe *mesapike*²⁴, nëse mund të konsiderohen të tilla), në mjaft shembuj antroponimesh, etnonimesh, toponimesh dhe hidronimesh ilire²⁵. Për këto arsye është ende hipotetike çdo përpjekje për të treguar lidhjet midis *ilirishtes* (duke përfshirë edhe *mesapishten*) dhe gjuhëve të tjera të familjes *indoevropiane*. Më shumë duke u mbështetur në konsiderata të karakterit gjeografik se sa gjuhësor, disa dijetarë kanë parë lidhje midis gjuhës *ilire* dhe disa gjuhëve të tjera *indoevropiane* të hapësirës ballkanike në mijëvjeçarin e II - I para erës sonë, si *dakishtja*, *trakishtja*, *maqedonishtja e vjetër*, *peonishtja* e *frigishtja*. Megjithatë këto mbeten në kuadrin e hipotezave. Gjuha *ilire* nuk ka lënë trashëgimtarë historikë të njohur e të vërtetuar drejtpërsëdrejti. Kjo i ka çuar disa dijetarë që përkohësisht *ilirishten* (sepse lidhjet e saj me gjuhë të tjera, të lashta dhe moderne, vazhdojnë të studiohen) ta vendosin në një degë më vete. Një grup tjetër dijetarësh, duke filluar nga shekulli XVIII, ka hedhur idenë se gjuha moderne *shqipe* e ka prejardhjen nga

²³ G. Mayer, Die lateinischen Elemente im Albanesischen, in G.Gröber, Grundris der romanischen philologie, Strassburg, I, 1888, f. 804

²⁴ *Mesapishtja* - mendohet të ketë qenë një nga gjuhët ilire, të cilat ishin folur kryesisht në anën tjetër të detit Adriatik (në zonën e Pulias së sotme). Kjo hipotezë është mbështetur në studimet e bëra rreth disa emrave të përveçëm të gjetur në mbishkrimet e varreve dhe në disa referenca klasike. Mesapishtja mendohet të jetë zhdukur pas pushtimit të zonave të rajonin e Pulias nga Republika Romake, çka çoi edhe në asimilimin e banorëve (romanizimin e tyre).

²⁵ Woodard, Roger D. (2008), *The Ancient Languages of Europe*. Cambridge University Press., f. 6 - Wilkes John J. (1995), *The Illyrians*. Oxford: Blackwell Publishing, "Though almost nothing of it survives, except for names, the Illyrian language has figured prominently in several theories regarding the spread of Indo-European languages into Europe." f. 67.

gjuha *ilire*, duke qenë një nga hipotezat më të pranueshme sot e kësaj dite.

Megjithatë, përderisa njohuritë mbi gjuhën e lashtë *ilire* mbeten të paplota dhe të fragmentarizuara, kjo çështje mbetet e hapur dhe objekt debatesh e diskutimesh ndërmjet indoevropianistëve ²⁶.

- Gjuha *venetike* ²⁷– Ishte gjuha e folur nga popullsia e lashtë venete, e vendosur në Italinë verilindore. Nga kjo gjuhë na kanë arritur vetëm disa mbishkrime (kryesisht varresh) që vijnë kryesisht nga zona e Este-s (e konsideruar si qendra kryesore e civilizimit), nga Padova, Vicenza dhe lugina e Piaves, por edhe nga Trieste dhe Karinzia, që i përkasin një periudhe që varion nga shekulli VI para erës sonë deri në kohën romane (shekulli II para erës sonë). Shembuj të izoluar tregojnë se përdorimi i kësaj gjuhe mund të ketë shkuar deri aty nga shekulli II të erës sonë, kohë kur mendohet të jetë shuar përfundimisht. Zona e gjerë e shpërndarjes ka çuar në formimin e disa varieteteve lokale, të tilla si *venetikja alpine*, *venetikja* e Estes dhe *venetikja* e Padovës. Akoma edhe sot po hetohet rreth marrëdhënieve të saj me gjuhët e tjera *indoevropiane*. Bazuar në studimet e deritanishme shumica e dijetarëve janë të mendimit se gjuha *venetike* ishte shumë e afërt me gjuhët *italike*.



²⁶ **Francisco Villar**, *Gli Indoeuropei e le origini dell'Europa*, Bologna, Il Mulino, 1997, f. 363-371, f. 409-412. - **Sh. Demiraj**, *La lingua albanese in Emanuele Banfi (a cura di) La formazione dell'Europa linguistica*, Firenze, La Nuova Italia, 1993, f. 413-415. - **C. Watkins**, *Il proto-indoeuropeo in Anna Giacalone Ramat, Paolo Ramat (a cura di) Le lingue indoeuropee*, Bologna, Il Mulino, 1993, f. 49 - 50

²⁷ Nuk duhet të ngatërrohet as me *venetane*, as me *veneciane* e as me gjuhë të *venedikut*. Venetike është një gjuhë *indoevropiane* e zhdukur, e folur në rajonin e Venetos rreth shekullit të VI p.e.s.

- Gjuha *liburniane* - në pamje të parë, mund të përfshihet në të njëjtin grup me gjuhën *venetike*, por ka mjaft dallime prej saj. Është një gjuhë e shuar, e folur nga liburnianët e lashtë (banorë të Liburnias në kohët klasike). Ka pasur mjaft diskutime lidhur me përcaktimin e vendit të kësaj gjuhe në familjen e gjuhëve *indoeuropiane*. Ka mjaft diskutime lidhur me vendin e saj në familjen e gjuhëve *indoeuropiane* (disa dijetarë e konsiderojnë gjuhë *venetike*, kurse të tjerë e marrin si një degë të veçantë në familjen e gjuhëve *indoeuropiane*), mbasi kjo gjuhë nuk është e dokumentuar me shkrim (deri më sot nuk janë zbuluar dokumente të shkruara në këtë gjuhë).
- Gjuha *mesape (mesapishtja)* – ishte një gjuhë *italiote*²⁸ e folur nga mesapët, një popullsi e lashtë Italice e vendosur në Jug të Italisë, në rajonin e Pulias së sotme.

Është një gjuhë deri më sot jo tërësisht e deshifruar, që dokumentohet me disa mbishkrime të shkurtëra që datojnë ndërmjet shekullit V - I para erës sonë. Kjo gjuhë është përdorur dikur në Italinë juglindore si nga *mesapët*, ashtu edhe nga *iapigët* e *peucezët*. Nga kjo gjuhë kemi trashëguar deri më sot rreth pesëqind nënshkrime (në pjesën më të madhe emra vendesh apo njerëzish), që datojnë nga shekulli VI – I para erës sonë. Për shkrimin e kësaj gjuhe u përdor një alfabet grek tepër i shkurtër, me siguri i importuar nga fqinjët grekë të Taranto-s. *Mesapishtja* mendohet të jetë zhdukur pas pushtimit të rajonit të Pulias nga Republika Romake, çka çoi edhe në asimilimin e banorëve (romanizimin e tyre).

Studiues të ndryshëm, duke u bazuar në emrat e përveçëm të njerëzve (gjetur në mbishkrimet e varreve) ose në referencat e shkrimtarëve klasikë, kanë vënë re se *mesapishtja* paraqet afri me *ilirishten*, prandaj mjaft prej tyre janë shprehur në favor të një lidhjeje të mundshme ndërmjet këtyre gjuhëve.

- Gjuha *frigiane* – gjuhë e Frigias (Phrygia) së vjetër, e folur nga frigianët e lashtë (një popull që ka emigruar gjatë periudhës së bronzit, ndoshta nga Thraka) gjatë antikitetit klasik, në një zonë që shtrihet në Azinë e vogël. *Frigishtja* është një gjuhë e dokumentuar minimalisht me vetëm

²⁸ Me termin *italiot* grekët e lashtë emërtonin popullatat greqisht-folëse që kishin kolonizuar dhe jetonin në gadishullin italian. Me vendosjen e sundimit romak *italiotët* ishin të dallueshëm nga popullatat vendase italice. *Mesapët*, *iapigët* dhe *peucezët* popullsi të lashta indoeuropiane të vendosura në zonat e jugut të Italisë, në rajonin e Pulias së sotme .

dy korpuse me dorëshkrime, ku njëri daton aty rreth vitit 800 para erës sonë (*paleo-frigisht*) dhe tjetri disa shekuj më vonë, në vitet e para të erës sonë (*frigishtja e re*). Kjo gjuhë mendohet të jetë shuar aty rreth shekullit VI të erës sonë. Në gjendjen e sotme të studimeve janë bërë përpjekje të rindërtohen disa fjalë me ndihmën e dorëshkrimeve (të cilat ishin shkruar me një alfabet të ngjashëm me atë grek) dhe të bëhen studime mbi këtë gjuhë. Nga këto studime, si dhe duke iu referuar burimeve antike, dijetarë të ndryshëm kanë arritur në përfundimin se *frigishtja* është një gjuhë që paraqet afri me *greqishten*, *trakishten* apo me *armenishten*. Kështu, Herodoti (7, 73) transmetonte një histori maqedonase, sipas së cilës *frigianët kishin emigruar në Azinë e Vogël nga Thrakia* dhe se *armenët ishin kolonë të frigianëve, prandaj konsideroheshin pjesë e së njëjtës popullsi në kohën e Kserksit I*. Ndërsa duke u mbështetur në të dhëna dhe në argumente gjuhësore ata kanë arritur në përfundimin se *frigishtja* ngjan të jetë më afër me *greqishten*, një gjuhë me të cilën ai ishte në kontakte për disa kohë. Ngjashmëria e disa fjalëve të kësaj gjuhe me korrespondueset në gjuhën greke ishte vërejtur edhe nga Platoni në “*Dialogjet e kratylusit*”.

- Gjuha *paeoniane* – gjuhë e vdekur. Është gjuha e paeonianëve të lashtë, mbretëria e të cilëve shtrihej dikur në veri të Maqedonisë, në Dardani dhe në kohët më të hershme në Trakinë jugperëndimore. Në burimet klasike paeonianët konsiderohen zakonisht si të dallueshëm nga trakasit



ose ilirët si për nga përkatësia etnike, ashtu edhe për nga gjuha e tyre. Dijetari i lashtë grek Athenaeus²⁹ e lidhte gjuhën *paeoniane* me *mizishten e lashtë* (edhe kjo një gjuhë që paraqet vështirësi). Nëse është e saktë kjo atëherë mund të thuhet se gjuha *paeoniane* ishte një gjuhë e Anadollit.

Nga ana tjetër, ka edhe mendime se paeonianët janë të lidhur me trakët dhe paraardhësit e frigianëve, çka mund të provojë se gjuha *paeoniane* është në grupin e gjuhëve *paleo-*

ballkanike. Edhe ndërmjet gjuhëtarëve të shekullit të kaluar ka patur mjaft

²⁹ *Athenaeus* - gojëtar dhe gramatikan grek, që jetoi aty nga fundi i shekullit II dhe fillimi i shekullit III pas erës sonë

diskutime e pasiguri lidhur me përcaktimin e vendit të saj në familjen e gjuhëve *indoevropiane* për shkak të mungesës së dokumenteve dhe të materialeve të shkruara. Nga njëra anë, gjuhëtarë të tillë si Wilhelm Tomaschek dhe Paul Kreçmer pretendojnë se kjo gjuhë i përkiste degës *ilire*, dhe, nga ana tjetër, gjuhëtari Dimiter Dečev pretendon se kjo gjuhë ka më shumë afri me *trakishten*. Megjithatë të gjitha mbeten hipoteza.

- Gjuha *trake* – është gjuhë e vdekur që mendohet se dikur përdorej nga një popullsi që mendohet të ketë jetuar në një territor që përfshinte gjysmën jugore të Bullgarisë, Serbinë lindore, pjesën lindore të Maqedonisë, Greqinë veriore, pjesën evropiane të Turqisë dhe pjesën veriperëndimore të Turqisë aziatike (Bithyninë). Deri aty nga shekulli V pas erës sonë shumica e kësaj popullsie (trakëve) ishte helenizuar ose romanizuar përfundimisht. Gjuha *trake* (*trakishtja*) është e vërtetuar vetëm me disa mbishkrime të shkurtëra (disa mbishkrime në unaza, shekulli VI - V para erës sonë) dhe disa fjalë të cituara në tekstet e lashta greke. Klasifikimi i gjuhës *trake* ka qenë prej kohësh një çështje e diskutueshme. Ka patur mjaft hipoteza në lidhje me pozitën e saj në rrethin e gjuhëve *paleo-ballkanike*. Një nga hipotezat është ajo që e lidh ngusht me gjuhën *dake*, një gjuhë tjetër *paleo-ballkanike* nga rajoni, ndonëse edhe kjo hipotezë mund të konsiderohet spekulative, sepse të dy gjuhët janë të vërtetuara minimalisht³⁰.
- Gjuha *dake* – është një gjuhë që shpesh është konsideruar si një dialekt i gjuhës *trake* ose si një gjuhë e veçantë (por e lidhur ngushtë me të). Kjo gjuhë flitej nga banorët e lashtë të Dakisë. Shumë karakteristika të gjuhës *dake* janë të diskutueshme ose të panjohura mbasi mungojnë dokumentet e shkruara në këtë gjuhë. Në gjendjen e sotme nuk kemi mbishkrime *dake*, prandaj ajo çfarë është e njohur për këtë gjuhë buron nga toponimet, hidronimet apo emrat e përveçëm. Shumë dijetarë mendojnë se *dakishtja* mund të ketë qenë një nga gjuhët më të mëdha të Evropës juglindore, e folur nga një popullsi që banonte në një territor që shtrihej nga Hungaria lindore deri në brigjet e Detit të Zi.
- Gjuha e lashtë *maqedone* (*maqedonishtja e lashtë*) – flitej në Mbretërinë e Maqedonisë gjatë mijëvjeçarit të parë para erës sonë, por që gradualisht u nxor nga përdorimi gjatë shekullit IV para erës sonë, duke u zëvendësuar nga një koine greke (e shndërruar në *lingua franca*³¹ të periudhës helenistike). Klasifikimi i kësaj gjuhe është i vështirë, mbasi ajo është e dokumentuar vetëm nga disa dëshmi fragmentare të mbijetuara (kryesisht glosa dhe

³⁰ Carl Waldman, Catherine Mason, 2006, Encyclopedia of European peoples, Infobase Publishing, f. 205.

³¹ “*lingua franca*” - një gjuhë e zakonshme e përdorur nga folësit e gjuhëve të ndryshme. Kjo koine ishte një dialekt i lashtë grek i përdorur nga banorët e zonave të Mesdheut lindor në periudhën e perandorisë së Aleksandrit të Madh dhe në atë të perandorisë romake.

emra të përveçëm). Kemi një numër relativisht të vogël fjalësh të mbledhura nga burime të lashta, kryesisht nga mbishkrimet dhe nga fjalorthi i Hesychius-it të Aleksandrisë (shekulli V), që arrin deri në rreth 150 fjalë dhe 200 emra të përveçëm. Sipas disa studiuesve, mbështetur në zbulimet epigrafike të kohëve të fundit, *maqedonishtja e lashtë* ishte një dialekt i Greqisë veriperëndimore³², çka mbetet për t'u vërtetuar.

Ajo është pjesë e grupit *paleo-ballkanik* (mendohet të ketë lidhje me *greqishten, ilirishten, trakishten* dhe *frigishten*). Për shkak të vërtetimit fragmentar të këtyre gjuhëve, lidhjet filogjenetike mes tyre në përgjithësi janë të paqarta, në mënyrë të veçantë problemet e afërsisë ndërmjet *maqedonishtes së lashtë* dhe *greqishtes*, që janë shndërruar në objekt debati (kryesisht sa i takon rindërtimit të gjuhës *proto-greke*).

- Gjuha *liguriane* – është një gjuhë e përdorur në periudhën pararomake e atë romake (aty nga mijëvjeçari i parë para erës sonë) nga një popullsi e lashtë e Italisë veriperëndimore dhe e Francës juglindore, e njohur si popullsia ligure. Shumë pak dihet për këtë gjuhë, mbasi nuk ka dokumente të shkruara (janë trashëguar kryesisht emrat e vendeve dhe disa emra të përveçëm). Ka diskutime lidhur me përkatësinë e saj në familjen e gjuhëve *indoevropiane*. Është vënë re se gjuha *liguriane* ka shumë karakteristika të përbashkëta me gjuhë të tjera të kësaj familjeje, kryesisht me gjuhët *keltike* dhe *italike*³³. Dijetarë të ndryshëm mendojnë se ajo mund të jetë pranë ose pjesë e gjuhës *kelte*. Ndonëse Straboni tregonte se ligurët si popullsi ishin të ndryshëm nga keltët, kur shkruante :

"Sa për Alpet...shumë fise (éthné) pushtuan këto male, janë të gjithë keltë (Keltikà) përveç ligurianëve, por këto ligurianë janë të ndryshëm si njerëz (hetero ethneis), ndonëse ata janë të ngjashëm me keltët në mënyrën e tyre të jetesës (bíois)."

- Gjuha *lusitane* – është një gjuhë *paleo-hispanike*, që, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, i përkiste familjes së gjuhëve *indoevropiane*. Kjo gjuhë është e njohur vetëm nga pesë mbishkrime, nga shumë emra vendesh (toponime) dhe emërtime perëndish (teonime). Ajo flitej nga fiset lusitane që banonin në zonën perëndimore të gadishullit Iberik, nga lumi Douro deri në

³²Sarah B. Pomeroy, Stanley M. Burstein, Walter Donlan, Jennifer Tolbert Roberts, 2008, *A Brief History of Ancient Greece: Politics, Society, and Culture*, Oxford University Press, f. 289

³³Pedreño, Juan Carlos Olivares (2005), "Celtic Gods of the Iberian Peninsula". Retrieved 12 May 2010. - Quintela, Marco V. García (2005). "Celtic Elements in Northwestern Spain in Pre-Roman times". Center for Celtic Studies, University of Wisconsin-Milwaukee. Retrieved 12 May 2010.

lumin Tagus (në pjesën më të madhe në Portugali dhe më pak në Spanjë). Është i njohur fakti se këta banorë u vendosën në këta territore aty nga shekulli VI para erës sonë. Gjuha *lusitane* mendohet të jetë më arkaike dhe mjaft e ndryshme nga gjuha *keltiberiane* apo nga gjuhët e tjera të folura në qendër të Gadishullit Iberik. Ka mendime të ndryshme sa i takon klasifikimit të saj. Studiuesit Anderson (1985) dhe Untermann (1987) e klasifikojnë gjuhën *lusitane* në të njëjtin grup me gjuhët *keltike*. Hipotezën e tyre ata e mbështesin në ngjashmëritë që vunë re në mjaft emra të përveçëm, në emra të hyjnive dhe në toponime në gjuhën *kelte*. Ndërsa studiues të tjerë (Villar dhe Pedrero - 2001) e kanë lidhur atë me gjuhët *italike*. Kjo është e bazuar në krahasimin e disa emrave të hyjnive, në disa njësi leksikore apo edhe në disa elemente gramatikore³⁴.

Mbishkrimet më të njohura janë ato nga Cabeço das Fráguas e Lamas de Moledo në Portugali dhe Arroyo de la Luz në Spanjë. Të gjitha janë të shkruara me alfabetin latin.

BIBLIOGRAFI:

1. Le lingue indoeuropee, Mulino, 1994.
2. **Auroux, Sylvain** (2000), *History of the Language Sciences*, Berlin, New York: Walter de Gruyter.
3. Encyclopaedia Britannica, 15th edition, vol.22, 1981.
4. **Kortlandt, Frederik**, 1990, The Spread of the Indo-Europeans, *Journal of Indo-European Studies*, 18, 1-2.
5. **Szemerényi, Oswald; David Jones, Irene Jones** (1999). Introduction to Indo-European Linguistics, Oxford University Press, ISBN 9780198238706.
6. **Anderson, J. M.** 1985. "Pre-Roman Indo-European languages of the Hispanic Peninsula", *Revue des Études Anciennes* 87, 1985, f. 319-326.
7. **Untermann, J.** 1987. "Lusitanisch, Keltiberisch, Keltisch", in : J. Gorrochategui, J. L. Melena & J. Santos (eds.), *Studia Palaeohispanica. Actas del IV Coloquio sobre Lenguas y Culturas Paleohispánicas* (Vitoria/Gasteiz, 6-10 mayo 1985). (Veleia 2-3, 1985-1986), Vitoria-Gasteiz, 1987, f. 57-76.

³⁴ *Indoeuropeos y no Indoeuropeos en la Hispania Prerromana*, Salamanca: Universidad, 2000.

Families of languages the world

SUMMARY

There many languages in the world. Progresses in the linguistic studies, archeology and genetics have helped scientists to explain the existence of such a big number of languages in the world. Their systematic study has led to the idea that languages and groups of languages may have the same ancestral origin. This kin relation is named "*linguistic family*".

Genetic, Paleoanthropologist, and Archeological researches, mainly with the linguistic character, (*related to cultural changes, migration and in the same time supported by accurate methods in defining the time*) have found out important elements that make possible to compile a general location scheme of languages in the world. Comparative linguistic has clearly defined that sister languages have genetic or genealogic relations, that is why they have been included in the same family.

In our article we aim to represent a classification of languages in the world (linguistic family, linguistic groups and sub-groups). Linguists have identified some big linguistic families from the comparative linguistics. These above mentioned families are divided into language groups and subgroups or even into individual languages.

In this article there is the analyzed only the Indo-European family of languages, which is composed of related languages and dialects in terms of genesis. This family includes major languages of Europe, Iran, India and it is also prevalent in the areas of Anatolia and Central Asia. This family has been documented since the period of bronze (in the form of the Mycenaean Greek and Anatolian languages).

This language family is thought to be composed of 449 languages and dialects. About half of them (about 219) belong to branch of Indo-Aryan languages. Languages of this family (Indo-European) are spoken by 3 billion people.

This family is composed of 10 main branches.

Remzi PËRNASKA

GABRIEL ANSEJA PËR LASHTËSINË E GJUHËS SHQIPE DHE TË POPULLIT SHQIPTAR

Që prej shekullit XIX e deri më sot janë botuar shkrime kushtuar prejardhjes së shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre prej një popullsie të lashtë paragreke, prej pellazgëve në pellazgjishten.

Autorët e vjetër grekë pohojnë se tributë e para greke, kur erdhën në brigjet e detit Egje, gjetën një popullsi më të vjetër, që përgjithësisht njihet me emrin pellazgët. Për një lagje gjuhëtarësh si Kretschmer-i, Budimir-i, Georgiev-i, van Windekens-i, etj., kjo popullsi i përkiste familjes indoevropiane. Të tjerë mendojnë se kjo popullsi qe autoktone mesdhetare, joindoevropiane.

Ky shkrim trajton disa ide të një studiuesi të lashtësisë së popullit grek e shqiptar, të një helenisti të formuar francez, të Gabriel Ansesë (Gabriel Ancey).

Para së gjithash, më duhet të them se nuk jam gjëkund specialist i kësaj fushe, madje as edhe lexues i kualifikuar dhe nëse ia hyra parashtrimt të ideve të kësaj figure njohur në kohën dhe qytetin e vet, në Marsejë, dhe të harruar mandej, këtë e bëj për vetë historinë e studimeve të kësaj natyre për gjuhën shqipe, si edhe për të nderuar kujtimin e një njeriu që për interesa të pastërta shkencore e diturake punoi me pasion e këmbëngulje për më se tridhjetë vite, madje edhe i mënjanuar dhe hera-herës edhe i qëndisur prej të tjerëve, të diturve të kohës, helenistëve francezë. Motivi im nuk është veçse peng kujtimi. Dhe kjo nuk më kyç, nuk më zoton, se kam pranuar idetë e Gabriel Ansesë.

Vite më parë, në shkrimet dhe intervistat e mia, kam folur për një lloj të veçantë tejzash në studimet albanologjike franceze për lashtësinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar.³⁵ Ndër ta mund të shtihet edhe Gabriel Anseja që ka mbetur thuajse i panjohur për breza të gjerë lexuesish.

³⁵ “Dhe çfarë kombësie! Më e lashta e kontinentit tonë...”, “Zëri i popullit”, 3.08.1990, f.3; “Kongresi i Drejtshkrimit të gjuhës shqipe e radhiti popullin shqiptar ndër popujt e qytetëruar të botës”, Rilindja, 26.07.1994, f.13, botuar më parë me tituj të tjerë te Illyria,

Interesi për lashtësinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar është gjallëruar veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore. Mjaft autorë i janë përkushtuar këtij hetimi, rezultat i punës së të cilëve është botimi i shkrimeve nëpër të përditshme, ose si libra më vete.³⁶ Gabriel Anseja është ndër të paktët filologë francezë që janë interesuar për lashtësinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar. Të tillë janë Louis - Lucien Bonaparte, Benlëvi (Benloew), Robert d'Anzhëli (d'Angely), Andre Martineja, Mathieu Aref, e ndonjë letër.

Lindi në Marsejë në vitin 1865 dhe vdiq në Eks-en-Provansë (Aix-en-Provence) në prill të vitit 1945.

Studimet e tij të mesme, si ishte rregull në atë kohë, ishin thujse tërësisht letrare. U diplomua mandej për letërsi. Edhe doktoratën e mbrojti po për letërsi më 1901, me një zë të dyfishtë, në frëngjisht dhe në latinisht:

11-13.07.1994, f.16, edhe ende më parë në gazeta të tjera shqiptare, "Avant-propos" te R.D Angely, Grammaire compare de l'albanais, Paris, 1998, f.V-VI.

³⁶ Në pamundësi të një liste shteruese, ja disa syresh: N.Chetta, *Tesoro di notizie intorno all'origine dei Macedoni*, në M.Mandala, *Nicolo Chetta nel bicentenario 1803- 2003*, Palermo, 2003, S. Frashëri, *Shqipëria ç' ka qenë, ç' është e ç' do të bëhet*, Bukuresht 1899, "Gjuha shqipe" në *Alfabetare e gjuhës shqip*, Kostandinopojë, 1879, f.26: P.Vasa, *Shqypnija e Shqyptart*, në *Alfabetare e gjuhës shqip*, Kostantinopojë, 1879, f. 34-70, Georg von Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854: P. Kretschmer, *Einleitung in die Geschichte der griechischen Sprache*, Göttingen, 1896. V.Georgiev, *Vorgriechische Sprachwissenschaft*, I- II, Sofje, 1941- 1945, "Sur l'origine de la langue des Pelasges, des Philistins, des Danaens et des Acheens..." 1948, " *Ethnogenese de la peninsula balkanique d'après les donnees linguistiques*" Studia albanica, Tirana, 1971, *Introduction to the history of the indo European languages*, Sofia, 1981, A.J. van Windekens, *Le Pelasgique. Essai sur une langue indo europeenne prehellénique*, Lauvain, 1952 S.Konda, *Shqiptarët dhe problemi pellazgjik*, Tiranë, 1962, 1964, Z.Mayani, *Les etrusques commencent a parler*, Paris, 1961, *La fin du mystere etrusque*, Paris, 1970, R.Katicic, *Ancient languages of the Balkans*, The Hage Paris, 1976, A. Martinet, *Des steppes aux oceans*, Paris, 1986, R. d Angely, 1984, *Lashtësia e gjuhës shqipe, Etruskishtja gjuhë e gjallë* (në italisht), 1989, " *Protogjuha dhe pellazgo iliro etruskishtja*, Iliria, Roma, 2000, f.177- 183 G.Catapano, *Thot parlava Albanese*, Roma, 1984, A. Kola, *Arvanitët dhe prejardhja e grekëve, Gjuha e harruar e perëndive*, 1989, E. Jacques, *The Pilika, Pellazgët origjina jonë e mohuar*, Tiranë, 2005, Sh.Demiraj, *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tiranë, 2008, M.Aref, *Albanie(histoire et langue ou l'incroyable odyssey d'un peuple prehellénique*, Paris, 2003 *Grece(Myceniens) Pelasges) ou la solution d'une enigme*, Paris, 2004, Sh.Demiraj, *The origin of the Albanians (linguistically investigated)*, Tirana, 2006, *Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët*, Tirana, 2008, P.Margilaj, *Ilirët flasin shqip shqiptarët flasin ilirisht*, Podgoricë, 2000, e shumë të tjerë.

L'opinion sous Octavien, Recherches sur...des esprits a Rome, de 711(an de Rome) a 724; De C. HelvioCinna poeta.

Profesor letërsie dhe histori-gjeografi në shkolla të ndryshme të Marsejës, drejtor i kolegjit të vjetër të jezuitëve në Marsejë.

I martuar, baba i tre fëmijëve. I ve qysh në moshën 39 vjeçare.

Nuk pati gjithmonë jetë të lehtë, por kurrë nuk hoqi dorë nga puna intelektuale. Shkruante me pseudonime (ndër të cilat më i përdoruri është Palafite), tregime dhe rrëfenja për gazeta, sidomos për “*Le Journal de Marseille*”, shkrime diturake, romane, ftesë teatrore, njëra prej të cilave u vu në skenë me shumë bujë. Komeditë e tija me tri ose katër akte karakterizohen nga dialogu i këndshëm, i ngjeshur dhe i thukët, si edhe nga një vështrim tejet i veçantë i mosmarrëveshjeve njerëzore. Janë të njohura rrëfenjat e tija të shkurtëra, ku në secilën, trajton një problem të veçantë disi filozofik që e zgjidh me frymë qëndisëse.

Akademiku Edmond Jaloux, i cili e kishte pasur Ansenë profesor retorike, në një shkrim të botuar në “*Les saisons littetires*” thotë se Gabrieli nuk jepej pas lavdisë si shkrimtar³⁷, madje hoqi dorë shpejt nga letërsia për t’iu kushtuar krejtësisht filologjisë, me gjithë mungesën e dashamirësisë të të diturve dhe të kolegëve të tjerë filologë.³⁸

Njeri me interesa të gjera, u muar edhe me gjuhësi.

Si thotë në hyrje të dorëshkrimit *Le mythe grec*, të ripunuar më 1926, filloi të merret në gjuhës shqipe që më 1911, nën ndikimin e veprës së August Dozonit *Manuel de la Lingue Chkipe ou albanaise*. Ka përdorur fjalorin e Gustav Meyer-it *Etymologisches Wörterbuch des albanesischen Sprache* dhe *Studien zur albanesischen Etymologie und Wortbildung* të Nobert Joklit, si edhe shkrime të Pedersenit.

Gabriel Anseja është marrë më shumë se tridhjetë vite me lashtësinë e gjuhës shqipe.

³⁷ Les saisons litteraires, Fribourg, Plon, 1942, f. 257 “*Il travaillait vraiment pour le plaisir de creer et sans aouci de la moindre renommee. Je n’ai jamais vu a un auteur pareil dedain de l’opinion*”, “*nous aurions aime que Palafite Ancey les publiat en volume, mais il s’y refusait par modesti...*”

³⁸ Les saisons litteraires, Fribourg, Plon, 1942, f. 257 “*D’aillerurs la veine dramatique s’arreta egalement sans laisser de traces et notre ami, tres bon helleniste, se consacra a des travaux philologiques sur les origins de la langue grecque, ou il voyait des raciness pelagiques et montenegrines. Il eut a ce sujet de savants discussions avec des confreres chatouilleux et des amis naturellement malveillants, car il semble derniere qu’ait ressentie mon ami Ancey et qu’il s’y consacre encore avec la meme sagesse et la meme tenacite dans un coin perdu d’Aix en Provence*”.

Qe i bindur se gjuha shqipe, së paku një substrat i saj, flitej në Ballkan, në të njëjtën kohë me greqishten, qysh në lashtësinë e hershme. Në këtë pikë, ai ndjek austriakun Jahn (*Albanesische Studien*, Wien, 1853) dhe gjermano-francezin Lui Benlëv (Louis Benloew) (*La Grece avant les Grecs*, 1877, *Analyse de la langue albanaise*, 1879), si dhe Rilindasit shqiptarë. Këta studiues janë marrë me shpjegimin e emrave të përveçëm hyjnorë dhe të heronjve të mitologjisë helenike, si: Demetra, Kore, Kronos, Tetis etj.

Thelbi i kërkimeve të tija është se vuri re që disa fjalë të gjuhës shqipe hedhin dritë papritur te disa emra të përveçëm të mitologjisë greke.

I dërgoi letër akademik Salomon Reinach-ut (1885-1932) autor i *Manuel de philologie classique*, Paris, 1880 dhe i *Cultes, mythes et religions*, Paris, 1913, i cili botoi dy shkrime të Ansesë në revistën e vet arkeologjike, të cilën e drejtonte së bashku me akademik G.Perrot: “*Sur deux epigrammes de Crinegoras*”³⁹, “*Questions mythiques*”⁴⁰ në këto shkrime nuk bëhet fjalë për gjuhën shqipe, por ato flasin për dijet e gjera të autorit në mitologji.

Iu vu punës për të vazhduar rrugën e çelur prej Hahnit dhe Benlëvit. Por përpjekjet e ndeshnin në vështirësi nga më të ndryshmet.

Më 1912 botohet në Athinë libri i vëllimshëm i P. Thomopoulos-it *Pelasgika*, që karakterizohet nga mungesa e frymës kritike aq e domosdoshme për hetimet shkencore, ndaj e bëri të pamirëpritur shfrytëzimin e gjuhës shqipe për hetimin e greqishtes në letër.

Edhe akademiku Salomon Reinnach-u, që ishte autoritet në kohën e vet, e quajti të mbyllur përpjekjen për të shpjeguar fjalë të helenishtes me brumë të shqipes; nuk e dëgjonte më Gabriel Ansenë, me gjithë letrat e vijueshme që ky i fundit i shkroi deri në fund të jetës së tij.

Po kështu ndodhi edhe me helenistin Autrun, i cili në fillim qe shumë i ngrohtë për kërkimet e Gabriel Ansesë dhe kishte miqësi me të, por në fund i ktheu shpinën në këtë pikë.

Më 1914 botoi me shpenzimet e veta dy broshura: *L'albanais dans le mythe grec* dhe *Notes albanaises*, të dyja nga Shtëpia e njohur botuese “Fontemoing”. Në to mbron teorinë se legjendat për perënditë dhe heronjtë e mitologjisë mbështeten në pjesë të madhe të lojë fjalësh, ose, si thuhet zakonisht, tek *etimologji të rrema* ose *etimologji popullore*, të krijuara që

³⁹ *Revue archeologique*, Ernest Leroux, Paris, 1910.

⁴⁰ *Revue archeologique*, Ernest Leroux, Paris, 1913.

në kohët homerike, madje edhe më parë, duke i shpjeguar si gjëegjëza të gjitha anët e kësaj bashkësie të ngjeshur dhe të ngatërruar që quhet mitologji greke, një pjesë të së cilës mundohet ta zbërthejë me anë të shqipes.

Më vonë Victor Briard-i u përpoq të provojë që edhe fenikishtja mund të shërbente si çelës.

Gabriel Anseja përdori si çelës të gjuhës shqipe duke futur në punë më së pari ato fjalë që gjuhëtarët i mbajnë për anase shqiptare, numri i të cilave vazhdon të rritet prej etimologëve, dhe vetëm pastaj edhe asosh me etimologji të dyshimtë. Dhe si strategji për të vërtetuar tezën e vet zgjedh shumësinë e rasteve. Ai nisej nga ideja se mprehtësia e rasteve që, sipas analizave të veta, shpjegoheshin duke futur në punë gjuhën shqipe, nuk mund të mbahet për rastësi. Thënë ndryshe, ai mbështetej më shumë të “kryeneçësia” e rasteve, e fakteve, sesa të rreptësia e metodës.

Metodat e reja shkencore mbështeten të përsëritja e fakteve në sistem.

Dhe tani është e qartë se këtu mbetemi në hipotetikë, nuk ka vijim, rregullsi, por ndërprerje në metodë.

Në fillim të shekullit XX, profesorët francezë nuk e quanin serioze t’i jepej kaq mundësi lojës së fjalëve, nga njëra anë, në kërkimet e mirëfillta etimologjike dhe, nga ana tjetër, në kërkimet etimologjike të një gjuhe kaq shumë të hetuar si helenishtja, pale andej të përdorej si çelës një gjuhë e dokumentuar vonë si shqipja. Nuk munguan jo vetëm mënjanësia (indiferenca) e mirësjellshme, por as edhe sarkazmat, megjithatë ai i vazhdoi kërkimet, i mënjanuar: hartoi qindra skeda dhe mbushi me shkrime mbi 15 fletore. Njeri i përkorë, aspak luftarak, i vetmuar në kërkimet e veta, ai nuk reshti kurrë së thelluari hetimet. Nga fundi i jetës, i verbuar, i diktonte nipit, djalit të vajzës së vet profesorit Zhan-Pjer Tenevin (Jean-Pierre Tennevin), pjesë të tëra të arritjeve të veta në këtë fushë.

Zhan-Pjer Tenëvën u njoh me gjuhëtarin e njohur italian Vittore Pisani në vitin 1957. Ky botoi më 1959 në revistën e vet “*Paideja*”, në numrin mars-prill, një artikull mjaft të gjatë për arritjet e Ansesë, të shkruar prej Tenëvënit që parashtrori thuktazi teoritë e gjyshit të vet. Ai i dërgoi shkrimin e vet botuar nga Pisani Ambasadës së Shqipërisë në Paris, Universitetit të Tiranës, Universitetit të Prishtinës, Universiteti popullor shqiptar në Gjenevë, por asnjëherë nuk pati përgjigje. Ia ka dhënë Ernest Toçit, i cili ia dorëzoi akademikut Eqrem Çabej, pastaj akademikut Idriz Ajetit. Ai ua ka dhënë shkrimin e vet dhe disa studentëve nga Kosova, por asnjëherë asnjëri nuk i është përgjigjur.

Kohët e fundit janë botuar shkrime të Zhan-Pjer Tenevinit në shtypin shqiptar, disa të përkthyer prej akademik Artan Fugës.⁴¹

E ndjejmë veten të detyruar të përsërisim se ne nuk jemi në gjendje të themi se teza e Gabriel Ansesë se shumë emra të përveçëm të hyjnive të mitologjisë greke shpjegohen me shqipen është ose jo e pranueshme. Me këtë le të merren specialistët, por meqë synimi i shkrimit të pranishëm është thjesht paraqitës, nuk na mbetet veçse t'i parashtrijmë gjërat ashtu si i ka parashtruar Anseja vetë.

Vetë Gabriel Anseja i verbuar, kur nipi i lexonte dy broshurat e botuara më 1914, i gjente ato të vjetëruara dhe me guxime që nuk do t'i përsërite më. Më vonë më 1926, ka bërë, gjithmonë sipas tij, përqasje më bindëse, të cilat gjenden aty. Për mendimet e tij të mëvonshme, për evoluimin e tyre, le të shfrytëzohet shkrimi i profesor Zhan-Pjer Tenëvinit, botuar në revistën “*Hylli i Dritës*”, 2009, Nr. 2-3, i mbështetur kryesisht dorëshkrimi i vitit 1926.

Broshurat që janë vënë në bazë të parashtrimit janë: *Memoire sur l'albanais dans le mythe grec*⁴² dhe *Notës albanaises*⁴³, e para me 32 faqe dhe e dyta, si plotësim i së parës me 12 faqe, të botuara të dyja njëra pas tjetrës, në prill e në qershor të vitit 1914.

Autori e fillon parashtrimin e vet që në thelb nuk mund të mos ishte veç deduktiv, me ndehjen e tetë tezave, të cilat ngjajnë më së fortë si argumente. Për të kuptuar metodën e tij të punës, sidomos atë të parashtrimit, po i japim ato ashtu si dalin në broshurën e parë dhe të dytë. Broshura e dytë saktëson zërat e trajtuar në të parën duke shtuar diçka thuajse për secilën prej tyre. Për lehtësi parashtrimi, dhe që lexuesi ta ketë më të lehtë ndjekjen e tyre, ne i lejuam vetes t'i bashkojmë në vendet përkatëse të dyja broshurat. Ja renditja e tezave:

1. Gjithçka sillet sikur shqipja, në fondin e vet zanafillës, së bashku me greqishten, t'i kishte shërbyer mitit helenik.

2. Ky mit mbështetet, për një pjesë të përfillshme, në etimologji dhe lojëra fjalësh, pa mendim udhëheqës filozofik të kapshëm qartë.

⁴¹ Jean Pierre Tennevin, “La theorie albanaise d’apres les notes de Gabriel Ancey”, docteur es letters 1865, 1945, Paideia, vëllimi XIV, nr 2, 1959, f.81 107, “Gjuha shqipe dhe mitologjia greke” Spektër, 15.04.200, f.40 43, “Gjuha shqipe dhe mitologjia greke” Pajtimi, nr.3, korrik shtator 2000, f. 71 85., “L’albanais dans le mythe grec”, “Hylli i dritës”, Shkodër, 2009.

⁴² G.Ancey, Memoire sur albanais dans le mythe grec, Fontemoing, Paris, 1914, f.32.

⁴³ G. Ancey, Notes albanaises, Fontemoing, Paris, 1914, f.12.

3. Qëllon që e njëjta fjalë të ketë disa përkthime dhe të ndryshojë kuptimin nga shqipja në greqisht dhe anasjelltazi. Emra me burim të huaj pësojnë trajtim të njëjtë nga ai i anasve. Në broshurën e dytë, për këtë tezë shton: “I tillë do të ishte rasti, ai i anasve,” që e lidhin me fenikishten (shqip hapurë ditë, që hap ditën) - Për Mucertinoz egjiptiane, i trajtuar si *muk' erhun*, që vonohet natën, - për Prëteuz egjiptian Prouti etj.

4. E quaj shqipen, për lehtësi për mua, dhe sepse më duket e hamendshme, PELLAZGJISHT. Më duket se është folur në të njëjtën hapësirë si edhe greqishtja para dhe njëkohësisht me të. Trajtat toske dhe gege do të gjendeshin në të, po ashtu si edhe disa të tjera të ruajtura në të folmen shqiptare në Italinë e Poshtme.

5. Ndryshimet fonetike të saj duhet të kenë qenë qysh atëherë shumë të mëdha, aq sa shqipja moderne do të mjaftonte për shpjegimin e më se një etimologjie fantaziste ose të vërtetë, në të cilën kanë gisht mitografët. Por është gjithmonë thelbësore t'i drejtohem formës së pastër të rindërtuar nga punimet e Majerit dhe Pedersenit për të pasur kuptime më arkaike dhe më afër së vërtetës.

6. Gjithmonë me keqardhja, dhe i shtërnguar nga postulate të shumta dhe të ngutshme, u jep disa skajeve të shqipes një lashtësi që gjuhëtarët e më sipërm do t'ia kundërshtonin. Rastet ku Majeri, në këtë pikë, ka pasë qenë i njohur si tejeti rreptë pikërisht prej Joklit), më shtyjnë të mendoj se kërkimet e reja do të gjenin edhe më syresh. Në broshurën e dytë kësaj teze i shton : “pikërisht prej Joklit” Cf. *Studien zur albasischen Etymologie und Wortbildung*, Vien, 1911, f.2: “ Mehrund merh gelangte er hierbei zur Ueberzeugung, dass G.Meyerin der Forschern wie W.Meyer-Lübke...und H.Pedersen...eins zu wissen, gereichte ihm zur Freude”.

7. Mungesa e teksteve në gjuhën shqipe, nga antikiteti në kohët moderne, është një gollë për të bërë si duhet paraqitjen. Në broshurën e dytë shton “Të parat janë të shekullit XVI. Duhet përmendur gjithashtu pikat e takimit midis shqiptarëve të Pindit dhe të atyre të emigruar në Itali në shekullin XV. Më parë, gjurmë të shpërndara, ..si grusa(=grëhusë) në Arnobe, pa folur për fjalë helenike (Shih Memoire –in tim , in). Kjo u jep tezave të mësipërme karakter hipotetik. Sjell si prova krejtësisht personale, faktin që i kam hamendësuar, me gjithë kuptimin e tyre, trajta të ndryshme shqiptare që nuk i njihja si dergie, sëmundje, ndrukjem, shtriqem etj. Në broshurën e 2-të shton: “Dergjë e postuluar sipas një analize të emrit Podaleijrio” (shihni Memorie, 10 dhe 28) ndrukj- (si miklim lajkatar) sipas asaj të Androclo”. Krahaso “shtriqje” të ngjashme të gjarpërit që duhej të zgjohej nga Androgeja e Eneidës, II, 379 e vijim.

Dihet se kjo këngë prejvjen prej “Ilvioupversi” të Pisandrit nga Rodi).

8. Shumësia e trajtimeve që gjej në pelasgjisht, mundet ende, a priori të dobësojë provën time. Por shembulli se ç’ndodhi në vetë greqishten –për skaje si ... (1)- shpërbërë në $\alpha\phi\eta + \iota\sigma\tau\omicron\varsigma$ dhe $\eta\beta\eta$ (ose $H\beta\eta$) $\alpha\iota\sigma\tau\omicron\varsigma$ – më provojnë se në ç’skallë ishte atëherë imagjinata gojore. Rreziku këtu do të jetë të shtysh veten përtej fantazive të pellazgjishtes. Në broshurën e dytë shton “Legjendat e ndryshme të ...nxirren (pa folur për shqipen)¹ prej $\alpha\phi\eta + \iota\sigma\tau\omicron\varsigma$, të trajtuara: A. përplasje, ndeshje, këmbë (legjenda e shtemësisë, gjymtimit të zotit), B. “tubim” këmbë (atentati i dështuar ndaj Athinasë), C. “tubim”, cohë, pëlhurë (adulteri i befasishëm në një rrjet metalik), D. ndezje, shkop (Hefaestosi prodhuesi i zjarrit) 2 prej $\eta\beta\eta \alpha\iota\sigma\tau\omicron\varsigma$, Hebeja e papërvojë, ose ndoshta, $\alpha - \iota\sigma\tau\omicron\varsigma$ ” e kuptuar si “çalamane”

Ajo që vijon përbëhet nga shembuj. Na duket se për të kuptuar shpjegimet e bëra prej Ansesë në shembujt që vijnë, është krejt e domosdoshme të njihet më parë në mitologjia për secilin emër të analizuar, ndryshe nuk kuptohen këto shpjegime në vetvete. Kjo del jashtë mëtimit të shkrimit të pranishëm, veçse do të shtojmë që për këtë synim mund të përdoret ndonjë fjalor i Mitologjisë helenike. Ne i kemi drejtuar shpesh fjalorit të Mitologjisë greke e romake të Pjer Grimalit dhe Mitologjisë së Edit Hamiltonit⁴⁴ nga ana tjetër, broshuarat e botuara prej Ansesë u drejtohen specialistëve, në radhë të parë, helenistëve ndaj janë tejet të vështira për t’u kuptuar prej lexuesve të zakonshëm. Me vështirësi të kësaj natyre kemi ndeshur edhe ne, ndaj parashtrimi i etimologjive të parashtruara prej Ansesë për emrat e heronjve të mitologjisë greke, nuk do të jetë veçse i pjesshëm. Lexuesi i interesuar duhet t’u drejtohet patjetër këtyre broshurave.

Lexuesi le të na ndjejë që nuk kemi mundur t’i vëmë teknikisht të gjitha shenjat sankritike të fjalët e greqishtes së vjetër.

Broshura e parë hapet me trajtimin e emrave të disa festave helenike.

“Një festë greke quhet e; orthv, emër që sqarohet veçanërisht me shqipen (të) veshuritë, veshja. Duhet sjellë ndër mend se festa e madhe athinase, panaqhvaia, përbëhet kryesisht nga vënia e një cohe të re Figurës

⁴⁴ Pierr Grimal, Dictionnaire de la mythologie grecque et romaine, Presses Universitaires, Paris, 1951, Edith Hamilton, Mythologie, Marabout, Paris, 2003.

së shenjtë. Do të kisha besuar se emri është shprishje e panë-dhana, taksa e cohës, dhe se emri i ericqovnio"-it si themeluesi kësaj feste duhet trajtuar si jerë-kthenjës, ai që ndërron cohën.

Festa Ηασιφαις, e mbarimit të zisë, shpjegohet me shqipen pa –zi, sipas një forme të ndërtuar baidhë.

Festa e bukës që i dhurohej Apollonit në Thangelitë gjen shpjegim në shqipen thar ellë.

Skiroforitë paraqiten në kalendarin athinas me figura me një sakrifikues, çka gjen shpjegim me shqipen shqerrë *bierës*.

Po me shqipen shpjegohet edhe festa e Anthesterive: *anth-shtjerrë* përbërë nga diminutiv i *anë, enë* dhe *shtjerrë*. Ai vë në dukje se numri i personazheve ose ανθ, legjenda e të cilëve bën fjalë për një kupë ose për një kovë, është i mdh, por nuk jep veçse emrat *Ανθευς, Κλεανθης*.

Emri i atit të Hiasintëve të Spartës, *γαχινθος*, i emigruar në Athinë si mik publik, si mik i të gjithëve, shpjegohet me shqipen *huai gjenthë* (gjithëve).

Mandej, pjesa tjetër e broshurave, u kushtohet emrave të hyjnive, ose të heronjve të mitologjisë.

Palamedesi, bir i mbretit të Eubesë, mbahet prej grekëve si shpikës i shumë gjërave, i shumë lojërave, shpjegohet me shqipen *paljam hedhës*.

Amazonat, gra luftëtare që digjinin gjirin e djathtë për ta pasur më lehtë të qëllonin me hark, vrisnin fëmijët e tyre meshkuj ose ua dorëzonin etërve të tyre. Sipas Ansesë, θηνη e pamëkuar në gji, ose Hyjni fëmijë, lidhet me *αμαζων*, ndaj Αθηναί janë Amazonat e Athinës. Ελενη e Atikës kishte të njëjtat shenja si Athina, shpjegohet me shqipen *hellë-ne*, Virgjëresha me heshtë, me silah. *Πενθεσιλεια* që Cikliket e kuptonin bintëse –ill(ëvet), Perandorja e Yjeve, për Ansenë është bintës-sjella, ajo që mban ...e shpatës. Barasvlerësi i saktë i *Αμαζων* është te emri i Nimfës *Πασιθηη*.

Emri i Peleut (Πηλευς), mbret i mirmidonëve të lolkos, bir i Eakut, mbret i Eginës, burrë i Tetisit dhe at i Akilit, shpjegohet me shqipen pjellës. Edhe epiteti *Μυρμιδωνογέ* i ngjitet *Πηλευς* shpjegohet me burr-mjedhun. Edhe kuajt e pavdekshëm të *Πηλες*-it gjejnë shpjegim me shqipen pell kalë dhe peljë pelë. Te kjo fjalë e shqipes gjen shpjegim edhe legjenda e Pelias-it, që kur ishte fëmijë, një pelë e shenjo i përjetë me patkua në faqe.

Φοινς-in, personazh i Iliadës dhe mësues privat i Akilit, e verbojnë se rivalizon më t'atin *Αμυντωρ* në dashuri me *Φθιη*-në *Αμυντωρ*-i shpjegohet prej Homerit me *.μαζεσχεγυαιχα- μητερεμην* (II, IX, 450-I), shqip amë-hunjtur.

Këto janë disa nga etimologjitë popullore të mitologjisë greke që shqyrton Anseja në... broshurat e sipërpërmendura.

Me këtë mënyrë të analizuari vështrohen prej Ansesë edhe emrat e mëposhtëm të hyjnive dhe të heronjve të mitologjisë greke. Për arsye se shpjegimet e autorit janë ata dhe parakuptojnë njohje të mirë të mitologjisë greke, në shkrimin e pranishëm, ato...në formë listash, në radhën dhe ashtu si i ka parashtruar autori.

βαιμων (pa gjak), Αντηνωρ (ndënjur), Ουχαλεγων (vek djegun) Τιθωος (zi thënë se ditun) Ρεια(reja), Αθαμας(at hamës), Ελλησποντες (sjellës shpend), Φιλυρα (peljë)..., Ιξιων (si qën), Κενταυρος (gjend avull, qen n'avull), Ιοβατηρ (gjobë atë "mulactae...", διφθερα (dhi -vdjerë) Αμυντωρ (amë-hunjtur), Αμυντορδης (emëën -thërritës), (ah-sjellës, luctus allator") Μηδεια (mjedhija, "mbledhja"), Πεισιστρτος... -dhjetë rrath(uem), Αυσιστρατη (dy-dhet<dymbëdhjetë rrath(uem), Δημητηρ damëtar), Ιχαριος (ikjari, qarësi) Στυξ (shtek, shtenk, shtok), Εχτωρ (heq -turë), Παρις (...ridh), ατροφος (atëre-hupës, atëre atëritë; vatrë hupës) Αδρηστειν (atëre-shtë shtatë etër), Αδραστος (had-rrashta "ha rreshtna, kafka") Ατρυτωνη (ha trutë), e disa të tjerë.

Më në fund, edhe si mbyllje, ja se ç'shkruan Anseja në rreshtat e fundit të broshurave të veta.

Emri Πελαγοι më duket krejt shqip. Ai do të thotë thjesht βαλανηφαγοι, fjalë e pellazgëve arkadienë, që nxirret nga pjell, mbush, dhe nga askë, lëndë ahu. Duke qenë se pjell ka marrë kuptimin e dhënies së jetës, kuptohet "bir i fηγος- it". Ka edhe një variant atik Πελαργοι (Straboni) që nuk më duket se është paronimi, po një formë e..., sipas mënyrës elene. Me domethënie lejlek, Πελαργος = shqip, ljeljek...sipas meja), për ta afruar me fjalën Λελερες që u jepet këtyre pellazgëve.

Besoj se etniku i Ελληνες-ve është edhe ai shqiptar, dhe çon te vëllam, i ...(për sveslam). Vëllamëria dodoneane e Σελλοι përbëhej prej Vëllezërish vëlla, për svesla) njëjësi i shquar i së cilës duhej të ishte Ιολαος (i vëlla) emër i vëllaut të armëve i Herakliut..

Homeri ndoshta e ka ndjerë Ελληνες hell- ljenë, "affolés de la lance", si "μεμαωτες εγχειησιν".

Gabriel Anseja on the anciency of the Albanian people
and their language

SUMMARY

In this study, the researcher, Remzi Pernaska has dealt with the contribution of the French philologist Gabriel Anse to the study of the ancient history of the Albanian people and their language. Anse had deep knowledge in social and linguistic sciences, especially in the Albanian Language.

Orjeta BAJA

RRETH *TEMËS* DHE *FOKUSIT*, SI PËRBËRËS KRYESORË INFORMATIVË TË KUMTIMIT

Shkolla e gjuhësisë në Pragë⁴⁵ ka qenë e para që ka nisur një reflektim sistematik mbi faktin se, përkrah parimeve të tipit sintaksor dhe semantik, në formën⁴⁶ që merr një kumtim, veprojnë edhe parime me natyrë pragmatike.

Gjuhët kanë mjete të ndryshme për të paraqitur strukturën informative të kumtimit në përputhje me variacionin e *dinamizmit komunikues*⁴⁷ të pjesëve të saj. Përsa i përket vendosjes lineare të përbërësve, pra rendit të fjalëve, duket se ekziston një tendencë ndërgjuhësore, sipas së cilës, kumtimet ndërtohen sipas një rritjeje të dinamizmit komunikues. Për të transmetuar një informacion, folësi vepron duke u nisur nga të dhënat e njohura bashkërisht, për ta përmbyllur me të dhëna të panjohura. Në këtë mënyrë ndërtohen zakonisht titujt e gazetave, si:

- Basha: Liberalizimi i vizave brenda 2010-s

- Tiranë: Trafiku në kaos

në të cilët vendosen në radhë të parë informacionet që mund të përbëjnë për lexuesin një pikënisje të njohur, për të vijuar më tej me informacionet e reja.

Në vijim po pasqyrojmë se nëpërmjet cilave mjete shprehëse kodifikohen dy funksionet kryesore informative të kumtimit, të *temës* dhe *fokusit*:

⁴⁵ R. Sornicola, A. Svoboda, "Il campo di tensione. La sintassi della scuola di Praga", Napoli, 1991, f. 16.

⁴⁶ Forma e kumtimit = mënyra e organizimit të informacionit.

⁴⁷ *Dinamizmi komunikues* vesh pjesë të ndryshme të kumtimit: *dinamizmi komunikues minimal* silltet nga elemente të njohura nga të dy bashkëbiseduesit; *dinamizmi komunikues maksimal* silltet nga elementë të rinj dhe të panjohur, që përbëjnë kulmin informativ, pra objektivin e vërtetë komunikues.

Përkufizohet si **temë** elementi informativ që folësi paraqet si ‘argument’ të kumtimit, lidhur kjo me atë që synohet të thuhet. Rolin e temës e luan zakonisht kryefjala.

Në dy kumtimet e mëposhtme, që përshkruajnë të njëjtën rrethanë, pra kanë vlerë semantike identike:

a- Pritja me pijet freskuese do të ofrohet nga Bashkia.

b- Bashkia do të ofrojë pritjen me pijet freskuese.

roli i temës luhet nga dy referentë të ndryshëm (‘pritja’ tek kumtimi *a*, ‘bashkia’ tek kumtimi *b*), të dy të kodifikuar si kryefjalë. Të dy fjalitë vijojnë në mënyra të ndryshme që vënë në shënjestër rolin e temës të luajtur në të dy rastet nga të dy referentët:

a- Pritja me pijet freskuese do të ofrohet nga Bashkia dhe do të shërbehet rreth orës 13:00.

b- Bashkia do të ofrojë pritjen me pijet freskuese dhe do të merret me festimet.

Ekzistojnë edhe mënyra të tjera për të vënë në pozicion teme një përbërës, si:

- Lidhur me grevën, more vesh gjë?

- Artanin, e lajmëron ti?

- Përsa i përket kërkesave për leje të paguar, vartësit duhet t’i drejtohen zyrës së personelit, në të cilët, luajnë rol teme elementët e vendosur në pozicion fillestar dhe të prirë nga ‘lidhur me’ dhe ‘përsa i përket’, ashtu si edhe kundrinori ‘Artanin’ i zhvendosur në pozicion fillestar.

Duke vendosur një element në pozicionin e temës, folësi sinjalizon bashkëbiseduesin për atë ‘lidhur me të cilën’ synon të flasë dhe e fton të grumbullojë informacionet vijuese si përkatëse të temës së parashtruar. Vendosja e temës në pozicion fillestar dhe sinjalizimi i saj me treguesit përkatës, i japin dëgjuesit udhëzimet se si ta organizojë informacionin në vijim. Tema pra, është pikënisja e një kumtimi. Si i tillë, elementi i temës ka shkallë të ulët dinamizmi komunikues, apo prezantohet nga folësi si element informativ i njohur. Kjo nuk do të thotë që tema e parashtruar nga folësi, identiteti dhe roli i saj, të pranohen pa diskutim nga bashkëfolësi, por vetëm që folësi e pret një gjë të tillë.

Zakonisht tema është një element i dukshëm dhe aktiv në ligjërim. Kur nuk ndodh kështu, ky fakt mund të sinjalizohet me struktura të veçanta: shqipja disponon për këtë qëllim fjalinë prezantuese ‘është *x* që’, që shërben për të futur një element të ri në modelin e ligjëratës, duke sinjalizuar njëkohësisht se ajo është tema që parashtrohet për fjalitë vijuese:

(1) - Çfarë po ndodh?

- *Është macja që gërvish tek dera.*

(2) *Na ishte njëherë një kukull prej druri që...* [fillimi i përrallës]

(3) *Ishte një italian, një skocez dhe një francez që po udhëtonin me avion...* [fillimi i barceletës]

Përkufizohet si **fokus** pjesa e kumtimit që ka shkallën më të lartë të dinamizmit komunikues, pra që përbën objektivin komunikues të mesazhit. Fokusi i një kumtimi është zakonisht i vendosur në pozicion fundor. Përveç këtij treguesi, një rol thelbësor luan edhe prozodia: folësit kanë tendencë të sinjalizojnë me një theks më të fortë pjesën e kumtimit që ka shkallën më të lartë të dinamizmit komunikues. Të dy këto sinjale funksionale lehtësojnë perceptimin e pjesës kryesore të kumtimit nga ana e dëgjuesit. Fokusi është në fakt pjesa themelore e një kumtimi. Kjo është veçanërisht e dukshme në dialogjet pyetje-përgjigje: në këtë rast, elementet që kanë shkallë më të vogël dinamizmi komunikues, të pranishme në pyetjen e drejtuar, mund të hiqen gjatë përgjigjes.

Në dialogun:

(1) A- E ke paguar kafen?

B- Po!

fokusi informativ tek i cili synon pyetja e folësit A, është kryerja e veprimit 'paguaj kafen' nga ana e bashkëfolësit B. Në përgjigjen e tij, B sqaron këtë informacion (pra faktin se veprimi në fjalë është kryer).

Përkundrazi, në dialogun :

(2) A- Kush e pagoi kafen?

B- Unë!

fokusi informativ tek i cili synon pyetja e folësit A, është identiteti i individit, të cilit i atribuohet përgjegjësia për faktin e verifikimit të rrethanës së 'pagesës së kafes'. Në përgjigje, bashkëbiseduesi B sqaron këtë informacion. Ndërsa fakti që rrethana e 'pagesës së kafes' është verifikuar, konsumohet nga vetë pyetja.

Në të dy rastet e mësipërme (1) (2), *fokusi është i tipit plotësues*: një informacion qendror i ri, që dëgjuesi nuk e kishte më parë dhe që, në vijim të kumtimit nga ana e folësit, dëgjuesi thjesht e integron në ligjërim. Por mund të ndodhë edhe që një informacion i ri të shtohet jo thjesht si i ri, por të seleksionohet mes disa alternativave të përmendura në ligjërim. Një informacion qendror i këtij tipi, i quajtur *fokus kundërshtues* (me kontrast), sinjalizohet me anë të mjeteve gjuhësore të ndryshme nga ato të fokusit plotësues, dhe normalisht më të forta, si p.sh. një theks kundërshtues specifik apo një strukturë sintaksore e përshtatshme. Në gjuhën shqipe, një fokus kundërshtues sinjalizohet nga një strukturë e tipit "është x që duhet të bëjë y", p.sh.: "Ti duhej ta paguaje" del "Ishe ti që duhej ta paguaje" (dhe

jo të tjerët). Në këtë mënyrë, folësi sinjalizon bashkëbiseduesin se ekzistojnë edhe kandidatë alternativë për rolin qendror, por që përjashtohen.

Tek shembulli:

A- E ke paguar ti tashmë kafen, apo ta paguaj unë?

pyetja e drejtuar nga A formulohet në mënyrë që të sqarohen kandidatët e mundshëm për realizimin e kësaj rrethane ‘pagesës së kafes’, dhe nëpërmjet pyetjes kërkohet të tregohet se cili nga këta kandidatë është efektivisht i vlefshëm: ‘unë’ dhe ‘ti’ janë fokuse kundërshtues.

Një kontrast edhe më i fortë paraqitet tek shembulli:

A- E pagove kafen?

B- Unë jo, ishe ti që duhej ta paguaj.

Këtu, fokusi kundërshtues ‘ti’ i përdorur nga folësi B, sinjalizon bashkëbiseduesin A se duhet të fshijë nga ligjërimi i tij bindjen, e vetëkuptueshme në pyetjen e tij, se bashkëbiseduesi B ishte natyrshëm kandidati që duhej të kryente veprimin e ‘pagesës së kafes’.

Nisur nga pikëpamja informative, *një fokus plotësues* ka funksionin e shtimit të një informacioni duke sinjalizuar se ky informacion nuk është akoma pjesë e ligjërimin. *Një fokus kundërshtues* ka funksionin e dhënies së një informacioni duke sinjalizuar se në ç’ mënyrë duhet të modifikohet një përbërës i mëparshëm në ligjërim.

Në bazë të dy funksioneve themelore të kumtimit, të *temës* dhe *fokusit*, dallohen struktura informative të ndryshme⁴⁸. Në vijim po paraqesim strukturat informative më të studiuara, që kanë çuar në përfundimin e këtyre kumtimeve:

- Një *kumtim prezantues* ka si objektiv komunikues t’i prijë në ligjëratë një referenti të ri, që në vijim do të mund të kryejë funksionin e temës. Ndërtohet nga një strukturë verbale, në të cilën hyn, në pozicion qendror, referenti i ri që do të bëhet temë e ligjëratës në vijim:
 - U bë i gjallë Dritani.
 - Ja ku është macja.
 - Ishte një ëmbëlsirë shumë e mirë.
- Një *kumtim kallëzuesor* ka si objektiv komunikues të japë informacione lidhur me një referent të identifikueshëm të vendosur si temë:
 - Përsa i përket Dritanit, nuk ka probleme.

⁴⁸ K. Lambrecht, “Information structure and sentence form. Topic, focus and the mental representation of discourse referents”, Cambridge, 1994, f. 41.

- Macen e çon ti tek veterineri?

- Shkodër: trafik i rënduar.

Ka raste kur një temë aktive në ligjërim mund të lihet jashtë. Në këtë rast kemi struktura kallëzuesore me temë të nënkuptuar ose të pathënë:

- [Ç'më thua për Dritanin?] Nuk ka probleme.

- [duke treguar nga macja] E çon ti tek veterineri?

- Një *kumtim eventiv* (i ngjarjes) ka si objektiv komunikues të informojë mbi ndodhinë e një ngjarje, duke e futur si të re në tërësinë e saj, por pa sinjalizuar një temë 'në bazë të së cilës' do të radhitet informacioni. Në këto lloj kumtimesh nuk është lehtësisht i dallueshëm pozicioni i temës, sepse i gjithë kumtimi prezantohet si tërësisht qendror, pa 'pikënisje' që bën lidhjen me bisedën që po zhvillohet:

- Telefoni Dritani.

- Është e nevojshme të çohet macja tek veterineri.

- Cunami i frikshëm në Oqeanin Indian.

- Një *kumtim identifikues* ka si objektiv komunikues të identifikojë referentin e duhur në një marrëdhënie kallëzuesore, ndoshta edhe duke kundërshtuar informacione tashmë të pranishme në ligjërim. Në këto kumtime, një element qendror i tipit kundërshtues i kundërvihet një kallëzimi të paraqitur si i padiskutueshëm. I gjithë interesi informativ qëndron tek shquarja e elementit qendror, ndërkohë nuk mund të flasim për një element të mirëfilltë teme:

- Dritani ka telefonuar?

- Kush mund ta çojë macen tek veterineri?

- Janë italianë dhuruesit e këtyre librave.

Çdo gjuhë ka mjetet e saj specifike për të sinjalizuar strukturën informative të kumtimeve, por jo gjithmonë ekziston një lidhje e qartë mes nyjetimit informativ të kumtimit dhe mjeteve shprehëse që e sinjalizojnë. E njëjta strukturë gramatikore mund të përdoret për të shprehur më shumë se një strukturë informative, ose ndryshe, struktura e një kumtimi mund të jetë e turbullt nga pikëpamja e nyjetimit informativ dhe përkufizohet plotësisht vetëm brenda ligjëratës ku bën pjesë. Në shqip, rendi bazë i fjalisë

kryefjalë-kallëzues-kundrinor, me theks fundorl, mund të ketë sa funksion kallëzuesor aq edhe funksion eventiv:

- [Ku janë djemtë?] Luani ka çuar biçikletën tek mekaniku, Iliri është në pishinë.

- [Çfarë ka ndodhur?] Luani ka çuar biçikletën tek mekaniku.

Funksionet e *temës* dhe *fokusit* janë opsione në dispozicion të folësit për të sinjalizuar në mënyrë të kuptueshme se si do të interpretohet informacioni që transmeton kumtimi dhe se si do të integrohet në ligjërim. Përveç këtyre, disa studiues⁴⁹ dallojnë edhe funksione të tjera që, në kumtimet e identifikueshme brenda një bisede në formë dialogu, mund të paraqiten me njëfarë rregullsie dhe që janë të pajisura me mjete shprehëse që përsëriten: karakteristik është fakti se mund të sinjalizohen nga një intonacion i veçantë. Në disa raste bëhet fjalë për funksione që kanë të bëjnë me *transmetimin e mirëfilltë të informacionit*, në raste të tjera për funksione që kanë të bëjnë me *drejtimin e bisedës*:

Funksioni setting (i vendndodhjes) lidhet me shpërndarjen e informacionit dhe disa studiues e përfshijnë në funksionin e *temës*. Këtë funksion (të vendndodhjes) e kryejnë elementet që japin koordinata hapësinore-kohore, në lidhje me të cilat bëhet i vlefshëm informacioni i transmetuar:

- Nesër, a je aty?

- Kinë: ekonomia e tregut përparon.

Më të lidhura me drejtimin e bisedës janë:

funksioni i apelit (i thirrjes), me të cilin tërhiqet vëmendja e bashkëbiseduesit:

- Landi? Si thua për të?

funksioni i hapjes, me anë të të cilit folësi sinjalizon fillimin e kumtimit apo të një pjese të re të ligjëratës:

- Beh! Nëse jeni dakort, do të filloja.

funksioni i mbylljes, me anë të të cilit folësi sinjalizon se synon t'i japë fjalën bashkëbiseduesit:

- Fillojmë, apo jo?

Në mbyllje, theksojmë se prania e dy përbërësve kryesorë informativë të kumtimit, është funksionale për sinjalizimin se në ç'mënyrë do të integrohet në ligjërim informacioni që transmeton kumtimi. Kumtimet prezantuese, kallëzuese, identifikuese dhe eventive na shpjen në funksione të ndryshme komunikuese.

⁴⁹ E. Cresti, "Corpus di italiano parlato", Firenze, 2000, f. 53.

BIBLIOGRAFI:

1. C. Andorno, "Che cos'è la pragmatica linguistica", Roma, 2009.
2. E. Cresti, "Corpus di italiano parlato", Firenze, 2000.
3. E. Lombardi Valauri, "La struttura informativa dell'enunciato", Firenze, 2002.
4. F. Orletti, "La conversazione diseguale. Potere e interazione", Roma, 2000.
5. K. Lambrecht, "Information structure and sentence form. Topic, focus and the mental representation of discourse referents", Cambridge, 1994.
6. M. Bracops, "Introduction à la pragmatique: les théories fondatrices: actes de langage ...", Paris, 2006.
7. R. Sornicola, A. Svoboda, "Il campo di tensione. La sintassi della scuola di Praga", Napoli, 1991.
8. S. Levinson, "La pragmatica", Bologna, 1993 (trad. it).
9. Xh. Lloshi, "Stilistika dhe pragmatika", Tiranë, 2006.

Le thème et le focus, des principaux éléments de la proclamation.

RESUME

Dans cet article, l'auteur souligne les faits que: les langues ont des outils différents pour présenter la structure informative de la proclamation et en ce qui concerne l'ordre des mots, il apparaît une tendance de toutes les langues, selon lesquelles, les proclamations se construisent selon une progression de dynamisme communicatif. Pour transmettre de l'information, l'orateur agit à partir des données connues pour refermer avec des données inconnues.

Les moyens d'expression qui codifient les deux fonctions principales de la communication de l'information sont : *le thème*, principal élément d'information, qui est défini comme le sujet que l'orateur présente comme *argument* de la proclamation ; *le focus*, élément d'information, qui a le plus haut degré de dynamisme communicatif. L'objectif d'une proclamation se trouve généralement dans la position finale. Le focus est en effet un élément essentiel d'une proclamation.

Qemal MURATI

DUKURI DHE NOCIONE SOCIOLOGUISTIKE TË KOMUNIKIMIT

1. Ajo që quhet *sociolinguistikë* na mëson që, ndryshe flasim me dikë në kafene, ndryshme kur jemi përpara një eprori, dhe ndryshe flasim (komunikojmë) në një konferencë shkencore, etj. Pra, si thotë populli: *sipas vendit, bëhet kuvendi*.

Gjuhën mund ta përdorim në disa nivele: në *rrafshin formal* (standard), *informal* (substandard), në formë të *shkujdesur*, etj. Çabej thoshte se kur flasim mund të përdorim *format lente* (të ngadalshme): *shtëpi*, dhe *format alegro*: *shpi*, varësisht sipas situatave të ndryshme sociolinguistike.

Pra, *Sociolinguistika* është disiplinë shkencore që studion lidhjet e ndërsjella mes varianteve të një gjuhe dhe shtresëzimit shoqëror të bashkësisë që e përdor atë gjuhë. Ngërthen një problematikë shumë të gjerë të raporteve *gjuhë-shoqëri*, duke filluar nga studimi i përdorimeve individuale dhe i varianteve sociale të gjuhës, i dygjuhësisë, i gjuhëve hibride dhe deri te problemet e politikave gjuhësore, etj. Kjo ushqehet sa nga hetimet mbi lëndën konkrete, aq dhe nga përgjithësimet teorike (Memushaj 2002).

Varianti gjuhësor i shtresave të ndryshme shoqërore të një komuniteti brenda një dialekti regjional është quajtur *sociolekt*. Është mënyra e shprehjes së popullsisë së varfër, të pasur, fshatare, qytetare, politike.

Sociolinguisti i njohur amerikan Joshua Fishman për larminë e gjuhës ka krijuar dhe termin *çelësi i sociolinguistikës* - që do të thotë gjuha është e larmishme sipas këtyre pyetjeve: *Kush flet? Me kë flet? Ku flet? Kur? Për çfarë? Dhe në cilin varietet gjuhësor?*

2. *Hulumtimi i normave të komunikimit* në bashkësinë gjuhësore, përfshirë këtu faktorët folësorë, jofolësorë dhe shoqërorë, njihet me termin a nocionin *etnografia e të folurit (komunikimit)* (ang. *ethnography of speaking*). Çdo shoqëri ka normat e veta të sjelljes komunikative. Nëse dikush rri ulur në karrige në restorant dhe dëshiron të marrë kripën që nuk mund ta arrijë, mund t'i drejtohet tjetrit: *Kini mirësinë të më jepni kripën?*,

ose: *Ju lutem, më jepni kripën ose Ma jepni atë kripën*; madje mund dhe të mos thotë asgjë, por ta shtrijë dorën përmbi personin tjetër dhe ta marrë kripën. Disa sjellje janë më të pranueshme se të tjerat, kjo varet nga situata, ndërsa disa të tjera nuk janë fare të pranueshme.

Për të treguar respekt dhe afri më të madhe ndaj mysafirit, në anë të Kërçovës (Maqedoni) kemi veneruar që i zoti apo e zonja e shtëpisë do t'i drejtohet atij me: *do të pimë bashkë nga një kafe ?* (në shumës). Ndërsa po t'i thuhet *a doni një kafe ?*, ose po t'i çohet kafeja pa e pyetur, kjo do të ishte sjellje më formale, por më pak e përzemërt se e para.

Është e rëndësishme të theksohet që normat nuk janë të njëjta në çdo shoqëri. Në traditën shtëpiake baske i zoti i shtëpisë dëshirën e tij edhe për një gotë verë mund ta komunikojë duke i rënë tavolinës, pa asnjë fjalë; kjo mbase nuk do të ishte e pranueshme për bashkësinë gjuhësore angleze (dhe as që është e zakonshme kjo për të rinjtë baskë).

Linguistët antropologë qysh prej shumë kohësh theksonin rëndësinë e sjelljes në komunikim në kontekstin kulturor, ndonëse emërtimin *etnografia e të folurit* (ose *etnografia e komunikimit*) e krijoi në vitet 70-të linguisti antropolog amerikan Dell Hymes. Hulumtuesit veneruan variabla të shumta në bashkësi të ndryshme folësore: forcën e të folurit, lartësinë e të folurit, largësinë ndërmjet folësve, shprehësinë dhe pozicionet, shikimin dhe kontaktet me sy, mënyrën e kushtëzimit, rregullat e fillimit të bisedës dhe shumëçka tjetër.

Meksikanët në bisedë parapëlqejnë të rrinë më afër sesa amerikanët, që do të ishte kjo qesharake kur meksikani do të fliste me amerikanin. Italianët kur flasin bëjnë shumë gjestikulime, kurse suedezët jo. Hulumtimi i etnografisë së komunikimit sjell surprizime pa fund dhe sot për këtë problematikë ekziston një literaturë e pasur (Trask 2005).

3. Përdorimin e dy varieteteve gjuhësore në funksione të ndryshme, “të lartë” (arsim, administratë, kulturë), dhe “të ulët” (komunikimi i përditshëm në shtëpi ose në rrugë), e shënjon termi sociolinguistik *diglosi*. Me fjalë të tjera, diglosia është ekzistenca pranë njëra-tjetrës e dy varianteve të së njëjtës gjuhë. P.sh. në Zvicër, ku gjermanishtja letrare dhe “Schweizerdeutsche” (dialekti zviceran) fliten pranë njëra-tjetrës. Sociolinguisti amerikan J. Fishman mendon se *diglosia* duhet dalluar me kujdes nga *bilinguizmi* që është më shumë objekt studimi për psikologët dhe psikolinguistët, pasi ka të bëjë me aftësinë e një individi për të përdorur më shumë se një variant gjuhësor; ndërsa *diglosia* është objekt i sociologëve dhe i sociolinguistëve dhe ka të bëjë me distribucionin e më shumë se një varianti të gjuhës për përmbushjen e nevojave të ndryshme

komunikimi në shoqëri.

Kur njeriu njërën gjuhë e di mirë, tjetrën e di jo mirë, kemi *diglosi të çalë*.

4. Në praktikat sociolinguistike ndeshim dhe nocionin *ekolinguistikë* (ose *ekologjia e gjuhës*) – degë e lingistikës e cila merret me hulumtimin e raporteve ndërmjet gjuhëve, si dhe me raportin e njerëzve ndaj gjuhës/gjuhëve. Gjithashtu hulumton dhe raportin ndërmjet gjuhëve dhe rrethit (gjuhë të ndryshme, institucione të caktuara shoqërore, faktorë natyrorë etj.), në të cilat gjuha ekziston dhe funksionon. Ka të bëjë me mënyrën e përdorimit të gjuhës dhe me organizimin dhe të drejtat për përdorimin e gjuhës nëpër vende të ndryshme, tolerancën e shtetit përkatës për gjuhët minoritare dhe ofrimin e gjuhës së vet secilit person për shkollim dhe në situata përgjegjësie. Një problematikë tjetër e kësaj disipline është “ndotja e gjuhës”, qoftë e natyrës etike – keqpërdorimi i gjuhës, sidomos në mjetet e informacionit, internetit, madje dhe ideologjizimi i gjuhës etj., qoftë të natyrës estetike – trysnia ndaj funksionit estetik të gjuhës në letërsi. Edhe raportet ndërmjet gjuhëve të mëdha dhe gjuhëve të vogla përfshihet në kompetencën e gjuhësisë ekologjike. Sociolinguisti norvegjez Hogen konsiderohet ndër themeluesit e *ekologjisë gjuhësore* (Islamaj 2008).

SHKURTIMET E LITERATURËS

1. Islamaj 2008 = Islamaj, Shefkije, *Gjuha dhe identiteti*, Botimet Toena, Tiranë, 2008.
2. Memushaj 2002 = Memushaj 2002 = Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, Tiranë, 2002.
3. Trask 2005 = Trask 2005 = Robert Lawrence Trask, *Temeljni lingvistički pojmovi*, Školska knjiga, Zagreb, 2005.

Sociolinguistic phenomena and notions of communication

SUMMARY

The author in this article shows that sociolinguistics includes a range of problematic language-society relations, starting from the study uses individual and social variations of language, bilingualism, language hybrid of sociolinguistikës etj. Çelësi decomposed by questions: Who speaks? Who speaks? Speaking? When? For what? And which language variety? Concepts to be distinguished diglosi - bilinguizëm. Gjithasht should distinguish the notion ekolinguistikë research dealing with relations between languages, and the ratio of people to languages.

Merita HYSA

PLANIFIKIMI GJUHËSOR DHE EFEKTET E GLOBALIZMIT NË GJUHËN SHQIPE

Ekzistenca evolutive e gjuhëve ka tërhequr shpeshherë vëmendjen e gjuhëtarëve dhe studiuesve në përgjithësi, kjo sepse çdo element i veçantë i zhvillimeve gjuhësore përkon me një fazë reale të zhvillimit të shoqërisë. Çdo individ qëkur lind e gjen veten anëtar të një bashkësie të caktuar shoqërore, si rrjedhojë ai i nënshtrohet në mënyrë të vetëdijshme (zgjedh të jetë përdorues i një varieteti ose gjuhe të veçantë) ose edhe instiktivisht (është folës i lindur i një gjuhe a varieteti) të gjitha sanksioneve socio-kulturale që i ofron kjo bashkësi.

Në qoftë se ne pranojmë faktin që gjuha është një domosdoshmëri ekzistenciale dhe refleks i drejtpërdrejtë i jetës shoqërore, atëherë nuk kemi si të mos i vërejmë edhe diferencimet që i bëhen asaj, jo vetëm në individë të ndryshëm, por edhe në situata jokonstante përdorimi.

Pikërisht në këtë moment ne kemi pranuar konceptin e variabilitetit gjuhësor, që përbën një prej shfaqjeve dhe funksioneve themelore të gjuhës në një bashkësi. Gjuha ndryshon pasi ndryshojnë edhe kushtet në të cilat ajo përdoret, si rrjedhim duket se një prej elementeve më qenësore që përlligj vetë ekzistencën e saj, është funksioni pragmatik. Një funksion i tillë bën të mundur dekodimin e drejtpërdrejtë të skemave konkrete të komunikimit, duke iu referuar inventarit gjuhësor dhe përjashtësimeve të mesazheve nëpërmjet procesit të të folurit.

Diskutimet që përfshijnë raportet gjuhë-të folur, bartin në vetvete një koncept binar që rrok aspektin më të përgjithshëm të krahasimit të tyre. Këtu i referohemi shkollave të ndryshme gjuhësore dhe periudhave të zhvillimit të shkencës së gjuhësisë, për të parë se cili prej koncepteve ka qenë zotërues.

Studimet e thelluara të fund shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX e kundruan gjuhën si shfaqjen më reale të ekzistencës së një bashkësie, duke studiuar lakoren e ndryshimeve të saj diakronikisht dhe duke lënë në hije mënyrën e funksionimit real të saj.

Ndryshe ndodh me studimet më të reja në këtë lëmë, të cilat vërejnë aspektin dinamik të zhvillimit të gjuhës, shfaqjet dhe ndryshimet e saj,

pikërisht të folurit. Ky proces shihet në një kah të dyfishtë, nga njëra anë të folurit, siç vëren Sosyr është krejtësisht individual, sepse varet nga “vullneti i folësit”⁵⁰, dhe nga ana tjetër, përderisa ai na jep mundësinë të komunikojmë në një bashkësi të caktuar dhe meqenëse komunikimi është një veprimtari shoqërore, mund të thuhet se edhe të folurit ka karakter shoqëror dhe është një aspekt real i bashkëveprimit shoqëror.

U ndalëm më tepër tek të folurit, si një prej shfaqjeve më të prekshme dhe variable të gjuhës. Në këtë rrafsh sistemi gjuhësor pëson ndryshimet më të dukshme, që prekin jo vetëm nivelin leksikor, por edhe nivelet e tjera gjuhësore.

Gjuha shqipe është në fazën e përqaasjeve të gjera gjuhësore, të cilat variojnë nga një dygjuhësi e thjeshtë dialektore, e krijuar si rezultat i migrimit të brendshëm të popullsisë, deri te ‘beteja’ disi e pashpresë me elementet e huaja që duket sikur burojnë vazhdueshëm nga porët e një shoqërie në zhvillim.

Janë këto dy etapa që ndikojnë në mospërvetësimin e plotë të së ashtuquajturës ‘metagjuhë’ nga individët shqipfolës. Problemeve të përballjes standard-dialekt, duket se po i shtohet një virus i ri, elementet e huaja, që në shumë rrethana rezultojnë fitimtarë, sidomos në ligjërimin e shkujdesur.

Dobësitë strukturore në përdorimin e standardit sjellin si pasojë dyndje të panevojshme strukturash të huazuara, gjë që lidhet me të asimiluarit e kësaj dukurie si një orientim i ri drejt një kulture globale. Në këtë fazë jemi duke u përballur me krijimin e një substrati të shqipes, thënë ndryshe me një ‘shqipe trendy’, e cila po i kapërcen caqet e një përdorimi të dëshiruar normativ.

Kjo gjendje lidhet me një liri të tepruar në përzgjedhjen e mjeteve një ose shumë gjuhëshe, gjë që u fal një konotacion negativ dhe të paqartë mesazheve të përcjella nga bashkëbiseduesit.

Shpeshherë dëgjojmë të përmenden terma të tillë si ekonomi globale, teknologji globale, globalizim kulturor etj., të cilët janë bërë pjesë e një rituali të përditshëm mediativ duke i servirur këto procese si një ekuacion me ndryshore të njohura dhe me përfundim gati të pritshëm, pa u ndërgjegjësuar për refleksat që këto procese paraqesin për kulturën tonë, në të gjitha nivelet e jetës shoqërore.

⁵⁰ F.de Sosyr, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002, f. 35.

Ndërsa në aspektin socio-ekonomik globalizimi po shihet si një maratonë e pandalshme, si një virozë mbase e dobishme, që po prek gjymtyrët e brishta të bashkësive të vogla shoqërore, në aspektin gjuhësor duhet rivlerësuar ndikimi i kësaj kulture globale.

1.1. *Elemente të planifikimit gjuhësor*

Procesi i standardizimit të gjuhëve përkon me një seri fazash. Ideja e seleksionimit të një varieteti gjuhësor, i cili do t'i shërbejë njësimi kombëtar dhe do të rrisë shkallën e identitetit kombëtar, është faza e parë e këtij procesi.

Ky varietet fillimisht do të përdoret nga një pjesë e veçantë e popullsisë dhe më vonë do të përhapet në të gjitha nivelet e organizimit shoqëror.

Pasi përzgjidhet varieteti që quhet “i denjë” për t'u vendosur në bazë të gjuhës standard, del si domsdoshmëri njësimi i normës drejtshkrimore, normës leksikore dhe asaj gramatikore. Në shumë raste duhen ndërmarrë një sërë masash që lidhen me pasurimin dhe zhvillimin e sistemit leksikor, në mënyrë që përdorimi të mbulojë sfera të ndryshme dhe sektorë të veçantë të një shoqërie moderne që ndryshon pareshtur.

Haugen⁵¹ ka parashtruar disa pika që lidhen me fokusimin e proceseve standardizuese:

- Së pari, përcaktimi i vatrës shoqërore, përmes së cilës realizohet “*statusi i planifikimit*”. Ky proces ka të bëjë me vendimet që duhet të marrë një shoqëri në lidhje me përzgjedhjen në të gjitha nivelet gjuhësore që përmendëm më sipër.
- Së dyti, identifikimi i vatrës gjuhësore, që përbën “*korpusin e planifikimit*” dhe ka të bëjë me nismat që merren nga institucione të caktuara për të kodifikuar dhe përpunuar (njëkohësisht dhe zhvilluar) një gjuhë.

Përmes këtyre dy fokuseve gjuhësore dhe shoqërore njëkohësisht Einnar Haugen⁵² sillte një model të përgjithshëm të planifikimit gjuhësor, duke skematizuar fazat nëpër të cilat duhet të kalojë përzgjedhja gjuhësore dhe fiksimi i një norme të përbashkët.

⁵¹ E.Haugen, *Bilingualism and language planning*, Berlin, 1987, f.268.

⁵² Po aty, f.275

	Forma (ose politikat e planifikimit)	Funksioni (kultivimi i gjuhës)
Shoqëria (statusi i planifikimit)	1. Seleksionimi (procedurat e përzgjedhjes) a- Identifikimi i problemeve b- Përcaktimi i formave normative	3. Zbatimi (përhapja përmes arsimimit) b- procedurat e korrigjimit të formave të pasakta c- vlerësimi
Gjuha (korpusi i planifikimit)	2. Kodifikimi (procesi i standardizimit) a- fiksimi i një norme drejtshkrimore b- fiksimi i një norme gramatikore c- procesi i leksikalizimit	4. Përpunimi (zhvillimi funksional) a- evoluimi i terminologjisë b- zhvillimet në nivel stilistikor c- institucionalizimi dhe ndërkombëtarëzimi i normave të njësuar

Planifikimi gjuhësor, si proces, zhvillohet duke i shqyrtuar kodet në kontekstin e tyre shoqëror, politik, ekonomik, psikologjik dhe demografik. Një analizë e tillë e përkufizimit të planifikimit gjuhësor na çon në cilësimin e tri entiteteve: *planin*, *planifikuesit dhe planifikimin*, të cilat shihen si elemente në procesin kompleks të standardizimit dhe integritit të sistemeve gjuhësore.

Plani, lidhet me programet (maketet) e propozuara në fazën fillestare të njësimit të gjuhës. Ai parakupton bashkërendimin e disa disiplinave dhe i vlerëson ato përmes përfshirjes në struktura të caktuara administrative.

Realiteti është se *planifikuesit* u përkasin mjediseve kulturore të veçanta dhe operojnë nën ndikimin e përbërësve shoqërorë, kulturorë, ekonomikë dhe politikë.

Së fundi është përmasa ‘e *planifikimit*’ ose zbatimi i maketit të formuluar nga planifikuesit. Procesi i planifikimit është kompleks dhe lidhet me mënyrën sesi funksionon dhe ndryshon një bashkësi shoqërore, i bazuar në prirjet historike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore.

Në qoftë se planifikimin gjuhësor do ta shihnim si përpjekje të një klase shoqërore për të modifikuar dhe përmirësuar sjelljen gjuhësore të një bashkësie për arsye të caktuara, do të zbulonim në thelb funksionin e gjuhës standard. Formimi i standardeve kryesisht përkon me formimin dhe konsolidimin e kombeve dhe njihet si gjuhë prestigji, varietet i konotuar shoqërisht.

Krijimi i standardit të shqipes mund të zërë vend në përshkrimin e mësipërm, duke pasur parasysh fazat dhe zbatuesit e tyre.

1.2. Reflekse të ndikimeve globaliste në shqipen e sotme dhe roli i planifikimit gjuhësor

Sot standardi ynë po përballlet me diskutime të gjera, nga njëri krah qëndrojnë rishikuesit e tij, për të mos përmendur një term më të mprehtë, ‘kundërshtarët’ e tij, që në çdo moment përpiqen të vënë në dukje aspektet delikate me të cilat po përballlet gjuha jonë zyrtare. Nga ana tjetër ne po përballemi me një trysni të madhe termash të huaj, që kanë hyrë në zhargonet e përditshme të shqipfolësve.

Diskutimet mbi vlefshmërinë ose jo të standardit nuk duhen kufizuar vetëm në artikuj problematikë, me nxjerrjen e të dhënave ‘in vitro’, por në krijimin e një kuadri të gjerë teorik, i cili duhet të ofrojë zgjidhje konkrete për problemet në fjalë.

Standardizimi është një proces i vazhdueshëm, për të cilin mund të theksojmë vetëm se kur ka nisur dhe ç’arritjesh janë shënuar gjatë kësaj rruge. Duke qenë se zhvillimi i një gjuhe duhet të shkojë krahas me zhvillimin shoqëror, lakorja e ndryshimeve paraqitet e pandërprerë, si rrjedhim edhe reflektimet gjuhësore nuk mund të mbeten peng i disa të dhënave të quajtura ‘të patjetërsueshme’, por duhet të përfshihen në vorbullën e përditësimeve të shpeshta.

Kemi dëgjuar shpesh të flitet për planifikim gjuhësor dhe për politika zyrtare në zbatimin e normës. Përdorëm një kohë të tillë, sepse tanimë e tashmja mungon në politikat shtetërore për mbrojtjen dhe zhvillimin e gjuhës standard.

Në qoftë se me politikë gjuhësore kemi parasysh aktivitetin e ndërgjegjshëm me të cilin shteti vendos të ndërhyjë në mënyrë sistematike, me qëllim që të modifikojë një gjuhë ose raportet që ekzistojnë midis varieteteve të ndryshme gjuhësore në një territor të dhënë⁵³, me keqardhje do të vërenim se një qëndrim i tillë thuhet mungon pas viteve ’90.

⁵³ C.Baylon, H.Mignot, *Komunikimi*, Shkup, 2004, f.184.

Në vjetarët e ndryshëm studimorë kjo situatë zbrazëtie justifikohet në mënyra të ndryshme, duke dhënë konsiderata të pjesshme lidhur me ndikimet e shpejta të strukturave të huaja.

Tranzicioni socio-ekonomik padyshim dha reflekset e tij edhe në aspektin kulturor e gjuhësor. Situata paraqitet shqetësuese pasi përdorimi i gjerë i fjalëve të huaja po dobëson edhe strukturat gramatikore të gjuhës. Në qoftë se fillimisht ishte niveli leksikor, më i prekur nga këto njësi, sidomos nga bumi i pashmangshëm i neologjizmave terminologjike, refleksi i ndërhyrjeve të një dinamizmi shoqëror, tanimë ne po përballemi edhe me përdorime jokorrekte morfologjike dhe sidomos sintaksore. Duket se përdorimi i pasaktë mediatik dhe nga elitat socio-politike i trajtave gjuhësore, është bërë një problem shqetësues për studiuesit e shqipës.

Në këtë fazë duhen zbatuar masa dhe projekte të mundshme që institucione të veçanta ndërmarrin në këtë drejtim, për të rivendosur themelet e një standardi më të konsoliduar.

Problemet mund t'i vërejmë edhe në aspekte më konkrete, që lidhen me ndërhyrjet në nivelet e ndryshme gjuhësore të këtyre elementeve:

- Në nivelin fonetik, ndërhyrjet prekin sidomos çështjet që lidhen me drejtshkrimin dhe transkriptimin e njësive të huazuara, jo sepse shqipja nuk ofron një inventar fonemor (dhe grafemor njëkohësisht) të pasur, por sepse ligjësitë e lidhjes dhe konkretizimit të njësive në lema të ndryshme variojnë nga një gjuhë në tjetrën. Këtu jemi para një diskutimi të pazgjidhur, nëse duhet t'i ruajmë të paprekura strukturat e huaja fonetike, apo duhet t'i përshtasim me sistemin tonë drejtshkrimor, për të siguruar një shqiptim sado të përafërt me origjinalin. Në qoftë se do t'i referoheshim kodit tonë drejtshkrimor, atëherë do të prananim mundësinë e dytë, gjatë zbatimit të së cilës, do të vërenim shpesh inkoherenca drejtshkrimore, të cilat lidhen me numrin e madh të elementeve të huaja që janë në qarkullim këto kohë.

Një mosnjohje e drejtë e gjuhëve origjinale çon shpesh në krijimin e situatave groteske gjatë shqiptimit të fjalëve. Kjo lidhet sidomos me përballjen e njësive leksikore që vijnë nga gjuhët që kanë një transkriptim të ndryshëm nga shkrimi, sidomos anglishtja dhe frëngjishtja. Në të tilla raste nuk mund të bëhet një përshtatje grafemore identike, p.sh. *National Geographic* (nuk mund ta shqipërojmë 'neshënnall xheografik' ??), ose *The Economist*, *Daily Telegraph* etj.

Si rrjedhim për mendimin tonë më e pranueshme do të ishte alternativa e parë, e cila duhet të plotësohet me një transkriptim të përafërt nëse ndihet i nevojshëm.

Lidhur me këtë çështje, duhet rishikuar drejtshkrimi i shqipes, për të shtuar ato elemente që i shtron për zgjidhje vetë evolucioni gjuhësor.

- Në nivelin leksikor komentet për ndërhyrjet e shumta do të ishin të tepërta, veçse në rastet kur kemi një mbivendosje njësisish, fjalëve që janë të pranishme në shqipë, u kërkohen në mënyrë të sforcuar, shumicën e rasteve thjesht për variacion⁵⁴, gjegjëset e huaja.

Përdorime të tilla si: *staf, bord, unifikoj, axhendë, impakt, kauzë, komunitet*, e një mori fjalësh të tjera, për më tepër edhe huazime që kanë hyrë së bashku me objektet që përfaqësojnë, si: *e-mail, hard-disk, I-pod, chat, flash-driver, PC* etj, kanë bërë që ligjërimi ynë i përditshëm të dalë jashtë kufijve njëgjuhësorë.

Fakte të ngjashme i vërejmë edhe në gjuhë me një standard më të konsoliduar se yni, të cilat mjaftohen me huazime reciproke në nivel terminologjik, ku shpeshherë janë gjetur edhe gjegjëse të vlefshme.

Disa studiues nuk i shohin këto të dhëna shqetësuese⁵⁵, por më tepër si elemente të domosdoshme të një një ekzistence globale evolutive.

Është e vërtetë që në shumë raste (edhe në shembujt që dhamë pak më lart), në vend të një mungese terminologjike, huazimi është një proces instiktiv që bazohet në krijimin e një kuadri të plotë komunikativ, por mbetet e diskutueshme çështja e përdorimit të njësive të panevojshme në ato raste kur gjuha e plotëson këtë nevojë për komunikim.

Dallimet mes një përdorimi ‘të mirë’ dhe jo ‘të mirë’ të gjuhës, lidhen me shfaqjet konkrete ligjërimore, si rezultat të ashtuquajturat ‘risi’, kanë prekur shumë shpejt masën e gjerë folëse.

Duhet të kemi parasysh që është e vështirë të kontrollohet ligjërimi i shkujdesur, sidomos i brezit të ri, të cilët shpesh krijojnë kode të veçanta komunikimi, ndonjëherë të vështira për t’u dëshifruar nga shtresat e tjera. Në këtë mënyrë ata shfaqen si pjesa më e prirur të përqafojë ndryshimet në gjuhë, ndonëse shpesh këto vijnë si rezultat i një ndikimi të pavetëdijshëm, ose vetëm përshtatjeje formale, për të mos u dalluar nga bashkëmoshatarët e tjerë (identiteti brenda “peer- group”-it).

- Në nivelin morfologjik, ndikimet prekin padyshim format gramatikore. Përdorimet foljore analitike (sidomos koha e kryer, p.sh. *ka filluar shpërndarja*, për *filloi shpërndarja*, ose *ka arritur nivelet...*, për *arriti nivelet* etj), në rastet kur shqipja përdor format sintetike, vërehen si në shfaqjet mediatike, ashtu edhe në diskutimet e së ashtuquajturës elitë shoqërore, duke i ngarkuar më kot mesazhet eksplicite.

⁵⁴ Pa dashur ta quajmë një snobizëm gjuhësor

⁵⁵ *Dukuri të shqipes bashkëkohore*, (Përmbledhje aktesh), Tiranë, 2005, f.33.

Ndërhyrja gjuhësore në këtë nivel duhet të përballet edhe me gjedhet artificiale të fjalëformimit. Nëse në nivel leksikor mund të mjaftohemi me shmangien a zëvendësimin e fjalëve të huaja, këtu çështja paraqitet shqetësuese, sidomos për ato huazime që kanë krijuar tipa kalkesh fjalëformuese (duke i bashkangjitur fjalës së huaj një parashtesë ose prapashtesë të fondit të shqipes, si rezultat i një ngjashmërie të pjesshme fonetike), jo të shpeshta për fat, por që po synojnë të përhapen, qoftë edhe në mënyrë të gabuar. P.sh. *opcion ~ opcional, kreativ ~ kreativitet, menaxhoj~ menaxhim etj.* Për fjalët e mësipërme në shqipe kemi gjegjëset përkatëse, në këtë mënyrë përdorimi është dyfish i gabuar.

- Në nivelin sintaksor, çështja paraqitet më komplekse. Në qoftë se ndikimet në nivel fonetik mund të prekin vetëm strukturën sipërfaqësore të gjuhës, ndërsa ato në nivel leksikor shpeshherë janë të përkohshme, nuk është e thënë që të fitojnë një status të menjëhershëm në gjuhë dhe me kalimin e kohës mund të zhduken ose zëvendësohen, ndikimet në nivel sintaksor prekin strukturat e brendshme të gjuhës duke sjellë një kaos të vërtetë në organizimin e mendimeve. Shpesh po përballemi me botime të ndryshme, jo vetëm të medias së shkruar, por edhe botime studimore, me struktura sintaksore të huaja për shqipen. Ato krijohen si rrjedhojë e një përkthimi të papërpunuar të literaturave të vjela dhe nga një gjuhë e rënduar me diskutime të stërzgjatura, duke i falur teksteve një ngarkesë të panevojshme, me fraza bashkërenditëse që i rëndojnë së tepërmi mesazhet.

Në këtë moment një prej orientimeve parësore i politikave shtetërore duhet të jetë patjetër pastrimi dhe pasurimi i inventarit të gjuhës.

Është e vërtetë që kjo prirej shpesh degradon në kufijtë e një purizmi të skajshëm, një përvojë e njohur në kurrikulat gjuhësore, por që duhet parë si një nevojë e ngutshme, sidomos për gjuhët e bashkësive të vogla.

Si domosdoshmëri jetike për një gjuhë të njësuar shfaqet padyshim emancipimi gjuhësor. Duhet që standardi të mos mbetet në nivelin e klisheve gjuhësore si një tërësi rregullash të detyrueshme për t'u zbatuar, por si një inventar i përvetësueshëm dhe i pëlqyeshëm për hapësirën mbarëshqiptare. Në fazat evolutive që po kalon shqipja nuk mund të flasim më për përmbysje, apo për një standard të vendosur me ose pa të drejtë, është zhvillimi shoqëror ai që do ta vlerësojë këtë fakt, ajo që është shqetësuese lidhet me mentalitetin regresist, në një kohë që të gjithë flasin për progres socio-kulturor. Në rrethana të tilla, edhe pse ndikimi i politikave shtetërore për mbrojtjen e gjuhës nuk është shumë i pranishëm,

duhet të ndërjegjësohemi për të ruajtur një standard sa më të konsoliduar, i cili mund të pasurohet me prurje të dobishme dialektore. Themi të dobishme sepse nuk mund të flasim për krijimin e kontureve estetike dytësore, por për ndërhyrje të qarta mbi vështirësitë që vërehen në përvetësimin e standardit.

Parë në këtë aspekt nuk duhet ta shohim politikën gjuhësore si një ndërhyrje abuzive të shtetit në normalizimin e një gjuhe, por më tepër në ndërjegjësimin shoqëror për krijimin e një situatë të qëndrueshme gjuhësore.

Në këtë kontekst depërtimi i kulturës globale, më saktë i globalizmit gjuhësor, do të kishte pasoja negative mbi standardin tonë të brishtë. Këto reflekse të menjëhershme duhet të fashiten disi nga zbatimi normativ i kodit gjuhësor. Të gjitha variacionet ligjërimore dhe jo vetëm, që përdoruesit e gjuhës endin në pëlhurën sociale, duhet të përzgjidhen me kujdes në gamën e mundësive që ofron gjuha jonë, më pas të orientohemi drejt një prirjeje jo origjinare dhe jo të ndodhë e kundërta.

Si një prodhim dhe përbërëse shoqërore, gjuha mund të mbrohet me ligj, por shkalla e imponimit të saj në nivel përdoruesish, mbetet relative. Kjo mbase është pika delikate ku mund të ndërhyjë pashmangshmërisht procesi i globalizmit gjuhësor, si një prirje njësuere e kulturave. Sa më solid të jetë standardi i një gjuhe, qoftë nga pikëpamja gjuhësore qoftë edhe nga niveli i përdorimit mbi masën e gjerë, aq më e vogël është trysnia e huazimeve që ushtrohen mbi këtë gjuhë.

BIBLIOGRAFI:

1. Baylon, Ch., Mignot, X., *Komunikimi*, Shkup, 2004.
2. Birge, R., *Language planning and education*, Clevedon, 1990.
3. *Dukuri të shqipes bashkëkohore*, (Përmbledhje aktesh), Tiranë, 2006.
4. De Sosyr, F., *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Tiranë, 2002.
5. Haugen, E., *Bilingualism and language planning*, Berlin, 1987.
6. Holtgraves, Th., *Language as social action*, Londër, 2002.
7. Hudson, R., *Sociolinguistika*, Tiranë, 2002.
8. Jahr, E.H., *Language conflict and language planning*, Berlin, 1993.
9. Shamku-Shkreli, L., *Shtatë vjet prolog*, Tiranë, 2005.
10. Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, Tiranë, 1996.
11. Vehbiu, A., *Fraktalet e shqipes*, Tiranë, 2007.

Linguistic planning and the impact of globalization on the Albanian language

SUMMARY

Every segment of society has language and individuals competently use language for a variety of purposes. We have examined Haugen's model for language planning as one way of visualising the scope and the sequence of the language planning process. We have done this by examining corpus planning and status planning with their respective focus on language and society.

Whether in language planning or language –in- education planning, there are many potential questions to be asked, so the selection of questions has the potential to influence significantly the nature of the proposed language plan. The solutions must be sensitive to the cultural, social and historical conditions in the environment in which solutions will be applied. The global effects of cultural impact find domain in language characteristic too. We can't avoid the reflex off this impact, but we must try to find ways and methods to observe this interference and to assuage language innovation.

Anisa KOSTERI

FJALËSI I BOGDANIT NË FJALORIN E “BASHKIMIT”

Në kulturën qytetare shkodrane fundi i shekullit XIX dhe fillimi i atij XX kanë qenë të mbushur me ngjarje arsimore: hapje shkollash shqipe, botime të librave shqip, duke u karakterizuar nga një lëvizje e fuqishme iluministe siç ishte ajo e Rilindjes Kombëtare, me kërkesa jo vetëm për shkëputje nga zgjedha turke, por edhe për ruajtjen, zhvillimin dhe konsolidimin e gjuhës amtare.

Në të gjitha ngjarjet e shënuara të asaj kohe na tërhoqi vëmendjen botimi i Fjalorit të Shoqërisë “Bashkimi”, si një vepër me mjaft interes në studimet tona leksikografike. Nga ana tjetër, kemi vërejtur se në literaturën tonë shkencore, për Fjalorin e “Bashkimit” nuk ka analiza të hollësishme. Për të është shkruar pak duke u ndalur kryesisht tek numri i fjalëve, e në pak çështje të përmbajtjes.

Duke u ndalur konkretisht në fjalësin e përdorur, vërejmë se një pjesë e madhe e tij është marrë nga autorët e vjetër, si nga Bogdani, Budi, Bardhi, por edhe nga Kristoforidhi dhe ndonjë fjalë tek-tuk nga De Rada. Përkatësisht fjalësi i Bogdanit zë një vend mjaft të gjerë në Fjalorin e “Bashkimit”, rreth 130 fjalë.

Shpjegimin e këtyre fjalëve e kemi dhënë përmes përqasjes së Fjalorit të “Bashkimit” me “Leksikun historik të gjuhës shqipe” të Kolë Ashtës (IV, 2002), në të cilin e kemi të plotë analizën e fjalëve të Bogdanit shoqëruar këto edhe me fjali për ta qartësuar më tepër atë.

Tek “Leksiku historik...” kuptimi i fjalëve pothuajse gjithnjë përkon me atë të “Bashkimit”; ndryshimet qëndrojnë vetëm në anën fonetike e drejtshkrimore, dhe kjo për arsye të përdorimit të alfabetëve bazë. Ka shumë fjalë që në “Fjalor” jepen si të marra nga Bogdani, ndërsa tek “Leksiku...” (2002) nuk ndeshen fare. Të tilla janë, p.sh., *aferdites*, *aneprane*, *bilé*, *cannroj*, *choitoj*, *discaroi*, *gurtoi* etj. Mund të themi se kemi të bëjmë me një paraqitje jo të plotë të fjalësit të Bogdanit, ose për një mungesë të saktë informacioni nga autorët e “Bashkimit”.

Kuptimi i fjalëve tek “Leksiku...” është dhënë i qartë, ndërsa kur fjala është e rëndomtë e vetiu e kuptueshme, nuk ndihet nevoja për shpjegim të kuptimit.

Po i vërejmë me radhë.

---A---

Aferdites- *afërdita* (planet), (shpjegimi në italisht), (f. 18). Siç e vërejmë emri i këtij planeti është përdorur në leksikon e P.Bogdanit dhe gjithashtu e ndeshim edhe tek “Bashkimi”, por, tek “Leksiku historik i gjuhës shqipe IV” i Kolë Ashtës (2002) nuk e kemi si fjalë.

Amshim- *përjetësi, amshim* (shpjegimi në italisht), (f. 22). E gjejmë të shpjeguar me të njëjtën trajtë edhe tek “Leksiku...” (2002); **amëshimi-** “*ndë amëshim*” II, III, 15 “*ndë amëshimt nuk ashtë as të shkuem as të ardhunë po ghithë t’afere*” I, III, III, 4 (Lek, f. 111). Siç e vërejmë, tek “Bashkimi” kjo fjalë përdoret pa **ë** pastheksore, ndërsa tek “Leksiku...” e gjejmë me **ë**.

Amshoj- *përjetësoj, amshoj*, (shpjegimi në italisht), (f. 22). Siç e vërejmë, Bogdani ka përdorur edhe trajtën foljore të kësaj fjale, por tek “Leksiku historik...” nuk e ndeshim.

Aneprane- (shpjegimi në italisht), (f. 23). Këtë trajtë nuk e gjejmë të shpjeguar tek “Leksiku...” i K.Ashtës (2002), edhe pse përbën një mënyrë fjalëformimi interesante, e cila sot nuk gjen më përdorim në standardin e gjuhës shqipe.

Asilade- *dobii, a, prodhim, i* (f. 27). Kjo është një fjalë turke që sot ka dalë nga përdorimi. Tek “Leksiku...” (2002), nuk e kemi të përdorur si pjesë e leksikut të Bogdanit.

Atille, a e atill, i- *i tillë, i ngjashëm* (shpjegimi në italisht), (f. 28). E gjejmë tek “Leksiku” (2002); **atillë, i-** “*t’atillatë punë*” II, IV, I, 11: “*tali cose; ishinë fort gëzuem se ishinë pjekunë mbë t’atillët shok*” II, IV, I, 18⁵⁶. E kemi në përdorim edhe sot një përemër të tillë.

---B---

Barkagnosm, i- *1.hidropik, 2.i sëmurë me trupazi* (shpjegimi në italisht), (fq 34). E ndeshim të shpjeguar edhe tek “Leksiku...” (2002) me të njëjtën trajtë; **barkagnosm-** *njeri barkanjoz, barkalec. Termë sëmundjeje, hidropik*” *shëndoshi nji barkagnosm*” II II, V, 29 (Lek, 122).

Barrni, a- *shtatëzani, a* (shpjegimi në italisht), (f. 35). E kemi edhe tek “Leksiku...” (2002); **barrëni- a** “*të nandë muejtë e barrënisë*” II I, II, I (Lek, f. 123). Siç e vërejmë, e kemi të shpjeguar njëllor në të dy rastet, vetëm me

⁵⁶ Kolë Ashta, Leksiku historik i gjuhës shqipe IV, 2002, f. 119.

një ndryshim drejtshkrimor, se tek Bogdani përdoret **ë** pastheksore ndërsa tek Bashkimi nuk e kemi **ë**-në.

Bilë- *mu, poënnë* (f. 43). Këtë ndajfolje nuk e ndeshim tek K.Ashta.

Binii, a- *bijim* (shpjegimi në italisht), (f. 43). E ndeshim edhe tek “Leksiku...” (2002), por me një trajtë tjetër; **bijëni-a-** nga *bijë + ni* “*bijënia e shpirtit*” II I, III, 7 “*Figliolanza Spirituale*”; “*bijënia ende ndë kreatyrëtë (e) kësaj jetë, nuk qëndron preshtu se një kafshë len o del prej sjetëre, po kur len mbë shëmbëlltyrë të atit kahë len*” II, II, 10 (Lek, f. 126). Pra e kemi të reduktuar nga *bijëni* në *binii*.

Binnohem- *nderoj thellë* (shpjegimi në italisht), (f. 43). Tek” Leksiku... “i Kolë Ashtës nuk e ndeshim të shpjeguar.

---C---

Cannroj- *rri pa lëvizur* (shpjegimi në italisht), (f. 60). Këtë fjalë nuk e gjejmë të shpjeguar tek “Leksiku...” i K.Ashtës.

Celii, ja- *qeli, dhomë* (shpjegimi në italisht), (f. 62). E ndeshim tek “Leksiku...” (2002) me të njëjtin kuptim; **qeli,a-** *odë e vogël* “*tue him ndë shtëpi votë ndë qeli të së dvekunësë*” II II,II,20 (f. Lek, 322).

Civuer,ori- *kjuer,ori* (f. 67).E ndeshim me këtë trajtë; **kjuer,ori-** *quer, pjesa përdhese e shtëpisë ku mbahen almise e gjëra të tjera , katua, burg; qilar, bodrum,për të mbajtur si qumësht, gjellë, zahire, pije* (Lek, f. 214).

--CH--

Chtjelle- *shif: me shtjelle* (f. 76).E kemi tek “Leksiku...” (2002); **çtjellë-** *shtjell do të thotë shprish leshin, e hap, por me kuptim të përfytyruar shtjell, shtjelloj do të thotë zhvilloj, shpjegoj si te Bogdani”i çtjell tue thanë*” I I,I,3 (Lek, f. 139).

Choitoj - *imagjinoj* (shpjegimi në italisht), (f. 76). Këtë fjalë nuk e gjejmë të shpjeguar tek K.Ashta (2002).

---D---

Diiekec- *dashakeq, dinak* (shpjegimi në italisht), (f. 87). E ndeshim tek Ashta; **dijekeq-** *dinak* “*një gjarpënë dije keq*” I I,VII,I (Lek, f. 148). Siç e shohim, e ndeshim me të njëjtin kuptim, vetëm me një ndërrim fonetik të **i** (Bashk.) në **j** (Ashta).

Diiekcij,a- *dashakeqësi, dinakëri* (shpjegimi në italisht), (f. 87). E gjejmë me të njëjtin kuptim tek “Leksiku...” (2002); **dijekëqi,a-** *dinaki, mbrapshti”a e kish bam atë punë për diekëqi*” I III,1,2 (Lek, f. 148). Edhe këtu si më sipër kemi përdorimin e **i** në vend të **j**.

Discaroi- *shpjegoj* (shpjegimi në italisht), (f. 88). Këtë fjalë nuk e ndeshim

tek "Leksiku..." (2002).

Dishmignii- *dëshmi* (shpjegimi në italisht), (f. 88). Edhe këtë fjalë, si më sipër, nuk e ndeshim të shpjeguar tek "Leksiku..." i K.Ashtës.

Dobii - *dobi, fitore* (shpjegimi në italisht), (f. 90). E kemi tek me të njëjtin kuptim si tek "Bashkimi"; **dobi-a-** *serbokroatisht dobiti "fitoj". Fitore, luftë o garë. "ndër sa po hinte (Sauli) ndë Jerusalemt mbas dobie(= dobije), vashëzatë, kahë shkonte, ndë valle tue kcyem, këndojnë(= këndojinë, këndonin)"* I III,II,9 (Lek, f. 151). Si gjithnjë kemi një ndryshim në trajtën fonetike sepse tek Bashkimi e kemi me dy **i**, ndërsa tek "Leksiku" (2002) me një **i**.

Dobis- *gëzoj, fitoj, bëj për vete* (shpjegimi në italisht), (f. 90). Si trajtë foljore nuk e ndeshim të shpjeguar tek Ashta (2002).

Drekoi- *ha drekë* (shpjegimi në italisht), (f. 93). Tek Ashta si emër ekziston i shpjeguar, ndërsa si trajtë foljore nuk gjindet.

Dvare(me)- *shif: me vaierre* (f. 95). Më të saktë shpjegimin e kemi tek Ashta; **dvarunë-bjerr, humb** "fjalëtë (e) mia nukë kanë me u dvarunë" I I, III,19: "për të mos dvarunëregjënë (e) vet" II I, VI, 10 (Lek, f. 157).

---F---

Fat(me)- *me begati* (shpjegimi në italisht), (f. 106). Me këtë kuptim nuk e kemi të përdorur tek "Leksiku..." (2002).

Figne- *pikë, gjëndje* (shpjegimi në italisht), (f. 108)⁵⁷. E ndeshim tek Ashta me këtë kuptim; **finjë-a** -*kjo fjalë në kuptimin e saj nuk lidhet me fjalën tjetër finjë, që është ujë e hi i valuar për të larë rrobat.Por finja e Bobdanit do kuptuar më mirë në frazeologjinë e saj"ndë finjë të mortës" që po ashtu i përgjigjet kuptimit të frazeologjisë popullore "asht në fill të mordes" që do të thotë në castin efundit të jetës, për njeriun që po vdes, që është në pikën e fundit të jetës...II III,III,11* (Lek, f. 173). Siç e shohim kemi të njëjtin shpjegim si tek "Bashkimi", vetëm se kuptimi del më i qartë tek Ashta (2002).

Frashkii,a- *freski* (shpjegimi në italisht), (f. 114). E ndeshim tek "Leksiku..." (2002), me një trajtë tjetër ; **frasqi-a-** *ital.fresco (fresk). Një lloj ere e lehtë si fllad që fryn prej perëndimit"erëtë për krahë frasqisë: prej së djathtet asht gerbini, prej së shtërmajtet ashtë maestri"* I I,VI29 (Lek, f. 176).

⁵⁷ Fjalori i Bashkimit, 1908, f. 108.

---G---

Gershis- *nxit, shtyj* (shpjegimi në italisht), (f. 126). Tek “Leksiku...” (2002) e ndeshim me këtë trajtë; **gërshas-** *ftoj, grish* “*gërshesënë të tjerë*” II,IV, 7 (Lek, f. 181).

Grahe, grahi, me grahe- *ulërij, çirrem* (shpjegimi në italisht), (f. 130). E kemi me të njëjtin kuptim edhe tek Ashta; **grahunë-** *bërtas me zë të fortë. Kjo fjalë grah me këtë kuptim të britmës, të zhurmës ka mbetunë te fjala grahmë*” *zhurma e nxjerrë nga ai që po vdes*” “*ka me grahunë*” I III,X(=XI),4 (Lek, f. 185).

Gumchi e gumsii- *shaka* (shpjegimi në italisht), (f. 135). E ndeshim tek Ashta në një trajtë tjetër, ndonëse kuptimi është i njëjtë; **gumëci-a-** *Serbokro. Gllymiti. Buzuku ka një formë më të vjetër me gl në foljen glumitem “tallem, argëtohem”. Bogdani e ka si emër me kuptimin tallje, të përqeshur” kje nieri i dërejtë, i urtë e zemëruer (=trim)i fortë, aqa i dashun i së dërejtësë sa nukë kish rem (=rrejtë) ende për gumëci*” I III,V,I (lek, f. 187).

Gurtoi- *nxitoi* (shpjegimi në italisht), (f. 136). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku...” i K.Ashtës (2002).

Guruem (t’)- *ngurim* (shpjegimi në italisht), (f. 136). Edhe këtë fjalë, si më sipër, nuk e ndeshim tek “Leksiku...” (2002).

Gute,a- *podagër, cermë e këmbës* (shpjegimi në italisht), (f. 136). Kjo fjalë nuk ndeshet e shpjeguar tek Ashta.

---Gh---

Ghithaxi- *krejtësisht* (shpjegimi në italisht), (f. 142). Me një trajtë të tillë nuk e ndeshim tek “Leksiku...” i K.Ashtës.

---Gn---

Gnermue- *sforcohem* (shpjegimi në italisht), (f. 146). Edhe këtë trajtë foljore nuk e gjejmë tek Ashta.

Gnimennohem- *përshatam* (shpjegimi në italisht), (f. 147). Edhe këtë fjalë, po me këtë kuptim nuk e ndeshim tek “Leksiku...” (2002). *gnimenne- në të vërtetë.*

Gnimenne- *në të vërtetë* (shpjegimi në italisht), (f. 147). E ndeshim si më poshtë; **njimend-** *nga nji+ mend. Vërtet, me të vërtetë “ashtë nji mend”* I I,I,19 (Lek, f. 282). Siç e shohim, kemi një ndryshim në përdorimin e fonemës **nj**. Tek “Bashkimi”, i cili ndikohet nga alfabeti latin e kemi me **gn**, ndërsa tek Bogdani e kemi, **nj** ashtu siç përdoret edhe sot.

---H---

Hijenue (me)- *hijesoj* (shpjegimi në italisht), (f. 160). E ndeshim si emër; **hie-ja- 1.***errësirë e shkaktuar nga një trup që zë dritën, 2.kënaqësi* “gjithë (=cdo) kafsha për hie gëzohetë hijet (=prej hijet) së vet: I I,II,3 **3.***lloj, mënyrë* “herë bahet mballë faqe sa kush do i njuh se për të njimendë janë ashtu; herë vinjënë mbëluem e bahenë ndënë hije të njëj së mire” I I,VII,6 (Lek, f. 198). Pra, e ndeshim në tre kuptime, ndryshe nga “Bashkimi” që përdoret vetëm me një kuptim, edhe pse kemi të bëjmë me një trajtë foljore.

---I---

Ietesietes- *përjetësisht* (shpjegimi në italisht), (f. 69). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku...” i K.Ashtës (2002).

---K---

Kallushe,a- *fshikëz, ënjtje* (shpjegimi në italisht), (f. 179).Edhe këtë fjalë, si më sipër, nuk e gjejmë të shpjeguar tek Ashta (2002).

Kercitun (t’)- *podagër, cermë e këmbës* (shpjegimi në italisht), (f. 190). E ndeshim në këtë trajtë; **kërçitunë,i-** *termë mjekmëgnkësore për sëmundjen e artrites: të kërçitunë kambësh për fjalën e huaj podagra dhe të kërçitunë duarsh për kiragra* “grykësitë e të dejmënitë (=grykësorët e pijanecat) shkurtojnë jetën e vet tue pësuem lëngime: të kërçituna kambësh e duersh” II I,VI,13 (Lek, f. 211).

Kmegnenii- *budallallëk* (shpjegimi në italisht), (f. 195). Këtë fjalë nuk e kemi të shpjeguar tek “Leksiku...” (2002).

Kmeie- *budallallëk, marrëzi* (shpjegimi në italisht), (f. 195). Si më sipër, nuk e ndeshim të shpjeguar.

Krahnoshe- shif:krahnortse- *brez lëkure që vihet në qafë* (shpjegimi në italisht), (f. 205). Tek “Leksiku...” (2002) e kemi të tillë; **krahënoshe-ja-** *trajtë e mbajtur me krahë në sup me një fjalë të huaj ruksak”tue marrë gëzofthinë e vet të barisë me krahënoshe të vet ndë të sijët pat shtim pesë gurë e me baet ndorë votë” I III,II,7* (Lek, f. 217). Pra, e kemi pothuajse me të njëjtin kuptim, vetë se tek “Bashkimi”, si gjithnjë, kemi mospërdorimin e ë-së.

Krushkohem- *bëj krushqi* (shpjegimi në italisht), (f. 208). E ndeshim tek “Leksiku...” (2002), pothuajse me të njëjtin trajtë dhe me të njëjtin kuptim;

krushquem- *lidh krushqi* “hijnë me u krushquem me Kainitat” I I VII,13 (Lek, f. 218).

Kthiellë (i,e,t’)- *i pastër, i kulluar, kthjelltësi* (shpjegimi në italisht), (f. 212). E gjejmë të shpjeguar tek Ashta me po të njëjtin kuptim; **kthjellë, i-** *kur qielli e uji është i pastër. Në mënyrë figurative thuhet për njeriun e*

qartë në mendime ose të qetë përnga gjendja shpirtërore “i kthjell(ë) nieri” II III,III,8 (Lek, f. 219).

Kumet,i- *lajmi* (shpjegimi në italisht), (f. 215). E gjejmë tek “Leksiku...” (2002) si të tillë; **kumët-itë-** *lajm çfarëdo, por këtu lajm vdekjeje*”shpu *kumëtitë(=kumtim) Davidit të mortës(së) Saulit*”I III,II,23 (Lek, f. 222).

Kupe,ia- *tyl, perde* (shpjegimi në italisht), (f. 217). E ndeshim si të tillë; **kupë-a- 1.** *Jo me kuptimin e mirëfilltë gotë e të tjera si kjo, por me kuptim të përfytyruar si kupa e qiellit për vetë qiellin “kupë të qiellit”*I III,III,5. **2.***Në kuptim të përfytyruar për term të arkitekturës të atij mbulimi mbi siprinën e odës o të ndërtesës, i cili vjen në formë kupe”kisha u da n dysh kupet e ndjerë mbë dhe”* II III,III,11 (Lek, f. 223). Në të dy kuptimet e shpjeguara tek “Leksiku...” (2002), asnjëri nuk përkon me atë të përdorur tek “Bashkimi”.

Kuvise,ia- *bisedë, takim* (shpjegimi në italisht), (f. 221). E ndeshim tek Ashta (2002) me këtë kuptim; **kuvise-t-** *shumësi i kuvend-i-1.bëj kuvend”bani atë kuvend”*II I, VI,10: “*ban si një kuvend ndër tre vetët e një të mposë”* I I,VI,1. **2.**”*prej Kuvendit Sirmiënsit*” I I,III,1 (Lek, f. 225).

---L---

Lanne'ia- *lëndë (e parë)*, (shpjegimi në italisht), (f. 224). E gjejmë tek Ashta pothuajse me të njëjtën trajtë; **landë-a 1.***dru si lëndë ndërtimi”landa së sillet (=prej së cilet)ashtë trajtuem, qi ashtë druja e selvisë qi kurraj s’kalbetë”* I II,III,10. **2.***për çdo lëndë që vlen për të ndërtuar o zbukuruar punesën”bani gati lëndënë, qi ashtë drutë, gurëtë, hekuritë, rgjandnë e arrë(=arnë, arin)”* X III,III,1 (Lek, f. 226). Pra, këtu e kemi me dy kuptime, ku vetëm njëri përkon me atë të “Bashkimit”, ndërsa nga ana fonetike, tek Bogdani përdoret i plotë togu i bashkëtingëlloreve **nd**.

Lavdii,a- *lavdërim* (shpjegimi në italisht), (f. 227). E ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku” (2002);**lavd-i- 1.**”*ty të heshtunitë asht lavd”*I I,I,27. **2.***çpifete “bin një madhështi fort e pa udhë e lavd i pa rnesë”* I I,II,4. **3.***këngë të quajtura lat.hymnus” ty përket lavdi”* I I,I,27 (Lek, f. 228). E gjejmë, pra në tre kuptime, ku vetëm njëri përkon me atë të “Bashkimit”.

Lil,i- *zambak* (shpjegimi në italisht), (f. 233). E gjejmë tek Ashta me një trajtë disi të ndryshme; **lilj-i-** *zambak “posi një lilj ka me lulëzue”* I III,VI,13 (Lek, f. 233).

Lmagne,ia- *hambar, drithnik* (shpjegimi në italisht), (f. 234). Këtë fjalë nuk e ndeshim të përdorur tek “Leksiku...” (2002).

Lmaie- *hark* (shpjegimi në italisht), (f. 234). Si më sipër, edhe kjo fjalë nuk ndeshet tek “Leksiku...” i Kolë Ashtës (2002).

Lpoxe- *blozë* (shpjegimi në italisht), (f. 237). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek Ashta.

---M---

Manese- *vonesë (shpjegimi në italisht)*, (f. 251). E kemi në këtë trajtë; **manesë-a-** *vonesë, vonim “manesa e ngushëllimit” I I,VII,5 (Lek, f. 251).*

Manoi- *vonoj (shpjegimi në italisht)*, (f. 251). Si trajtë foljore nuk e ndeshim të përdorur tek “Leksiku...”(2002).

marmur,i- *mermer (shpjegimi në italisht)*, (f. 253). E kemi tek “Leksiku” (2002); **marmor-i-** *“kje mbaruem kishagjithë marmori së së bardhë prej Parit” I III,IV,8 (Lek, f. 242).* Siç shihet, kuptimi nuk del shumë i qartë tek Ashta (2002), ndërsa kemi një ndryshim fonetik të **u** në **o**.

mraxte- *bosh (shpjegimi në italisht)*, (f. 276). Këtë fjalë nuk e ndeshim tek “Leksiku...” (2002).

Mrytet (i,e)- *i errët, i fshehtë (shpjegimi në italisht)*, (f. 277). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek Ashta (2002).

Mryyt- *i dendur, i shpeshhtë (shpjegimi në italisht)*, (f. 277). Si më sipër, edhe kjo fjalë nuk gjindet.

---N---

Nchuem- *ngjitje, shpejtësi (shpjegimi në italisht)*, (f. 288). E kemi si të tillë; **nçuem-** *çuem (Lek, f. 262).* Kuptimi është i njëjtë në dy rastet.

Ngadhnei- *dominoj, zotëroj (shpjegimi në italisht)*, (f. 291). E ndeshim tek Ashta; **ngadhënjem-** *“me ngadhënjem” I I,IV,10; “shtij beleg regjit me gjithë ushtërit me lëftuem vetëmë me besë(=kusht) qi populli i atij, qi të ngadhënjë, t’ish dobitës e i zoti i popullit(të) atijqi të jesë mujtunë” I III,II;6 (Lek, f. 273).*

Ngheroi - *rrethoj (shpjegimi në italisht)*, (f. 298). E ndeshim tek Ashta me po të njëjtin kuptim; **ngjëruem-** *rreth. Formohet nga n+ gjir (gjër) + oj, ku rrënja gjir-i “rreth” ka një i të theksuar, e cila u kthye në ë për shkak se theksi kaloi tek prapashtesa. Rretho, sillem rreth e rrotull “ka me ngjeryem dhenë” II I,VIII,13 (Lek, f. 277).*

Nghic a nigh- *mjegull, tym (shpjegimi në italisht)*, (f. 298). E vërejmë edhe tek “Leksiku...” (2002) me po të njëjtin kuptim; **ngjiq-i-** *thuhet edhe negj, nigj, që do të thotë mjegull e hollë, lpe-ja, si mjegull, që është grumbull avujsh të dendur e të ftofët, por, një mjegull e lehtë”niegulla ashtë qish lanë rët mbas veti, mbasi të ketë ram shi”(Lek, f. 277).*

Nnerdyym- *dyshim, pezull, i varur (shpjegimi në italisht)*, (f. 301). Kjo fjalë nuk gjindet tek “Leksiku...” (2002).

Nnerkaca- *ndërkohë (shpjegimi në italisht)*, (f. 301). E ndeshim si të tillë; **ndërkaqa-** *“erdh ndërkaqa një za” II II,V,8 (Lek, f. 267).*

Nnertsoi- *formoj përsëri* (shpjegimi në italisht), (f. 302). E gjejmë të shpjeguar tek “Leksiku...” (2002); **ndercuem-itë,të-** *folja ndercoj është denominative nga emri nder + coj dhe do të thotë: e jap në formë të re, e bëj rishitas, ndreq gabimet e të metat, e kthej në një gjendje të pëlqyeshme e të nderueshme* (Lek, f. 264).

Nniekoi- *vardisem* (shpjegimi në italisht), (f. 303). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek Ashta (2002).

Nneshkoi- *ndëshkoj* (shpjegimi në italisht), (f. 302). E kemi si të tillë; **ndëshkuem-** “ *ndëshkoi me bam pendesë*” I III,X,(=XI), 1 (Lek, f. 268).

Nnivenese- *profeci, orakull* (shpjegimi në italisht), (f. 304). E kemi tek “Leksiku...” (2002) në tre kuptime që përkojnë me këto të “Bashkimit”; **ndivënësë-a-** *1.të parafolurit për gjëra të jetës, të marrët me mend të ndonji veprimi të ardhshëm me anën e shenjave “(të paraflasësh) për kafshë të kësaj jetë, i thonë ndivënësë o godi” I II,1,3, 2.enigmë ose fshehtësi për t’u zbuluar”duhetë qi ato misteria të jenë dëftuem profetësë si ndë një pasëqyrë e ndë ndivënësë” I I,1,24, 3.profeti “këta kallëzojnë profetitë o ndivënësëtë “I I,IV,14* (Lek, f. 269).

Nnshoi- *përkulem dhe nuk i rri fjalës* (shpjegimi në italisht), (f. 308). Këtë fjalë nuk e kemi të shpjeguar tek “Leksiku...” i K.Ashtës (2002).

Nnmyhem- *nxihem* (shpjegimi në italisht), (f. 309). E ndeshim tek “Leksiku...” (2002), pavarësisht se shpjegimi nuk del i qartë; **nymërym,i-irnim** “ *me të nymërymitë(e) tijnaj*” I III,IX,11 (Lek, f. 281).

---P---

Padeknii- *pavdekësi* (shpjegimi në italisht), (f. 313). E ndeshim të shpjeguar këtë fjalë tek “Leksiku...” (2002), por me pak ndryshime fonetike, si përdorimin e *ë-së* dhe dyfishimin e zanores *i* për të treguar gjatësinë e zanores; **padekëni-a-** *neologjizëm i Bogdanit” u duk Josefi dalë n’burgut me krip rruem të dekënisë e veshunë së padekënije e bam ndë vend të regjit ndë për gjithë dhë të Misirit” II IV,1,6* (Lek, f. 285). Kuptimi na del i qartë përmes kësaj fjalie.

Pagtyre- *pagë, shpërblim* (shpjegimi në italisht), (f. 314). E gjejmë tek K.Ashta me të njëjtin kuptim; **pagëtyrë-a-** *shpërblim* (Lek, f. 286).

Parabirni- *parëbirni* (shpjegimi në italisht), (f. 320). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku...” i K.Ashtës (2002).

patershane- *shtixe* (f. 324). E kemi të shpjeguar si më poshtë; **patërshanë-a-** *mjet i vjetër luftimi shtizë, heshtë “me i ram patërshanë kish me e pasë mbytnë “ I I,VI, 18* (Lek, f. 295).

Pelcere- *antipode* (shpjegimi në italisht), (f. 326). Kjo fjalë nuk gjindet e shpjeguar.

Perbalts- *luftues, atlet* (shpjegimi në italisht), (f.328). E gjejmë të shpjeguar tek “Leksiku...” (2002) me të njëjtin kuptim ,por në një trajtë tjetër emërore; **përbalcas-i-** *luftëtar pa armë, mundës* “Rebeka në shpirt thirri Jakobnë, i pari përbalcas” I II, IV,3 (Lek, f. 300). Përveç këtij ndryshimi, kemi edhe një përdorim tjetër të fonemës *c*, ku tek “Bashkimi” përdoret grupi i bashtingëlloreve *ts*.

Perbeeme- *yshtje* (shpjegimi në italisht), (f. 329). Këtë fjalë e gjejmë të shpjeguar në “Leksikun...” e K. Ashtës (2002); **përbëm-** *bëj që të dëbohet një e keqe, sëmundje, rrezik, djallëzi, 2. i lutem shumë* “kajfasi o përben tue thane” II III,I,10 (Lek, f. 300). Pra, e gjejmë me të njëjtin kuptim si tek “Bashkimi”, ndonëse me ndryshime fonetike, siç është përdorimi i ë-së dhe dyfishimi i zanoreve për të treguar gjatësinë.

percielle- *përqeshje* (shpjegimi në italisht), (f. 329). E kemi të shpjeguar si më poshtë; **përcjellë-** *1.shoqëroj një njeri për një copë rrugë” po e përcill ajo e çkushëllueme amë tue e ndjekunë”* II II, III,6 (Lek, f. 300).

Perdlei- *kam mëshirë, fal* (shpjegimi në italisht), (f. 331). Nuk e ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku...” i K.Ashtës (2002).

Perhiem- *i urryeshëm* (shpjegimi në italisht), (f. 335). E ndeshim si të tillë; **përhiem-** *i sajuar nga per + hie + m , rrënja e fjalës është hije, e cila përveç kuptimeve tjera do të thotë hije e zezë në mënyrë të përfytyrueshme.I përhiem ose i urrejtshëm, që përbuzet” zu fill ky mpkati përhiem”*II,I,8 (Lek, f. 302)

Perkore- *përkorë, masë* (shpjegimi në italisht), (f. 336). E kemi me të njëjtin kuptim edhe tek Ashta (2002); **përkorë,i-** *i përkuem, që ka masë në të ngrënë e në të pirë* “nieri i përkorë mbë haet e piet gjithë herë ashtë ma jetë giatë”I I,VI,16 (Lek, f. 302).

Perkrenare- *helmetë, përkrenare* (shpjegimi në italisht), (f. 336). Kjo fjalë nuk ndeshet e shpjeguar në “Leksik...”(2002).

Perkthielloi- *qartësoj* (shpjegimi në italisht), (f. 336). Edhe kjo fjalë, si më sipër, nuk ndeshet në “Leksik...” (2002).

Perkuer- *në mënyrë moderne* (shpjegimi në italisht), (f. 336).Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar në “Leksik...” (2002).

Perkuidesem- *ngashërehem* (shpjegimi në italisht),(f. 337). E ndeshim të shpjeguar me të njëjtin kuptim si tek “Bashkimi”; **përkujdesunë-** *kam kujdes” përkujdesunë, mb’breg (të) lymit qëndroi e soditi”* I III,I,2 (Lek, f. 303). Ndryshimi i vetëm qëndron në përdorimin e fonemës *j* tek “Bogdani në vend të *i* që përdor “Bashkimi”.

Perlevdue (m’u)- *krenohem* (shpjegimi në italisht), (f. 337).Tek “Leksiku” nuk ndeshim ndonjë shpjegim të hollësishëm të kësaj fjale, vetëm rastin ku

ajo është përdorur; **përlëvduem-** “përse u përlëvdue mbet dënuem” II II, V,33 (Lek, f. 303).

Permetoi- *shif:premttoi* (f. 338). E kemi tek Ashta (2002) me dy kuptime: **përmetuem-** 1.edhe këtu nga italishtja *promettere* “premttoj” “të parënë të mirë ja dha ndor e t’jetërënë ja përmetoi” I I,VI,242. këtu me kuptimin e italishtes *permittere* “lejoj, lëshoj” “disa ujëna tue i përmetuem ndë natyrë të ver” I I,IV,23 (Lek, f. 304).

Perpalli- *përhap, publikoj* (shpjegimi në italisht), (f. 340). E ndeshim edhe tek “Leksiku...” me të njëjtin kuptim; **përpallunë-** *përhap* “këjo godi përpallur ar tinë (e) tijnaj” I III, IV,4 (Lek, f. 305).

Pertochark- *rreth e rrotull* (shpjegimi në italisht), (f. 343). E kemi të shpjeguar njëllor edhe tek “Leksiku...” (2002), vetëm me ndryshime fonetike, përdorimi i ë-së dhe ai i q-së tek Bogdani që përkon edhe me fonemën e sotme, kurse tek “Bashkimi” kemi ch-q, sepse i është përshtatur alfabetit latin; **përtoqark-** *rreth e qark* “është përtoqark” I I,V,4 (Lek, f. 307).

Pervaesue (me)- *lag, spërkat* (shpjegimi në italisht), (f. 344). Këtë formë të pashtjelluar gege, nuk e ndeshim të shpjeguar në “Leksikun...”(2002).

Perxiarshem, (i,e)- *i flaktë* (shpjegimi në italisht), (f. 345). E ndeshim në këtë trajtë; **përzjarshim,i-** “*duketë i përzjarrshim e i bdriçim*” I I,VI,23 (Lek, f. 308). Këtu shpjegimi jepet në kontekst, ndërsa kemi ndryshime në pamjen fonetike; kemi përdorimin e ë-së, në vend të e-së, të z-së në vend të x-së tek “Bashkimi”, si dhe përdorimin me i dhe jo me e siç është përsëri tek “Bashkimi”.

Peshkuie- *pishinë* (shpjegimi në italisht), (f. 346). E kemi pothuajse me të njëjtën trajtë; **peshkujë-a- peshkësujë-** *formohet nga peshk + (ë)sujë. Prapashtesa ujë(sujë, zujë) dëgjohet në gegërishten veriore(Aleksandër Xhuvani- Eqem Qabej”Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë 1962; f. 96; Prapashtesa –ujë). Bogdani sajton një neologjizëm që i përgjigjej fjalës lat. Piscina” bani me bām një peshkësujë o një të mbëledhë ujënash”I III,IV,9 (Lek, f. 297). Ashta i jep një shpjegim të gjerë formimit të kësaj fjale, por tek “Bashkimi” nuk përdoren fonemat k dhe ë. Kjo të lë të mendosh se nuk kemi të bëjmë me një “huazim” të plotë nga Bogdani, por vetëm mbështetje në atë fjalë.*

Piegull- *pisë, katran* (shpjegimi në italisht), (f. 347). E ndeshim në një trajtë tjetër, por kuptimi është i njëjtë; **pjergull-** *nga distilimi i qymyrgurit ose nga distilimi i thatë i drusë nxirret katrani ose zifti;pjegulla:pastaj nga distilimi i katranit nxirret peshkvja ose pisa. “sulfurë, pjegullë e plumb përziem bashkë”I IV,VI,2 (Lek, f. 310).*

Pjeteposhte- nga lart poshtë (shpjegimi në italisht), (f. 349). E kemi të shpjeguar njëlloj edhe tek “Leksiku” i K. Ashtës (2002); **pjetëposhtë- teposhtë, tatëpjetë.** “rëzou pjetëposhtë” II I, VIII, 13 (Lek, f. 311).

Ploge (i,e)- i mefshtë, i flashkët (shpjegimi në italisht), (f. 356). E kemi të shpjeguar tek “Leksiku” pothuajse me të njëjtin kuptim; **plogë,i- përtac** “ndëshmi ata që ishinë kjanë të plogë” II II, VI, 8 (Lek, f. 312).

Pokrove- liit,a (Bashk), çarçafë (shpjegimi në italisht), (f. 357). E ndeshim me të njëjtën përmbajtje si është e përkthyer në italisht, ndërsa shpjegimi i “Bashkimit”, sot mund të quhet një arkaizëm; **pokrovë, a- mbulesë, çarçaf** “pokrova o lencuoli ndë të sijtë kje vorruem, kje huajtunë, marrë ngjetaj” II I, IV, 13 (Lek, f. 313).

Polemi- popull (shpjegimi në italisht), (357). Këtë fjalë e kemi njëlloj të shpjeguar dhe tek “Leksiku” (2002); **polem-i- popull** “polemi kashte për t’u e mbëledhë” I III, VII, 1 (Lek, f. 313).

Pomenne- memorie, kujtesë (shpjegimi në italisht), (f. 358). E kemi në këtë trajtë tek Ashta (2002); **pomendunë,i- të mbajturit mend, kujtesë** (bani me bam një shëmbëlltyrë fort mbë gasë të birt, tue vum emënitëasaj figurë idhullë, qi doj me thamë të pamendunit’ e vajit” I I, I, 9 (Lek, f. 313). Këtu kemi një ndryshim vetëm në trajtën fonetike ku Bogdani e ka të përdorur të plotë grupin e bashkëtingëlloreve *nd*, ndërsa tek “Bashkimi” e kemi të asimiluar në *nn*.

Pothe,a ose pofte - mënyrë (shpjegimi në italisht), (f. 360). E ndeshim të shpjeguar në trajtën e dytë dhe me të njëjtin kuptim; **pofte-ja –gjethe, model, mostër** “(janë) katër pofto damesh qi goditnë ndë fushat e janë krymbatë, kacadrëjtë, vëmetë e niegulla” I III, X (=XI), 1 (Lek, f. 313).

Priskoi- me stërpikë (f. 364). E kemi tek Ashta me të njëjtën trajtë dhe të njëjtin kuptim; **priskuem- stërpik, spërkas** “(gjaku) embushi tue priskuem faqenë atyne qi e rafinë” II III, II, 11 (Lek, f. 317).

Prothoi- ndihmoj, hyn në punë (shpjegimi në italisht), (f. 365). E gjejmë të shpjeguar tek “Leksiku” (2002) në një trajtë tjetër, por domethënia është e njëjtë; **prodhuem- është e vëjyer, e vlefshme** “prodhon fort të gedhunitë e saj për të marrë vesht shumë profeti” I IV, III, 1 (Lek, f. 318). Pra, ndryshimi qëndron se tek “Bashkimi” kemi të përdorur bashkëtingëlloren e e pazëshme *th*, ndërsa Bogdani ka përdorur të zëshmen *dh*.

Prugnim- ulje, rënie (shpjegimi në italisht), (f. 366). Tek Ashta nuk e gjejmë si emër vepruesi, por si mbiemër dhe kuptimi është thajse i njëjtë; **prunjshim, i- i përvujtë, kokulur** “me u bām i prujshim” II IV, III, 7 (Lek, f. 318). Një ndryshim tjetër qëndron edhe në përdorimin e bashkëtingëllores

gn, sipas alfabetit latin tek “Bashkimi”, ndërsa Bogdani përdor bashkëtingëlloen *nj* të alfabetit shqip.

Pshtimte (i,e,t’)- i mbyllur (shpjegimi në italisht), (f. 368). Kjo fjalë nuk gjendet e shpjeguar në “Leksikon” e K.Ashtës (2002).

Puke (udhe puke) – *rrugë kryesore* (shpjegimi në italisht), (f. 368). E gjejmë me të njëjtin kuptim edhe tek Ashta; **pukë-a-** *gjendet si pjesë e togfjalëshit udhë pukë “udhë kryesore”, “mbsheli udhënë pukë”* I III,XI (=XII), 1 (Lek, f. 319).

---R---

Resmi- *trashëgimi* (shpjegimi në italisht), (f. 374). Tek Ashta e kemi të shpjeguar në një trajtë disi të ndryshme, por domethënia është e njëjtë; **rrezmi-** *trashëgim, ajo që trashëgohet prej njëri tek tjetri brez “rrezmi”* I II,III,15 (Lek, f. 334). Ndryshimi qëndron në anën fonetike, ku kemi të përdorur *r* për *rr* (Bog), dhe *s* për *z* (Bog).

Rexe- *thith,i, menteshë, çivi* (shpjegimi në italisht), (f. 375). Tek Ashta (2002) e kemi të njëjtën trajtë por me një kuptim të ndryshëm ; **rreze-ja-** *“bahet posi syu i kukuvajësë përpara rezësë (së) diellit”* I I, I, 22 (Lek, f. 334).

Rige- *mbret* (shpjegimi në italisht), (f. 375). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku” (2002).

---RR---

Rragne- *rrënjë, lloj dushku* (shpjegimi në italisht), (f. 378). E ndeshim në këtë trajtë; **rranjë-a-** *fjalën rranjë nuk e merr si pjesë e nëndheshme e bimëve, as nuk emërton dushkun apo lisin, por atë dru si shkurre e pemën e saj, që e quajnë ferrëmanzë o manaferrë, Rranjë “manaferrë” del edhe më poshtë”* due të vete e të shof të pam të madh, përse nukë ntrete të rranja” I III, I,7(lek, f. 333). Kemi një ndryshim fonetik, përdorimi i fonemës *gn* (bashk) për *nj* (Bog). Kjo ndodh sepse “Bashkimi” përdor alfabeti latin.

Rrok,u- *cak, afat* (shpjegimi në italisht), (f. 383). E ndeshim tek Ashta të njëjtën trajtë por me *r* e jo me *rr*; **rok-u-** *afat, caktim” kishte vum rok me çuem”* I I, VIII, 20 (Lek, f. 331).

---S---

Sielle,a- *ceremoni* (shpjegimi në italisht), (f. 397). Tek “Bashkimi” e kemi me një kuptim, atë të ceremonisë, ndërsa Bogdani e përdor me tre kuptime. E ndeshim tek “Leksiku...” i K.Ashtës (2002); **sjellë-të,të-**

1.mënyrë”jo veçë vepërat e patriarkëvet po ende ato të sjella o çeremonia duhenë me u marrë me dy mëndyra vesh”I, II,I,13, **2.Bogdani** thotë të sjellëtë e kambës për hap “me të parët (të) sjellë të kambësë për t u avitunë”I III,I,8, **3. gjuajtje,goditje me forcë** “therri vetëhenë m’shpatet e, tue mbetunë pak gjall së siellet së vet, u lut një shatëri ta mbysë për të mos pësuem”I,III,II, 23 (Lek, f. 342). Një ndryshim tjetër qëndron në përdorimin e zanores *i* tek “Bashkimi”dhe *j* tek Bogdani.

Starifat- *krushkamadh* (f. 405). Tek “Leksiku...” (2002) e ndeshim në këtë trajtë; **starisfat-i-** *krushkamadh, krushkaparë, ai që u prin krushqve “ e pa starisfati se vend ish ma së miret doreje”* II II,I,8 (Lek, f. 344).Vërejmë se Ashta *i* ka dhënë një shpjegim më të qartë kësaj fjale me prejardhje sllave, por ka një ndryshim në drejtshkrim se “Bashkimi” e përdor pa bashkëtingëlloren *s*, ndërsa tek Bogdani e kemi me *s*. Ndoshta mund të bëhet fjalë edhe për ndonjë lapsus.

Stenitse- *çimkë, tartabiqe* (shpjegimi në italisht), (f. 404). E gjejmë me të njëjtin kuptim tek “Leksiku”(2002); **stenicë-a-** *çimërr, çimkë “shumicë e pa njehunë stenicash”*I III,I,16 (Lek, f. 344). Kemi një ndryshim të përdorimit të fonemës *c*, ku tek Bogdani e ndeshim të plotë sipas alfabetit të sotëm, ndërsa tek “Bashkimi” kemi përdorimin e grupit të bashkëtingëlloreve *ts* për *c*, gjithnjë sipas alfabetit latin.

---SH--

Shijon – *bie shi* (shpjegimi në italisht), (f. 420). Kjo fjalë e cila sot nuk zë vend në leksikon e përditshëm, është formuar nga Bogdani nga rrënja e emrit shi.Si të tillë e gjejmë edhe tek K.Ashta (2002); **shijuem-** *bie shi, shij-on “reshit shijoftë”* II I, III, 9 (Lek, f. 349).

Shkuimoi- *gjeneroj, prodhoj* (shpjegimi në italisht), (f. 427). Këtë fjalë nuk e ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku” i K.Ashtës (2002).

Shmijegni,a- *konfuzion* (shpjegimi në italisht), (f. 429). As këtë fjalë, si më sipër nuk e ndeshim të shpjeguar tek “Leksiku” (2002).

Shtektoi- *shtegtoj* (shpjegimi në italisht), (f. 438). Kjo fjalë e përdorur tek “Bashkimi” ashtu edhe tek Bogdani është e njëjtë me kuptimin aktual.Si të tillë e ndeshim edhe tek Ashta; **shtektuem;** “*shtegton*” I II,IV,10 (Lek, f. 356).

Shugtaar- *kupëmbajtës* (shpjegimi në italisht), (f. 443). Kjo fjalë nuk gjendet e shpjeguar në “Leksikon...” e K.Ashtës (2002).

Tame,ia- *qendër* (shpjegimi në italisht), (f. 57). Këtë fjalë nuk e ndeshim tek “Leksiku...” (2002).

Tebane- *tabernakull* (shpjegimi në italisht), (f. 450). Në “Leksikon...” e Ashtës e ndeshim në një trajtë tjetër dhe jo ashtu siç jepet tek “Bashkimi”; **tabernakull-i-** “*ata votnë ndë tabernakullit*” I III, I, 30 (Lek, f. 359). Pra, tek Bogdani e kemi në trajtën siç përdoret sot.

Tinai (i,e)- *i tij* (shpjegimi në italisht), (f. 456). E kemi tek “Leksiku...” në këtë formë; **tijnaj,i-** “*gjithë nierëzia e shtëpisë (së) tijnaj për të përgëzuem të zotnë (=kryefamiljarin), zunë fill me i u bindunë atij idhullit*” I I, I, 9 (Lek, f. 362). Kemi pak ndryshime në drejtshkrim nga *tinai* tek “Bashkimi” në *tijnaj* tek Bogdani.

---TH---

Thin,i- *sqep* (shpjegimi në italisht), (f. 475). Tek Ashta e ndeshim me të njëjtin kuptim, por me pak ndryshime në anën fonetike; **thind-i-** *thimth* “*(mushkaja ka) thind qi depërton lëkurën’ e nji kau*” I I,i,4 (Lek, f. 368). Ndryshimi qëndron tek përdorimi i grupit të bashkëtingëlloreve *nd* ku Bogdani i përdor të plota, ndërsa “Bashkimi” e asimilon në *n*.

---TS--- (C)

Tsehe- *minierë* (shpjegimi në italisht), (f. 477). E kemi në këtë trajtë; **cehe-ja:xehe-ja-** *minierë* “*xehe (graf.zeha) ari e rëgjandi*” I I,V,15 (Lek, f. 382). Vërejmë se Bogdani përdor dy trajta emërore për këtë fjalë, ndërsa nga ana fonetike “Bashkimi”, sipas alfabetit latin, përdor grupin e bashkëtingëlloreve *ts* për *c*.

---V---

Visaar,i- *thesaar* (f. 495).tek “Leksiku” i Ashtës kuptimi jepet vetëm përmes një fjalie; **visari-** “*nxjerr erët prej visareshit si vet*” I I,V,21. Ndryshimi qëndron si gjithnjë në anën fonetike, ku tek “Bashkimi” kemi përdorimin e dyfishimit të zanoreve për të treguar gjatësinë.

Vitee, vitëni- *trokull* (për rrush, ullinj) (shpjegimi në italisht), (f. 495). E gjejmë tek “Leksiku” (2002) me të njëjtin kuptim e formë; **vitë-ni-** *dërrasë e trashë që mëshon mbi kanistrën, shpëtë e gjërë, me ullinj e rrush për të shtrydhur* “*kanë me u grumbulluem vitëji me venë e me vaj*” (Lek, f. 377).

Voeson- *bie vesë* (shpjegimi në italisht), (f. 497). E gjejmë të shpjeguar tek “Leksiku...” (2002); **voesuem-** *veson, bie vesë (voëzoni(graf. voëssoni), e qiell, përsipëri*” I, IV,36 (Lek, f. 378).

Voishtii,a- *taksë* (shpjegimi në italisht), (f.497). E ndeshim tek “Leksiku...” si të tillë; **Vojshtinë-** *haraç, taksë* “*nukë paguen vojshtinënë Perëndorit*” II II,V,11 (Lek, f. 379). Kemi një ndryshim të vogël drejtshkrimor, ku “Bashkimi” përdor *i* në vend të *j* tek Bogdani.

Vojvode- *kryetaar* (f. 497). Këtë huazim serb e ndeshim të shpjeguar tek Ashta thuajse me të njëjtin kuptim; **vojvodë-a-** “*i parë fisi*”. *Kapiten ushtrie* “*dha një letërë Urisë ta shpij Joabit, vojvodësë (së) ushtërisë (së) vet*” I III, II, 25 (Lek, f. 379).

Volleenneie, vollennet- shif: vullnese- vullnet (shpjegimi në italisht), (f. 498). E ndeshim tek “Leksiku...” (2002) në këtë trajtë; **vollëndetja-vullëndet-ja** (Lek, f. 379). Vërejmë se shpjegimi është i njëjtë, por ndryshimi qëndron në anën fonetike, ku tek Bogdani e ka përdorur të plotë grupin e bashkëtingëlloreve *nd*, ndërsa tek “Bashkimi” e kemi të reduktuar në *nn*.

---U---

Ugnii,a- tërësi, perfeksion (shpjegimi në italisht), (f. 503). E gjejmë tek “Leksiku” (2002) në një formë tjetër, por kuptimi mbetet i njëjtë; **ungji-tërësisht** “*tue mbajturë vajzëninë (e) parë ungi*” II I, IV, 5 (Lek, f. 370). Vërejmë se kemi ndryshime në përdorimin e kësaj fjale tek përdorimi i bashkëtingëllores *gn* tek “Bashkimi”, ndërsa tek Bogdani kemi në vend të saj *gj*. Gjithashtu për të treguar gjatësinë e zanores tek “Bashkimi” kemi dyfishimin e saj, ndërsa tek Bogdani kemi përdorimin e shenjës diakritike (*ī*).

---X--- (Z)

Xotenuer- zotërues (shpjegimi në italisht), (f. 521). E kemi tek “Leksiku” (2002) në të njëjtën formë; **zotëruer-ori-** “*zotënor*” I III, XIX (Lek, f. 388). Kemi ndryshime vetëm në anën fonetike. Ndodh fenomeni i rotacizmit ku tek “Bashkimi” kemi *xotennuer* dhe tek Bogdani *zotëruer*. Gjithashtu kemi të bëjmë me përdorimin e bashkëtingëllores *x* për *z* tek “Bashkimi”.

Vërejmë se si Bogdani ashtu edhe fjalori i “Bashkimit” i përkasin të njëjtit dialekt, atij gegë, por tek Bogdani dallohen tipare të një gëgërishteje pak a shumë të normalizuar.

Bogdani shkon gjithnjë me paravajtesit e tij, Buzukun, Matrëngën, Budin e Bardhin, në ruajtjen e ë-së. Ajo tek Bogdani përdoret në pozicione të ndryshme, herë në rrënjët e fjalëve, herë në parashtesa e herë në prapashtesa. Shumë shkrimtarë përdorin tingullin *e* për *e* dhe *ë*, ashtu siç ndodh me autorët e Bashkimit, dhe janë të paktë ata që e përdorin atë të prerë, siç kemi në rastin tonë, Bogdanin. Ky fakt, sipas K.Ashtës, dëfton se gjuha e Bogdanit në këtë pikë shkon më shumë me atë të shokëve përpara tij sesa me atë të pasardhësve. Kemi shembuj të plotë, si: *perkore* (Bash)-

përkorë (Bog), *perkuidesem* (Bash)- *përkujdesunë* (Bog), *rragne* (Bash)-*rranjë* (Bog), *siella* (Bash)- *siellë-të* (Bog), *stenitse* (Bashk)- *stenicë* (Bog), *vojvode* (Bashk)- *vojvodë* (Bog), *xotenuer* (Bashk)- *zotëruer* (Bogd) etj.

Bogdani ashtu siç autorët e Bashkimit i ruajnë të plota grupet e zanoreve uo/ue, ae/oe, ie/ye, psh.: *xotenuer* (Bashk)- *zotëruer* (Bog), *civuer* (Bash)- *kjuer*(Bog), *nniekoi* (Bash), *perhiem* (Bash)- *përhiem* (Bog), *perkthielloi* (Bash), *pervaesue* (Bash), *voeson* (Bash)-*voesuem* (Bog) etj.

Tek Bogdani vërejmë përdorimin e plotë të grupit të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng,ngj*, ndërsa tek Bashkimi i kemi të reduktuara në *nn* psh.:*gnimenne* (Bash)- *njimend* (Bog), *lanne'ie* (Bash)-*landë* (Bog),*nnerkaca* (Bash)-*ndërkaqa* (Bog), *nnertsoi* (Bash)- *ndercuem* (Bog), *nnivenese* (Bash)- *ndivënesë* (Bog), *pomenne* (Bash)- *pomendunë* (Bog) etj. Por ka edhe raste kur “Bashkimi” i përdor të plota këto togje: *ngheroi* (Bash)- *ngjëruem* (Bog), *nghic* (Bash) - *ngjiq* (Bog).

Tek “Bashkimi” kemi përdorimin e *i* në vend të *j* tek Bogdani, psh.: *diiekec* (Bash)- *dijekeq* (Bog), *kthielle(i)* (Bash)- *kthiellë,i* (Bog), *percielle* (Bash) – *përcjellë* (Bog), *perxiarshem,i* (Bash) – *përzjarshëm,i* (Bog), *peshkuie* (Bash)- *peshkujë* (Bog), *piegull* (Bash)- *pjergull* (Bog) etj. Por, ka edhe raste kur “Bashkimi” përdor *j* njëlloj si Bogdani, psh.:*chtjelle* (Bash) – *çtjellë* (Bog), *hijenue (me)* (Bash) – *hie-ja* (Bog), *pjeteposhte* (Bash)-*pjetëposhte* (Bog).

Bashkimi përdor fonemën *ts* për *c* tek Bogdani, psh.: *perbalts* (Bash) – *përbalcas* (Bog), *stenitse* (Bash)- *stenicë* (Bog), *tsehe* (Bash)-*cehe* (Bog) etj.

Së fundi, mendojmë që autori (apo autorët) e këtij Fjalori kanë qenë në nivelin e dijeve albanologjike të kohës, përderisa kanë vënë shënime kopetente etimologjike duke grupuar fjalë me prejardhje nga turqishtja, italishtja, serbishtja. Në këtë mënyrë Fjalori ruan sot e kësaj dite vlera historike, jo vetëm në planin leksikografik, por edhe në atë gjuhësor për të parë e studiuar nënsistemin - që nga fjalëformimi deri tek gjendja e sistemeve emërore, foljore, mbiemërore e ndajfoljore, prandaj mund të shprehemi, siç shënon prof. Emil Lafe, kjo kolanë ka vlera meritore.

BIBLIOGRAFI:

1. Fjaluer i rii i shqypes, 1908
2. Kolë Ashta, Leksiku historik i gjuhës shqipe IV, Tiranë, 2002.
3. Tahir Dizdari, Orientalizmat në gjuhën shqipe, Tiranë, 2005.
4. Jani Thomai, Frazologjizmat në gjuhën shqipe, Tiranë, 1999.

Bogdani's lexicon in the Dictionary "Bashkimi"

SUMMARY

In all the events of these time we were concentrated at the edition of "Fjalori i shoqërisë Bashkimi", like an interesting work in our lexicographic studies.

Otherwise, we have overlooked that in our scientific literature for "Bashkimi" doesn't have detailed analysis.

The lexicon of Bogdani has a great content in the dictionary of "Bashkimi", over 130 words.

The commentary of these words are given through "Leksiku historik i gjuhës shqipe" IV, Kolë Ashta, 2002.

In "Leksiku historik i gjuhës shqipe" although the meaning of the words is the same with the dictionary of "Bashkimi", the changes are only phonetic and orthographic.

The meaning of the words in "Leksiku historik i gjuhës shqipe" is given clearly, but when the word is habitual, we didn't feel the necessary to give the explanation.

Aida URUÇI

**VËSHTRIM RRETH LIGJËRIMIT ARTISTIK DHE
NGJYRESAVE TË MJEDISIT TEK ROMANI “RRATHË”
I MARTIN CAMAJT**

***“Martin Camaj i veçantë midis të veçantëve,
i ngjashëm vetëm me vetveten, më i kompletuari
poet modern i poezisë shqipe, që do të kuptohet
e shijohet progresivisht me rritjen progresive
dhe evropianizmin e kulturës shqiptare, është
mjeshtër i madh i fjalës”⁵⁸***

* * *

Kryevepra e Martin Camajt në prozë dhe në të njëjtën kohë, një nga kryeveprat më të shënuara bashkëkohore të letërsisë sonë tregimtare, është romani “Rrathë”. Ai është ndërtuar si një triologji, në tri pjesë, secila me titull më vete: “Rrathë uji”, “Rrathë zjarri”, “Rrathë gjaku”, dhe është gjithashtu një model me pasuri të madhe gjuhësore në mjaft rrafshe, që nga leksiku i rrallë, frazeologjia, formimi i fjalëve me brumë të shqipes dhe sidomos nga mënyrat e veçanta të ndërtimeve sintaksore, sipas natyrës së gjuhës sonë.

Një nga studiuesit e thukët të krijimtarisë së Camajt në planin letrar (të mitit, metaforikës dhe simbolikës), poeti K. Petriti nënvizon se *Fjala është e njëjtë për të gjithë, shpirti i fjalës është vetjak*. Dhe është e vërtetë që me pasurinë e thesarit gjuhësor nga standardi e prurjet dialektore, Camaj arrin të shprehë atë që dëshiron dhe ashtu si dëshiron, atë që duhet dhe si e sa duhet me anë të përdorimit të fjalës si me magji, me anë të formanteve të shumta dhe të larmës të idolektit të tij, që del i pastër, i moçëm, gjithmonë i aftë dhe i efektshëm për të ravijëzuar skena e mjedise, ngjarje e pasazhe, dukuri të natyrës, deri në labirintet e mendjes e shpirtit njerëzor.

Duke qenë njohës i mirë i ligjërimit e të folmeve popullore të Malësisë, po edhe të gjuhës letrare shqipe të njësuar e të gjedheve

⁵⁸ K.Petriti, *Fjala poetike-kuti e Pandorës*, Globus R, 2008, f. 367.

fjalëformuese, M. Camaj shquhet në vepër për aftësinë që të krijojë figura, të japë mjedise e tablo të gjëra, të përshkruajë e të portretizojë personazhe nga më të larmishmit, me hollësinë dhe bukurinë e nevojshme, po edhe me të gjitha ngjyresat e duhura ligjërimore që u përshtaten atyre. Ngjyresat më të bukura krahinore treten e shkrihen natyrshëm me trajtat normative letrare duke e bërë ligjërimin e kësaj vepre të pasur, kumbuese e me peshë të madhe tek lexuesi.

“Gjuha e prozës së Camajt, megjithëse në parim ishte kundër një gjuhe letrare të njësuar mbi ato parime që u ndërtua, është rreptësisht e pastër, e kuptueshme, me figurshmëri që buron prej frazeologjisë dhe idiomatikës së vetë ligjërimin të folur shqip. Është një shqipe që e tejkalon pretendim që zakonisht thuhet se ishte synimi i tij.”⁵⁹

Camaj është mjeshtër i skenave dialogjike dhe i dialogut të rrjedhshëm, edhe kur ka pamje prekëse biseda, edhe kur ajo del e shtruar në replikat e njërit dhe është e hovshme në ato të marrësit, edhe kur ajo mund të shpërthejë prej çastit në çast prej njëres palë, që bie në *dispjek* (zemërim, inat). Ligjërimi letrar (a bisedor) me anë të skenave dialogjike paraqet të vetmin rast kur koha e tregimit përputhet dhe koha e historisë përputhen. Dialogjet dhe skenat e dialoguara përdoren mjaft sot në narrativën moderne bashkëkohore. Kështu edhe Martin Camaj, ka pasazhe të mrekullueshme në roman, siç është takimi i Soses, të bijës së Rapsodit me Cubin e malit, tamam me një cub si i Migjenit tek tregimi “Puthja e cubit”, por te Camaj përzier me elemente folklorike dhe përshkrime psikologjike të thella. Pjesëmarrësit e bisedave dialogjike tek romani “Rrathë” nuk futen në veprim pa u përshkruar nga autori, pa të dhëna paraprake të dispozitave të tyre, siç bën autori kur pjek në takim gruan Vajtore me Cubin e malit:

“Grueja mund të kishte shumë-shumë me thanë nja njëzet vjeç, dhe e veshun zi ngjante tepër e bardhë në fytyrë si të mos kish pa rreze dielli atë mot. Nga ruba, tash lidhë mbas kreje, i delshin kshetët e shprishuna të flokëve të zez si pendë korb, ma të zez se teshat. Ndonëse e mbulueme me petka të trasha e të randa malsoreje shihej se ishte shtat-këputun e hollake; këta mund të dallohej edhe prej lëvizjeve të shkafta të gjymtyrëve. Novelistit i ra ndër mend një thanje e banorëve të saj anë: shëmtimi mund të fshehet ma lehtë se hijeshia. Ajo asht grue e bukur, tha Agoni. Burri ndiqte me sy duert e grues –të kërthnosta si fjolla avulli-të cilat së mbrami nxorën prej strajce një poture me të njomë.” (f.125)

⁵⁹ A.Klosi, *Martin Camaj, Vepra letrare I*, Tiranë, 1995, f.4.

Po kështu, i gjallë e deri në imtësi të trupit e shpirtit vizatohet Cubi, që do të hyjë në dialog me gruan e bukur e të hijshme: ai është *i padurueshëm*, se mban toka në një vend, siç thotë populli i atyre anëve, *dyshues*, *i ngutshëm*, *nuhatës i çdo rreziku të mundshëm*, gjithnjë gati të përballojë çdo gjë që *kundron ngulitshëm* dhe lëviz si egërsirë mali. Mjetet gjuhësore autori i merr në mjedisin rrethues ku Cubi çon jetën prej ilegali: *si cung lisi i thatë, si bigë mes dy currave, veshun me tirq zhguni të zez e këpucë të grisuna...*

“Ajo e dinte se një që jeton në ilegalitet asht i gërryem natë e ditë prej mosbesimit .Ata të gjithë kanë një sjellje e të pamë: lëvizjet e të arratisurve u përngajnë lëvizjeve të egërsinës së malit! Kërset dushku,dhe kryet ngrehet si vetima dhe sytë e tyne janë ma të shpejtë se drita. Ai dukej edhe në të pamë se ish asish: i djegun nga dielli dhe i acaruem në fytyrë prej erës e motit me shi e bore. Ashtu i parruem s’mund të zbulohej se çka mendonte dhe sa vjet kishte. Koha e përpjesshme mbi shpatullat e gjana e të çueme pakëz thep përpjetë, jepte përshtypjen e një cung lisi të thatë i mbajtur shtrënguet në bigën e dy currave. Kishte mbathë tirq zhguni të zez e këpucë të grisuna gome me siprinë lëkure lope. Një palë çorapë të dhintë me kallma deri në gjysmën e kërsisë.” (f. 125)

Jo vetëm personazhet aktivë e veprues janë protagonistë të ngjarjeve në romanin “Rrathë”, por edhe ato inaktiv, janë sjellë para lexuesit nga shkrimtari aq të gjallë e të individualizuar gjuhësisht, me anë të krahasimeve dhe një leksiku të zgjedhur, si vjen portreti i paharruar i Memecit tek pjesa “Rrathë zjarmi”, përndryshe, çasti i takimit të Novelistit me këtë qenie kaq interesante në planin psikologjik, të cilin natyra e ka privuar nga fakulteti (shqisa) gjuhësore e të folurit, por e ka kompesuar këtë mungesë me zgjuarsinë e pazakontë dhe me një mënyrë sjelljeje për të rënë në sy në veprime individuale dhe në marrëdhënie me të tjerët, që mund të kenë epërsi sa u takon shqisave dhe perceptimit të natyrës. Memeci, sipas autorit, është i pagoji dhe shurdhi, që komunikimin njerëzor e realizon vetëm me anë të gjymtyrëve, të trupit(trungut), shikimit të drejtpërdrejt apo ngultas; pse jo edhe me anë të heshtjes, ai ia del të hyjë në bashkëbisedë me të tjerët: *avitet , vë shuplakën e dorës në veshin e djathtë, kinse(gjoja)për të kuptue ma mirë, ai rri me një pasqyrë në dorë, të tjerët harrojnë si asht dhe i lëshojnë za, ai asht nervoz për këtë “padrejtësi”të nanës Natyrë...dhe autori ynë e ndjek portretizimin edhe përmes veprimeve të kursyera të të pagojit, i cili kujton se njerëzia luante me të:*

“Novelisti vërente prej nalt, pingul, fytyrën e vogël të tij e cila pa prej majes së currit nuk dukej ma e madhe se fytyra e një fëmije, e parrueme e me mustakë të gjatë e të zez. Në dorën e djathtë i pagoji mbante

një kizë që herë pas mbas here, si mbas lëvizjes së dorës nevrrike, shkëlqente në rrezet e diellit dhe këto i merrnin sytë Agonit...mes gishtave i shfaqej si nëpër flakë të vetëtimës i pagoji, i vogël-kryehudhër-dhe vetëm shputët e këmbëve të tij me këpucë gjigande zgjatëshin deri te rranza e shkëmbit si të kish ndërmend ta shqelmonte atë me gjithë Novelistin në mushk në maje, mun të tanë botën që tallej me të synonte ta rroposte memeci...”(f.100)

Ndonjëherë shkrimtari gjen mënyra tepër të kursyera për të vizatuar personazhet e rrëfimit gjatë romanit, përherë me tipare fizike në pajtim me malet e larta e honet e thella, shtëpitë e gurta me dritare të vogla, duke i sjellë si katallanë nëpër mjedise natyrore, krahasuar me shkëmbinj e masive gurore të forta:

“Kandili ndriste edhe parzmin e gjanë e kryet e madh të Bacit: koka e lidhun me qafën e trashë përbanin një copë trupore të vetme që soste në rrafshnaltën e butit të kresë pa flokë. Agoni s’mund t’ia shpjegonte vetes se si kish arritë të tanë ajo masë në kambët e veta deri atje nalt. Duhej të kishte një zemër çeliku!”(f.119)

Ndodh nëpër faqet e romanit” Rrathë”, që në dialogje (të cilat janë mjaft të rralla, pasi vendin kryesor e zënë përshkrimet psikologjike dhe përjetimet e autorit dhe të personazheve), të kemi replika kaq të kursyera, të ndërtuara me thënie e nëntekste, sa lexuesit i duhet të ndalet e të mendojë ku aludojnë folësit (dhënësi e marrësi), ku rreh biseda në përgjithësi, siç është rasti për prezantimet (paraqitjet) në një rreth shokësh a miqsh, kur në bashkëbisedime të tilla ka edhe faktorë gjuhësorë, me radhë pyetjesh të njëpasnjëshme, edhe jashtëgjuhësor:

“Mikeshë? E fejuemja? ” Pyeti Nusha ngurrueshëm.

“Ma tepër, shumë ma tepër!”

“Ma tepër? Kush asht ma tepër se e fejuemja?”

“Një vajzë, për shembull, e paarrishme!”

“Përtej kufijve? Kam kujtue se je ma i urtë, por ti qenke me te vërtetë fantast i pashërueshëm!”

“Si ta marrish: përtej kufijve mund të jetë andej lumit, për shembull, në Ripë.”(f.50)

Nëpër skenat dialogjike, me të folurit spikatur të pjesëmarrësve në bisedë, autori gjen vendin ku të bëjë përshkrimet dhe eksplorimet psikologjike të personazheve që trajton, ashtu si vepron brenda këtij dialogu të goditur, gjatë të cilit zotëron ligjërimi vetëm i Cubit, ndërsa Sosja më tepër hesht e flet me heshtjen, duke mbajtur qëndrimin e saj prej grajve të zgjuar që parasheh thujtë çdo gjë, parasheh edhe fundin e

ilegalit, edhe ditën kur do të qajë. Shkrimtari ia del jo vetëm të kalojë nga njëra kohë foljore tek tjetra, por edhe të ndërrojë aq bukur format foljore, nga të shjelluara në të pashtjelluara, me anën e të cilave diku veprimi ecën përpara, diku merr pamjen e qetë e mbetet edhe në vend, për t'u zënë me hapësirat psikologjike, të folurit e brendshëm. Nga teoritë e interpretimit të teksteve, dihet se për narrativën letrare, tipike janë kohët e shkuara, kryesisht e pakryera, më se e kryera dhe e kryera e tejshkuar, por në prozën epike të këtij romani të Camajt gjejmë një pasuri shumë më të gjërë të përdorimit të foljeve edhe në të tashmen, edhe në të kryerën e thjeshtë, prania e së cilës, me denduri të dukshme, në kuptimin përfundues, e çon më tej narracionin, duke prishur vazhdimësinë (vijimsinë monotone, plogështinë) e së pakryerës. Seria e gjatë –pa ndërprerje –e foljeve në të pakryerën shërben për të përshkruar protagonistët dhe për të dhënë njoftime të shkurtëra mbi rrethana të ndryshme. Prandaj, mund të thuhet që tek ky shkrimtar i Veriut, foljet në kohët e pakryer, e tashme, e kryer e tejshkuar dhe format “duke+përcjellore”, japin skena statike ose përshkruese, ndërkohë që foljet në të kryerën e thjeshtë e të së tashmes historike shënojnë veprime e kështu shërbejnë të gjitha në çuarjen përpara të historisë. Sipas studiuesve të sintaksës së tekstit, ndër të cilët edhe gjuhëtari i paharruar Tafil Kelmendi, pohohet se tipare themelore të kohës së kryer të thjeshtë, janë tipari i obligueshëm kohor-e shkuara-dhe tipari i obligueshëm aspektual”aoristik”, kurse tiparet themelore të së pakryerës janë tipari semantic (kushtimisht i obligueshëm), “e shkuara” dhe tipari aspectual “imperfektiv”. Në rrëfim, e kryera e thjeshtë dhe e pakryera janë në marrëdhënie ndërplotësimi, bashkëplotësimi (komplementariteti): e para për të shënuar kuptim aspektual të kryesisë (imperfektiviteti) a për dhënien e veprimit në të shjelluar, në vijimsinë e tij.”⁶⁰

Kjo dukuri quhet në gjuhë ecuri e rilievizimit, që ndeshet mjaft dendur në pjesë rrëfimtare të romanit që kemi si objekt hulumtimi. Në dialogun që po sjellim këtu nuk ka shumë lëvizje, por dalin zhvillime të vërteta, para çastit të ligjërit dhe pas tij, duke arritur një drejtpeshim ndërbesedor të atillë që perceptimi i dëgjuesit (lexuesit), të jetë gjithnjë i tendosur, aktiv, pa ndërprerje, po linear në vargun sintagmatik ligjërimor, siç ngjet edhe në pasazhe dialogjike si këto:

“Ai ia ngjiti bukës dhe e kafshoi si mollë. Asht një cub i rendomët, tha Novelisti, pa ideale, produkt i instinkteve të dobëta të shoqnisë....”

“Në katund po vijnë shumë njerëz të huej! ” Pëshpëriti nusja.

“Çka flitet? Çfarë flitet vesh më vesh? Këtë due me ditë! ”

⁶⁰ T.Kelmendi, *Studime sintaksore*, Prishtinë, 2008, f. 67.

“Kush dreqi e di prej kuj e për ç’punë përhapen këso fjalësh. Ndër bjeshkë s’ka njeri të gjallë pos meje, a merr vesh? Unë, a merr vesh? Jam zot mbi bjeshkë, shpella, kroje e përroje!”

Grueja qeshi tue tregue dhambët e bardhë.

“Nuk më zen besë?” E pyeti atë idhnueshëm.

“Emrin tand s’e përmend njeri i gjallë!”

“Mirë, mirë, por vëni shej kësaj fjale: nuk do të bjerë ky gjeth pa ma pasë përmend emrin i madh e i vogël, prej këtu deri në det! -Emni im do të kalojë gojë në gojë si era!”

“Si dreqin nuk po të marr vesh pse shurdhë nuk jam, por vëja mendën e të mos qaj mbi ty si mbi këtë strajcë të zezë sot e mbi hebet para dy ditësh. E kësaj herë me gjithë mend.” (f.126)

Duke e pasë njohur në thelb të folurit e lirë të malësorëve që përshkruan, Camaj, njeh dhe të fshehtat e synimit të thënieve të tyre, *replikave edhe me të hjedhuna*, që dalin natyrshëm nëpër dialogje a kuvende të improvizuara, të cilat vijnë sipas çasteve dhe përshtaten aq bukur e qëllojnë aty ku duhet, pa vrarë dikë, a, ndoshta edhe duke gjuajtur disi. Ligjërime të tilla si ai i bisedës së shkurtër mes Novelistit dhe një ripasi, të bëjnë përshtypje, shprehin më shumë sesa thonë e shfaqin një pasuri në disa pamje, ku spikat kryesisht mirësjellja gjuhësore, si kortezi:

“Mos ma merr për randë që të pyeta se për kah je nisë. Qenke veshë mirë: veshja burrnore e Ripës asht e përmendun dhe të paska hije.”

Burrakoqi përnjimend i pashëm u kënaq për lëvdime tha qesh e ngjesh:

“Fjala jote në vesh të grave të bukura! - (Përshtatje a shtrembërim i qëllimshëm i thënies popullore fjala jote në vesh të perëndisë!) - Edhe mënyra si e tha ia mbushi mendën Agonit se kish shque mirë me cilësorin Lakmues . - Po mue më ka kalue koha e lakmimeve; apo m’i sheh thijat?”

“Edhe ujqit janë të përhimë..”

“Vërtetë! - Qeshi Lakmuesi. - Po ujku lind pakëz i përhimë.”

“Pa i lypë njeni - tjetrit emnin, u përshëndetën dhe u ndanë në drejtime të kundërta.” (f.102)

Romani “Rrathë” nuk ka shumë personazhe, por portretet e tyre janë aq të gjalla, si në pamjen fizike, ashtu edhe në atë shpirtërore, siç ngjjet me Sosen (thirrur me këtë emër për të mos lindë ma përjetë në truall asnjë vajzë e për të pritur mashkullin e shtëpisë, ndërsa e ëma që s’e lindi djalë, do të quhej Ara e Keqe), është *andërruese*, për disa malësorë, *nuk asht mirë me mend*, për një opinion më të gjerë, ajo vajzë asht e *ndërrueme Orësh*, sipas disave dhe ashtu si e tregon i ati, Shalagani: *Rapsodi ban be e rrëfe se natën në një gjendje mes adrrës e zhgandrrës e ka pa me sy se si Ora ia kishte marrë të*

bijën në djep dhe ia ka ndërrue ndërsy me një vajzë tjetër po si Sosja. Pra kjo ashtë Sosja që njohim na , si mbas Shalaganit, nuk asht e bija sepse të bijën e vërtetë ia kanë marrë Orët. (f.134)

Sosja na shfaqet njeri dhe Orë, Zanë dhe Floçkë, herë dukej si hijedrite, herë zhdukej si frymë, herë shfaqet me gjithë rroba si një çikë e vërtetë malësore, herë me karmin lakuriq. Ajo është një qenie ireale dhe reale, herë shtëpiake e mirë, herë epshore dhe tërheqëse për meshkujt, që kurrë s' mund ta preknin me dorë. Këtë bukuri e kërcënon dhunimi e përdhunja e rengu që kishte dashtë t'i sillte ilegali! Portretet e Camajt më shumë se me ngjyra piktori, janë përshkrime të imëta lëvizjesh me duar, këmbë e kokë, me heshtje e përjetime, si jepet Sosja Vajtores:

“Për atë kohë që e vërejtë, Sosja s' mbeti asnjë të imët e qetë: herë goditej, herë përpushte zjarmin, herë thente grimca krandsesh dhe i vente pranë, grumbull, në mënyrë që nëse ndalej flaka ta ndezte me to pa vonesë. Ngjante e përqendrueme në punët e veta dhe zanun plotësisht me vetvete si me qenë fare vetëm. Agoni përpiquej të hynte në gjendjen e saj shpirtnore. Vajza në vetmi, thoshte ai me vete, ka gjetë vetvetiu njëlloj drejtpeshimi apo mënyrën ma të përshtatun për të kalue kohën.” (f.147)

Martin Camaj arrin të depërtojë në psikologjinë e personazheve malësorë, siç ndodh edhe tek figura e Rapsodit që njihet me emrin Shalagan (fonetikisht i përafërt dhe, ndoshta, si një identifikim shpërdorues i Katallan). Nuk ka si të ndodhte ndryshe. Malësitë e Dukagjinit e Temalit, ku zhvillohen ngjarjet e romanit, ishin hapësira të krijimit të miteve dhe banorët epikë të këtyre anëve s'kanë si të mos kenë në formimin e tyre elemente të menduari, mendësi dhe sjelljeje të mbështetura në besime e ide të tilla.

Studiuesi Tonin Çobani duke shkruar për figurat mitologjike në Lahutë të Malcis (një areal i njëjtë pothuajse me hapësirën ku zhvillohen ngjarjet e romanit “Rrathë”), ka vënë në dukje se ndër male të Veriut, *Zanat dhe Orët ishin një realitet, ta quajmë fantastik shqiptar. Ditën malësorët gjallonin me pushkë në krah, natën mbylleshin në kullat e tyre për t'ua lëshuar trojet përreth qenieve mitike, të cilat kishin në dorë jetën e njerëzve, mbarëvjtjen e gjësë së gjallë, shumimin e bërëqetit. Secili person ose çdo gjë e gjallë kishte orën e vet të bardhë ose të ligë. Çdo fis a krahinë kishte Zanën e vet që ishte e bukur “me të verbue”, trime “me të çartë”...Netëve me hënë të plotë Zanat dhe Orët e maleve këndonin dhe hidhnin valle zabeleve të bukura buzë ujërave, ashtu si ditën malësorët mblidheshin në log duke u argëtuar me këngë e valle.⁶¹*

⁶¹ T.Çobani, *Figurat mitologjike në Lahutë të Malcis*, Toena, Tiranë, 2008, f.16.

Dhe kjo ndodhë atje në Malësi me Shalaganin rapsod, mbasi ai ka thye ligjin e Orëve: ato nuk duhen prekur, nuk duhen shikuar dhe u nuk duhen vrarë dhitë e egra, kur burrat dilnin për gjah, sepse dhitë magjike janë të tyre e mbrohen prej tyre (kujto dhitë e egra të Lugjeve të Verdha në Epos, që i japin qumësht Mujit për t'u bërë i fuqishëm, pasi nuk i ka trazuar dhitë e Orëve), por Shalagani, *në rini paska gjuejtë tepër gjah të egër, sidomos dhi të egra. E dhitë e egra janë nën mbrojtjen e Orëve e të Zanave: këtë e dinë edhe fëmijët e vegjël te na!* (f.134)

Autori thekson se njerëzit e kësaj ane jepen më shumë pas së panjohurës, kanë kërshtëri të jashtëzakonshme, edhe nga fakti se nuk e njohin frikën, i afrohen misterit, deri sa edhe e pësojnë, si Rapsodi, që do t'i shkojë gjer në fund së fshehtës, *por shitohet nga të Bukurat e malit: "Aty e mbrapa nisa të andërroj mbi Orë e Zana. Atë ditë e mbrapa filloi të më qajë çdo punë dhe çdo gja që të prek, më prishet, sikur të ishte dora ime zjarm që djeg gjithçka."*(f.133-134)

Në kësi rastesh Camaj dredhon shpesh në arsyetime filozofike dhe etike për personazhet e veta, në mënyrë që të ngulmojë në njohjen e tyre, në zhbirimin e thellësive të zemrës e të shpirtit të tyre:

"Por mbas gjase Bacit i bante përshtypje grindja e mbrendshme, ndamja e vetjes së Rapsodit dhe shpjegimi tij se çka asht e mira dhe keqja. Ky thoshte: thelbi i arsytimit qëndronte në bindjen se njeriu "pirmitiv" paska shpikë vetvetiu qenësit e mbinatyrshëm sepse të domosdoshëm për të që të gjejë drejtpeshimin shpirtnor."(f.134)

Është interesante të vihet në dukje që autori, në momente të caktuara përshtypje jo të zakonshme të ngjarjeve dhe karakteristikave të heronjve të tij thërret në ndihmë edhe lexuesin, të vijë e të shohë, të vërejë, të çmojë e të vlerësojë, me një fjalë të mbajë qëndrim para asaj që jepet, duke na sjellë në letërsinë tonë rastet e teksteve të hapura, me ndërhyrje si këto, kur shkrimtari e ndjen nevojën të thërrasë lexuesin për të parë e gjykuar mbi Sosen-Floçkë, apo Kshesë, siç quhen qenësit mitike të brigjeve të lumejve dhe deteve: lexuesi sigurisht e ka vu re se Novelisti ynë...; *Ose: ngjarja që ndjek, lexuesi, vërteton se ka andërra e andërrime që lidhen përnjëherë në vend e pa vonesë me njëmendësinë...As Novelisti nuk iu dha të gjykojë Sosen sit ë dalun hatullash(të luajtur mendsh), kur ai pau atë lakuriq, pa fillin e petkut veshë...Si mbas një doke së vjetër ajo ishte la shpesh natën te kroni, por kjo ishte e para herë që e shihte dikush picak(lakuriq)! E kapi turpi e u zhyt me lehtësinë e erës në ujën e cemët(të ftohtë). Gulfat u derdhen anash në lugun e plotë: përkundej përmbranda si rosë me krahë të bardhë."*(f.163).

A.Klosi, ky botues i parë i një pjese të korpusit të veprës së shkrimtarit(1-5), tregon se *shqipja e Camajt në prozë është një muzikë e gjallë prej fillimi në fund (Dranja), është në të vërtetë një himn për mundësitë e gjuhës shqipe të veriut, për sensualizmin e tingujve të saj prej guri , diqka e ngjashme me himnet e poetëve mesdhetarë Elitis e Seferis për greqishten e tyre dhe sensualizmin e tingujve të detit; kësaj gjuhe poeti i gëzohet si fëmijë, sepse ajo i jep mundësinë ta jetojë edhe një herë jetën e humbur përmbi Drin, të ndiejë edhe një herë gjithë aromën e fëminisë dhe rinisë, të shohë edhe një herë të gjitha ngjyrat që digjen në ajër, t'i shkelë edhe një herë ato anë jo vetëm në hahësirë por edhe në kokë, prej se jeton aty ai "fis i panjoftun që nuk pati nevojë për tragjedinë dhe art skenik...që zotave të huej u la emnin e vet për të mos përlye gjuhën me ta. "(f. 37)⁶². Martin Camaj ka besimin e gjithhershëm tek fjala shqipe, që është "zjarr në Jug e qumësht në Veri" dhe i përkulet asaj me devocin të shenjtë:*

Fjala

...këndej nis edhe muzika
e lidhet me dritën e gjithësisë,
dashtunisë,
pa krahasim me asnjë fjalë tjetër.

* * *

Vetëm nga një analizë e shkurtër rreth ligjërimit artistik e ngjyresave të mjedisit tek romani "Rathë", vërejmë se M.Camaj mbetet një shkrimtar model i ligjërimit.

- Ai arrin të shkrijë natyrshëm ngjyresat më të bukura krahinore me ato të trajtave normative letrare, duke e bërë ligjërimin e kësaj vepre më të pasur e kumbuese.

- M.Camaj arrin të punojë me ngulmim të dukshëm me fjalën, të vetmin mjet që kishte për të shfaqur individualitetin e tij krijues. Ai përpiket të kërkojë forma më të përsosura, me qëllim që të gjithë ta kuptojnë. Në krijimtarinë e tij përdori një gegërishte të standardizuar.

-Shkrimtari vazhdimisht përpiket të realizojë një ligjërimit artistik sa më funksional, duke shfrytëzuar mjaft leksikun popullor të trevave të Veriut

⁶² A.Klosi, *Martin Camaj, Vepra letrare I*, 1995, f. 37.

(Temalit), frazeologjizmat, ndërtimet gramatikore të strukturës sintaksore të gjuhës shqipe e ngjyresa të ndryshme stilistikore.

BIBLIOGRAFI:

1. M.Camaj, "Rrathë", Munchen, 1978.
2. K.Petriti, Fjala poetike-kuti e Pandorës, Globus R, 2008.
3. A.Klosi, Martin Camaj, Vepra letrare 1-5, Tiranë, 1996.
4. T.Kelmendi, Studime sintaksore, Prishtinë, 2008.
5. T.Çobani, Figurat mitologjike në Lahutë të Malcis, Toena, Tiranë, 2008.
6. Sh.Sinani, Çështje të stilit në ligjërimin e Martin Camajt, Studime filologjike, Nr.1-2, 2007.
7. Xh.Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Albas, Tiranë, 2005.
8. Sh.Islamaj, Gjuha e Jakov Xoxës, Prishtinë, 2000.

A survey on the artistic speech and environmental coloring of the Novel "Rrathë", by Martin Camaj

SUMMARY

Just from a brief analysis of the artistic discourse of the colors to the environment at the "Rrathe" novel we note that M. Camaj remains a writer of the lecture model.

- He manages to melt naturally the most beautiful provincial colors with those of literary forms, making the speech of this work richer and more vibrant.
- M.Camaj manages to work with remarkable persistence with the word, the only tool that had to display his individual creativity. He tries to seek the most perfect form, so that everyone understands. In his creativity he used a standardized gegërishte.
- The writer constantly strives to achieve a more functional artistic discourse, using highly popular lexicon of North regions (Temali) phraseology and grammatical constructions of the Albanian language syntactic structure of various stylistic connotations.

Rezearta MURATI

MENDIMI I FAIK KONICËS PËR NJË GJUHË TË PËRBASHKËT

Faik Konica është një ndër figurat poliedrike të kulturës dhe mendimit shqiptar, e formësuar që në ngjizje me ndërthurje mes ndikimit evropian dhe njohjes së thellë të orientit. Penën e tij të mprehtë dhe lehtësisht të dallueshme e shohim që në vitet e hershme të rinisë në shtypin francez të kohës ku ai trajtoi me guxim dhe elokuencë çështje të shqiptarëve dhe shqiptarisë.

Në vitin 1897 Konica mori përsipër një mision të rëndësishëm në dobi të bashkatdhetarëve të tij, me themelimin e revistës dygjuhëshe shqip-frëngjisht “Albania” në Bruksel. Kjo revistë u bë tribunë e mendimit dhe e çështjes shqiptare duke përfshirë si bashkëpunëtorë figura të rëndësishme të kulturës shqiptare dhe synonte të përforconte ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve nëpërmjet pasqyrimin të historisë së traditës, kulturës e vlerave të tyre.

Që në numrin e parë të revistës Konica si kryeredaktor i saj hedh themelet e një nisme, që në fakt është vazhdë e frymës së Rilindjes, atë të krijimit të një gjuhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët, si atyre që jetojnë brenda vendit, por edhe të tjerëve që jetojnë jashtë tij. Konica si njohës i kujdesshëm i jetës dhe i mentalitetit shqiptar thekson se deri në atë kohë shqiptarët kanë njohur si jetë të përbashkët vetëm jetën e fshatit dhe të qytetit të tyre, prandaj secili ka qenë i kënaqur dhe i plotësuar me përdorimin e dialektit të tij. Por, me ndryshimet shoqërore dhe në situatën e një lëvizjeje më të madhe, shqiptarët filluan të jetojnë një jetë më të gjerë, *jetën kombëtare*. Ky moment i kalimit nga një kontekst i ngushtë e i kufizuar me kufi të përcaktuar qartë, në një kontekst më të gjerë e më gjithëpërfshirës që kërkon kompetenca të reja nga folësi, është në fakt një moment historik dhe i rëndësishëm. Autori parashtron që ky zgjerim historik dhe shoqëror shtrëngon të zgjerojmë edhe gjuhën si një mjet i

përbashkët komunikimi. “*Ky trup i ri, KOMBI, ka nevojë për një organ të ri.*” (A, 1905/6, f.294)⁶³.

Që në numrin e parë të revistës paraqitet rëndësia e krijimit të një gjuhe të përbashkët (*letrarishte*) jo vetëm si nevojë e brendshme, por edhe si ndikim nga vendet e tjera në frymën shtetformuese europiane: “*Të tëra vëndet e dheut kanë nja gjuhë letrarishte, d.m.th. të qëruarë dhe të zbukuruarë, që me atë shkrohen vivllat, letrat, punërat...*” (A, 1897/1, f.55). Ideja e Konicës për mënyrën e krijimit të *gjuhës letrarishte* ndryshon me kalimin e kohës. Në fillim ai mendon për përcaktimin e elbasanishtes si bazë për gjuhën e përbashkët. Por nuk vazhdon të mbajë të njëjtin qëndrim si duket duke njohur mirë psikologjinë e shqiptarëve ndaj ai shprehet: “*E rënda e punës godit që – me marrë nja nënëgjuhë shqipe si shtypin e gjuhës letrarishte të kombit – është frikë të mos mëriten ata qi kuvëndojnë nënëgjuhërat e tjera; se perëndia na shpëtoftë me kokën që kanë shqipëtarët!...asnja nënëgjuhë ka miaft qëruari për me u lartuem në krye të tjerave.*” (A.1897/1, f.55).

Pak më vonë hedh idenë e shkrirjes së dy dialekteve, duke e njohur si një proces aspak të thjeshtë dhe të gjatë, të cilin e ndan në dy faza:

1. në fazën e parë të dy dialektet të njiheshin reciprokisht në dallimet dhe veçoritë e tyre e të përdoreshin në të shkruar nga të gjithë shqipfolësit.
2. në fazën e dytë pas një lëvrimi për një kohë të gjatë në të shkruar të arrihej në mënyrë graduale e të natyrshme shkrirja e dy dialekteve duke formuar kështu një gjuhë të përbashkët. Autori shprehet: “*Duhet të përziejhen dalngadal dhe nga kio përzejte të dalë një gjuhë e re dhe e shëndoshë: gjuha shqip e përgjithshme*” (A, 1897/8, f.97).

Duke shkruar më tej, hedh hipotezën që toskërishtja të përdorej nga shkrimtarët për gjuhën e prozës në veprat e tyre, kurse gegërishtja për poezinë. Ai mendon që shqiptarët duhet të arrijnë të njohin mirë dhe të jenë të aftë të përdorin të dy dialektet. Konica e zotëronte këtë njohje gjë që e dëshmon në faqet e revistës ku ka raste që shkruan edhe në gegërisht. Në shkrimet e tij kundrojmë një gjuhë të pastër e të pasur, ku fjala zë natyrshëm vendin që i takon. Shpeshherë ai përdor fjalë e shprehje nga gegërishtja duke theksuar se “*...dialekti gegë përmban qindra shprehje frazeologjike të humbura nga toskët dhe që janë thesarë të vërtetë të lënë trashëgim nga të parët tanë që nga lashtësia.*” (A, 1897/10, f.99).

Konica shton se dallimet mes dy dialekteve kufizohen kryesisht në ngjyime shqiptimore. Këto dallime janë thelluar edhe më tej për shkak të

⁶³ Shënim: Referimet nga revista “Albania” janë marrë në librin “Faik Konica, Mendime gjuhësie”, Jorgaqi, K., Tiranë, 2006.

mungesës së traditës shkollore, sepse shqiptarët, duke mos pasur fjalorë dhe gramatika, kur kanë dashur të shkruajnë gjuhën e tyre, janë bazuar në parimin e shkrimit të fjalëve siç shqiptohen.

Dallimet gjuhësore të dialekteve bazohen edhe në dallime në karakter e personalitet të folësve të tyre “...*dialekti toskë, i gjallë, i përpunueshëm, i hollë, në zhvillim të vazhdueshëm, e përmbledh mirë natyrën toske, që përbëhet nga dhuna e përmbajtur, mendjemprehtësia, shkathtësia, intriga e paqëndrueshmëria; dialekti gegë, përkundrazi, i ngadalshëm, i rëndë, i pandryshueshëm, i zhveshur nga shprehjet me dy kuptime, përmbledh për mrekulli karakterin gegë, i përbërë nga serioziteti e ciltërsia e pastër, shpesh pa ligësi, e mbi të gjitha armik i risive.*” (A, 1897/10, f.99).

Konica ishte për ndërthurjen e të gjithë nënëgjuhërave, jo me një përzerje të çfarëdoshme, por të bazuar në disa parime bazë:

1. Kur një fjalë përdoret në disa variante fonetike (pra nuk janë sinonime, por variante të së njëjtës fjalë), atëherë duhet të përzgjidhet varianti që është më përgjithësues ku forma i afrohet më shumë rrënjës së fjalës p.sh. të përdoret fjala *bora* karshi varianteve të tjera fonetike të saj në të folme të ndryshme.
2. Kur dy ose më shumë fjalë kanë kuptim të përafërt, por japin nuanca kuptimore të ndryshme ose ngjyrimë të ndryshme emocionale, atëherë duhet të përdoret secila prej tyre duke i caktuar secilës kuptimin dhe ngjyrimin e saj të veçantë, p.sh. *shoh, vështronj, shikonj*. Kjo sjell një pasurim të leksikut të gjuhës letrare jo vetëm në numrin e fjalëve, por në cilësinë e tyre dhe në fuqinë shprehëse që i japin ligjërimin.
3. Kur nuk e njohim rrënjën e fjalës atëherë duhet të zbatohet një parim krejt origjinal “*bukurtingullimin*”. Konica thotë “*kujt zëri fërkon më ëmbël veshin*” (A, 1897/1, f.56), pra që fjala të jetë në sintoni me veçoritë tingullore të vargjeve sintagmatike që ajo krijon. Zbatimi i këtij parimi kërkonte studime të veçanta fonetike dhe fonologjike të fjalësit të shqipes në plan diakronik dhe sinkronik, por kërkon edhe një ndjeshmëri artistike të gjuhëtarit.

“*E ashpër dhe e sertë, si populli i fuqishëm që e flet, por edhe plot shije e hir, si pemët dhe lulet e maleve ku flitet, gjuha shqipe – edhe pse e varfëruar nga një mungesë lëvrimi shumëshekullore – është e aftë të shprehë, me një ndjesi të mrekullueshme të ngjyrimëve, konceptet më të holla të mendjes njerëzore, dridhjet më të pakapshme të nervozizmit...*” (A, 1897/1, f. 58)

Autori thekson faktin që gjuha shqipe e varfëruar nga moslëvrimi i saj ka nevojë për përtëritje dhe për shtimin e fjalorit të saj. Ky pasurim që kërkon një kujdes të veçantë dhe njohuri të mira gjuhësore dhe historike kryhet në dy mënyra:

1. Nëpërmjet krijimit të neologjizmave nga shkrimtarët me bashkimin e fjalëve ekzistuese të fjalësit të shqipes, por shkrimtarja duhet të jetë e plotë në mënyrë që si rezultat të kemi një fjalë të re si në rrafshin kuptimor ashtu edhe atë gramatikor.
2. Nëpërmjet marrjes së lëndës së huaj gjuhësore duke i kushtuar vëmendje të veçantë “*mënyrës së sintezës*”, sepse një fjalë e ndërkallur duke mos pasur parasysh ligjet e përgjithshme të zhvillimit fonetik të shqipes është si një vragë në gjuhë dhe siç thotë autori “*stonon mes fjalëve të tjera dhe tingëllon keq në vesh*”.

Në numra të ndryshëm të revistës Konica krijoi edhe një rubrikë ku pasqyronte fjalë të reja të krijuara si me brumë të shqipes mbi bazën e modeleve ose fjalë të vjetra shqipe të përdorura nga autorët e vjetër, të cilat kanë dalë nga përdorimi. Fjalët i përkisnin sferave të ndryshme duke plotësuar zbrastësi e duke pasuruar fjalësin e shqipes së shkruar. Ndër fjalët që ndeshim në këto lista të herëpashershme mund të përmendim: *Kuvënt, kuvëndëtar, pjesëtar i kuvëndit, përruronj, anë, anëtar, zyrtar, zyrtarisht, flamur, ushtëri, ushtëtar, obor, obortar, sundim, sundimtar, qeveri, qytet, qytetar, bashkëqytetar, qytetërim, kryeqytet, çështie, shënjë, shënim, etj.* (A, 1901/2, f.139).

Konica pranon që huazimet të vinë nga latinishtja dhe greqishtja si gjuhë klasike, por edhe nga gjuhë të tjera kur është e domosdoshme. Nuk mban qëndrim konservator ndaj gjuhës, sepse siç shprehet në një prej artikujve edhe gjuha, si organizmat e gjalla, ka nevojë për lëndë të huaja që i shërbejnë si ushqim për rritje e zhvillim. Nga ana tjetër dënon përdorimin e fjalëve turke në shkrimet shqipe e në gjuhën e folur dhe në numra të ndryshëm të revistës “Albania” na ka lënë edhe fjalorthë të vegjël udhëzues për zëvendësimin e fjalëve turke që përdoren në atë periudhë p.sh. *ortak (shok), sevda (dashuri), hasm a dushman (armik), sokak (rrugë), gjynah (mëkat), javash (ngadalë), sabah (mëngjes), mesele (çështje), vakt (kohë)* etj. Në një artikull të tij Konica vë në dukje edhe rolin dhënës që ka pasë gjuha shqipe për gjuhën greke si një fakt që dëshmon lashtësinë e gjuhës dhe kulturës shqiptare.

Mendimtari dhe gjuhëtari arrin të kuptojë që është e nevojshme të vendosen disa rregulla për zhvillimin e gjuhës, por këto rregulla janë orientuese dhe nuk mund t’i imponohen përdoruesve të gjuhës. Gramatika

vjen si rrjedhojë e fakteve gjuhësore të vëzhguara në praktikë, prandaj autori shprehet: “*Si në gjithë gjuhët, ashtu edhe në shqip, gramatika do të themelohet, kur të themelohet një letrëturë e pastaj.*” (A, 1902/4, f.160). Më tej Konica këshillon që shqiptarët të shkruajnë të gjithë sa të mundin, të botohen me mijëra artikuj e qindra libra, dhe me kalimin e kohës disa nga këto shkrime do të kenë vlerën e një letrarishite të vërtetë dhe do të mbeten si shtyllat e një *letrëture kombëtare*.

Vepra e Konicës është vlerësuar dhe kontestuar nga bashkëkohës të tij që e kanë njohur dhe kanë punuar me të në një periudhë të zhvillimeve të rëndësishme shtetformuese dhe kulturore të kombit shqiptar.

Personaliteti dhe vepra e Faik Konicës është lënë në hije për një kohë të gjatë në Shqipërinë komuniste, ndaj vlen të vendoset në vendin e rëndësishëm që i takon në piedestalin e mendimit modern shqiptar.

BIBLIOGRAFI:

1. Ismajli, R., *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2005.
2. Jorgaqi, K., Faik Konica, *Mendime gjuhësie*, Tiranë, 2006.
Konica, F., *Vepra 5*, Tiranë, 2001.
3. Haxhi, A., Topalli, T., “Mendimi gjuhësor i Faik Konicës”, *Mendimi shqiptar dhe shkolla shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2010.

The idea of Faik Konica for a common albanian language

SUMMARY

Faik Konica is a polyhedral personality of Albanian culture and thought, in 1897 he took on an important mission, the establishment of bilingual Albanian-French magazine "Albania" in Brussels. Since the first issue of the magazine, Konica lays the foundation of an initiative, that of creating a common language for all Albanians, as those living within the country but also others living abroad. The author emphasizes the fact that the Albanian language has been impoverished by its need for renewal of its vocabulary. Personality and work of Faik Konica is overshadowed for a long time in communist Albania. Now he must take the important place to the pedestal of modern Albanian opinion.

Irida HOTI

VËSHTRIM MBI NJË DISIPLINË TË RE GJUHËSORE

Termi *gjuhësi e aplikuar*⁶⁴ u shfaq në vitin 1940 përmes përpjekjeve të mësuesve të gjuhës, të cilët donin të bashkoheshin me gjuhëtarët dhe të shkëputeshin nga mësuesit e letërsisë. Në mesin e viteve 1950⁶⁵, u hap shkolla e Gjuhësisë së Aplikuar në Universitetin e Edinburgut (më 1956) dhe u krijua Qendra për Gjuhësi të Aplikuar (CAL, 1959) në Shtetet e Bashkuara. Gjatë viteve 1960, termi u institucionalizua në Shoqërinë ndërkombëtare të gjuhësisë së aplikuar (AILA, 1964) me evoluimin e disa shoqërive të gjuhësisë së aplikuar (si ajo e Britanisë më 1967).⁶⁶

Termi “Gjuhësi e aplikuar”⁶⁷ përfshin nëndisiplina të ndryshme gjuhësore, si edhe fusha ndërdisiplinare që përdorin metoda gjuhësore, si: pedagogji gjuhësore, psikolinguistikë, përvetësimin e gjuhës, përvetësimin e gjuhës së dytë, përkthimin, analizat krahasuese, planifikimin e gjuhës, leksikografinë, gjuhësinë e njehsuar, etnolinguistikën, sociolinguistikën etj. Gjuhësia e aplikuar ndryshon nga gjuhësia teorike. Termi “gjuhësi e aplikuar” në disa raste keqkuptohet, duke qenë se në shumë nga nëndisiplinat gjuha studiohet si nga perspektiva teorike ashtu edhe nga ajo praktike. Për më tepër disa fusha duhet të konsiderohen “aplikime” të gjuhësisë.

Gjuhësia e aplikuar si fushë po shfaq interes gjithnjë e në rritje në fushën e gjuhësisë. “Ajo nuk mund të kuptohet përveçse përmes një procesi të mbështetur dhe të vetëdijshëm të ndërtimit të njohurive ndërdisiplinare

⁶⁴ Gjuhësi e zbatuar.

⁶⁵ Robert B. Kaplan, *The Oxford handbook of Applied linguistics*, Oxford University Press, 2002, Preface.

⁶⁶ Më vonë kjo fushë u shtri (zgjerua) me botimin e “Introducing Applied Linguistics” (Corder, 1973) dhe me botimin e “The Edinburgh Course in Applied Linguistics” (Allen and Corder 1973/1975). Gama dhe cilësia e kërkimeve u identifikua së shpejti përmes themelimit të një numri gazetash, duke përfshirë “Language learning” (1948), TESOL Quartely (1967), “Applied Linguistics” (1980) dhe “Annual review of Applied linguistics” (1980).

⁶⁷ Bussmann, Hadumond, *Routledge Dictionary of language and linguistics*, London and New York, Routledge, 1996, f. 30.

*dhe shumëdisiplinare, i të menduarit dhe të bërit.*⁶⁸ Ndërtimi i njohurive është një kusht vendimtar për të analizuar dhe interpretuar strukturat, përmbajtjet dhe vlerat kryesore të disiplinave përbërëse të gjuhësisë së aplikuar. *Të menduarit* përfshin të menduar kritik, reflektiv, racional rreth problemeve, teorive, parimeve dhe praktikave duke arsyetuar rezultatet e kërkimit dhe planifikimin e kujdesshëm dhe efikas të mësimdhënies dhe objektivave të të mësuarit, proceseve, strategjive, rezultateve.

Të bërit ose *të vepruarit* buron nga ndërtimi i njohurive për të aplikuar dhe vlerësuar produktin e këtyre njohurive të përfuara dhe të mendojë në mënyrë tradicionale apo bashkëkohore, krijuese, imagjinuese, por duke përfshirë metoda, teknika dhe strategji produktive. Këto përfshijnë mësimdhënien aktuale, mësimin, trainimin, kërkimin, zhvillimin, përhapjen, monitorimin dhe vlerësimin.

Po paraqesim disa mendime të disa gjuhëtarëve mbi gjuhësinë e aplikuar, shkëputur nga tekstet e tyre me të njëjtin titull:

*“Gjuhësia e aplikuar përfshin: Çfarë dimë për gjuhën, Si mësohet?, Si përdoret?”*⁶⁹

*“Gjuhësia e aplikuar ka të bëjë me lidhjen mes njohurive, teori dhe praktikë në fushën e gjuhës.”*⁷⁰

*“Gjuhësia e aplikuar nënkupton shumë gjëra për shumë njerëz.”*⁷¹

*“Gjuhësia e aplikuar është një fushë ndërdisiplinare e lidhur ngushtë dhe e bazuar në gjuhë dhe me synimin në një kuptim më të thellë të ndërveprimit gjuhësor njerëzor në kontekste të ndryshme dhe në mënyra eksploruese për të ndihmuar përmirësimin e cilësisë së rritjes dhe zhvillimit komunikues njerëzor.”*⁷²

*“Gjuhësia e aplikuar nisat më shumë nga problemet e botës së vërtetë se sa nga eksplorimet teorike.”*⁷³

Sipas Grejb (Grabe)⁷⁴, gjuhësia e aplikuar duhet të merret me:

⁶⁸ Victor. B. Owhotu, *Understanding applied linguistics*, University of Lagos Press, Akoka, Yaba – Lagos, Nigeria, 2007, f. 1.


⁶⁹ Alan Davies, *An introduction to applied linguistics. From practice to theory*. Edinburg University, 2007, f. 1.

⁷⁰ Michael McCarthy, *Issues in applied linguistics*, Cambridge University Press, 2001, f. 9.

⁷¹ Guy Cook, *Applied linguistic*, Oxford introduction to languages study, Series H. G. Widdowson, Oxford, 2003, f. 5.

⁷² De Gomes, *What is applied linguistic? A personal view. Issue of applied linguistics*; Vol 2, 2005, f. 159.

⁷³ William Grabe, *Applied linguistics: An emerging discipline for the twenty – first century*. In B.R Kaplan (f.3-12), *The Oxford handbook of applied linguistics*, Oxford University Press, 2001.



- **Probleme të të mësuarit të gjuhës** (rregulla, përdorim, kontekst etj.).
- **Probleme të mësimdhënies të gjuhës** (praktikë, ndërveprim, kuptim, përdorim, kontekst, motivim etj.).
- **Probleme të lexim shkrimit** (çështje të të mësuarit dhe çështje të gjuhës).
- **Probleme të kontaktit gjuhësor** (gjuhë dhe kulturë).

⁷⁴ Në këtë punim emrat e huaj të gjuhëtarëve do të shkruhen sipas parimit drejtshkrimor të shqipes, të shqipëruara dhe në kllapa shkrimi origjinal.

- **Probleme të parregullsisë gjuhësore** (etnicitet, klasë, gjini, moshë).
- **Probleme të planifikimit dhe politikës gjuhësore** (planifikim i statusit, ekologji e gjuhës).
- **Probleme të vlerësimit të gjuhës** (përdorim, përgjegjshmëri, siguri).
- **Probleme të përdorimit të gjuhës** (dialekt, regjistra).
- **Probleme të teknologjisë dhe të gjuhës** (të mësuarit, vlerësim dhe përdorim).
- **Probleme të interpretimit dhe të përkthimit** (teknologji).
- **Probleme patologjike të gjuhës** (afazi, dialeksi, paaftësi fizike).

Ndërsa Gai Kuk (Cook) ka të njëjtin mendim si Uidouson (Widdowson): “*Detyra e gjuhësisë së zbatuar është të ndërmjetësojë mes gjuhësisë dhe përdorimit të gjuhës.*”⁷⁵

Synimi i gjuhësisë së aplikuar⁷⁶ është së pari të përcaktojë një metodologji për kategorizimin e formimit kuturor, mjedisit shoqëror dhe joshqëror të folësve. Roli i kërkimit të testeve gjuhësore si një aktivitet i gjuhësisë së zbatuar synon të ndihmojë të kuptuarit tonë për mësimin e gjuhës dhe të ndriçojë hapësirën ende të paeksploruar të përdorimit të gjuhës.

Në 1980⁷⁷ një nga çështjet kyç kërkimore në vlerësimin e gjuhës ishte e ashtuquajtura hipoteza e kompetencës ose faktori i përgjithshëm gjuhësor. Këto hipoteza u përkrahën mes të tjerëve edhe nga Xhon Uoller (John Oller) (1983), i cili pohoi që theksimi i të gjitha aftësive gjuhësore, ishte faktori i parë, faktori gjuhësor i përgjithshëm. Aftësia gjuhësore nuk ishte unike, por dy ose shumëfaktorëshe. Por nëse gjuha nuk ishte unike, a do të thotë se gjendeshin aftësi të ndara (dhe njohuri të ndara) për fusha të ndryshme të gjuhës, të njohura në kontekste të ndryshme si stile, regjistra, gjini, qëllime të veçanta, varietete apo retorika?

Mësimdhënia e gjuhës dhe vlerësimi i gjuhës në vitet e fundit është përqendruar shumë tek përpjekjet mbi mësimdhënien dhe vlerësimin e gjuhës për qëllime të veçanta (akademike, profesionale, mjekësore, ligjore, ekonomike e kështu me radhë).

Nëse nisemi nga mendimi i Çomskit “*Gjuha është një sistem i pasur dhe kompleks i një lloji, me veçori specifike që përcaktohen nga natyra e*

⁷⁵ Guy Cook, *Applied linguistic*, Oxford introduction to languages study, Series H. G. Widdowson, Oxford, 2003, f. 20.

⁷⁶ Alan Davis, *An introduction to applied linguistics. From practice to theory*. Edinburg University, 2007, f. 29.

⁷⁷ Alan Davis, *An introduction to applied linguistics. From practice to theory*. Edinburg University, 2007, f. 30.

mendjes/trurit. Kjo gjuhë, nga ana e saj përcakton një larmi dukurish të mundshme; u jep një strukturë shprehjeve gjuhësore që tejkalojnë çdo përvojë."⁷⁸, mund të dalim në përfundimin se roli i gjuhëtarit aplikues është shumë i rëndësishëm në mësimin e gjuhës, sepse krahas formimit të tij teorik (i cili është parësor) atij i duhet të gjejë rrugë dhe mënyra të ndryshme se si t'i aplikojë në situata të ndryshme këto njohuri dhe t'i bëjë të tjerët të aftë t'i perceptojnë, t'i njohin, t'i gjykojnë për nga rendi dhe rëndësia dhe më pas t'i aplikojnë ato si duhet, ku duhet dhe në mënyrë efikase.

*"Gjuhëtari bashkëkohor aplikues duhet të jetë një mësues kompetent, i aftë të ndërtojë plan veprimtarish racional për të zgjidhur një gamë të madhe problemesh gjuhësore, novator në kërkime, sasior dhe veçanërisht cilësor dhe në kërkim të vazhdueshëm për të vlerësuar teoritë ekzistuese të përfuara nga kërkimet bazë."*⁷⁹



❖ Gjuhësia e aplikuar, fushë **ndërdisciplinare** dhe **shumëdisiplinare**.

Pra, gjuhësia e aplikuar, si një fushë ndërdisciplinare dhe shumëdisiplinare, nuk mund të mendohet pa disiplinat e tjera gjuhësore dhe jogjuhësore, sepse do të ishte e çalë, pa interes dhe pa dobi tek përdoruesi i gjuhës, i cili e aplikon gjuhën që në lindje pa e njohur gramatikën dhe rregullat gramatikore.

⁷⁸ Noam Chomsky, *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Përktheu: Blerta Topalli, Botimet Toena, Tiranë, 2007, f.36.

⁷⁹ Victor. B. Owhotu, *Understanding applied linguistics*, University of Lagos Press, Akoka, Yaba – Lagos, Nigeria, 2007, f. 8.

BIBLIOGRAFI:

1. Bartles, N., *Applied linguistics and language teacher education, Educational linguistics*, Volume 4, Springer, USA, 2005.
2. Carter R., *Vocabulary: Applied linguistic perspectives*, (2nd ed.) London, Routledge, 1998.
3. Chomsky, N., *Gjuha dhe problemet e njohjes*, Përktheu: Blerita Topalli, Botimet Toena, Tiranë, 2007.
4. Davies, A., *An introduction to applied linguistics. From practice to theory*. Sec edition, Edinburgh textbooks in applied linguistics, Edinburg University Press, 2007.
5. Davies, A., *A glossary of applied linguistics*, Edinburg University Press, 2005.
6. De Gomes, F., *What is applied linguistic? A personal view. Issue of applied linguistics*, Vol 2, 2005.
7. Guy C., *Applied linguistic*, Oxford introduction to languages study, Series H. G. Widdowson, Oxford, 2003.
8. Grabe, W, *Applied linguistics: An emerging discipline for the twenty – first century*. In B.R Kaplan “The Oxford handbook of applied linguistics”, Oxford University Press, 2001.
8. Crystal, D., *Directions in Applied linguistics*, Academic Press, 1981.
9. Hadumond, B., *Routledge Dictionary of language and linguistics*, London and Neë York, Routledge, 1996.
10. Kaplan, B. R., *The Oxford handbook of Applied linguistics*, Oxford University Press, 2002, Preface.
11. McCarthy, M., *Issues in applied linguistics*, Cambridge University Press, 2001.
12. Owhotu, B.V., *Understanding applied linguistics*. University of Lagos Press, Akoka, Yaba – Lagos, Nigeria, 2007.
13. Pennycook, A., *Critical Applied linguistics: A Critical Introduction*, University of Technology, Sydney, Lawrence Erlbaum Associates, Inc., 2001.
14. Richards, J.; Schmidt, R., *Longman Dictionary of Language Teaching and Applied Linguistics*, Pearson Education, Longman, Third edition published 2002
15. Widdowson, H.G, *Learning Purpose and Language Use*, Department of Linguistics, University of Edinburgh, 1973.
16. Widdowson, H.G, *An Applied Linguistic Approach To Discourse Analysis*, Department of Linguistics, University of Edinburgh, 1973.

-
17. Widdowson, H.G, *Exploration in applied linguistics 2*, Oxford University Press, Printed in Hong Kong, 1984.

A new linguistic discipline

SUMMARY

Applied linguistics is a new discipline, which uses information from sociology, psychology, anthropology, and information theory as well as from linguistics in order to develop its own theoretical models of language and language use, and then uses this information and theory in practical areas such as syllabus design, speech therapy, language planning, stylistics, etc.

Understanding applied linguistics may not be possible except through a conscious and sustained process of multidisciplinary and interdisciplinary knowledge-building, thinking and doing; not knowledge-building, or thinking, or doing. Knowledge-building is a crucial condition for analyzing and interpreting the structures, contents and core values of the constituent disciplines of applied linguistics.

The contemporary applied linguist is therefore expected to be a very competent teacher, able to build rational scenarios for solving a wide range of language related problems, competent in the design and execution of conventional and innovative research— quantitative and especially qualitative, and to constantly seek to validate existing theories derived from basic research.

Through this article is aimed to give a general view of this new linguistic discipline.

Besarta QALLIAJ

ZHVILLIMI I TERMINOLOGJISË GJUHËSORE (SINTAKSORE) SHQIPE GJATË SHEKULLIT XX

Për terminologjinë gjuhësore të shqipes, zhvillimin, pasurimin dhe krijimin e bazës së saj mbi hullinë e gjuhës amtare, studiuesit janë të mendimit se në periudhën e gjatë të konsolidimit të saj duhen dalluar dy faza: *nji fazë të kryeme, e cila mund të konsiderohet si një kapitull i përfunduem në këtë fushë të aktivitetit gjuhësor, dhe nji fazë të dytë të re që asht në trajtim e sipër.*⁸⁰ Secila prej këtyre dy periudhave ka veçoritë dhe karakteristikat e veta; ajo e para kufizohet me termat e gjuhësisë fillestare (çka për shqipen përtakon me disiplinat e morfologjisë dhe të leksikologjisë) dhe kushtëzohet prej faktit se gramatikat tona të para u hartuan për shkollat fillore e të mesme. Kurse perioda e dytë zë fill dhe vazhdon me kohën e themelimit të institucioneve të larta shkollore dhe shkencore : instituteve, universiteteve, duke u lidhur me zgjerimin dhe thellimin e studimeve në të gjitha nivelet e gjuhës: nga fonetika, morfologjia, sintaksa dhe disiplina të tjera më të përimituara në përshkrimin e shqipes. Edhe në ditët e sotme, gjuhëtarët dhe specialistët e fushave të ndryshme të gjuhësisë, pohojnë se prej gjysmë shekulli e këndeje, shkenca gjuhësore e së bashku me të prurjet në lëmin terminologjik, kanë pasur një zhvillim të hovshëm, *që nga koha kur gjuhësia shqiptare dallonte për një kufizim të fushave dhe tematikës së saj dhe kishte më së shumti karakter didaktik*⁸¹. Bazat shkencore të zhvillimit të terminologjisë gjuhësore të shqipes janë hedhur që në Rilindjen Kombëtare, megjithëse terma gjuhësorë, letrarë, kulturorë, gjenden edhe tek autorët e vjetër: Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani. Është e njohur në këtë fushë se pionier i krijimit të terminologjisë gjuhësore shqipe është pa dyshim rilindësi i shquar Sami Frashëri, i cili botoi librin “*Shkronjëto e gjuhës shqipe*” – Bukuresht 1886, ku farkohet e para terminologji e gjuhësisë shqipe; me gjithë thjeshtësinë e saj ajo ka shërbye si pikënisje në zhvillimin e terminologjisë sonë gramatikore; një pjesë e mirë e terminologjisë së sotme asht ende ajo e Samiut.”⁸² Lidhur me këtë punim, duhet

⁸⁰ L. Dodbiba “Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Konferenca e parë e studimeve Albanologjike, 15 – 21 Nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 183.

⁸¹ Sh. Rrokaj, *Çështje të gjuhës shqipe- 2*, “Shkronjë pas Shkronje”, Tiranë, 2009, f.79.

⁸² L.Dodbiba “Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Konferenca e parë e studimeve Albanologjike, 15 – 21 Nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 185.

thënë se duke e parë sipas kërkesave dhe synimit tonë, vepra e Samiut, aq e rëndësishme për kohën kur u shkrua, nuk përmban asnjë term sintakse, vetëm morfologjie⁸³.

Në punimin e Lirak Dodbibës, termat e sjellë sipas kronologjisë së veprave nga janë mbledhur, ndahen në: terma të përgjithshëm, terma të fonetikës, morfologjisë dhe terma të sintaksës, të cilat po i sjellim ashtu siç i ka renditur autori i shkrimit në përmbledhjen e cituar:

Terma mbi fjalitë. Për fjalinë kemi *propozicion* (Xanoni), *fjalim* (S. Dako), *folje* (G. Mikeli), *paravume* A. Xhuvani (1919), marrë nga Kristoforidhi prej termit biblik *panem propositiones* (“bukën e paravumes”); A. Xhuvani më 1922 ban *fjalinë*, që adaptohet nga autorët e mëvonshëm. *Fjali e thjeshtë, e zgjanueme* (e zgjeruar Cipoja, e *zmadhueme* G. Mikeli, J. Rrota), *mungesore* (Xanoni e *coptë*; e *gjymtë* J. Rrota, e *metë* Myderrizi) i kemi nga Xhuvani. Terminologjia e sintaksës, si do ta shohim edhe më poshtë, asht brumosur në vija të përgjithshme nga A. Xhuvani; por merr hov dhe pasunohet nga J. Rrota (*Sintaksi i shqipes*, 1942), nga K. Cipoja dhe M. Domi; te Rrota gjejmë ma se 20 lloje fjalish, vetëm me katër terma të huej; 2 të huej te Cipoja dhe asnjë te M. Domi.

Terma mbi gjymtyrët e fjalisë dhe pjesët plotësuese. Kryefjalën e përdor Xhuvani më 1926. deri më 1919 *kallzuesit* i kanë thanë *predikat*; *kallzues* e kemi nga A. Xhuvani (1922 – 1924); kemi gjithashtu po nga A. Xhuvani *kallzues emnuer e foljuer*. Këta dy terma themelore shqip J. Rrota dhe O. Myderrizi i venë në kllapa, tue pranue si kryesorë *subjektin* dhe *predikatin*; kështu vepron edhe Cipoja në sintaksën e Institutit; në atë shkolloren pranon *kryefjalën*. M. Domi i pranon të dyja. Xhuvani sajon edhe termin *këpujë* (nga *copula*) e latinishtes, - nuk kuptohet se në bazë të çfarë analogjie asht bamë *copula – këpujë* në shqipet; ky term asht pranue nga Cipoja, Domi; Myderrizi, ma drejt, e quen *lidhëz* (këpujë). *Kundrina* e krijueme nga A. Xhuvani del në dritë aty nga viti 1922, por ka kurdoherë si kundërshtar *objektin* (G. Mikeli, J. Rrota, K. Cipo, te sintaksa e ish-Institutit të Shkencave). Termat *cilësor* dhe *ndajshim* (të Xhuvanit) bashkëjetojnë te Cipoja dhe Rrota me *atributin* dhe *opozicionin*; po këta terma pranohen nga autorët e tjerë, që heqin dorë prej fjalëve të hueja. A. Xhuvani krijon *plotësin* (1924) dhe *plotësorin* (1926 -1940); pëlqehet nga të gjithë autorët *plotësi*; këtë s’e përfill vetëm Rrota, që përdor *advërbjarin*.

Vlen të shënohet se numri i plotësave nga 7 tek A. Xhuvani i kalon të 25-ët te Cipoja, tue pasë emën të huej vetëm pesë sish; kurse te Domi i kemi të tanë shqip.”⁸⁴ Nga një paraqitje panoramike, shkruan studiuesi Dodbibë, *del se nistor i vetëdijshëm i terminologjisë sonë gjuhësore asht Kristoforidhi dhe themelues i vërtetë i saj asht Samiu, i cili me “Shkronjëtoeren” e tij na ep një terminologji*

⁸³ S. Frashëri, *Shkronjëtoere e gjuhësë shqip*, “Logos”, Prishtinë, 2004, f.172 -175.

⁸⁴ L. Dodbibë, “Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot”, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Konferenca e parë e studimeve Albanologjike*, 15 – 21 Nëntor 1962, Tiranë, 1965, f. 190.

shumë a pak të plotë, megjithëse fillestare; vepra e Samiut vazhdohet nga një plejadë mësuesish, si: Gurakuqi, Xhuvani, Peci, Xanoni, Rrota, Dako, Mikeli, Myderrizi, Cipo, Domi por në mes të kësaj plejade shquen puna e veteranit të mësuesve të shqipes, puna e A. Xhuvanit, i cili plotëson edhe njëson termat e morfologjisë dhe i ve themelet e terminologjisë së sintaksës së sotme.”⁸⁵

Sa u takon termave të sintaksës, është me vend të japim një model të papërsëritshëm ndër autorët e fillim shekullit të 20-të, atë të pedagogut dhe veprimtarit të madh të arsimit tonë kombëtar, Gasper Mikelit, i cili, në “Gramatikën e gjuhës shqipe”⁸⁶, jep mjaft terma sintaksorë. Shohim ndër këta terma përpjekje për shqipërimin e tyre, por edhe dëshmi të ndikimit të plotë të logjicizmit, aq sa autori i kësaj gramatike, analizën logjike e barazon me analizën sintaksore. Pranë shembullit të G. Mikelit, nuk mund të mos vëmë edhe gramatikën e Ilias Jahja Përmetit me titull “Fillime të gramatikës shqipe”⁸⁷. Historiani i shquar i Gramatologjisë shqiptare, Jup Kastrati, tek i cili jemi mbështetur për këta dy shembuj model të përdorimit të terminologjisë gjuhësore, përndryshe të skajeve sintaksorë, dhënë më sipër, analizon ndër të tjerë edhe tekstin “Gramatika shqype”⁸⁸ e Anton Xanonit, 1909. Ai njofton se përveç vlerave filologjike gjuhësore në shumë rrafshë, kjo vepër e fillimshekullit të 20-të “mbyllet me një fjalorth termash gramatikore, në shqip dhe në italisht. Për historinë e terminologjisë gjuhësore shqipe,- pohon Kastrati, - kanë një vlerë, sado relative”.

Në një kritikë dhe bibliografi, botuar në shtypin shkencor për Fjalorin e termave të gjuhësisë, gjuhëtari Mansaku është i mendimit se *albanologjia në përgjithësi dhe gjuhësia si komponente e saj në veçanti, u lëvruan kryesisht nga albanologë të huaj të vendeve të ndryshme e të shkollave të ndryshme gjuhësore, as nuk mund të flitej për njësimin e një terminologjie gjuhësore kombëtare...Por siç është e natyrshme në fillimet e një shkence...për shprehjen e nocioneve të reja në gjuhësi, u përdorën si terma të rinj më shumë asimilime termash të huaj, se sa krijime mbi bazën e gjuhës shqipe.*⁸⁹

Sipas studiuesve tanë, zhvillimi në të gjitha nivelet i shkencës gjuhësore në këta 100 vjetët e fundit, ka bërë që edhe terminologjia e saj të njohë përparime të dukshme, duke përfshirë në këtë lëmë koncepte të reja themelore, si prurje të

⁸⁵ Po aty, f. 190.

⁸⁶ G. Mikeli, *Gramatika e gjuhës shqype*” Shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër, 1916, 138 faqe. Cituar sipas J. Kastratit në “*Histori e gramatologjisë shqiptare*”, Prishtinë, 1980, f. 337.

⁸⁷ I. J. Përmeti, *Fillime të gramatikës shqipe*. Pjesa e parë për shkollat permetare, Shtypur në Shtypshkronjën e “Diellit”, Boston, 1917, f. 142. Citohet sipas J. Kastratit, *Histori e gramatologjisë shqiptare*, Prishtinë, 1980, f. 342.

⁸⁸ J. Kastrati, “*Histori e gramatologjisë shqiptare*”, Prishtinë, 1980, f. 281.

⁸⁹ S. Mansaku, Kritikë e bibliografi, *Fjalor i termave të gjuhësisë*, Tiranë, 1976, SF, 1977/2, f. 208.

depërtimit të drejtimeve të reja në gjuhësinë shqiptare. Është me vend të theksojmë se kur shohim zhvillimin e terminologjisë gjuhësore në planin kronologjik, arrijmë në përfundimin se kjo terminologji ka pasur përherë prirje për të qenë sa më tepër *amtare*, çka do të thotë se, në krahasim me terma të fushave të tjera të njohjes njerëzore, ka pasur e ka në bazë brumin e shqipes, pasi gjuha jonë ka mundësi të mëdha të formojë terma të rinj. *Krijimi i termave të rinj, pohon Q. Murati, realizohet përmes rrugëve të ndryshme të burimit vetjak e të huazuar, si dhe me vënien në përdorim të disa termave të tjerë që kanë qenë farkuar edhe më parë etj., pa të cilët (terma) mund të thuhet se nuk ka mundur të ecet përpara.*⁹⁰ Në të mirë të këtij mendimi, për karakterin amtar të terminologjisë gjuhësore shqipe, shohim të jetë shprehur edhe *Fjalori i termave të gjuhësisë i vitit 1975*, ku autorët kanë synuar edhe shqipërimin e termave të huaj, pa cënuar përmbajtjen shkencore.⁹¹ Ky fjalor (joshpjegues) u hartua në një fazë të rëndësishme dhe të konsoliduar të gjuhësisë sonë, është vepër e vëllimshme me 586 faqe, dhe përfshin 3533 terma, me përgjegjësit e tyre në 6 gjuhë : shqip, rusisht, frëngjisht, anglisht, gjermanisht dhe italisht, që mbulojnë të gjitha fushat e gjuhësisë.⁹² Sa i përket terminologjisë së sintaksës që po shqyrtojmë këtu në këtë trajtesë, vërejmë se jo pak terma të formuar me tharmin e shqipes kanë zënë vend e përdoren që nga formimi i tyre edhe sot e kësaj dite, ndërkohë që përgjegjësit e tyre në mjaft gjuhë të tjera kanë mbetur ndërkombëtarë, si: *kryefjalë, kundrinor, kallëzues e togfjalësh* ndaj : *subjekt, objekt, predikat, sintagmë* etj.

II

Një ngjarje me shumë rëndësi në historinë e planifikimit të shqipes që *Komisia letrare shqipe në Shkodër*, e cila e zhvilloi veprimtarinë e vet në Shkodër, gjatë vjetëve (1916 – 1918), shënon fillimin a hedhjen e bazave shkencore të përpunimit dhe kodifikimit (normëzimit) të termave në gjuhën shqipe dhe bën hapat e parë të hartimit të terminologjisë në fusha të ndryshme të dijes. Kjo detyrë e Komissisë dilte në plan të parë, sepse kjo ngjarje e madhe gjuhësore për shqipën është quajtur si hapi i parë i Planifikimit gjuhësor të gjuhës sonë amtare.

1. Tue marrë para sysh, se gjuha shqipe mjerisht deri tashti nuk ka qenë e livrueme edhe e punueme nëpër shkolla e administrata si gjuhë e përgjithshme dhe e përbashkme edhe tue qenë se visari i gjuhës nuk asht i përmbledhun ene, për ketë shkak komisis i bije për barrë hartimi i një shumicës së madhe të termave teknike. Duhet pra të ruhet fort si nga neologjizmat si nga barbarizmat e teperme; mbasi nga neologjizmat kuptimi i gjuhës do të bahet shumë i vështirë; në vend qi nga barbarizmat gjuha do të bjerrri ngjyren kombtare.

⁹⁰ Q. Murati, *Për një terminologji më të saktë e më shkencore të gjuhësisë sonë*. Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 27/1, Prishtinë, 2008, f. 256.

⁹¹ Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalori i termave të gjuhësisë*, Tiranë, 1975, f. 5.

⁹² S. Mansaku, Kritikë e bibliografi, *Fjalori i termave të gjuhësisë*, Tiranë, 1976, SF, 1977/2, f. 208

Termat e përgjithshëm të ditunis të rrjedhura prej gjuhvet klasike e qi kanë marrë sot një ngjyrë ndërkombëtare, tue qenë të pranuese në të gjitha gjuhët e Evropës do të pëlqehen edhe në gjuhën shqipe ndën trajtën, qi i përket karakterit të gjuhës.

2. Skajet qi nuk mund të thirren të përgjithshme, do të përbahen prej rrajave shqipe a do të përdoren për ‘to fjalë të gjalla, të cilave u duket mirë kuptimi. Atje, ku këjo punë nuk mund të bahet, do të mund të pranohen edhe terma të hueja, tue marrë para sysh gjuhët e reja qi nuk janë neolatine. Kjo punë po bahet nga ngushtimi i kohës dhe nga mungimi i landës, edhe nga shkaku, qi asht ma lehtë të shkulet me kohë nga gjuha një termë e huej, se të ndreqet një termë e bamun keq nga rraja shqipe.
3. Disa pak fjalë të hueja a të hapuna edhe të njoftuna nepër gjithë Shqipnin edhe për të cilat nuk ka sot një korrespondentë, do të përdoren përkohësisht, deri sa t’u gjindet apo t’u sajohet korrespondentja shqipe.⁹³

III

Një ngjarje tjetër e shënuar për shkollën shqipe dhe përgjithësisht arsimin kombëtar, është edhe *Kongresi i Lushnjës*, 1920, i cili mori vendime të rëndësishme për zgjerimin e shkollave shqipe në vendin tonë, botimin e librave shkollorë dhe për terminologjinë shqipe, sipas fushave të dijes dhe në gramatikat e gjuhës sonë. Në *Këshillin e Epër Arsimuer*, që doli nga ky kongres, vepronte edhe gjuhëtari dhe tekstologu i njohur Aleksandër Xhuvani, i ngarkuar edhe me detyrën e kryetarit të këtij forumi. Duhet shënuar se filologu Aleksandër Xhuvani dhe veprimtari e organizatori i madh i arsimit kombëtar, Mati Logoreci, kanë dhënë një ndihmesë aq të rëndësishme për çështje të gjuhës në këtë periudhë; i pari me rubrikën *Selectae* dhe i dyti *Nji rrezik për gjuhë*, për pastërtinë e gjuhës.

Përpjekje për hartimin e termave të rinj, me brumë të gjuhës sonë, janë vërejtur edhe nga Instituti i Studimeve Shqiptare, që u ngrit në Tiranë në vitin 1940. Aty, bile, u krijua edhe një komision me detyra të qarta, *përbërë nga studiuesit më eminentë të këtij institucioni*.⁹⁴ Autori shkruan se ky komision *do të zgjidhte dhe do të propozonte fjalët dhe termat shqip që do të zëvendësonin fjalët me prejardhje nga gjuhët e tjera. Ishte një problem sa i ngutshëm, por edhe delikat, pasi në sfera të ndryshme të jetës po hynin pa kriter fjalë e terma të huaj*.⁹⁵

IV

Çështja e thelbit të fjalisë është një problem filozofik e gjuhësor, logjik dhe psikologjik, që ka tërhequr vëmendjen e dijetarëve dhe të lingvistëve gjatë

⁹³ T. Osmani, *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër* (1916 – 1918), Shtëpia botuese “Camaj-Pipaj”, Shkodër, 2009, f. 255-256

⁹⁴ T. Osmani, *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor- 3*, “Camaj –Pipaj”, Shkodër, 2009, f. 211.

⁹⁵ Po aty, f. 211.

shekujve. Në historinë e studimeve sintaksore shkruhet se për konceptin e fjalisë, deri më sot, janë dhënë më shumë se 300 përkufizime, një fakt i mjaftueshëm për të treguar se një koncept i tillë është mjaft i komplikuar. Për ta parë problemin në rrafshin historik, duhet të themi se ka qenë dijetari dhe gjuhëtari latin *Prishiani* (që jetoi në Bizant në shekullin V pas Krishtit),⁹⁶ i cili e përkufizonte fjalinë “*si një kombinim koherent fjalësh që shpreh një kuptim të plotë.*” Me “*kombinim koherent*” do të kuptojmë një bashkim të formuar mirë si nga ana formale – gramatikore, ashtu edhe nga përmbajtja e tij. Shumë kohë përpara Prishianit, filozofi i madh helen, Aristoteli, thoshte se në struktura të tilla (të fjalisë) janë të pranishme dy elemente – njëri prej të cilëve predikati që shpreh një përkatësi të vlefshme për të gjithë individët e shënuar prej elementit tjetër, subjektit; ndërkohë që pohimi i anasjelltë nuk është i vërtetë. Kështu, në qoftë se thuhet *Njeriu është një qenie e gjallë, një qenie e gjallë është predikati*, kurse *njeriu është subjekti*; pra: të gjithë njerëzit janë qenie të gjalla, por jo të gjitha qeniet e gjalla janë njerëz.

Në veprën “*Postulatet*” Blumfildi shprehet se “*Fjalja është një konstrukt që, brenda një thënieje, nuk është pjesë e një konstrukti më të madh, pra, një konstrukt maksimal i thënies.*”⁹⁷ “Për shembull: *Popujt do të ndërtojnë të ardhmen e tyre bazuar në kulturë dhe demokraci.*” Për Blumfildin, *Fjalja është njësi më e madhe e analizës gramatikore.*⁹⁸

Një përkufizim të qëlluar për fjalinë ka dhënë edhe gjuhëtari gjerman Jürgen Ries në veprën “*Was ist ein Satz*” (Ç’është një fjali?), më 1931, kur shprehet se *fjalja është njësi minimale e ligjërimit, e formësuar gramatikisht, që e shpreh përmbajtjen në perspektivën e lidhjes së saj me realitetin.*⁹⁹

Për studimet tona sintaksore, fjalja është njësi themelore sintaksore, sepse në këtë nivel realizohen funksionet themelore të gjuhës; më së pari, *funkcioni komunikativ i saj*. Konceptet për fjalinë në gjuhësinë e përgjithshme janë të ndryshme, mbasi ajo është njësi fort e ndërlikuar – me tipare gjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Edhe në ditët tona ka probleme që sjellin mjaft diskutime, çështje të pazgjidhura, për të cilat mbahen qëndrime të kundërta. Ndërsa mund të thuhet se pranohet prej të gjithëve që fjalja është *njësi themelore e sintaksës*, për çështje të ndryshme, siç janë kufijtë e saj me njësitë e tjera më të vogla e më të mëdha, apo përkufizimi i saj etj., nuk janë dhënë përgjigje të njëjta. Në formulimin e

⁹⁶ G. Graffi, *Sintaksa*, Dituria, Tiranë, 2008, f. 121. Përkufizimi origjinal thotë që fjalja (lat. *oratio*), është një *ordinatio dictionum congrua sententiam perfectam demonstrans*.

⁹⁷ R. Memushaj, *Gjuhësia gjenerative*, Shblu, Tiranë, 2008, f. 31.

⁹⁸ J. Lyons, *Hyrje në Gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001, f. 168. Në kapitullin 5 të këtij libri, autori, kur paraqet njësitë gramatikore, shkruan se gramatikanët ndërmjet fjalisë dhe fjalës dallojnë edhe dy njësi të tjera: *sintagmën dhe fjalinë e thjeshtë*: Çdo varg fjalësh, që nga ana gramatikore është e njëvlershme me një fjalë të vetme dhe që nuk lidhet me kryefjalën ose kallëzuesin e vet, quhet sintagmë; në të kundërt, vargu i fjalëve me kryefjalën dhe kallëzuesin e vet, që përfshihet në një fjali të madhe, quhet fjali e thjeshtë. Ndryshimi midis sintagmës dhe fjalisë së thjeshtë gjatë analizës së fjalive të caktuara nuk është gjithmonë i prerë dhe konsekuent.

⁹⁹ R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 259.

përkufizimit, për shembull, disa gjuhëtarë nisen nga forma, të tjerë nisen nga përmbajtja; kurse një palë përfshin edhe nuancat etj. Në gjuhën shqipe fjalia konceptohet si njësi e ligjërimit, e përfshuar mbi bazën e ligjeve të shqipes, të lidhjeve e të marrëdhënieve midis fjalëve e gjymtyrëve për të shprehur ndjenja, mendime, dëshira e forma të tjera të të menduarit. Përgjithësisht pranohet se fjalia është njësi komunikative e gjuhës, ndryshe nga togfjalëshi që nuk e ka këtë tipar. Në më të shumtën e herës fjalitë ndërtohen prej disa fjalësh, por ka edhe jo pak raste kur ato përmbajnë vetëm një fjalë, si: *Vjeshtë. Vapë*.

Në vështrimin gjenerativ, mësojmë se gjuhëtarë të ndryshëm kanë mbrojtur tezën se për të pasur një fjali, është e nevojshme prania e një foljeje në mënyrë të shtjelluar, por ndaj këtij qëndrimi ka mjaft kundërshtime: *më së pari*, është vëzhguar që kundërvënia mes formave të shtjelluara dhe të pashtjelluara foljore (lexoj/me lexue), nuk është aspak e përbashkët në të gjitha gjuhët, por shfaqet vetëm si veçori e gjuhëve i.e. *Nga ana tjetër*, fjali ekzistojnë në të gjitha gjuhët, kështu që prania ose jo e një foljeje të mënyrës së shtjelluar, s'mund të merret si një kriter i vlefshëm për njohjen e një shprehjeje të caktuar gjuhësore si fjali. Në gjuhën shqipe, edhe në shumë gjuhë të tjera i.e. (të lashta e të reja), ka fjali që nuk përmbajnë as folje në formë të shtjelluara dhe janë fjali (për shembull, fjalitë emërore). *Problem tjetër* paraqesin edhe fjalitë e varura brenda një strukture periudhe, të cilat nuk shprehin një kuptim të plotë, duke qenë kombinime të rregullta. Këto arsyetime përfundojnë me atë që *karakteristika sintaksore që e bën fjali një kombinim të caktuar fjalësh, është ajo e të qenit një strukturë predikative*¹⁰⁰, e cila mund të realizohet përmes pranisë së një foljeje të shtjelluar, por kjo s'është një gjë e nevojshme; *ajo që ka rëndësi është që të gjitha gjuhët kanë një mënyrë për të treguar një kombinim predikativ dhe e dallojnë atë nga kombinimet e llojeve të tjera.*¹⁰¹

V

Në librin e A. Xhuvanit, kryefjala përfshihet tek pjesët e para të fjalisë dhe studiohet tek tema nr.1 *Fjalija e pjesët e para të saj*¹⁰². Ja dhe përkufizimi: *Kryefjala dëftën njerin, kafshën a gjân, për të cilën flasim në fjali. Kryefjalën e gjëjmë tue bâmun para kallzuesit të pyetunat : ç'? kush? cili ? cila? cilët? cilat ?*¹⁰³ *Kallzuesi dëftën çka thohet për kryefjalën, edhe e gjëjmë tue bâmun para këtij të pyeturat: ç'asht? ç'janë? qysh asht? qysh janë? ç'ban ? ç'bajnë? ç'ngjajn? ç'ndodhë? ç'bahet? ç'bahen?*¹⁰⁴ Ky përkufizim, pothuajse bartet besnikërisht,

¹⁰⁰ G. Graffi, *Sintaksa, Strukturat e ligjërimit*, Dituria, Tiranë, 2008, f.125.

¹⁰¹ Po aty, f. 125.

¹⁰² A. Xhuvanit *Njohunit e para të Syndaksës shqipe, Pjes'e parë për klasët e nalta të fillores prej*, Shtypshkronja "Vlora", G. Direttore, Vlorë, 1922, f. 5.

¹⁰³ Po aty, f. 5.

¹⁰⁴ Po aty, f. 5.

edhe në botimet e mëvonshme (1935, 1938) të sintaksave shqipe të këtij autori, bile në publikimin e vitit të fundit përcaktimi i kryefjalës mungon.

Në pjesën e katërt të tekstit “*Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*”-sidomos e toskërishtes – të I. D. Sheperit, ku nis trajtimi i kësaj disipline (pas Fonologjisë, Morfologjisë dhe Etimologjisë), përkufizimi i kryefjalës dhe i kallëzuesit jepen brenda një segmenti ku shpjegohet fjalia: “*Fjalia më e thjeshtë ka të pakëtën dy fjalë, prej të cilave njera tregon vetën ose gjënë për të cilën bëhet fjalë, dhe quhet kryefjalë dhe tjetra tregon se ç’ thuhet për kryefjalën, dhe quhet kallëzues.*”¹⁰⁵

Po në këtë linjë vepron edhe J. Rrota, që duke u thelluar në paraqitjen e kategorisë *fjali*, përcakton: *Fjalia pra, asht një mendim i diftuem me fjalë. Në se të cilën fjali do të jetë i shprehun, jase i nenkuptuem: a) frymori a sendi për të cilin flasim e ky thirret subjekt; b) shka thomi për të, e këta thirret predikat.* Subjekti e predikati janë dy kryegjymtyrët e fjalës.¹⁰⁶ Është me interes të vëmë në dukje se sintaksat e fillimit të shekullit të 20-të janë më të çliruara (jo nga trajtimi), por nga terminologjia e logjikës në shpjegimin e këtyre kategorive sintaksore.

Shohim se në vitin 1952, gjuhëtari Kostaq Cipo, në fillim të librit të tij “Sintaksa” – Instituti i Shkencave – përdor prerë skajet *subjekt* dhe *predikat*. *Subjekti, që quhet edhe kryefjalë dhe që është një nga bërthamat kryesore të fjalisë, është, me kuptimin e ngushtë të fjalës, emër, po me një domethënie më të gjerë të fjalës munt të jetë një përemër ose çdo pjesë tjetër e ligjëratës e marrë si emër...*Ky përkufizim i cunguar (krahasuar me atë të autorëve të tjerë dhe sipas pikëpamjes së sotme), vijon në këtë mënyrë: “*Për të gjetur subjektin e një fjalie, bëjmë përpara foljes pyetjen kush.*”¹⁰⁷ Pa bërë dallimin se pyetja *kush* nuk mund të përdoret për çdo kryefjalë, po vetëm për kryefjalët emërore e përemërore që shënojnë njerëz. Ndërsa *predikati* nuk ka një përkufizim të caktuar në këtë gramatikë të Cipos, veç kjo kryegjymtyrë jepet me pohimin se është dy farësh: *foljor* dhe *emëror*. Unikalisht për gramatikat tona të këtij gjysmëshekulli është shpjegimi i skajit *predikat foljor*, për të cilin autori shkruan: “*Quhet predikat foljor, çdo folje që mjafton ajo vetë të plotësojë kuptimin e fjalisë.*”¹⁰⁸ Te *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa e dytë, Sintaksa e M. Domit (1954), kryegjymtyrët e fjalisë u shpjegohen nxënësve në rrugë induktive, nëpërmjet shembujve të dhënë.

Selman Riza, tek Sintaksa e tij, gjatë shpjegimit të ndërtimit të fjalisë gramatikore, &86, I.- *Gjymtyrët kryesore të fjalisë gramatikore, shkruan* – Dy janë gjymtyrët themelore të njëj fjalije gramatikore: 1. ndën-ana a subjekti dhe 2. ana a “jekti”. Subjektin e përban emëni i sendit gjegj. i vehtjes që ban diçka kurse “jektin” e përban ajo trajtë e cilësdo folje qoftë, që shfaq këta të bamë diçkah të

¹⁰⁵ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, sidomos e toskënishtes (për shkollat e mesme), Botuar në Vlorë, më 1927, f. 139.

¹⁰⁶ J. Rrota, *Sintaksi i shqipes*, Shtypshkronja “A.Gjergj Fishta”, Shkodër, 1942, f. 5 – 6.

¹⁰⁷ K. Cipo, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952.

¹⁰⁸ Po aty, f. 4.

subjektit.¹⁰⁹ Përkufizimi është larg të qenit shkencor, jo vetëm se ka përzier terma të gjykimit me të sintaksës, por edhe sepse në thelb vjen i gabuar (krahasojmë sintagmat: *emëni ban diçkah – folja shfaq këta të bam*).

Stefan Prifti, në Sintaksën e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1971, kapitulli IV, A. Kryefjala (Subjekti), &17. Përkufizimi i kryefjalës – shkruan: *Kryefjala, siç e tregon vetë termi, është fjala kryesore, gramatikisht e pavarur, e cila tregon objektin kryesor mbi të cilin është përqendruar mendimi ynë dhe për të cilin flasim në fjali*.¹¹⁰ Më tej autori shpjegon se kryefjala shërben vetëm për ta emëruar objektin për të cilin flasim, dhe jo për ta karakterizuar atë. Karakterizimi dhe sqarimi i kryefjalës në fjalinë e thjeshtë bëhet vetëm nga kallëzuesi, kurse në fjalinë jo të thjeshtë, kryefjala mund të sqarohet e të përcaktohet edhe nga pjesë të tjera, siç është cilësori, ndajshtimi etj. Përkufizimi i kallëzuesit, Prifti shkruan: *Gjymtyra e dytë kryesore e fjalisë është kallëzuesi. Ai mund të përkufizohet kështu: Kallëzuesi është fjala (apo fjalët) që tregon atë çka i pohohet, ose i mohohet kryefjalës. Kallëzuesi është pjesë kryesore e fjalisë, se pa të nuk formohet fjalia, por gramatikisht ai është i varur nga kryefjala, për arsye se ai përmbahet në vetë [me] kryefjalën, është një analizë e saj*.¹¹¹ Në vijim Prifti, si asnjë autor tjetër deri në këtë periudhë, vë në dukje se *analiza e sinteza e kryefjalës me anë të kallëzuesit, është e mundur vetëm në raportin pozitiv të tyre, d.m.th. në fjalinë pohore; përkundrazi një punë e tillë është e pamundur në raportin negativ të tyre, do të thotë në fjalinë mohore*.¹¹² Shpjegimet e tjera për kryegjymtyrët e fjalisë nxjerrin në pah qëndrimin krejt të ndryshëm me trajtimin e sotëm që u bëhet këtyre kategorive sintaksore, jo vetëm nga përkufizimi i tyre, por edhe për marrëdhëniet e ndërsjella.

Mendimi më i përparuar në gjuhësinë e sotme shqiptare për këto kryegjymtyrë është ai që shprehet nga studiuesi i sintaksës shqipe, R. Përnaska, i cili, kur paraqet skemën Kryefjalë – Folje kallëzues – Kundrinor, shpjegon si më poshtë:

“Në këtë skemë shihet gjithashtu se nënanori (kryefjala, shënimi im, B. Qalliaj) dhe kallëzuesi bashkëlidhen, pra nuk mund të thuhet as se nënanori përshtatet me kallëzuesin, as se kallëzuesi përshtatet me nënanorin. Ideja e bashkëpërshtatjes midis kryefjalës dhe kallëzuesit nuk është e re, ajo në gjuhësi shpesh është shprehur nga skaji gjuhësor përshtatje solidariteti për ta dalluar pikërisht nga përshtatjet e tjera, si p.sh. të mbiemrit me emrin.¹¹³

¹⁰⁹ S. Riza, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta XXVI, Seksioni i Gjuhës dhe i Letërsisë, Libri 13. Prishtinë, 1997, f. 504.

¹¹⁰ S. Prifti, Sintaksa e gjuhës shqipe, “Rilindja”, Prishtinë, 1971, f. 51.

¹¹¹ Po aty, f. 60.

¹¹² Po aty, f. 61.

¹¹³ R. Përnaska, *Kundranori me paraafjalë në gjuhën e sotme shqipe*, NBGL, “Dukagjini”, Pejë, 1996, f. 23.

VI

Me një paraqitje të shkurtër të këtyre kategorive sintaksore, duhet shënuar se ndarja e gjymtyrëve funksionale të fjalisë në kryesore dhe të dyta, i përket gjuhëtarit danez Otto Jespersen, i cili e motivoi këtë shtresëzim, duke u mbështetur kryesisht tek “ekstrapozicioni” a pozicioni i veçantë i gjymtyrëve. Ky “ekstrapozicion”, shkruan R. Përnaska, nuk është mjete i vetëm dhe i gjithëfuqishëm për të dalluar gjymtyrët kryesore nga ato jokryesore...në “ekstrapozicion” mund të vihen edhe gjymtyrë të tjera midis tyre.¹¹⁴ Po e nisim këtë përshkrim diakronik të terminologjisë e kuptimit të skajeve gjuhësore, duke nisur me gjymtyrën tjetër argumentative (posë kryefjalës), kundrina.

Kundrina – kështu është emërtuar për herë të parë në Sintaksën e A. Xhuvanit kjo gjymtyrë argumentative, në vitin 1922.¹¹⁵ Autori jep edhe të parin përkufizim të kësaj kategorie, duke pasë paraqitur shembuj të mjaftueshëm: *Kundrinë* quhet fjala që dëftën njerin a gjân, mbi të cilën bije veprimi i foljes a të kallzuesit foljuer.¹¹⁶ Xhuvani shënon se kundrinë marrin vetëm foljet veprorë dhe një dy farat e kundrinave dhe shpjegon. Kundrina quhet *e drejtë*, kur vëhet në rasë dëshmore, p.sh. kërkova *librin*; harrova *rrugën*. Kundrina quhet *e shdrejtë*, kur është në rasë dhanore, p.sh. *i shkrova mikut*; *i rashë mandolinës*.

Sheperi, në librin e tij të gramatikës, e jep kundrinën dy farësh, ndërsa përkufizimi i kundrinës së drejtë vjen si vijon: “*Kundrin’e drejtë tregon personën ose gjen mbë të cilën shkon përsëdrejti veprimi i kryefjalës; vihet në rasën kallzore, dhe i përgjigjet pyetjes “kë” ose “çë”?*”¹¹⁷ P.sh. lajmova *mikun*, shkrova *letrën*. Së pari, duhet thënë se më së shumti thuhet *veprimi i foljes* (si e shënojnë pothuajse të gjithë gjuhëtarët tanë) dhe jo i kryefjalës, siç e shkruan autori. Për kundrinën e zhdrejtë lexojmë përkufizimin: “*Kundrin’e shdrejtë tregon personën ose gjën mbë të cilën vepërimi i kryefjalës shkon tërthorazi; vihet në rasë dhënore dhe i përgjigjet pyetjes kujt?*” P.sh. *I shkrova mikut*. Edhe këtu shkruhet përsëri *veprimi i kryefjalës*, kurse termi *dhanore*, del nga pjesorja e toskërishtes *dhënë-dhënore*. E reja që shohim te Sheperi është në shpjegimin e & 430, ku autori arrin në përfundimin se *edhe një fjali e tërë vihet si kundrin’e drejtë*. P.sh. *Mësova që erdhi; dua të shkruaj; nuk di se ku vate*. Autori e quan këtë *kundrinë me fjali të dytë*.¹¹⁸ Ashtu si pararendësi i tij Xhuvani, Sheperi tregon përfundimin e kundrinorëve me folje *transitive* dhe *intransitive*, por bën edhe vërejtje të tilla, si ajo e & 432, ku vihet në pah dukuria morfosintaksore e tërheqjes së kryefjalës nga folja e fjalisë së parë në strukturat dyshe të periudhave, p.sh. : *Nuk e di Alin se ku*

¹¹⁴ Po aty, f. 191.

¹¹⁵ A. Xhuvani, *Njohunit e para të Syndaksës shqipe, Pjes’e parë...* Shtypshkronja, Vlorë, 1922, f. 16.

¹¹⁶ Po aty, f. 17. Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1935, f. 13 – 14.

¹¹⁷ I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe*, Sidomos e toskënishtes (për shkollat e mesme), Botuar në Vlorë, më 1927, f. 145 – 147.

¹¹⁸ Po aty, f. 145.

*ka vatur = Nuk e di se ku ka vatur Aliu.*¹¹⁹ Një zë më vete tek trajtimi i kësaj gjymtyre dalin *pleonazma e kundrinave dhe kundrina e brendshme*. Për të parën, autori shpjegon se *foljet vepërore bëhen transitive duke marrë përpara trajtat e shkurtëra të përemrit vetor, si pleonazma të kundrinës që pason ose nënkuptohet*. P.sh. *shkruaj, e shkruaj; përgjigjem, i përgjigjem.*¹²⁰ Ndërsa për të dytën (kundrinën e brendshme) , “*çdo folje mund të marrë si kundrinë një emër të prejardhur nga rrënjë e saj ose me domethënie të rrënjës së saj* (punoj punë, shkruaj shkrim, flê gjumë),¹²¹ del pleonazma e vërtetë, siç e trajtojmë sot te kundrinat tautologjike.¹²²

Shtjellimin më të gjerë, origjinal dhe më shkencor të kundrinorit e gjejmë tek “*Sintaksi i shqipes*” i Justin Rrotës, dhënë me termin e dyfishtë *objekt – kundrinë*.

Më 1954, Mahir Domi harton tekstin mësimor për shkollat shtatëvjeçare *Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa e dytë*, dhe gjymtyrën *kundrinë* e jep vetëm në dy trajta: të drejtë e të zhdrejtë. Për të parën lexojmë përkufizimin: *Kundrinë e drejtë quhet fjala që plotëson kuptimin e kallëzuesit foljor dhe tregon njerinë, kafshën a sendin, mbi të cilin bie drejt për drejt veprimi që kryen kryefjala. Kundrina e drejtë shkon vetëm me foljet kalimtare (transitive) vepërore.*¹²³ Ndërsa për kundrinën e zhdrejtë, Domi jep përkufizimin: *Kundrinë të zhdrejtë quajmë fjalën që tregon njerinë, kafshën a gjënë, ku tërthorazi vete e mbaron veprimi i shprehur prej foljes, d.m.th. fjalën që tregon cakun drejt të cilit shkon veprimi i fjalisë.*¹²⁴

Ndryshe vjen paraqitja e kundrinës nga Selman Riza, i cili, më së pari e rendit këtë gjymtyrë tek të ashtuquajturat *Gjymtyrë plotësore të njëj fjalije gramatikore.*¹²⁵ Pas kësaj ky gjuhëtar tregon se në përbërje të kësaj fjalie hyjnë: *rrethanat e llojllojshme, kundrana e drejtë dhe kundrana e zhdrejtë*. Për të parën thuhet se është gjymtyrë plotësore e fjalisë *kundranë e drejtë a objekt direkt që shenjon sendin a vehtjen që pëson veprimin e subjektit e që vehtet në akuzativ*. Ndërsa kundrina e zhdrejtë jepet në përjasje me serbo-kroatishten, si *objekt indirekt që shënjon sendin a vehtjen që si të thuesh pret veprimin e subjektit e emni i të cilitvehet jo vetëm në dativ por edhe në ndonjë rasë tjetër të prime me parafjalë.*¹²⁶ Termin *kundranë* e ndeshim edhe në një rimarrje që bën autori, duke

¹¹⁹ Po aty, f. 145.

¹²⁰ Po aty, f. 146.

¹²¹ Po aty, f. 146.

¹²² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe, II*, Tiranë, 2002, f. 254.

¹²³ M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe, Pjesa e dytë*, Tiranë, 1957, f. 40.

¹²⁴ Po aty, f. 44.

¹²⁵ S. Riza, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1997, f. 505.

¹²⁶ Po aty, f. 506.

shkruar se *çdo llojfalë që mund të shërbejë si ndënanë gjegj. si i pertekallxuem, mund të shërbejë edhe si kundranë*.¹²⁷

Stefan Prifti, në Sintaksën e vet, jep një përkufizim për kuptimin e përgjithshëm të kundrinës, që përmbledh dy *farat* e saj: *Kundrina është gjymtyrë e varur e fjalisë së zgjeruar, tregon sendin mbi të cilin bie direkt ose tërthorazi veprimi i gjymtyrës nga ajo varet*.¹²⁸ Duhet shënuar se autori trajton brendinë dhe formën e kësaj gjymtyre, kundrinën e brendshme dhe të jashtme, si dhe *kundrinën si plotësor emëror të foljes*. Në Gramatikën normative të Akademisë së Shkencave, kundrinori shihet sipas marrëdhënieve dhe lidhjeve me gjymtyrën ku varet: *Kundrinë është gjymtyra e fjalisë që vihet në marrëdhënie objektore në kuptim të gjerë dhe që lidhet me lidhje nënrenditëse drejtimi me gjymtyrën prej së cilës varet*.¹²⁹ Trajtohen gjithashtu në vijim kundrina e drejtë, e zhdrejtë, ku përfshihet edhe kundrina me parafjalë.

Këtu mendojmë të bëjmë një “thyerje” të kësaj linjeje në paraqitjen e terminologjisë sintaksore, duke ruajtur planin diakronik të saj. Lënda e sjellë më lart ka lidhje me *argumentet* e fjalisë, të cilët lidhen me valencën e foljeve. Elementet që “*mbushin*” valencën e një foljeje, domethënë ato që detyrimisht duhet të përdoren së bashku me foljen, janë përkufizuar nga Tesniere *aktantë*¹³⁰, kurse në vepra dhe autorë të ndryshëm quhen edhe elemente “*nukleare*”, të tjerë edhe “*argumente*”. Sipas kësaj gjuhësie *argumentet* tregojnë njësitë e përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e përshkruar nga folja.

VII

Me mjaft interes është paraqitja e gjymtyrëve të dyta funksionale, që nga Sintaksa e Aleksandër Xhuvanit, deri tek Gramatika normative e shqipes, pasi në të gjitha këto tekste shkollore të niveleve të ndryshme, ka një shumësi termash, nisur nga plotësorët. Këtu duhet të bëjmë përjashtim vetëm librin për shkollat e mesme të gramatikanit Justin Rrota, i cili arriti të reduktojë së tepërmi klasat e ndryshme të këtyre kategorive sintaksore, duke kaluar vetëm në 3 gjymtyrë të dyta. Kështu, në tesktin për shkollat fillore, përveç plotësve (rrethorëve – shënimi im), që kanë krijuar traditë si terma sintaksorë në gjuhën shqipe: *plotësori i vendit, plotësori i kohës, plotësori i mënyrës, plotësori i shkakut dhe plotësori i qëllimit*, autori rreshton edhe: *plotësin e landës, plotësin e kufizimit, plotësorin e krahasimit, plotësin e emnimit, plotësorin e plotnisë dhe të mungesës, plotësirin e*

¹²⁷ Po aty, f. 531.

¹²⁸ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe* (Pjesa e parë), Prishtinë, 1971, f. 104.

¹²⁹ Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II* Tiranë, 2002, f. 260.

¹³⁰ G. Graffi, *Sintaksa, Strukturat e ligjëritimit*, “Dituria”, Tiranë, 2008, f. 62. *Nga latinishtja *actantus* – në gjuhësinë strukturore, ai që kryen veprimin e treguar nga folja/secila nga njësitë që merr pjesë në mënyrë aktive apo pasive në veprimin e shprehur nga folja.

pjesës, plotësorin e të ndamit a të largimit, plotsorin e rranjës a të prejardhunit, plotësorin e agjentit.

Tek “Gramatika dhe Sindaksa e gjuhës shqipe” e Sheperit (1927), klasifikimi bëhet mbi baza morfosintaksore, ndarë në dy grupe të mëdha, sipas rasave: a) në plotës që marrin rasën e emrit që plotësojnë, b) në plotës që kanë rasë të caktuarë. Pastaj autori i ndan në: *plotës me gjënore, me dhënore, me kallëzore, me rrjedhore, me thirrore*, për të kaluar tek vargu i gjatë i funksioneve sintaksore sipas kësaj terminologjie: *plotës i pronës, plotësi foljuer, plotësi i landës, plotës vendi, kohe, mënyre, sasije, shkaku.*

Kategoria e plotësorëve tek Justin Rrota, gjen reduktimin e rrethorëve që kemi sot; kjo kategori thirret prej autorit *advërbjar* (për shkak të ndërtimit tipik që marrin këto gjymtyrë me ndajfolje të ndryshme). Te Sintaksi i shqipes (si tekst për shkollat e mesme) gjejmë : *atributi (cilësori), apozicjoni (ndajshtimi), advërbjari i vendit, advërbjari i kohës, advërbjari i mënyrës, advërbjari i shkakut.*

Ndërsa tek Sintaksa e K.Cipos, numri i plotësorëve të paraqitur me funksione gjymtyrore arrin numrin 25, duke sjellë terma, si: *plotësi i specifikimit, i mjetit a i veglës, i agjentit, i marrëdhënies, i rrënjës, i dobisë a i dëmit, i këmbimit, i fajit, i argumentit, i pjesës, i mbushullisë, plotësi i përjashtimit etj.*

Katër vjet më vonë botohet Sintaksa e Mahir Dimit dhe ky numër plotësorësh arrin deri në 23, duke mbetur disa terma emërtues, si: *plotësor mjeti, plotësor lënde, çfarësie, prone, plotësor emërtimi, plotësor vepronjës etj.* Numrin më të madh të këtyre plotësorëve e ndeshim tek Sintaksa e Stefan Priftit (1971), që arrijnë në 30; midis tyre lexojmë edhe terma të tillë, si : *plotësori i autorit, plotësori i tërësisë, plotësori etik, plotësori i përmbajtjes, plotësori i largimit, i veçimit, i zanafillës, etj.*

VIII

Lidhur me terminologjinë e njësisë më të madhe sintaksore, siç është periudha, ka pasur qëndrime të ndryshme prej autorëve të gramatikave (Sintaksave) shqipe gjatë shekullit të 20-të. Në tekstet shkollore, të dhjetëvjetëshave të parë të shekullit të kaluar, kjo njësi është shënuar sipas modeleve të gramatikave të huaja, me *periudhë* ose *periodë* – nga Xhuvani, Sheperi, Rrota, Prifti, ndër të cilët Justin Rrota përdor edhe termin *fjali e perbame*, që ka gjetur përdorim në tekstet tona shkollore parauniversitare vetëm në vitet '70 e këndeje, siç e kemi shënuar gjatë këtij punimi. Natyrisht që ky term (periudhë) është përdorur edhe prej të huajve, kur kanë dhënë konsiderata për sintaksën e gjuhës shqipe, si vepron edhe Max Lambertz-i tek studimi i thelluar *Periudha me fjali kushtore në gjuhën shqipe*. Dhe është vazhduar ky qëndrim i gramatikanëve tanë më të njohur, duke shpejguar se termi *periudhë* ose *periodë* i përgjigjet më mirë prejardhjes së termit, përmbajtjes e kuptimit të tij – si e paraqet Stefan Prifti në Sintaksën e tij. Në këtë vazhdë, i pari që përdor një term tjetër për të shënuar këtë njësi është M.Domi, i cili në librin e tij për shkollat e larta, botuar në Prishtinë, në vitin.1971, sjell në përdorim edhe termin *frazë*. Edhe ky term nuk

vjen pa probleme terminologjike, pasi me *frazë*, në gjuhësinë botërore shënohet edhe *fjalìa*, edhe *periudha* (përndryshe: si *fjalìa* e thjeshtë, si *fjalìa* e përbërë). Në vitin 2000 M.Totoni, harton librin (tekst universitar) me titull “Fraza me nënrenditje”, duke shmangur tërësisht termin *periudhë*. Autorët e Gramatikës normative (Pj.II- Sintaksa), e kanë parë të arsyeshme që për paraqitjen e kësaj njësie të vënë në përdorim termin *periudhë*. Lidhur më këtë, një qëndrim të ndryshëm mban prof. R. Memushaj, i cili në tekstet “*Fonetikë e shqipes standarde*” dhe “*Hyrje në gjuhësi*” parapëlqen termin *frazë*. Sidoqë të jetë, termi nuk e ndryshon përmbajtjen e njësisë që përfaqëson, por mosqëndrimi unik bën që gjuhëtarët tanë të fushave të ndryshme të detyrohen që përbërësit e frazës (periudhës) t’i japin me terma aspak të njëjtë, si: *fjali*, *bërthamë predikative*, *bërthamë kallëzuesore*, *njësi predikative*, *njësi kallëzuesore*, deri edhe me termin *si fjali*, që na vjen në punimet shkencore të M.Çelikut, njëri prej bashkautorëve të Gramatikës normative.

BIBLIOGRAFI:

1. **AKADEMIA E SHKENCAVE E RPSH**, INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË, SEKTORI I TERMINOLOGJISË, *Fjalor i termave të gjuhësisë*, (shqip, rusisht, frëngjisht, anglisht, gjermanisht, italisht), Tiranë, 1975.
2. **AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË**, INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË, *Gramatika e gjuhës shqipe II, (Sintaksa)*, Tiranë, 2002.
3. **CIPO, K.**, *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë, 1952.
4. **DODBIBA, L.**, *Zhvillimi i terminologjisë gjuhësore shqipe nga Rilindja deri sot*, Universiteti Shtetror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, *Konferenca e parë e studimeve Albanologjike, 15 – 21 Nëntor 1962*, Tiranë, 1965.
5. **DOMI, M.**, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Pjesa e dytë, Sintaksa. Tekst për shkollat shtatëvjeçare e shkollat e mesme, botim i tretë. Botim i Ministrisë s’Arsimit dhe Kulturës, Tiranë, 1957.
6. **DOMI, M.**, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1971.
7. **FRASHËRI, S.**, *Shkronjëto e gjuhës shqipe*, “Logos”, Prishtinë, 2004.
8. **GRAFFI, G.**, *Sintaksa*, Strukturat e ligjërimin, Dituria, Tiranë, 2008.
9. **KASTRATI, J.**, *Histori e gramatologjisë shqiptare*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980.
10. **LYONS, J.**, *Hyrje në Gjuhësinë teorike*, Dituria, Tiranë, 2001.

11. **MANSAKU, S.**, Kritikë e bibliografi, *Fjalor i termave të gjuhësisë*, Tiranë, 1976, SF, 1977/2.
12. **MEMUSHAJ, R.**, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2002.
13. **MEMUSHAJ, R.**, *Gjuhësia gjenerative*, Shblu, Tiranë, 2008.
14. **MEMUSHAJ, R.**, *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë, 2010.
15. **MURATI, Q.**, *Për një terminologji më të saktë e më shkencore të gjuhësisë sonë*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 27/1, Prishtinë, 2008.
16. **OSMANI, T.**, *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916 – 1918)*, Shtëpia botuese “Camaj-Pipaj”, Shkodër, 2009.
17. **OSMANI, T.**, *Tradita dhe e sotmja në vështrimin gjuhësor- 3*, Shtëpia botuese “Camaj-Pipaj”, Shkodër, 2009.
18. **PËRNASKA, R.**, *Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe*, NBGL, “Dukagjini”, Pejë, 1996.
19. **PRIFTI, S.**, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Ndërmarrja gazetare-botuese “Rilindja”, Prishtinë, 1970.
20. **RIZA, S.**, *Vepra 2*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Botime të veçanta XXVI, Seksioni i Gjuhës dhe i Letërsisë, libri 13; Prishtinë, 1997.
21. **RROKAJ, SH.**, *Çështje të gjuhës shqipe 2*, Shtëpia Botuese “Shkronjë pas Shkronje”, Tiranë, 2009.
22. **RROTA, J.**, *Sintaksi i shqipes*, Shtypshkroja “A.Gjergj Fishta”, Shkodër, 1942-XX.
23. **SHEPERI, I. D.**, *Gramatika dhe sindaksa e gjuhës shqipe*, Shtypshkronja “Vlora” G. Direttore & C, Vlorë, 1927.
24. **TOPALLI, T.**, *Fjali e përbërë, frazë apo periudhë*, Gjuha jonë, 1-4/2004.
25. **TOTONI, M.**, *Fraza me nënrenditje*, Shblu, Tiranë, 2000.
26. **XHUVANI, A.**, *Njohunit e para të syndakses shqipe, Pjes’e parë* për klasat e nalta të filllores, Shtypshkronja “Vlora” G. Direttore & C. Vlorë, 1922.
27. **XHUVANI, A.**, *Libri i gjuhës shqipe për klasën e tretë të filllores*, Shtëpia Botonjëse, “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1926.
28. **XHUVANI, A.**, *Njohunit e para të syndakses shqipe, Pjes’e parë*, për klasët e nalta të filltores e për të ultat e shkollave të mesme, Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1935.
29. **XHUVANI, A.**, *Sintaksa shqip, Pjes’e dytë, për klasët e ulta të shkollave të mesme*, Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1938.

The development of the Albanian linguistic terminology (syntax)
during the twentieth century

SUMMARY

During this modest description and research into albanian grammars, which have been published within this century, referring to the beginning and the development of the terminology of syntax, it is very important to record that linguists and the formulators of the texts have always been concerned about the terms formation, which they wanted to be based on the albanian root. In the best cases, the authors of the syntax of our language, have represented the terms of this discipline with double terminology in latin and albanian language, because of the fact that the first books and some school disciplines were written in a foreign language. The scientific bases of the albanian linguistic terminology were launched by the Albanian Renaissants. The pioneer of the creation of this linguistic terminology was the prominent renaissant Sami Frashëri, However linguistic, literary and cultural terms can be found at the old authors such as Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani. The syntax terminology was begun by A. Xhuvani and was successfully followed by J. Rrota, K. Cipoja dhe M. Domi.

Alfred ÇAPALIKU

RIARDHJA NË KOHË E NJË LIBRI POETIK TË PIPËS

Duke e perifrazuar shkrimtarin Arshi Pipa (Shkodër, 1920-Washington, 1997), “stoiku i letrave shqipe”¹³¹, ai mund të portretizohet në kornizën: punëtori i madh, intelektual i shquar përkthyesi i talentuar, polemisti i rrallë. Kromatika e këtyre penelatave zuri fill qysh në botimin e një vëllimi të hollë me vjersha, në rininë e tij. Libri poetik “Lundërtarë”, Tiranë, 1944, e nisi kursin në oqeanin e trazuar të Luftës së Dytë Botërore dhe e renditi krijuesin me dell poetik të pasur në flotën e atyre që kërkonin mënyra të reja, krijuese në devizën:

“për me vuejtë jemi ba gati
jemi nis kah bukuria!”¹³²

Ashtu si në poezinë e Poradecit, Koliqit, Migjenit, Palit edhe në atë të Pipës, lirikat nuk mund të shquheshin më si atdhetare.

Tek Arshi Pipa ato modelohen si kujtime për shokët, mall për fëmijërinë, lidhje me familjen, mbresa për qytetin e lindjes. Këto tipare pena e Arshi Pipës i shprehu poetikisht përmes orkestrimit të vargut dhe i mbështeti estetikisht përmes aranzhimit të fjalës, në joqëllimoren e artit modern.

Poetikisht: “Shpesh herë kur mbramja zbriste mbi ne
Na gjente t’heshtun ulun m’nji bankë
E shoqet m’thojshin me sy përdhe:
Na kndo nji kangë!”¹³³

¹³¹ Myftar Gjana: “Arshi Pipa ose stoiku i rrallë i letrave”. Gaz. “Drita”, Tiranë, 22.05.2005, f. 4.

¹³² “Lundërtarë” tek Arshi Pipa “Vepra 1”. “Lundërtarë”. Libri i dashunis dhe i fatit”, Tiranë, 2000, f. 69.

¹³³ “Kujtime fminije” tek Arshi Pipa “Vepra 1...”, f. 25.

Estetikisht: “Do t’ishe fort i knaqun sikur ndër kto vargje të gjindej aq sa ka: dëshirë, kërkim i poezis, mundim i krymbit për me u ba flutur, ankth i të pavetëdishmes instinktive për me dalë në pastërtin e mendimin, në shpirtin e kthiellët”.¹³⁴ E konceptuar në tre cikle: “Libri i elegjive”, “Fantazina”, “Provat”, kjo përmbledhje poetike është shkruar në formën e një bashkëbisedimi të veçantë, ku zëri i lutjes ekzistenciale kundërshtohet vazhdimisht:

“Fluturuesha mbi humnera
N’lundra t’brishta si gastare
Na do t’end’mi kah t’fryj era,
anash botës kufitare.”¹³⁵

Receptimi i poezisë elitare të Arshi Pipës u bë në kohë reale, në Shkodër nga studiuesi erudit Qemal Draçini që përhapi recensionin e parë vlerësues për krijuesin e ri:

“Atmosfera mystike e Shkodrës është skenari ma i zgjedhun,
një atmosferë e dashtun plot jehe të një kalese lehtësisht të mërtisun,
atmosferë buzëmbrajsh pranverore në të cilën lartësohet
kanga vetare e një andrratari...”¹³⁶

Në vargjet herë të hajthshme e herë të flashkëta të Pipës, Draçini, poet për vete, pikasi edhe gjendje onirike. Shkëputja e plotë nga realiteti është një procedim i mirëfilltë hermetik.

Por të tjerë kritikë bashkëkohës nuk e kuptuan poetikën e “negatives” së Pipës që shprehte shqetësimet e një pjesë të kulturës mes dy luftërave botërore. Ndoshta se ajo nuk formoi dot rrymë, veç me një libër të botuar.

Pas mbirjes në 28000 kilometra katrore të letërsisë së realizmit socialist shqiptar, receptimi i librit “Lundërtarë” u ndërpre, autori u brengos e u anatemua. Parandjenjën e moskomunikimit Pipa e kishte shpallur përmes një monologu:

“Un kndova por kangën kush m’a ndigjovi”¹³⁷

¹³⁴ Parathënie pa titull-tek Arshi Pipa. “Vepra 1...”, f. 11-12.

¹³⁵ “Lundërtarë” tek Arshi Pipa, “Vepra 1...”f.69.

¹³⁶ Qemal Draçini : “Recension “Lundërtarë”.Rev. “Fryma”, Shkodër, Nr.3/1944, f.141.

Lirika e tij meditative është univers humbjesh dhe zhgënjimesh, ku veç rastësisht duket një shteg shprese dhe shpëtimi:

“Ti m’deshte mue e un deshta njerëzimin!
Veç atje nalt na kemi me u kuptue”¹³⁸

Në pjesën më të madhe të 32 poezive, takimi me jetën e hidhur, mbushur me mëri stoike i kundërvihet optimizmit idealist. E megjithatë këtu e merr pikënisjen kërkimi i shtegut të shpresës për shpëtim, të cilin jeta e përditshme e fshinte apo e fshihte:

..shenjonte zani i im për dashunorët...
Habitej nata e i ndalonte orët!”¹³⁹

Prurja e parë poetike e Pipës duket se paraqet një horizont të gjerë pritjeje. Plot 60 vite pas botimit, po në Tiranë, më 2004, studiuesi i njohur Ali Xhiku, në një botim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë i referohet 16 herë librit “Lundërtarë”, ku Pipa nga individualitet ngrihet në personalitet të letrave të viteve ’40:

“...Arshi Pipa e mendonte poezinë edhe enigmatike, të tillë që u drejtohej njerëzve të kulturuar , që lexonin duke menduar, i ktheheshin rileximit, që e kërkonin vetë brendinë e bukurinë tek mbartjet e emërtimeve dhe cilësive të objekteve, te vendosja e “parregullt” e fjalëve në fjali...”¹⁴⁰

Nga valët e trazuara të luftës së nxehtë dhe të ftohtë, libri i parë i Arshi Pipës e vazhdon udhëtimin në oqeanin e kohës sonë. Imazhin e lundërtarit të përjetshëm Arshi, çdo lexues e vizaton me lehtësi, mjaft që të mbajë një minutë heshtjeje mbi vargjet e Pipës:

“Kujtimi i yt , pak pluhun
N’gji t’nji luleje!”¹⁴¹

¹³⁷ “Vdekja e Norit” tek Arshi Pipa “Vepra 1...”, f. 36.

¹³⁸ Po aty, f. 37.

¹³⁹ “Kanga e bylbylit” tek Arshi Pipa “Vepra 1...”, f. 44.

¹⁴⁰ Ali Xhiku: “Letërsia shqipe si polifoni”, Tiranë, 2004, f. 172.

¹⁴¹ “Ndamja” tek Arshi Pipa “Vepra 1...”, f. 31.

Për një gjysmë shekulli të trazuar, kur arti i vërtetë u eklipsua nga parrullat socrealiste, Arshi Pipa u shfaq si figurë poliedrike me rrezatim nga diaspora e lirë, tek atdheu i izoluar. Por nga opusi i tij vinte vetëm jehona...

Edhe pas rënies së mureve ideologjike, vetëm kur njihesh e familjarizohesh me kontributet e Pipës, “pasi ke lexuar gjithë poezinë e tij origjinale arrin të vlerësosh përmasën reale që shfaq kjo poezi, që në fillimet e tij krijuese në librin “Lundërtarë”...”¹⁴².

Updating Arshi Pipa’s Poetical Work

SUMMARY

The “Stoic of the Albanian Literature”, Arshi Pipa (Shkoder, 1920-Washington, 1997), is to be portrayed as the great worker, outstanding intellectual, talented translator, special polemist. The chronicle of his literary work begins with his poetical work “Lundertare” (Sailors). This book, published in 1944, which set sail on the wavy ocean of WWII, ranked its author among the outstanding fleet members who were lead by the motto:

“we are ready to suffer
in search of beauty”

Pipa’s lyrics as well as those of Poradeci, Koliqi, Migjeni and Pali, could no more be permeated by the feeling of nationalism. Arshi Pipa depicts his reminiscences of his friends, childhood, family and birthplace, through rhyming lines esthetically supported by well-arranged words that were unintentional as they belonged to modern art.

¹⁴² Fatbardha Hoxha: “Fillimet poetike të Arshi Pipës”. Rev. “Kumtari 9”, Shkodër, 2009, f.100.

Agron XHAGOLLI

TRASHËGIMIA FOLKLORIKE SHQIPTARE NË KONTEKST EVROPIAN

Sot, më tepër se kurrë është shtruar për zgjidhje para popujve të Evropës bashkimi apo integrimi i tyre i përgjithshëm dhe i gjithanshëm. Për një realizim të tillë, përgjithësisht të mirëpritur, janë të pranishëm faktorë të ndryshëm. Së pari, duhet theksuar se larmia kulturore e popujve të ndryshëm nuk pengon, përkundrazi, shprehet si unitet në diversitet. Kjo larmi kulturore dhe integrimi i vendeve evropiane përbëjnë një problematikë shumë të rëndësishme, jo vetëm shkencore. Këtu mbledhen një sërë problemesh që meritojnë të shtrohen, të diskutohen, por edhe të mirëpritën zgjidhjet e ofruara.

Popujt në shekuj kanë dhënë e kanë marrë me njëri-tjetrin. Ata e kanë kuptuar, ndër të tjera, edhe në mënyrë intuitive, se zhvillimi dhe përparimi i tyre ishte i kushtëzuar edhe nga shkëmbimi i përvojave jetësore dhe i kulturave të tyre. Një nga fushat ku duken më për së afërmi kontaktet dhe ndërkomunikimet shekullore midis popujve, për ne shqiptarët para së gjithash me popujt fqinjë, por dhe me popuj të tjerë të Evropës, është krijimtaria folklorike. Të ndodhur në kushte zhvillimi afërsisht të njëjta apo të barabarta, me lëvizjet e shumta reciproke, për arsye nga më të ndryshmet, popujt fqinjë kanë pasur edhe një folklor të përafërt, me shumë pika kontakti dhe përbashkësish.

Krahas një bote tematiko-motivore të përbashkët të popujve të ndryshëm, të trashëguar nga periudhat më të hershme të shoqërisë njerëzore, folklori në popujt e Evropës ka krijuar edhe dukuri të veçanta, karakteristike të vetat, duke sjellë mëvehtësinë dhe individualitetin folklorik.

Por folklori në ditët e sotme rrezikohet nga faktorë të shumëfishtë, të brendshëm dhe të jashtëm. Midis tyre paraqitet edhe integrimi. Koncepti i bashkimit të të gjitha shteteve të ndryshme të Evropës apo i shumicës së tyre, tashmë ka filluar të jetë një realitet. Gradualisht, me sa duket, në një kohë të caktuar edhe ne shqiptarët do të jemi të përfshirë në Evropën e

bashkuar. Në këtë moment do të mund të realizohet ëndrra e shumëpritur e shqiptarëve...

Krahas anëve emocionale dhe përmbajtësore që rrejedhin a nënkuptohen apo shpresohen të arrihen pas këtij integrimi, mendojmë se mbartet edhe ndonjë rrezik. Të njëjtin shqetësim e shpreh edhe UNESCO-ja, e cila në proklamaten e vet të 15 nëntorit 1989, nisur nga situacionet reale të jetës së folklorit në vende të ndryshme, u rekomandon të gjitha shteteve pjesëmarrëse për të marrë masa lidhur me ruajtjen e kulturës dhe të folklorit tradicional, duke sjellë zbërthime konkrete e sugjerime për një ndryshim të ndjeshëm të gjendjes së kulturës tradicionale dhe të folklorit.

Për çdo popull kushte të caktuara kanë krijuar larmi, diversitete kulturore jo vetëm midis popujve të ndryshëm, por edhe brendapërbrenda krahinave apo ndarjeve të tjera etnofolklorike. Midis shqiptarëve p.sh. ka një larmi shumë të gjerë të krijimeve folklorike. Mjafton të kujtojmë se në rajone të caktuara të Shqipërisë këndojnë në mënyrë polifonike, në të tjera në mënyrë homofonike. Në disa komunitete a bashkësi praktikohen lloje të caktuara, që nuk kanë shtrirje mbarëshqiptare. Por ndodh që pikërisht nga këto lloje folklorike gjejmë të praktikuar në komunitete a bashkësi të popujve të tjerë fqinjë.

Duhet pohuar, nga ana tjetër, se ka dhe krijime të caktuara folklorike që kanë përhapje jo vetëm mbarëshqiptare, por mbarë ballkanike, evropiane dhe më gjerë. Është folur dhe praktikisht ekziston një substrat indoevropian. Nga fusha e folklorit do të përveçonim motive të përrallave, të baladave, legjendave, anekdotave, fjalët e urta etj., që kanë përbashkësi në popuj të ndryshëm të Ballkanit dhe më gjerë. Pa u ndalur fare në zanafillën burimore të tyre, do të thoshim se në këto përbashkësi ngërthehen edhe dukuri përveçuese, elemente tipike apo të specifikuar, shpirti krijues dhe origjinal i këtij apo i atij populli.

Po kështu, duhet thënë se përgjithësisht në çdo shtet të sotëm të Evropës ka shoqëri multikulturore. Lëvizjet e popullsive në kohë dhe në kushte të caktuara kanë qenë të tilla që kanë çuar në bashkëjetesë të etnive të ndryshme në të njëjtën strukturë administrative, pavarësisht nga raportet numerike të popullsive. Janë realizuar ndërkomunikime, këmbime, marrje dhe dhënie të natyrave të ndryshme.

Të gjitha sa thamë e bëjnë më bindëse idenë se ndërkomunikimet kulturore midis popujve kanë ndodhur në kohë të ndryshme në nivele të caktuara, edhe pa i takuar një përbashkësie drejtuese, ekonomike, politike etj. Mesa duket, marrëdhëniet kulturore kanë qenë më të shpenguarat dhe më të lirat midis popujve të ndryshëm. Pavarësisht nga pranimi i njëjës apo i tjetrës teori, që shpjegon burimin e përbashkësive kulturore midis

popujve, realitet i prekshëm është dukuria e ndërkomunikimit dhe e bashkëjetesës kulturore midis popujve të ndryshëm. E theksojmë këtë pasi mund të shërbejë edhe si një mesazh për ditët e sotme, kur është koha e bashkimeve të mëdha midis vendeve e popujve të Evropës.

Sot integrimi evropian shtron detyra të caktuara në fusha të ndryshme, por edhe përsa i përket integrimin kulturor. Ndryshimet e shumta që kanë ndodhur, strukturat e reja shoqërore që janë krijuar, kanë ndikuar dhe ndikojnë jo vetëm në jetën e njerëzve në përgjithësi. Ato kanë lënë gjurmë edhe në kulturën e popujve që bëjnë pjesë në Evropë; Kanë çuar në gjallërimin apo në shuarjen, në ripraktikimin apo në krijimin e jetës folklorike të çdo populli të saj. Në ditët e sotme midis përbërësve të sistemit kulturor të çdo kombi ka ndryshime themelore. Kjo bën që ndryshimet, të para si zhvillim apo braktisje, shmangie, të jenë të natyrës konfliktore. Kjo vetvetiu çon pastaj drejt një pluralizmi edhe në kulturën ekzistuese të vendeve evropiane. Por, njëkohësisht, kemi, krahas këtyre, edhe ecjen drejt një kulture të homogjenizuar evropiane, ndoshta dhe më gjerë, për shkak të proceseve integruese në përgjithësi që po realizohen gradualisht.

Një njohje më nga afër e faktorëve që ndihmojnë elementet erozivë të globalizmit, do të ofronte dhe marrjen e masave të nevojshme penguese apo parandaluese.

Lind pyetja: “Nëse realizohet përfundimisht integrimi evropian, a do të jetë ky caku i shkrirjes apo i zhdukjes së kulturave nacionale”? Kjo pyetje përbën një shqetësim të drejtë, veçanërisht në popujt që janë më të vegjël. Nëse do të ndodhte një asimilim i rrjedhur nga një bashkim i tillë, kjo jo vetëm që nuk do të ishte normale, por as e pranueshme kur rrezikohet zhdukja e kulturës, pra dhe e identitetit. Mendimi ynë, por dhe i studiuesve të tjerë, jo vetëm shqiptarë, i shprehur në sa e sa organizime veprimtarish shkencore, është se integrimi i vendeve të Evropës, me diversitete kulturore të ndjeshme, do të mund të realizohet, ndër të tjera, duke ruajtur secili popull identitetin e vet kulturor, përveçësitë dhe origjinalitetet e veta. Këto përveçësi, këto origjinalitete përbëjnë atë faktor *determinues*, ku diversiteti kulturor të mund të shihet si element përbashkues.

Niveli i kulturës demokratike dhe respektimi i saj, sa më drejt e më i plotë nga të gjithë faktorët veprues të një shoqërie të tillë të integruar, përcaktojnë përgjigjen e pyetjes sonë të mësipërme. Nëse ka një shqetësim dhe veprim të drejtë lidhur me respektimin e të drejtave të pakicave etnike, përfshirë dhe ato të identitetit të tyre kulturor, në vende të ndryshme, kjo do të thotë se në një bashkim evropian çdo komb do të hyjë me kulturën e vet, të respektuar nga të gjithë popujt e tjerë, në fakt edhe nga politikat e

niveleve drejtuese. Sa më mirë të njihet kultura e çdo populli, sa më natyrshëm të krijohen lidhjet ndërballkanike e mbarevropiane, duke ruajtur individualitetet e formuara dhe duke u çliruar nga paragjykimet e pikësnyimet nacionaliste, aq më normalisht do të realizohet edhe integrimi evropian.

Kulturat nacionale, me vlerat e paçmueshme autentike që ka çdo popull evropian, do të ishin ndihmesë për integrimin, por duke ndjekur një sërë rrugësh të efektshme për njohjen sa më nga afër të kulturave reciproke të popujve të ndryshëm, dhe në radhë të parë, të atyre fqinjë. Kjo do të shërbente për t'i afruar më shumë popujt midis tyre, për një vlerësim edhe më të madh, edhe më bindës të përmasave krijuese artistike shpirtërore e materiale, të përbashkësive e origjinaliteteve. Kështu, kultura, pavarësisht nga diversitetet që realisht ekzistojnë në popujt e ndryshëm, në këtë rast do ta jepte më natyrshëm këtë ndihmesë në integrimin evropian.

Dihet se shqiptarët, në kushte e në rrethana shumë të vështira, e kanë krijuar, përcjellë e pasuruar vazhdimisht folklorin e tyre. Ai ka shërbyer në shekuj si mjet identifikimi dhe individualizimi. Po kështu, folklori ka shërbyer edhe si një potencial i fuqishëm me vlera të spikatura për krijimin e një hapësire unike shqiptare, duke iu kundërvënë, kudo që kanë jetuar dhe jetojnë shqiptarët, përpjekjeve asimiluese apo dhe proceseve të natyrshme vetëmënjauese kombëtare. Në kompleksitetin e faktorëve ndikues dhe përcaktues edhe folklori ka dhënë ndihmesën e vet për të ruajtur dhe për të mbajtur të gjallë, për të përforcuar ndërgjegjen kombëtare dhe për të dëshmuar identitetin kombëtar shqiptar.

Brezat paraardhës na e sollën krijimtarinë e tyre folklorike, nëpërmjet rrugës gojore, dhe ne na takon detyra për ruajtjen, mbledhjen, sistemimin, botimin dhe studimin shkencor të kësaj pjese të rëndësishme të trashëgimisë sonë kulturore shpirtërore. Përcaktimi dhe ruajtja e individualitetit shqiptar nëpërmjet folklorit mendojmë se duhet të jetë një nga përparësitë e politikës kulturore të mbarë organizmave shtetërorë e privatë. Me fjalë të tjera, do të thoshim se detyra e jonë në ditët e sotme është përpjekja e përgjegjshme për të bërë gjithçka të mundshme për të ruajtur autenticitetin folklorik të krijimtarisë sonë popullore, pa e denatruar dhe shkapërderdhur atë, për asnjë motiv. Hapja e Shqipërisë ndaj botës, krahas anëve pozitive, që janë të qarta për të gjithë, ka sjellë dhe le të hapur mundësinë e ndikimit negativ, e bjerrjes dhe e shmangies së folklorit tradicional, të pasur e të larmishëm.

Zvjerdhja nga folklori, veçanërisht në kushtet e sotme të shoqërisë shqiptare, është me pasoja të dëmshme. Mania vetëm për të huajën, duke shpërfillur tënden, të lë pa individualitet. Por, nga ana tjetër, pasuria

folklorike shqiptare, si dhe e gjithë kultura shqiptare në përgjithësi, dhe kultura e huaj nuk duhen parë dhe nuk duhen vënë për asnjë moment në një raport të tillë, sikur ato e kundërshtojnë dhe e përjashtojnë krejtësisht njëra-tjetrën. Ato mund të ecin dhe le të ecin krahas, por ne si shqiptarë, së pari, të mbajmë gjallë vlerat tona të papërsëritshme folklorike, ta bëjmë bashkëkombasin që emocionalisht të ndjehet krenar, edhe përmes folklorit, se është shqiptar.

Realisht sot në Shqipëri folklori paraqitet si kulturë e kaluar dhe si kulturë e tashme. Krijimet folklorike, në intensitete të ndryshme, sipas llojit e zhanrit apo sipas krahinave etnofolklorike, bëjnë ende jetë të gjallë e aktive në mjediset shqiptare. Ato janë të pranishme në raste e në praktika të ndryshme, si p.sh., në festa e në gëzime familjare e shoqërore.

Tradicionalisht folklori në Shqipëri ka qenë formacioni i vetëm i jetës kulturore të popullit. Me lindjen dhe me zhvillimin e formacioneve të tilla si arti i kultivuar dhe ai amator, kuptohet se gradualisht vendi i folklorit në jetën e përditshme të shoqërisë shqiptare ka pësuar rrudhje. Realiteti i sotëm folklorik në Shqipëri jep një tablo të tillë: janë ruajtur dhe praktikohen një sërë krijimesh tradicionale në lloje e në zhanre të ndryshme; një pjesë e krijimeve tradicionale janë pasuruar me elemente të reja për arsye të natyrave të ndryshme; janë krijuar dhe vazhdojnë të krijohen një numër krijimesh të reja në lloje e në zhanre të ndryshme.

Kjo situatë folklorike mbart me vete dhe problemin e ruajtjes ose jo të autenticitetit folklorik, pasi, krahas veprimit të spontaneitetit dhe të rregullive folklorike, ndjehen edhe ndërhyrje të papranueshme që nuk e lënë folklorin të lirë në zhvillimin normal, në rrugën e vet të zakonshme. Ky problem shtrohet jo vetëm për krijimet e reja, por edhe për ato tradicionale. Por pasojat negative për folklorin janë të pranishme në realitetin shqiptar, të ardhura dhe në rrugë të tjera. Krahas sa u tha, mund të përmendim shkurtazi grupe pseudofolklorike, regjistrime (kaseta, video, CD etj.) dhe botime të krijimeve të ndryshme gjoja me burim folklorik.

Njohja e nxjerrja në pah, si dhe ndërgjegjësimi më i përgjithshëm i bashkësive të shqiptarëve me gjetjen dhe vlerësimin e folklorit shqiptar është një rrugë shumë e rëndësishme, për shprehjen dhe për ruajtjen e kulturës kombëtare shqiptare, jo me qëllim përveçimi a izolimi, por për të pohuar se çfarë na bashkon dhe çfarë na ndan me popujt e tjerë të Evropës. Vetëm pasi të jetë realizuar një kërkesë e tillë, si detyrë parësore, mund të flitet dhe të bëhen hapa edhe për procesin e integritimit.

Në këto kushte rritet edhe më shumë përgjegjësia e përgjithshme e shoqërisë shqiptare për të ruajtur folklorin e vet autentik dhe për ta përcjellë

jo vetëm për brezat e ardhshëm, si një dëshmi krenarie dhe identiteti, por edhe për t'ua dëshmuar popujve të tjerë si një trashëgimi, por edhe pjesë përbërëse e kulturës evropiane.

Jemi të mendimit se është detyrë e dorës së parë për mbledhësin e folklorit, për botuesin, organizatorët e veprimtarive folklorike, për transmetuesit radio televizivë etj., organizma të përafërta, që të sqarojnë e të përcaktojnë vlerat e mirëfillta të çdo krijimi që regjistrohet apo paraqitet. Kjo arrihet duke peshuar dhe diferencuar origjinalin nga e përshtatura, duke realizuar integrimin e faktit folklorik në gjirin e traditës ose duke e përjashtuar atë prej saj, duke përcaktuar mjediset kulturore nga vjen ky apo ai krijim, duke zbuluar përmasat dhe realizimin konkret të përtëritshmërisë dhe të improvizimit.

Në kushtet e ekonomisë së tregut është e pamundur të ndërmerren ligjërisht ndërhyrje ndaluese, për të mos lejuar apo për të penguar shfaqjen e dukurive negative që i përmendëm më lart. Përballimi i një situatë të rënduar, me pasoja negative, në kahe të ndryshme, për sot e për nesër, mendojmë se kërkon hapa energjikë nga organizmat shtetërorë, nëpërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve, për të krijuar hapësirat e nevojshme konkurruese të folklorikes me pseudofolkloriken.

Për të mos u zgjatur në këtë shtjellim, do të mjaftoheshim duke përmendur vetëm një mundësi. Në pika të ndryshme shitjeje të incizimeve të ndryshme gjenden gjithfarë llojesh, shpesh herë pa nivel, imitime a përkthime, intonacione joshqiptare që shiten për të tilla. Mendojmë se një situatë e tillë do të mund të ndryshonte për mirë nëse do të mundësohej prodhimi cilësor dhe me kosto më të lirë i incizimeve folklorike të përzgjedhura. Në këtë mënyrë jo vetëm që do të konkurroheshin prodhimet jocilësore, por do të ndikohej seriozisht në mosprishjen e shijes së publikut më të gjerë, veçanërisht të brezit të ri.

Është pikërisht një mundësi e tillë e dëmshme, kryesisht për popujt më të vegjël, ajo që e ka shtyrë organizmin ndërkombëtar prestigjioz të UNESCO-s të shpallë mbrojtjen e kulturës popullore jomateriale, ku përfshihet edhe folklori. Në rekomandimet e UNESCO-s theksohet një gjë e tillë: *“Qeveritë duhet të luajnë rol vendimtar në ruajtjen e folklorit dhe se ato duhet të veprojnë sa më shpejt që të jetë e mundur”*.

Realisht shteti shqiptar që pas vendosjes së pluralizmit deri më tani, me tendencë rritjen e përgjegjësisë së vet ndaj folklorit, ka kryer një sërë veprimesh që shprehin, të paktën, dëshirën e mirë. Mund të sjellim në kujtesë ligjin për trashëgiminë shpirtërore, organizimin e 3 festivaleve folklorike kombëtare, funksionimin e Qendrës Kombëtare të Veprimtarive

Folklorike, kryesisht përmes 5 festivaleve dhe takimeve tipologjike për çdo vit etj.

Do të ndaleshim shkurtimisht tek një problem shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me ndërkomunikimin e vlerave të mirëfillta folklorike midis shqiptarëve dhe pakicave etnike që jetojnë në Shqipëri. Theksojmë, së pari, se ky ndërkomunikim është i nevojshëm nisur nga koncepti ynë se ndërkomunikimi i vlerave folklorike përbën një moment të rëndësishëm, mesazh njohjeje, harmonie, mirëkuptimi, respekti e dashurie. Këta banorë të një shteti, pavarësisht nga raportet numerike, në bashkëjetesë relativisht të gjatë midis tyre, kanë dhënë e kanë marrë me njëri-tjetrin. Njohja reciproke nga afër edhe e krijimtarisë folklorike do të shërbente për t'u afruar më shumë shqiptarët me pakicat etnike në Shqipëri, do të bënte një vlerësim edhe më të madh dhe më bindës të përmasave krijuese artistike shpirtërore, të përbashkësive e të origjinaliteteve.

Tabloja paraqitet e njëjtë apo e përafërt në vende të tjera, në rajone të ndryshme të botës. Ndaj, për të mos ndodhur apo për të mos vazhduar më tej një situatë e tillë, shumë e rrezikshme, që mund të mënjanojë gradualisht folklorin, UNESCO-ja rekomandon marrjen e masave të cilat do të mund të garantojnë statusin dhe mbështetjen ekonomike për traditat folklorike. Në këtë përcaktim do të përfshinim, së pari, edukimin e përgjithshëm të shoqërisë shqiptare me kuptimin dhe me vlerat që bartin traditat folklorike. Mendojmë se me dashamirësi, me përpjekje të përbashkëta, mund të realizohen punë cilësore, pa komplekse që mund të burojnë nga konfliktime ndërnacionale të kohëve të kaluara në Ballkan. Kjo do të ishte rruga më e përshtatshme dhe më e drejtë për t'u ndjekur në të gjitha vendet e rajonit tonë Ballkanik, të trazuar historikisht, me probleme të shumta ndërnacionale. Integrimi i tyre në shoqërinë e civilizuar dhe të bashkuar evropiane kërkon, ndër të tjera, ruajtjen e mëvehtësive kulturore nacionale, të identitetit kulturor jo vetëm të kombeve në përgjithësi, por edhe të pakicave etnike që jetojnë në vende të ndryshme.

Do të theksonim se, në të gjithë këtë proces ndërkomunikues të folklorit të popujve të ndryshëm, duke shmangur vetëpërfshirjet apo vetëmënjanimet në kohë, nisur nga interesa ridimensionalizimi, është e domosdoshme edhe përfshirja e studiuesve, specialistë të folklorit, në vende të ndryshme. Ata, me formimin dhe me përgjegjësinë e tyre, të prirë në radhë të parë nga interesa shkencore, pa u vënë në shërbim të politikanëve apo të ideve nacionaliste, mund të ndriçojnë dhe të pasqyrojnë situatën që pasqyron vetë lënda e studimit të tyre. Por për këtë, krahas

punëve të mbyllura brenda institucioneve shkencore të çdo shteti, është e nevojshme edhe një hapësirë bashkëkomunikimi e bashkëveprimi.

Një gjë e tillë mund të realizohet përmes rrugësh të ndryshme. Ndër të tjera, mund të përmendim: organizimin e veprimtarive shkencore të përbashkëta; hartimin e projekteve gjithpërfshirëse, siç mund të jetë kompjuterizimi i lëndës folklorike me kritere të njësura dhe të përshtatura; botimin në lloje e në zhanre të ndryshme folklorike, fillimisht në nivel përfaqësimi ballkanik (ndër të tjera, hartimi i katalogëve të përrallave, legjendave, baladave etj.); këmbimin e informacioneve; realizimin e ekspeditave kërkimore-shkencore të përbashkëta; zhvillimin e sa më shumë festivaleve folklorike ndërkombëtare, mbi bazën e platformave shkencore të hartuara nga folkloristët etj.

Sa më mirë të njihet kultura e çdo populli, sa më natyrshëm të krijohen ndërlidhjet midis popujve të ndryshëm, duke filluar me ata fqinjë e më tej dhe me ata evropianë, duke ruajtur mirëfilltësinë e individualiteteve të formuara dhe duke u çliruar nga pikësynimet nacionaliste, atëherë normalisht do të realizohet edhe integrimi evropian.

Folklori i traditës sot përgjithësisht e ka rrudhur aktin e vet të praktikimit, ndaj dhe i duhet mëshuar domosdoshmërisë së konsolidimit të tij. Ruajtja dhe pasurimi i arkivit folklorik kombëtar, me qëllim që të shërbejë gjithnjë për cilindo të interesuar, është një bazë e padiskutueshme. Tek ne këtë funksion e ka përmbushur deri në një fare shkalle Instituti i Kulturës Popullore, sot Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit në Tiranë. Megjithatë, në këtë arkiv nuk është e përfshirë krijimtaria folklorike e gjithë hapësirës folklorike shqiptare. Nga ana tjetër, është e nevojshme që edhe në këtë arkiv ekzistues të realizohet sa më parë katalogizimi dhe kompjuterizimi qendror, që të mund të shfrytëzohet dhe të jetë i hapur për të gjithë.

Edhe masat e rekomanduara nga UNESCO-ja i shërbejnë mbrojtjes së folklorit si krijim intelektual brenda e jashtë vendit, si dhe një bashkëpunimi të organizuar ndërkombëtar. Disa nga momentet më të rëndësishme të rekomandimeve, që janë të prekshme për realitetin folklorik shqiptar janë: kërkesa për të hartuar dhe për të futur në kurrikulat shkollore dhe jashtëshkollore mësimdhënien dhe studimin e folklorit, në atë mënyrë që të dalë në pah respekti për folklorin në kuptimin më të gjerë. Në Shqipëri nuk i është dhënë përgjigjia e duhur dhe nuk i është kushtuar vëmendja e nevojshme kësaj ane. Përgjithësisht njohja e folklorit në shkolla bëhet shumë e sipërfaqshme, fillon në klasat e larta të arsimit nëntëvjeçar, me dhënien e disa poezive popullore dhe vazhdon me disa orë rreth folklorit në klasën e parë të shkollës së mesme. Në këta kufij është fillimi

dhe mbarimi i dhënies së folklorit në shkollat tona. Kaq mendoj se është krejtësisht e pamjaftueshme. Për më tepër, edhe lënda e servirur nuk është e përgatitur nga specialistë të fushës.

Jepet diçka nga lënda e folklorit gjatë një simestri edhe në shkollat e larta, në degën gjuhë shqipe – letërsi, por ajo është shumë pak. Mësuesit e ardhshëm nuk përgatiten të tillë, që nesër të jenë përcjellës të dashurisë për folklorin, si nxitës dhe përçues tek nxënësit të praktikimit të krijimeve folklorike, pasi ata si mësues, përgjithësisht nuk janë në gjendje t'i praktikojnë krijimet folklorike. Nuk ka se si të jetë ndryshe kur këtë lëndë përgjithisht e japin pedagogë të letërsisë, që plotësojnë orët e përgjithshme të mësimdhënies.

Kur pikërisht me këta parametra jepet informacioni për folklorin në shkollat tona, është e kuptueshme se çfarë mund të thuhet për folklorin e pakicave etnike që jetojnë në Shqipëri. Sipas UNESCO-s duhet që edhe tek ne të propagandohet edhe diversiteti kulturor që ekziston realisht. Kam parasysh këtu se si në Shqipëri, edhe në shtete të tjera krahas kulturës zotëruese, janë të pranishme dhe kultura të pakicave etnike.

Një rekomandim tjetër i UNESCO-s ka të bëjë me ngritjen nga çdo shtet të një Këshilli Kombëtar për Folklorin mbi baza ndërdisiplinore apo të një organizmi të ngjashëm koordinues. Çfarë do të kryente ky këshill? Nëse do të bënim një analogji, për gjuhën standarde shqipe ekziston një komision pranë Këshillit të Ministrave, që ka për detyrë, ndër të tjera, realizimin konkret të saj në të gjitha nivelet. Mendoj se duke u marrë në konsideratën e duhur, në të njëjtin pozicion duhet të jetë edhe ky Këshill Kombëtar për Folklorin, i cili do të duhej të organizonte, të koordinonte dhe të drejtonte, në nivelin e konceptimeve, të parimeve më të përgjithshme, punën për mbrojtjen e folklorit në Shqipëri. Duhet thënë se një organizëm i tillë tashmë është ngritur pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, por deri më sot është realizuar vetëm një takim dhe kaq. Mendojmë se përveç mosfeksionimit të mirë, një Këshill i tillë nuk duhej të ishte nën vartësinë e kësaj Ministrie, por të funksiononte pranë Këshillit të Ministrave. Një gjë e tillë do ta rriste së tepërmi autoritetin dhe mirëfeksionimin e këtij Këshilli të domosdoshëm.

Një detyrë shumë e rëndësishme dhe që nuk duhet nënvlerësuar aspak nga shteti shqiptar është dhënia e mbështetjes morale dhe ekonomike si për individë, ashtu dhe për institucione studimore, që mbledhin, ruajnë, botojnë dhe studiojnë folklorin shqiptar dhe atë të pakicave, një stimul konkret ky që i shërben gjithashtu kësaj çështje shumë të rëndësishme...

BIBLIOGRAFI:

1. A. Dusha, *Folklori në kontekstin e tranzicionit socio-kulturor*, “Seminari II Ndërkombëtar i Albanologjisë”, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, 2008, f. 634-642.
2. A. Xhagolli, *Integrimi evropian dhe folklori në Shqipëri*, “Gjurmime albanologjike – Folklor dhe etnologji”, 37-2007, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2008, f. 189-201.
3. L. Kadriu, “Glokalizimi - perceptime etnokulturore”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2009, “Recommendation on the Safeguarding of Traditional Culture and Folklore”, Adopted by the General Conference at its twenty-fifth session, Paris, 15 November, 1989.
4. U. Xhema, *Etnokultura dhe fenomeni i globalizimit*, “Shtresime kulturore”, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2005, f. 379-402.

Albanian folk heritage in European context**SUMMARY**

Recognition of highlights, as well as more general awareness of the Albanian community in finding and evaluating Albanian folklore, is a very important way to express and to maintain the Albanian national culture, to make steps for the process of European integration .

Vinçens MARKU

**MJESHTËRI PËRKTHIMORE NË SHQIP E VARGUT
ALEKSANDRIN NGA PROKOP GJERGO PËRMES
VEPRËS *ARTI POETIK* TË NIKOLA BUALOSË**

Përkthimet kanë qenë vazhdimisht një gur prove i rëndësishëm për të parë evoluimin e aftësisë shprehëse të një gjuhe. Krenari e një gjuhe ka qenë vazhdimisht përkthimi i veprave të Homerit, Dantes, Shekspirit e të tjerë autorë të rëndësishëm të kulturës letrare dhe filozofike mbarënjerëzore. Sprovat e para të përkthimit të *Iliadës* në gjuhët moderne janë quajtur suksese të padiskutueshme të gjuhëve pritëse, madje përkthimet homerike janë parë edhe si një pasurim i shprehësisë së gjuhës, duke e kthyer atë të aftë të takohet me gjuhën e lartë të Homerit. Kështu është vlerësuar prej studiuesve edhe përkthimi i saj i plotë në shqip nga prof. Gjon Shllaku. Gjuha shqipe, sidomos pas shpalljes së Pavarësisë, është përballur vazhdimisht me nevojën e përkthimit të teksteve të ndryshme nga të gjitha fushat e dijes. Dëshira këmbëngulëse e shqiptarit për t'u gjendur përkrah popujve të qytetëruar në rrugën e zhvillimit të njeriut, e ka çuar atë t'i drejtohet përkthimit të kryeveprave të shkëlqyera të letërsisë evropiane dhe botërore, të cilat në vetvete janë arritjet më të mëdha të vetë njeriut në lëvrimin e botës shpirtërore dhe tani janë kthyer në pasuri të mbarë njerëzimit.

Pikërisht rrugës emancipuese të shqiptarit përmes prurjeve të përkthimeve nga kryeveprat e letërsisë botërore i bashkohet edhe një ndihmesë e rëndësishme përkthimore e përkthyesit/poet Prokop Gjergo, i cili ka sjellë në shqip 49 vepra që kapin shifrën e 75128 vargjeve¹⁴³, sipas studiuesit Sali Hidri. Veprat më të rëndësishme që mund të përmendim këtu janë përkthimet: *Sidi* i Kornejt, *Tartufi* i Molierit, *Andromaka* e Rasinit dhe vepra poetike dhe teorike *Arti poetik* i Bualosë, që është njëkohësisht traktat doktrinor teorik i klasicizmit francez dhe i neoklasicizmit evropian. Pikërisht kësaj të fundit do t'i marrim në analizë forcën përkthimore

¹⁴³ Hidri, Sali. *Një jetë e jetuar. Poeti dhe përkthyesi Prokop M. Gjergo*. Botimi i dytë, f. 107. Argeta-LMG, Tiranë, 2009.

mjeshtërore, me të cilën Gjergo ka dëshmuar edhe njëherë talentin e tij prej përkthyesi cilësor, por mbi të gjitha ka dëshmuar aftësinë e shqipes për të dhënë me zhdërvjelltësi artin dhe mendimin e njërit prej njerëzve më elegant të letrave franceze dhe botërore, Nikola Bualosë.

Vepra *Arti poetik* (Arte poetique) e Nikola Bualosë (Nicolas Boileau) përbën, ndoshta, arritjen më të madhe teorike letrare të shekullit XVII në Francë dhe përgjithësisht në Evropë. Ajo është një prodhim i një kulture elitare të kohës, që kërkon t'i kushtëzohet mjeshtërisë së poezisë. Fryt i një France në shkëlqimin dhe në prirjen e saj të vazhdueshme, të kësaj periudhe, për t'i diktuar botës së qytetëruar mbisundimin kulturor të gjithanshëm. Fryma e veprës, siç duket, veçansohet pikërisht nga ajo frymë kulturore mbisunduese në Parisin e Luigjit XIV. Këtu zë fill edhe doktrina letrare e Bualosë. Franca e kësaj kohe qendërzon dhe njëjtëson vetveten me Parisin, rreth shkëlqimeve dhe jetës mondane të aristokracisë. Bualo është vetë prodhim i kësaj kulture. Qendërzimi i qytetërimit çon në qendërzimin e artit dhe të mjeteve që e shprehin atë. Poezia parisiane nuk mund të ishte si ajo e provincës. Shijet i duheshin përshtatur zhvillimit dhe këtij qytetërimi, e duhej patjetër meqë kjo gjë i vinte në ndihmë mbretit. Liritë jashtë vullnetit të pallatit mbretëror ishin të pakta, e këtë e ndien shumë herë edhe Bualo.

Parimet estetike të kësaj vepre mbështeten kryesisht te vetëdija letrare e kohës, te teknikat e krijimit të poezisë, sidomos duke u mbështetur mbi traktatet klasike të njohura, si: *Poetika* e Aristotelit, *E madhërishmja* e Pseudo-Longinit e veçanërisht tek *Arti poetik* i Horacit. Traktati i parë do të ndihet përmes frymës racionale të interpretimit të artit si prodhim i mendjes, i dyti nën frymën platoniane të Longinit mbi artin, ndërsa e treta do të huazohet shumë herë për t'i ardhur në ndihmë pikërisht parimësisë së Bualosë mbi teknikën e poetizimit.

Bualo përdori në poezinë e tij vargun aleksandrin. Fillesat e emërtimit të këtij vargu janë mjaft të dyshimta, megjithatë mund të themi se dy janë burimet kryesore nga të cilët ka marrë emrin ky varg: i pari dhe ndoshta më i besueshmi është emri i poetit francez të shekullit XII Aleksandër i Parisit¹⁴⁴ ose i njohur ndryshe Aleksandri i Berneit, i cili shkroi veprën e tij *Romani i Aleksandrit* (*Roman d'Alexandre*), ku trajtonte bëmat e Aleksandrit të Madh në një varg dymbëdhjetërokësh; i dyti, dhe me më pak gjasa, është emri i vargut të përdorur nga poetët francez të shekullit XII për të rrëfyer ngjarjet që kishin të bënin me Aleksandrin e

¹⁴⁴ Holman, G. Hugh; Harmon, William. *A handbook to literature*, f. 10. Macmillan Publishing Company, New York, 1986, USA.

Madh. Studimet filologjike në lidhje me origjinën e këtij vargu ende deri më sot nuk kanë dhënë një interpretim të saktë dhe të mirëpranuar nga të gjithë studiuesit, edhe pse, duhet theksuar këtu, dy burimet e përmendura më sipër janë pranuar si origjina të mundshme. Emërtimi si aleksandrin i këtij vargu filloi të njihej aty nga shekulli XIV dhe si varg aleksandrin klasik u quajt vargu i përdorur nga autorët e shekullit XVI, veçanërisht autorët e Plejadës¹⁴⁵ dhe më pas nga dramaturgët e mëdhenj, si Kornej dhe Rasin, por që u teorizua nga Bualo tek *Arti Poetik* në vargjet 105-106 të këngës së parë:

*Que toujours dans vos vers // le sens, coupant les mots
Suspende l'hémistiche, // en marque le repos.*¹⁴⁶

Përkthimi nga Gjergo:

*Në vargjet tuaja kuptimi, // duke prerë ligjërimin,
Të ndalë hemistikun // e të shënojë pushimin.*

Një përkthim fjalë për fjalë do të vinte në shqip kështu:

*Që gjithnjë në vargjet tuaja // kuptimi, duke prerë fjalët
Të pezullojë hemistikun, // të shënojë pushimin.*

Në italisht është përkthyer në prozë nga Patricia Opiçi¹⁴⁷ kështu:

*che sempre nei nostri versi il senso, spezzando il corso delle
parole, sospenda l'emistichio e segni una pausa.*

Në shqip nga italishtja do të vinte kështu:

*“Që gjithnjë në vargjet tuaja kuptimi, duke këputur rrjedhën
e fjalëve, veçojë hemistikun dhe të shenojë një pushim.”*

¹⁴⁵ Cuddon, J. A. *Dictionary of literary terms and literary theory*, f. 21, The Penguin books, London, 1991, England.

¹⁴⁶ Boileau, Nicolas. *L'Art poétique*, Chant I.

¹⁴⁷ Boileau, Nicolas. *Arte poetica*, f. 49, përktheu nga frëngjishtja në italisht dhe e pajisi me shënime Patrizia Oppici, *Hyrja Fausta Garavini*, Marsilio, Venezia, 1995, Itali.

Ky varg është i përbërë nga dy hemistikë heksasilabik (gjashtërokësh), të cilët ndahen nga njëri-tjetri me një cezurë të fortë. Në gjuhën tonë ky varg është përshtatur nga Asdreni dhe Poradeci në sonetët e tyre¹⁴⁸. Në shqip theksi i fjalës, ndryshe nga gjuha frënge që bie zakonisht në fund të fjalës, është parafundor dhe si rrjedhim hemistikët nuk mund të jenë gjashtërokësh, por shtatërokësh për të drejtpeshuar gjatësinë e vargut aleksandrin. Siç dihet në numërimin e rrokjeve të një vargu merret parasysh theksi mbi fjalën e fundit të vargut ose të hemistikut, të cilat zakonisht në frëngjisht kanë një theks fundor e si rrjedhim mund të numërohet me një rrokje më tepër. Pra i bie që në shqip, meqenëse fjalët janë zakonisht me theks parafundor, ky varg të përkthehet me 14 rrokësh me theksa në rrokjen e gjashtë dhe të trembëdhjetën, ndërsa në frëngjisht ky theks bie në rrokjen e gjashtë dhe të dymbëdhjetë.

Përkthyesi Prokop Gjergo, duke njohur mirë mjeshhtërinë e përkthimit të poezisë klasike franceze, njëkohësisht i pajisur mirë me kulturën klasike franceze dhe evropiane e mbi të gjitha i ndihmuar nga një dhunti poetike gjithmonë e gjallë, ka arritur të kthejë në gjuhën tonë një nga traktatet poetiko-teorike më të njohura në të gjithë historinë e letërsisë botërore. Ja si i jep në shqip dy vargjet e para hyrëse të kësaj vepre:

*C'est en vain qu'au Parnasse || un téméraire auteur
Pense de l'art des vers || atteindre la hauteur.*

Në shqip nga Gjergo:

*Më kot një autor i krisur, || mes artit t'poezisë,
N'Parnas mendon t'arrijë || në kulm të lartësisë:*

Një përkthimi semantik i këtyre vargjeve është:

*Më kot një autor i krisur në majë të Parnasit,
Mendon të arrij me artin e vargjeve.*

Ka arritur të sjellë bukur jo vetëm teknikisht këtë varg, duke kërkuar të ruajë rimën emërore dhe saktësinë e rrokjeve, por mbi të gjitha i ka dhënë hijeshi vargut përmes shprehësisë poetike, e cila ka plotësisht

¹⁴⁸ Leka, F.; Podgorica, F.; Hoxha, S., *Fjalorë shpjegues i termave të letërsisë*, f. 246, redaktor F. Leka, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Sektori i Terminologjisë, Tiranë, 1972.

natyrshmërinë e gjuhës pritëse, thuajse një krijim në gjuhën tonë. Të befason shumë sesi ka arritur të ngjizë në rrafshin semantik të prerë të një ligjërimi elitari dhe stilin poetik të Bualosë. Për ta konkretizuar më mirë le të shohim si e kanë sjellë në gjuhën e tyre anglezët me Sër Uilliam Sëumz dhe Dridën më 1710, të cilët kanë synuar një përkthim interkulturore:

*Rash Author, 'tis a vain presumptuous Crime
To undertake the Sacred Art of Rhyme;*¹⁴⁹

Semantikisht mund të jepet pak a shumë kështu:

*Autor i krisur, është një mëkat krenar i kotë
Të ndër marrësh artin e shenjtë të rimës;*

Nuk duhet të harrojmë këtu se Gjon Dridën është pa dyshim një ndër poetët më të mirë anglezë të kësaj periudhe dhe se ky përkthim vazhdon të mbahet edhe sot si një ndër përkthimet më të arrira të Bualosë në anglisht. Siç shihet është ruajtur fryma e idesë, poetika, stili, por jo metri dhe fjala “Parnas”. Te dy këto elemente, pra metri dhe fjala “Parnas”, të çojnë te klasicizmi francez dhe dëshira e tyre për të qenë imitues të artit klasik antik.

Një version tjetër i përkthimit në anglishten moderne i kohëve të fundit është ai i Prof. Bërtën Rafel i Universitetit të Luizianës, i cili i ka sjellë këto vargje kështu:

*Rush writers, thinking verse an easy road,
Rush up Olympus toward the sacred groove.*¹⁵⁰

Një përkthim semantik do të ishte:

*Shkrimtarë të ngutshëm, duke menduar vargun një rrugë të lehtë,
Mësyjnë Olimpin përgjatë lugajës së shenjtë.*

Edhe këtu notojmë përsëri në të njëjtat ujëra, por duhet theksuar se ky përkthim ka synime të tjera nga ai i Dridënit. Përpiqet të jetë më i saktë

¹⁴⁹ Soames, Sir William. *Art of poetry*. I rishikuar nga Dryden, vagjet 1 dhe 2 të këngës I. H. Hills, London, 1710.

¹⁵⁰ Boileau, Nicolas. *Selectetd poems*. Përkthyer në anglisht nga Burton Raffel. Yale University Press, 2007.

nga ana semantike, duke ruajtur sa më shumë që të jetë e mundur ngjashmërinë me origjinalin dhe ngjyresat e holla të koncepteve të Bualosë.

Në italisht kjo vepër është sjellë në prozë kohët e fundit nga përkthyesja Opiçi, përkthim i cili krejtësisht filologjik, ku rëndësi i jepet peshës kuptimore të secilës fjalë dhe shprehjeve dhe ngjyresave që ajo kishte në përdorimin e Bualosë. Për të ruajtur krahasimin me dy përkthimet angleze, japim më poshtë pikërisht dy vargjet e para të këngës së parë të përkthyer në prozë:

Invano l'autore temerario s'illude di raggiungere con l'arte dei suoi versi la cima del Parnasso.

Më kot autori i krisur mendon të arrijë me artin e vargjeve të tij majën e Parnasit.

Përkthim korrekt nga ana gjuhësore, por duke mos e lënë mënjanë edhe shprehësinë e tekstit poetik dhe veçanërisht domethëniet e rëndësishme të traktatit, të cilat kërkojnë të jenë pika orientuese për poetin. Përkthime të kësaj natyre tashmë kanë zënë një vend të rëndësishëm në kulturën përkthimore evropiane.

Për sa i përket vargut aleksandrin në shqip nga Gjergo duhet thënë se është lëvruar në të gjithë përmasën e tij dhe shfaqet në përkthim në të gjitha llojet e tij, si 14-rrokësh, si 13-rrokësh dhe 12-rrokësh. Vargu 14-rrokësh zë pjesën dërmuese të vargjeve, gjithnjë i ndarë në dy hemistikë shtatërrrokësh me një cezurë në mes. Vargu 13-rrokësh është përdorur në dy lloje, pra kur hemisktikë i parë është gjashtërrrokësh me theks në rrokjen fundore të tij, p.sh., vargu 26 i këngës së dytë: "*Prandaj merrni model // Virgjin dhe Teokritin.*" dhe hemistiku i dytë në shtatërrrokësh me theks parafundor, por edhe anasjelltas, p.sh., Vargu 12-rrokësh i pakët, por i ndërtuar me dy hemistikë ku bie theksi te rrokja e gjashtë, p.sh., vargu 31 i këngës së parë: "*Kur jemi në fillim, || hasim vështirësi,*" dhe vargu 231 kënga I:

E për t'i dhënë fund // me një shaka disi:

Budallai gjen ta çmojë || një më i marrë ng'ai.

Mjeshtresë së thurjes së këtij vargu në shqip nga Gjergo, i shtohet njëkohësisht edhe loja me rëniën e tingujve: si aferezë, sinkopë dhe apokopa, dhe shtimi i tingujve brenda fjalës si, epenteza. Cezura është e pranishme në çdo varg, në të cilën pushimi bie në funksion të kuptimit. Intonacioni gjithashtu ruan tonin e qëndrimit kritik dhe satirik të autorit. Stili është i njëjtë me atë të veprës origjinale, veçmas në përzgjedhjen e fjalëve poetike.

Si përfundim mund të themi se vargu aleksandrin i veprës *Arti poetik* i Bualosë ka ardhur në shqip mjeshtërisht nga përkthyesi i njohur Prokop M. Gjergo, mjaft i arrirë, nëse e krahasojmë me përkthimet e gjuhëve të tjera të mëdha si, anglishtja dhe italishtja. Ajo që i jep vlerë këtij përkthimi është ruajtja me fanatizëm i vargut aleksandrin, duke respektuar të gjitha cilësitë e vargut aleksandrin francez, veçanërisht vargut aleksandrin të klasicizmit francez të periudhës së Bualosë, dhe aftësia e përkthyesit në shfrytëzimin e energjive të brendshme të gjuhës shqipe për të përcjellë artin e Bualosë në gjuhën tonë.

BIBLIOGRAFI:

1. Boileau, Nicolas. *L'art poétique*. Përgatitur nga Guillaume Picot. Univers des lettres. Paris, 1984.
2. Boileau, Nicolas. *Arte poetica*. Përktheu nga frëngjishtja në italisht dhe e pajisi me shënime Patrizia Oppici. *Hyrja* Fausta Garavini. Marsilio. Venezia, 1995, Itali.
3. Boileau, Nicolas. *Selectetd poems*. Përkthyer në anglisht nga Burton Raffel, Yale University Press 2007.
4. Boileau, Nicolas. *Art of poetry*. Përkthyer nga Sir William Soames dhe i rishikuar nga John Dryden. H. Hills, London, 1710.
5. Cuddon, J. A. *Dictionary of literary terms and literary theory*. The Penguin books. London, 1991, England.
6. Hidri, Sali. *Një jetë e jetuar Poeti dhe përkthyesi Prokop M. Gjergo*. Botimi i dytë, Argeta-LMG, Tiranë, 2009.
7. Holman, G. Hugh; Harmon, William. *A handbook to literature*. Macmillan Publishing Company. New York 1986, USA.
8. Leka, F.; Podgorica, F.; Hoxha, S. *Fjalorë shpjegues i termave të letërsisë*. Redaktor F. Leka. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Sektori i Terminologjisë, Tiranë, 1972.

Prokop Gjerko's proficiency in translating the Alexandrian lines of
the Poetic Art, by Niccolo Bualo

SUMMARY

The essay "*Translating skilfulness in Albanian of the alexandrine verse by Prokop Gjergo through the work The art of poetry of Nicolas Boileau*" by Vinçens Marku treats the difficulty of translating this work and the capacity of translator to manage it. It is given also the comparison between the translations in English and Italian. The translation in Albanian according to Marku has managed its goal in making Boileau to speak Albanian.

Valbona KARAKAÇI

ANTOLOGJI E LIRIKËS SHQIPTARE, NJË HISTORI E POEZISË SHQIPE NË MINIATURË

Në mesin e viteve '30, Koliqi qe kthyer në një urë kulture mes Italisë dhe Shqipërisë, përmes botimit të *Poetët e mëdhenj të Italisë* antologji në dy vëllime. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, nën kujdesin e po këtij autori dhe Namik Resultit, në Tiranë më 1941, doli nga shtypi *Shkrimtarët shqiptarë*¹⁵¹ (1462-1878). Këto dy botime shtruan rrugën drejt një tjetër vepre “*Antologji e Lirikës Shqiptare*”¹⁵².

Vepra e Giuseppe Schiroit, “*Storia della Letteratura Albanese*”¹⁵³ duhet t'i ketë shërbyer si shtysë e fuqishme autorit për Antologjinë. “*Historia e Letërsisë (poezisë) Shqipe*”, pa bashkëshoqëruesen e natyrshme të saj “*Antologjinë*” (e poezisë shqipe), do të prezantohej e gjymtë përpara lexuesve e studiuesve të huaj. Megjithatë, parimet e përzgjedhjes së autorëve dhe poezive të përfshira në këtë antologji duket të kenë qenë subjektive. Kështu, nëse e konceptojmë antologjinë e Koliqit si një bashkudhëtare të “*Historisë së Letërsisë*” së Skiroit, shoqërimi qëndron vetëm në planin formal.

Duke iu referuar në mënyrë sintetike **hyrjes, bibliografisë dhe komenteve** të *Antologjisë së Koliqit*, natyrshëm arrijmë në konceptin e një “*Historie të Poezisë Shqiptare*” në miniaturë, e cila strukturohet në parime jo të panjohura deri atëhere, të cilat po i parashtrujmë më poshtë:

1. Konstatime mbi fillimet e letërsisë shqipe:

Fillimi është i lidhur ose me letërsinë popullore, ose me dokumentet e para të shqipes së shkruar. Koliqi fillimet i lidh me letërsinë popullore.

2. Periodizimi i letërsisë shqipe në analogji me historinë e popullit shqiptar

¹⁵¹ Dedikuar klasës III-IV të kursit të lartë të shkollave të mesme.

¹⁵² Doli nga botimi më 29 maj 1963 nën kujdesin e shtëpisë botuese *All' Insegna del Pesce, D'oro* e Milanos.

¹⁵³ Histori e Letërsisë Shqipe, botuar më 1959 në Milano.

Kryesisht Koliqi i përmbahet kësaj pike, kur flet për fillimet e letërsisë shqipe. Me Triadën e profet-poetëve e tutje, ai ndalet vetëm në ato ngjarje që kanë ndikuar drejtpërdrejt në letërsinë/poezinë shqipe.

3. Hartimi i monografive për shkrimtarët, duke përfshirë edhe vlerësime për vepra të veçanta

Si parim, ky është ndjekur në shënimet me të cilat lexuesi mund të njihet në fund të antologjisë.

Parimet e hartimit të një “*Historie Letërsie*”, Koliqi i kishte mirëbukur parashtruar në artikullin “*Dy shkollat letrare shkodrane*”, gjë që dëshmon për njohuritë teorike të autorit, por jo domosdoshmërisht respektimin e tyre në praktikë. Prej këtyre parimeve, Koliqi ka zbatuar me sukses:

a. Lidhja e njërit autor me tjetrin:

Kështu autorët në parathënien e antologjisë nuk paraqiten veçmas, por të grupuar;

b. Veprat e autorëve si trashëgimi kulturore:

Rasti i Triadës së autorëve;

c. Ndërlidhja mes ujëdhëve letrare

Autori prezanton dhe përshkallëzon tri rryma në letërsinë shqipe;

d. Parashtrësë e zhvillimit letrar e dituror

Koliqi në hyrjen e *Antologjisë* ka hedhur vështrimin prej studiuesi në një hark kohor, që përfshin tërë letërsinë shqipe;

e. Ndikime të jashtme e të brendshme mbi autorët, qendrat letrare dhe rrymat:

Koliqi kryesisht parashtron rrjedhat historike në proceset letrare dhe deri diku edhe ndikimet e letërsive dhe kulturave të huaja;

f. Kriteri kronologjik:

Ky kriter themeltar është ndjekur nga Koliqi duke e parë letërsinë shqipe si një të tërë pa marrë parasysh (vendin e gjymtyrët e fisit shqiptar ku lulëzuan autorët shqiptarë, toske, gegë, arbëreshë, kosovarë) dallimet në vise e rrethe. Edhe rrymat letrare janë parë jashtë rrjedhës krahinore të autorëve.

Duke gjykuar, që kriteret e mësipërme janë detajizime të tre parimeve kryesore që parashtruar në krye të herës, arrijmë në konkluzionin se në hartimin e parathënies së *Antologjisë*, Koliqi ka ndjekur kriteret e përshkruara në studimin “*Dy shkollat letrare shkodrane*”.

I. LETËRSIA GOJORE:

Për një kohë të gjatë, vëmendja prej studiuesi e Koliqit që përqendruar në mbledhjen dhe vënien në pah të vlerave të letërsisë

popullore. Puna e nisur në Shqipëri, kryesisht në Malësitë e Shkodrës, kishte vijuar në Itali ku ai si drejtues i Institutit të Studimeve Shqiptare, kishte nisur punën për hartimin e korpusit të traditave popullore të shqiptarëve të Italisë.

Letërsia gojore, si pasqyruese e natyrës së popullit shqiptar dhe shpirtit të tij kolektiv, përbënte një humus përfaqësues të tharmit shqiptar në botën e huaj. Përmes saj, kushdo mund të njihte konceptet e shqiptarit për jetën, psikën e tij komplekse, unitetin shpirtëror të këtij populli, mbijetesën e paganizimit, por dhe të besimit në Zot etj.

II. FILLIMET E LETËRSISË SHQIPE NË SHEK. XV-XVII:

Sipas Koliqit, në fillimet e saj letërsia shqipe ka qenë refleksive. Ndërsa, kjo periudhë karakterizohet nga vlera ekstraletërore, kryesisht historike dhe gjuhësore. Si përfaqësues, autori veçon Lekë Matrëngën, Pjetër Budin e Bogdanin, por nuk përmend Buzukun e Bardhin (mbase sepse këta nuk njihen si poetë).

III. SHEKULLI XVIII:

Islami si fe e re, që erdhi bashkë me pushtuesin otoman në Shqipëri, kishte çarë mes Veriut Katolik dhe Jugut Ortodoks, - na shpjegon Koliqi. Ashtu si autorët e parë të Shqipërisë kristiane kishin shkruar latinisht dhe greqisht, ashtu edhe shkrimtarët e parë të Shqipërisë myslimane përdoren mjetin shprehës të Perandorisë Otomane: turqishten dhe persishten. Nga përshtatja me kulturën islame, lind në Shqipëri letërsia e bejtexhinjëve. Si përfaqësues të kësaj letërsie në hyrje të *“Antologjisë”* do të gjejmë Muhamet Çamin, Nezim Frakullën, por nuk përmenden Hasan Zylo Kamberi, Sulejman Naibi, Dalip e Shahin Frashëri etj.

Në Shqipërinë e Jugut, edhe në kohën e sundimit turk kishte një popullsi të përzier folësish shqiptarë, grekë e aromunë. Kisha Ortodokse mbeti shprehësja e qytetërimit grek dhe iu përkushtua tërësisht gjuhës greke si mburojë kulturore kundër pushtuesit islam. Prej këtyre autorëve, që në një kuptim, përfaqësojnë trashëgiminë bizantine dhe traditën ortodokse në shekullin XVIII-XIX disi kalimthi Koliqi përmend vetëm Kostandin Beratin. Ky i fundit, murg ortodoks, vihet në një rresht me Muhamet Kyçykun (Çamin), i cili qe hoxhë. Ndoshta kjo traditë është ajo që është përmendur më pak nga të gjitha në parathënien e veprës së Koliqit. Theodor Haxhifilipi, Vangjel Meksi e Kostandin Kristoforidhi qenë të tjerë lëvruar të shqipes me alfabet grek, por jo poetë.

Në Italinë e Jugut, në këtë periudhë zhvillohej një tjetër degë e shëndetshme e trungut shqiptar, letërsia e arbëreshëve. Kjo letërsi përfaqësonte drejtimin latin, kristian. Pasi ka përmendur emrat e Nikoll Brankatit, Nikoll Filjas e Zef Barkas, Koliqi ndalet duke marrë në shqyrtim poetin e parë të artit reflektiv Jul Varibobën, e në veçanti veprën e tij “*Mbi jetën e Marisë së Virgjër*”.

Deri në këtë fazë të zhvillimit të letërsisë, Koliqi ka ruajtur parimin kronologjik duke i radhitur autorët në analogji me historinë e popullit shqiptar. Në vazhdim, ai do prezantojë grupe autorësh sipas vlerave duke i larguar rendit kronologjik.

IV. TRIADA:

De Rada, Naim Frashëri, Fishta, - seria e poetëve të ndërgjegjshëm, që përbëjnë zërin e kombit. Cili është parimi mbështetës për t’i sjellë këta tre autorë të grupuar në një?

Nëse përmend De Radën, si shembull të përfshirjes së letërsisë arbëreshe në Rilindje, Koliqi lë jashtë Santorin, Darën (junior) e Seremben që i përkasin po kësaj periudhe. Pasi ka folur për Naim Frashërin do të ishte e natyrshme të përmendte edhe emra të tjerë, por në mes të dyve, autori vendos Fishtën si poet kombëtar, përfaqësues ky i shekullit XX. Nëse tek dy të parët bien në sy tipare të romantizmit, Fishta është “paraqitësi më i mirë i realitetit shqiptar”; strukturat formale të tyre janë të ndryshme, por Koliqi me mendje të hollë nuk harron të na vërë në dukeje se edhe besimet s’janë të njëjta.

Mirëpo cilësitë e veçanta të secilit prej këtyre autorëve nuk e kanë penguar Koliqin ta krijojë si të tillë Triadën e vet, e cila është ngjizur sajë supstratit të veprës së këtyre autorëve: **përpyjekja për rizgjimimin e Shqipërisë**, ky është parimi mbështetës për t’i sjellë këta autorë në një Triadë.

Për të përmbushur këtë mision, autori nuk fshihet pas deklaratave romantike, përkundrazi ai thekson që “dasitë” që ekzistojnë mes shqiptarëve janë të pranishme edhe mes shkrimtarëve, por kjo nuk e pengon Koliqin t’i kapërcejë e të krijojë një monument të përbashkët për Triadën, monumentin e shqiptarisë. Sa i përket procedimit estetik, i rëndësishëm është fakti se ky është një proces i ndërgjegjshëm, si rrallëherë në art.

Të tërheqë vemendjen fakti se në parathënie përmenden personalitetet më në zë të Rilindjes, por jo vetë termi Rilindje. Në “Historinë e Letërsisë Shqipe” të 1994 Fishta quhet “poet autentik, i formuar në periudhën e Rilindjes, vazhdues i drejtëpërdrejtë i saj” dhe vendoset në grupin e shkrimtarëve të periudhës së Pavarësisë, në një kohë

që De Rada dhe Frashëri në atë të Rilindjes. Por Koliqi, termin Rilindje e zëvendëson me termin “rizgjim”, rizgjim i traditave të shqiptarëve. Shqipëria ishte aty, ajo s’kishte nevojë të rilindte për të kaluar sërish fazat e zhvillimit jetësor, mjaftonte që dikush ta shkundte nga letargjia e ajo të rishpallte vetveten përmes traditave të saj më të shkëlqyera. Triada e Koliqit që në ballë të këtyre traditave.

V. SKIROI, ÇAJUPI, MJEDA:

Këta janë tre autorët me të cilët Koliqi vijon shkrimin e tij. Vazhdimisht jemi në periudhën e “rizgjimit”, por pasi ka siguruar lexuesin e “*Antologjisë*” se Shqipëria ka hyrë në rrugën e rizgjimit, Koliqi përvijon vlerat e reja letrare.

VI. NGJARJE HISTORIKE QË NDIKOJNË NË HISTORINË E SHQIPËRISË:

Theksuam më parë parimin mbështetës të Koliqit, por i parë ky vetëm në planin letrar, në kuptimin e përpjekjeve të shkrimtarëve për “rizgjinin” e popullit shqiptar. Gjithnjë në shërbim të pasqyrimit sa më tërësor e të qartë të këtij parimi, Koliqi i rikthehet ngjarjeve historike, duke veçuar mes tyre Kongresin e Berlinit, vetëm tre ditë pas themelimit të Lidhjes së Prizrenit, si momentin historik që risjellë në vëmendje rizgjinin e popullit të vet.

Ngjarjet historike i imponohen letërsisë. Në qendër rivjen thirrja për liri. Bëhen të modës sërish Fishta e Frashëri. Një numër ngjarjesh historike si shteti i pavarur i 1912, Konferenca e Ambasadorëve, Traktati i Fshehtë i Londrës, mbarimi i Luftës së Parë Botërore, Konferencë e Paqes etj. e detyrojnë poezinë të ndërpresë rrugën e nisur, të kthehet prapa e të mbarset me frymën e kohës.

VII. TRI RRYMAT LETRARE TË VITEVE '28-'44:

Sakaq filli i traditës rilidhet në periudhën mes dy luftërave duke ruajtur linjën e vet evolutive. Shfaqet një koncept dhe shpirt i ri në strukturat formale të aplikuara nga autorë të tillë, si: Shantoja, Zadeja, Palaj etj. Shkrimtarët që janë edukuar jashtë sjellin impulse rinovuese në letërsi duke iu përshtatur modeleve botërore, të tillë janë V.Prendushi, L.Poradeci etj. Këta shkrimtarë, por edhe të tjerë si N. Haki, V.Kokona etj., Koliqi i rreshton në **rrymën moderniste të viteve '28-'44** ndërkohë që përmend edhe dy rryma të tjera që kërkojnë të dominojnë në letrat shqipe. **Rryma tradicionaliste** me përfaqësues Fishtën, Mjedën, Çajupin, Skiroin,

Prendushin dhe **rrymën revolucionare ekstreme** me pionier Migjenin. Për këtë të fundit, Koliqi shprehet me rezerva.

Migjenin, ai e quan vazhdues të të “zhgënjyerve” serb, poet që s’arriti të krijonte një shkollë pse u privua nga mbështetja në traditën lokale, i vlerësuar jo aq për anën sociale të tij sesa për disa modulime që të kujtojnë Corazzinin. Poezia e kësaj rryme, në vazhdim sipas tij lëkundet mes futurizmit e hermetizmit, duke minosur bazat e jetës tradicionale shqiptare.

Në këtë moment shfaqet në letrat shqipe, poeti dhe miku i Koliqit, **Martin Camaj**. Si një **fenomen më vete**, por të përfshirë në lëvizjen e këtyre viteve, Koliqi trajton Nolin. Sipas tij, Noli mund të rrallitej i katërti në Triadë, po të mos kishte kufizime të tilla si të jetuarit larg Shqipërisë dhe koha e shkurtër e qëndrimit në Shqipëri.

Nga veprimtaria e shtypit të kësaj periudhe, e cila për hir të së vërtetës duhet thënë se ishte e gjerë, Koliqi përmend vetëm dy organe “*Illyria*” (1934-1936) dhe “*Shkëndija*” (1940-1943), bashkëpunëtor e drejtues i të cilave qe dhe ai vetë. Ndërsa në këtë lëvizje publicistike përfshihej edhe “*Përpyekje shqiptare*” (’36-’39) dhe “*Hylli i Dritës*” (’30-’44) dhe “*Leka*” (’29-’44).

Prej gjithë kësaj lëvizjeje, Elsie në “Historinë e Letërsisë Shqipe” (1995), do të vlerësonte si lajmëtar të bashkëkohësisë veçanërisht Migjenin dhe Poradecin. Në vlerësimin e Koliqit, Poradeci ruan të njëjtin status, ndërsa s’mund të themi të njëjtën gjë për Migjenin. Me këtë të fundit Koliqi gjithnjë i kishin dalë probleme, që e kishin zanafillën në një numër kontradiktash në bazë të të cilave qëndronin origjina, botëkuptimi, idealet etj.

Jashtë trajtimit ngelin edhe një numër i konsiderueshëm autorësh të tjerë si Asdreni etj., ndërsa nga Rilindja grupi i shkrimtarëve geg verior P.Vasa dhe F. Shiroka.

VIII. REALIZMI SOCIALIST, “STOPIM” I PAPRITUR:

Që në hapat e parë të Realizmit socialist, në planin politik shenjohej persekutimi i shkrimtarëve të shkollës katolike shkodrane; ndërsa Migjeni qe ndarë nga kjo botë që më ’38, me ardhjen e stalinizmit pena e Poradecit heshti; një numër shkrimtarësh u larguan dhe një pjesë tjetër iu përshtat ndryshimeve të shoqërisë shqiptare. Por Koliqi nuk ndalet në paraqitjen e kësaj skene, atij i interesojnë elementët letrarë që vërtetojnë “stop-in” e ndjeshëm të letërsisë shqipe, si p.sh. interesimi i papritur ndaj strukturave formale, skemave metrike të mbyllura, imitimi i modeleve letrare sovjetike, dhe detyrimi për t’ia nënshtruar estetikën doktrinës sociale të komunizmit.

E gjithë kjo që mbyttëse për lirikën, megjithatë Koliqi duke kapërcyer vetveten arrin të gjejë shenja shprese në këtë letërsi përmes shkrimtarëve të tillë si: **Aleks Çaçi**, i cili nga lirika me thurje perfekte klasike para lufte kalon në vargjet e lira melodioze të ndikuara nga qëndrimi në Kinë, pas lufte; **Llazar Siliqi**, i cili ka bërë të vetat parimet e doktrinës komuniste, por kjo s'e pengon të përdorë leksikun e frazeologjinë e Jezuitëve dhe Françeskanëve, apo të na japë figurën e malësorit si model të shqiptarit të vërtetë. Sipas Koliqit, *lidhja me letërsinë paraardhëse shënohet vetëm përmes formave metrike dhe leksikut*. Duke na i shëmbëlluar përmes këtyre autorëve, Koliqi ngre zërin për mosbjerrje të talentit poetik, për shmangie nga shterpësia që është pjellë e diktatit. Por ndonëse *Antologjia*, botohet në '63, autori duket se ka ndalur vëzhgimin e tij mbi poezinë shqipe në dheun amë pikërisht në atë vit (vitin '6)1 kur ndodhin ndryshime të mëdha (shkëputja politike nga BS) e për rrjedhojë kur fillon të ndihet një frymëmarrje më e lirë edhe në letërsi përmes penave të tilla, si: Kadare, Agolli, Arapi etj.

IX. LETËRSIA SHQIPE NË JUGOSLLAVI:

Pasi bën një përshkrim të shkurtër të kushteve historike duke filluar nga ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore, që në një kuptim kishin qenë fatlume për krahinat e aneksuara shqiptare, sundimin shkombëtarizues të Karageorgevich e deri në periudhën kur shqiptarët fitojnë si kurrë më parë e më pas të drejta nën drejtimin e Jugosllavisë nga Titoja, Koliqi ndalet në një degëzim të ri të letërsisë shqipe në periudhën e pasluftës.

Zhvillimet e letërsisë shqipe në trojet shqiptare në Jugosllavi, Koliqi i kishte ndjekur rregullisht me aq sa kishte mundur. Kujtojmë këtu dy shkrimet e tij "*Kroje të reja në parnaz shqiptar*" (1957) dhe "*10-vjetori i së përkohshmes Jeta e Re*" (1959), botuar në revistën "*Shejzat*".

Koliqi vë në dukje disa nga përparësitë e këtij kori shkrimtarësh në krahasim me ato të vendit amë. Kështu këta autorë të rinj ishin rritur në prani të rrymave letrare botërore, që s'ishin ndaluar në Jugosllavi dhe kishin ruajtur të virgjër gjuhën e tyre. Ndër këta autorë, si një risi me vlera letrare e sociale, Koliqi veçon Ganimet Nuren, e cila shprehet me një lirikë nervoze kundër zakoneve prapanike.

Rëndësia e argumentit në fjalë, qëndron se për herë të parë letërsia shqipe (poezia) paraqitet në mënyrë të drejtë duke përfshirë brenda saj dhe letërsinë në viset shqiptare në Jugosllavi.

X. PËRFUNDIM:

Koliqi na ka dhënë një histori të poezisë shqiptare, duke përshkruar rrugën e zhvillimit të saj që nga fillimet deri në kohët moderne. Për t'u vlerësuar është qëndrimi i tij plot respekt për poezinë kosovare. Koliqi ka vënë në dukje përputhjen e vijueshme të poezisë shqipe, pavarësisht prej oshilacioneve të diktuar, me poezinë popullore dhe aty ku ka qenë e mundur ka hequr paralele mes poezisë shqipe me atë evropiane. Parimet që Koliqi ka përdorur, reflektojnë mendimin e përgjithshëm mbi historinë e letërsisë, por ato ofrojnë edhe alternativa për ta parë atë si produkt i këndvështrimeve të reja.

LITERATURA:

1. Koliqi, Ernest: "Antologia della lirica Albanese", Milano, 1963.
2. Elsie, Robert: "Albanian Literature": a Short History, London-New York, 2005.
3. Elsie, Robert: "Histori e Letërsisë Shqiptare", Pejë, 2001.
4. "Historia e Letërsisë Shqiptare – që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare", Tiranë, 1983. (Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë. Inst. i Gjuhësisë dhe i Letërsisë).
5. Hamiti, Sabri: "Tematologji", Libri 28 i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Prishtinë, 2005.

Anthology of Albanian Lyric, A History of Albanian
Poetry in miniature

SUMMARY

"*Antologia della lirica Albanese*", Milan 1963 of the Albanian author Ernest Koliqi presents a history of Albanian poetry from its popular source to the modern times. The integration of Kosovo poetry as part of Albanian history of poetry is of a special importance. The author has argued the regular correspondences of cultivated poetry with the popular roots, despite of the dictated divergences, and wherever possible it has drawn parallels between Albanian and European poetry. The literary principals the author has used to structure the "*Anthology*" reflect the general accepted criteria's of the literary history, but at the same time they provide as well a frame to see it from a new perspective.

Arben PRENDI

ROMANESKJA E KONGOLIT NDËRMJET ESTETIKËS REALISTE, MODERNE DHE POSTMODERNE

1. ROMANI BASHKËKOHOR SHQIPTAR SI FENOMEN ESTETIK AVANGARDË

Romani shqiptar bashkëkohor pas viteve 1990 ka hyrë në një proces interesant krijimi, që shënon një dukuri komplekse stilistike ku ndërthuren modele dhe stile të ndryshme të përqendruara në mënyrë të veçantë rreth stilit realist, modern dhe postmodern. Secili prej romancierëve në këto vite duke ruajtur individualitetin e përcaktuar krijues, ka hyrë në një fazë të re të krijimtarisë së tij, në konsolidim dhe në kërkim të mundësive të reja shprehëse artistike, duke e pasuruar veprën e tij letrare edhe me përvojat moderne letrare evropiane, por edhe me një shfrytëzim më të frytshëm të lirisë krijuese pse jo duke iu përgjigjur estetikisht edhe proceseve shoqërore e individuale shpirtërore të njeriut shqiptar të këtyre viteve. Romanet e këtyre viteve, dëshmojnë për zhvillime tepër cilësore të romanit shqiptar, që janë shenja të integritetit të letërsisë dhe romanit shqiptar në rrjedhat e romanit bashkëkohor evropian. Ajo që i përbashkon këto romane është shqetësimi për gjuhën dhe strukturën artistike të veprës, e cila i nënshtrohet një përpunimi stilistik të thellë deri edhe eksperimental.

Shkrimtarë si I. Kadare, me romanet: “Piramida”, “Shkaba”, “Spiritus”, “Hija”, “Jeta dhe loja e Lul Mazrekut” etj; D. Agolli, “Dështaku”, “Arka e djallit”; Dh. Xhuvani, “Jetë në arkivol”; V. Koreshi, “Një grua me të verdha në pyllin e Budhas”, “Ulku dhe Uilli”; F. Kongoli, “Kufoma”, “Dragoi i fildishtë”, “Ëndrra e Damokleut”, “Te porta e Shën Pjetrit”, “Lëkura e qenit”, etj; D. Çuli, “Ëngjëj të armatosur”; “Nata u nda në mes”, N. Lera, “Britma e një gruaje”; Zija Çela me “Monedha e dashurisë”, “Lëngata e hënës”, “Banketi i hijeve”, “Las Varrezas”, “Sos një buzëqeshje”, “Goja e botës”; Skënder Drini, “Eklipsi i hënës”, “Nata është grua”, “Klas”; etj; krijuan një distancim të qartë estetik nga stili i imponuar

i realizmit socialist, duke gjetur natyrshëm, identitetin e tyre si romancierë që kanë ende për të zbuluar në labirinthe të stilit të tyre.

Veç kësaj, autorë të tjerë, prozatorë të ndaluar të botonin gjatë diktaturës, apo që kishin krijuar gjatë burgjeve të tyre e pasuruan mozaikun e krijuar në prozën bashkëkohore, me kahje e tipare origjinale, si Kasem Trebeshina, “Stina e stinëve”, “Odin Mondvalsen”, “Rruga e Golgotës”; Pjetër Arbnori, “Mugujt e mesjetës”, “Shtëpia e mbetur përgjysmë”, “Vorbulla”; Astrit Delvina, “Ëndrra me ngjyra” etj.

Ndërkaq një brez shkrimtarësh, më i ri në moshë në raport me të parët, si Besnik Mustafaj, “Vera pa kthim”, “Boshi”; Bashkim Shehu, “Rrugëtimi i mbramë i Ago Ymerit”, “Rrethi”; Ridvan Dibra, “Nudo”, “Stina e ujkut”, “Triumfi i Gjergj Elez Alisë”, “Email”; Agron Tufa “Dueli”, “Tenxherja”; Ardian Kyçyku “Rrethi”, “Nata pas vitit zero”; Elvira Dones “I love Tom Henks”, Visar Zhiti, “Ferri i çarë”, Stefan Çapaliku “Kronikë në lindje” etj; e bën edhe më kompleks romanin bashkëkohor shqiptar ku ndërthuren breza krijuesish dhe stile të ndryshme. Për të shtuar këtu edhe zhvillime të kësaj natyre në romanin që shkruhet në Kosovë apo vise të tjera shqiptare ku shquhen këto vite shkrimtarë me përvojë si Mehmet Kraja me romanet “Muri i mjegullës”, “Im atë donte Adolfi”, “Selvitë e Tivarit”; Zejnullah Rrahmani “Udhëtimi arbdhetar”, “Romani për Kosovën” etj. deri te romancierët më të rinj në Kosovë si Kujtim Rrahmani me “Secili e citonte biblën”, “Vrimë e zezë, njolla blu dhe të kuqe”; apo romancierët mjaft interesantë: Kim Mehmeti (Maqedoni) “Ritet e Nishanës”, “Atje dhe dikur”, “Fshati i fëmijëve të mallkuar”; Luan Starova “Koha e dhive”, etj.

Nisur veçanërisht nga ndryshimet stilistike, që shënuan një prirje totale për t’u shkëputur nga letërsia e realizmit socialist, ndryshimet në romanin tonë bashkëkohor, janë të rëndësishme, kategorike. Në këtë vështrim mund të flasim për një estetikë avangardiste në këtë roman. “Tiparet e letërsisë avangardiste, në romanin shqiptar i vërejmë sa tek idetë dhe subjektet e veçanta dhe të guximshme, aq edhe tek narracioni dhe strukturat formale... në romanin shqiptar të botuar pas viteve ’90 vihen re përpjekje të shumta për të sjellë teknika rinovuese, moderniste e postmoderniste, që herë kanë mbetur në kufijtë e eksperimentit të dështuar e herë të tjera janë shndërruar në modele artistike që kanë ushqyer një rinovim tërësor të letërsisë vetë dhe, më tej edhe të lexuesit tonë. Ajo që është më e dukshme në këtë rrafsh ka të bëjë me ngushtimin gjithmonë e më shumë të hapësirës që zinte në prodhimin dhe konsumimin tonë kulturor

romani përshkrues—social dhe zëvendësimin e tij me romanin e ri, që mbart me vete shenjat e romanit modern”¹⁵⁴

Vetë gjendja ndërmjet modelit realist, modern dhe postmodern është dukuri e kësaj estetike avangardiste. Shenja të këtyre modeleve, kemi në romanin e disa romancierëve, si: Zija Çela, Mehmet Kraja, Kim Mehmeti, Veli Karahoda, Ridvan Dibra, Fatos Kongoli, Besnik Mustafaj, Zejnullah Rrahmani, Teki Dervishi, Eqrem Basha, etj.¹⁵⁵ Çfarë ka ndodhur në fakt në këtë fazë? Shkrimtarët, romancierët, u shkëputën nga dogma ideologjike,¹⁵⁶ që i pengonte. Me rënien e dogmës ideologjike, një rol të rëndësishëm ka vendosja e lidhjeve më të forta mes romanit shqiptar dhe romanit bashkëkohor evropian, lidhje që ose ishin të zbehta në të kaluarën, ose nuk ekzistonin fare, në rastin më të mirë kur shkrimtarëve vjedhurazi u jepej mundësia e leximit në gjuhën origjinale, të kryeveprave të letërsisë bashkëkohore evropiane. Tashmë F. Kafka, A. Kamy, Zh. P. Sartri, Xh. Xhojsi, D. Buxati, G.G. Markez, H.L.Borhes, U. Eko, M. Kundera, etj. Z. Frojdi, E. Fromm, Niçe, Bibla, Kurani, etj. nuk përbënin një fushë të minuar as për shkrimtarët as për lexuesit shqiptarë.

Sigurisht në romanin tonë bashkëkohor, kemi një çlirim tematik dhe stilistik të dukshëm, që mund të themi se përbën edhe kusht për një nivel më bashkëkohor dhe cilësor të tij. Bie në sy prirja për modelime dhe konstruksione letrare me elemente të theksuara të ireales, të magjikes dhe të mitit e të përrallës¹⁵⁷ dhe vendosja në qendër të këtyre romaneve e individit, me traumat dhe tragjikën e tij ekzistenciale individuale dhe shoqërore. Në qendër të këtyre romaneve shpesh mbizotëron përpjekja për të analizuar individin dhe tragjikën, traumat e tij nën diktaturën komuniste, por edhe në rrethanat e ndryshuara jetësore, postdiktatoriale. Ndaj e gjejmë shumë të preferueshme ndërthurjen e dy kohëve, atë të tiranisë dhe atë të pastiranisë, në përpjekje për të analizuar, ballafaquar dhe kuptuar traumat e njeriut shqiptar, të ndërthurura me shqetësimin e përhershëm ekzistencial filozofik të përhershëm të qenies njerëzore, siç na shfaqet trajtimi i temës së

¹⁵⁴ Jakllari, Adem, “Tipare të avangardës në romanin shqiptar të pas viteve ‘90”, në “Fenomeni i avangardës në letërsinë shqiptare”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Letërsisë, (Aktet e seminarit shkencor 3.5.2004) Arbëria, f. 80- 83.

¹⁵⁵ Rrahmani, Kujtim, “Rrjedha, autorë” në “Gramatika e fshehtë e motiveve”, Prishtinë, 1998, f. 81.

¹⁵⁶ Prendi, Arben, “Dukuri të reja në letërsinë e viteve të fundit”, në “Letërsia si e tillë”, Konf. Shkencore, Akad. e Shkencave, I. i Letërsisë, Tiranë, 1996.

¹⁵⁷ Mustafaj, Xhemal, “Interpretime, Proza e rezistencës” në “Mrekullia e shkrimit”, “Buzuku”, Prishtinë, 1999, f. 339.

vetmisë njerëzore, i persekutimit, vetëpersekutimit, i temës së vdekjes, i absurdit të lirisë, i temës së tjetërsimit njerëzor. “Mund të thuhet lirisht se prozatorët shqiptarë në Prishtinë dhe në Tiranë kurrënjëherë më përpara nuk e kanë trajtuar kaq dendur dhe me kaq pasion në krijimet e tyre temën e lirisë subjektive dhe të asaj objektive, temën e vetmisë e të vdekjes, fenomenin e absurdit, të paradoksit dhe tjetërsimeve gjithfarë, në radhë të parë të atij moral, të njeriut. Po ashtu, si kurrënjëherë deri tani, proza shqipe e viteve të fundit është përplot me ide, me kuptime dhe me situata për shqetësimet e thella shpirtërore, për shturjet dhe për deformitetet e rënda morale dhe etike”.¹⁵⁸

Po ashtu kësaj periudhe kemi risemantizim të temave, motiveve, figurave, simboleve, nga folklori, mitologjia, filozofia, librat e shenjtë fetarë, Bibla, Kurani, etj., risemantizim, i cili nxjerr në pah shenjat e postmodernes edhe në romanin shqiptar. P.sh. romani “Piramida” i Kadaresë, me temë nga epoka e faraonëve egjiptianë, romani tjetër “Shkaba”, me motiv të ndërmjetëm nga folklori, përkatësisht përralla shqiptare, romani “Vera pa kthim”, B. Mustafaj, dhe “Rrugëtimi i mbramë i Ago Ymerit” e B. Shehut, me motiv nga balada e të vdekurit që ngrihet nga varri për të mbajtur besën e dhënë; romani “Një grua në pyllin e Budhas” e V. Koreshit, me reflektime nga universi budist, apo “Ulku e Uilli” me përsiatje të natyrës biblike, të shkrimit të shenjtë, apo “Dragoi i fildishtë” e Kongolit, me përsiatje nga kultura e vjetër dhe e re kineze, “Te porta e Shën Pjetrit” me reflekse nga Bibla, “Stina e ujkut”, R. Dibra, me reflekse filozofike apo vepra të tjera të romancierëve që merren me “*mitikën*” e realitetit të përditshëm njerëzor.

Romani shqiptar pas viteve ‘90, afrohet më shumë me konceptet e romanit modern dhe postmodern evropian, megjithë vonesën në kohë, që nga *Neuvau roman*. Romani i ri, pra, bëhet transkriptim i vetëdijes në krizë të njeriut bashkëkohor në shoqërinë borgjeze që e shkatërron. Nga ky rrëfim do të dalin personazhe shpesh të prirur për të çmontuar historinë e ndëshkimeve të tyre dhe të vetëdijes së tyre të copëzuar. Nuk mjafton të thuhet, megjithatë, se romani i fillimit të Nëntëqindës, brendësohet dhe izohet nga sfondi shoqëror, siç pohohet ndonjëherë; e vërteta është, të paktën kështu na duket ne, që romani i ri, edhe pse duke reflektuar krizën e njeriut dhe duke u nisur nga sondimi i vetëdijes së tij, lexon realitetin dhe dimensionin e tij shoqëror. Kufijtë e tij sidoqoftë duhen gjurmuar në vështirësinë, dhe shpesh në paaftësinë, për të hipotezuar një “njeri të ri”. Prust, Kafka, Xhojs, Musil, Svevo, Pirandello: janë këto shkrimtarët e

158 Mustafa, Xhemail, po aty, “Mrekullia e shkrimit”, f. 337.

mëdhenj që përbëjnë “dimensionin nëntëqindës të rrëfimit”. Secili prej tyre angazhon ndjeshmërinë e vet artistike në një drejtim personal, ndjek objektiva të ndryshme, eksperimenton zgjidhje rrëfimore të veçanta; por të gjithë ndërmarrin një rrugë që të çon në një përtëritje të thellë të strukturave, të kodeve gjuhësore, të aspekteve stilistike të romanit.¹⁵⁹

Romani i shkrimtarit Fatos Kongoli, ndoshta është shembulli më ilustrues i fenomenit stilistik, katarzës dhe i estetikës avangardiste që kataraterizon romanin bashkëkohor shqiptar të këtij njëzet vjetëshi. Në romanin e këtij shkrimtari gërshetohen teknika e prosede të romanit realist me ato të romanit modern apo edhe postmodern, në atë mënyrë që mund të shohim atë si fenomen stilistik avangardë. Me romanet e ciklit të emërtuar si “Burgjet e kujtesës”: “I humburi”, 1992 “Kufoma”, 1994, “Dragoi i fildishtë”, 2000, “Ëndrra e Damokleut”, 2001 “Lëkura e qenit”, 2003, “Te porta e Shën Pjetrit”, 2005; Kongoli na paraqitet si një nga romancierët më sistematikë të kësaj periudhe. Për autorin, këto gjashtë romane, në rrafshin tematik, janë si të thuash një përzierje e të sotmes me të kaluarën, një inkursion në të kaluarën për të shpjeguar të sotmen, ndërsa në planin stilistik, një kërkim i formave dhe strukturave artistike më të efektshme të përpunimit të romaneskes.

Me romanet e tij Kongoli në këto vite ka krijuar individualitetin e romancierit, të dallueshëm prej romancierëve të tjerë, që të paktën, prej njëzet e pesë vitesh lëvron romanin në letërsinë tonë. Në romanet e Kongolit gjejmë cilësi të romanit bashkëkohor shqiptar, si në rrafshin kuptimor/ ideor ashtu edhe në rrafshin stilistik/gjuhësor. Shkrimtari është dëshmitar i dy periudhave traumatike, letrare dhe sociale: periudhës diktatoriale dhe periudhës në vazhdim të një tranzicioni të gjatë, ku njeriu shqiptar gjatë këtyre dy kohëve, iu nënshtrua përvojave ekstreme në ekzistencën e tij. Romanet e Kongolit bëhen në mënyrën e tyre, duke u mbështetur në “ndërgjegjen e romanit” vetëdija kritike e këtyre kohëve dhe krizës sociale dhe ekzistenciale të njeriut, jeta e të cilit është reduktuar në funksionin e saj shoqëror.¹⁶⁰

2. ROMANI I KONGOLIT - PËRFAQËSIM I FENOMENIT AVANGARDË

¹⁵⁹ Këto përcaktime për romanin janë marrë nga Sante Treré Graziella Gallegati *Testi e Strumenti*, Editore Bulgarini Firenze, Itali, 2000 f. 739-742.

¹⁶⁰ Përcaktim i përdorur nga Kundera për njeriun e kohës moderne në tërësi, në “Arti i romanit”, Toena, Tiranë, 2001, f. 24.

Në romanet e Kongolit, dallojmë disa veçori themelore, që shënojnë estetikën e shkëputjes nga elementet e romanit realist shqiptar drejt tipareve dhe veçorive karakteristike për romanin modern/ postmodern, siç mund të shënojmë në mënyrë të përmbledhur në disa prej këtyre veçorive si:

2. 1. Analiza e rolit të rastësisë dhe absurdit

Analiza e rolit të rastësisë dhe absurdit në jetën e qenies njerëzore. Gati në mënyrë ironike dhe paradoksale, rastësia (apo fati) dhe absurdi ndryshojnë rrjedhat e rrëfimit por edhe të fatit të personazheve të romaneve të Kongolit. Sigurisht kjo na paraqet krizën ekzistenciale të personazheve, por edhe rrethanat e pasigurisë reale ku veprojnë ata. Për këtë personazhet e Kongolit vuajnë drama të rrezikshme shpirtërore që i çojnë deri në delire dhe çmenduri totale. Ata vuajnë nga drama e mungesës së identitetit, dyzimit, nga ndjenja e padobisë, dhe kotësisë së jetës, nga gjendja pa rrugëdalje, ku të gjitha perspektivat janë të mbyllura. Është e qartë se në natyrën e këtyre personazheve: *Thesari* në romanin “I humburi”, *Festimi* në “Kufoma”, *Ergys* në “Ëndrra e Damokleut”, *Genci*, në “Dragoi i fildishtë”, *Kristi*, në “Lëkura e qenit”, *Platon* në “Te porta e shën Pjetrit”; apo edhe te dytsat e tyre, duhen kërkuar plagët e njeriut bashkëkohor shqiptar, që vuan nga makthet e së kaluarës dhe nga ankthet e së tashmes, nga pasiguritë e së ardhmes.

2. 2. Tema e humbjes së identitetit dhe e tjetërsimit

Krahas rolit të rastësisë dhe absurdit, në romanet e Kongolit shtjellohet gjerësisht tema e humbjes së identitetit dhe e tjetërsimit të njeriut shqiptar, gjatë diktaturës komuniste, por edhe gjatë periudhës së tranzicionit politik dhe social. Mund të thuhet se këto dy tema gjenden në të njëjtin nivel, të trajtimit të tyre, gjë e cila e pasuron veprën letrare të këtij autori jo vetëm me cilësitë artistike, por edhe me peshën e reflektimeve dhe vëzhgimeve me natyrë filozofike, eseistike, që përbëjnë deri diku edhe rrafshin kuptimor të kësaj vepre. Disa romane i përmbajnë këto tema që në tituj si p.sh. “I humburi”¹⁶¹, “Kufoma”¹⁶², “Lëkura e qenit”¹⁶³, “Ëndrra e Damokleut”¹⁶⁴, “Te porta e shën Pjetrit” etj. Sigurisht tema e humbjes së

161 “Sepse jeta ime ka qenë mediokre, jetë e një njeriu që nuk ishte kurrkush e nuk u bë dikush, një jetë anonime e shkrirë në anonimat e një lagjeje të humbur..”. “*I humburi*”, “Dituria” Tiranë, 1992, f. 13.

162 “Përballë kësaj frike, identiteti i krijesës anonime u bë për mua kushti i luftës për ekzistencë”. “*Kufoma*”, MçM, Tiranë, 1994, f.107.

163 “...Unë, pra, isha lëkura e qenit!”, “*Lëkura e qenit*”, Toena, Tiranë, 2003, f. 12.

164 “Ky itinerar më çon në botën e atyre njerëzve të cilët, ashtu si unë, nuk janë as elementarë, as të zakonshëm, as tipikë. Është bota e njerëzve të përjashtuar”. “*Ëndrra e Damokleut*”, Çabej, Tiranë, 2001, f.161.

identitetit dhe tjetërsimit të njeriut ka edhe një bazë të dukshme sociale, morale, të krizës së vlerave. Në një rast tjetër autori e cilëson njeriun e kohës si “prodhim i pakryer i krizës morale të një shoqërie”, “derivate të pazgjidhura krizash morale”¹⁶⁵.

Trajtimi i këtyre dy temave nuk përbën pra vetëm një yshtje për të trajtuar tema të kërkuara, por na paraqet sigurisht shqetësimin intelektual të shkrimtarit, për fatin dhe dramatikën e njeriut dhe të shoqërisë shqiptare.

2. 3. Rrëfimi nga veta e parë

Rrëfimi nga veta e parë, si formë mbizotëruese, ndeshet në të gjitha romanet, deri në trajtë të monologut. Kjo formë e rrëfimit sigurisht është e përshtatshme për të transkriptuar botën e brendshme të personazhit, “unin” e tij. Pastaj përmes “unit” të tij rijetohet realiteti objektiv me karakteristikat e veta. Nga rrëfimtari i jashtëm në romanin tradicional që di gjithçka, në këtë grup të romaneve të Kongolit kemi rrëfimtarin e brendshëm që është edhe protagonist vetë i rrëfimit. Por është me vend të nënvizojmë këtu si natyrë bazë e rrëfimit romanesk të Kongolit, thurjen e rrëfimit përmes tri perspektivash narrative, të paktën që nga romani i parë “Ne të tre” dhe ndërkaq mënyrën e zhdërvjellët të alternimit, unifikimit mes narratorit dhe personazhit.

2. 4. Heroi - narrator

Heroi- narrator, rrëfen edhe atëherë kur nuk ka në fakt ndonjë subjekt për të treguar. Në këtë rrëfim, hero/narrator sidomos në romanet e fazës së dytë të krijimtarisë së tij shfrytëzon me origjinalitet arritjet e “përroit psikik” si një formë e rrëfimit të natyrshëm për shumë prej personazheve të tij. Bota psikologjike dhe shpirtërore e personazheve shpaloset në rrëfim më shumë se në veprim apo subjekt. Në romanet e Kongolit personazhi/narrator është karakteristik. Atij i besohet shpesh rrëfimi duke shkurtuar distancën dhe praninë e autorit në rrëfim përballë lexuesit. Ndaj në këtë pozicion është e pranishme shpesh veta e parë rrëfyese. Personazhi narrator zakonisht nuk është vetëm një personazh, por mund të jenë disa, secili syresh brenda të njëjtit roman rrëfen historinë e tij, që mund të pritët diku me historinë e tjetrit. Biles kjo është teknikë e preferuar për autorin tonë, rrëfimi nga pika të ndryshme të perspektivës së rrëfimit. Për heroin-narrator, rrëfimi është një çlirim subjektiv, shpirtëror, një lloj katarsisi shpirtëror, apo një lloj psikanalize, ku pacienti/personazh,

¹⁶⁵ “Dragoi i fildishtë”, Toena, Tiranë, 1999, f.99.

çlirohet prej sekretit të tij, duke ia kaluar lexuesit peshën e tij të rëndë, që do t'i mbetet përfundimisht lexuesit. Kjo teknikë e rrëfimit i përshkon pothuaj të gjithë romanet e Kongolit duke konsoliduar kështu një teknikë bazë për këtë autor. Në këtë mënyrë në romanin e Kongolit del në pah në plan të parë, veçanërisht bota e brendshme shpirtërore e personazhit përmes monologut, apo dialogut të brendshëm, që i drejtohet personit të munguar apo vetë lexuesit; dhe në plan të dytë ngjarja. Mund të flitet shpesh për një rrëfim shumëstresor në romanet e Kongolit, që na jep një vepër polifonike, me harmonizimin e perspektivave të rrëfimit.

2. 5. Subjekti i shturur

Ndërsa dy romanet “Ne të tre”, (1985), “Karuseli”, 1990, respektojnë përgjithësisht subjektin tradicional, me fillimin, kulminacionin e veprimit dhe përfundimin, veçanërisht nga romani “I humburi” (1992) e në vijim romanet e Kongolit, shquhen për një shprishje të rregullave të romanit tonë tradicional. Pikësëpari vërehet kjo në shturjen e subjektit tradicional. Vetë teknika bazë e rrëfimit të Kongolit, veta e parë, apo rrëfimi përmes disa perspektivave të ndryshme, e shtur teknikën e ndërtimit linear të subjektit tradicional. Sigurisht rol të veçantë në këtë shturje të subjektit ka, trajta e rrëfimit në vetën e parë, koncepti i mbivendosjes së kohëve pa një prerje strikte mes tyre, si një kohë e brendshme në vazhdim.

Gradualisht në romanet e fazë së dytë, subjekti nuk është se zhduket plotësisht, por zëvendësohet herë pas here nga asosacionet e lira të personazheve, nga reflektimet mbi probleme të ndryshme të botës njerëzore. Megjithëse duke u larguar nga koncepti i subjektit tradicional, mund të thuhet se edhe romanet e fazës së dytë e “shturin”, në fakt kuptimin tradicional për të. Subjekti i nënshtrohet disa “operacioneve” që thyejnë kornizën tradicionale duke e pasuruar me elemente të reja atë, siç është karakteristike kjo e romanit modern. Ndërkaq, siç kemi theksuar, subjekti në romanet e Kongolit nuk e ka më atë rëndësinë e zakonshme që ka në romanin tradicional shqiptar, ai pothuajse bëhet i parëndësishëm sepse vendin kryesor tashmë e zënë “zbulesat” e botës shpirtërore të personazheve. Sigurisht në romanet e Kongolit nuk ekziston konflikti tradicional, i romaneve realiste, dhe është krejt i parëndësishëm fundi i rrjedhës së ngjarjeve apo fundi i personazheve.

2. 6. Personazhi “antihero”

Personazhet në prozën e periudhës së parë janë të thjeshtë, përgjithësisht të ndikuara nga modeli skematik i personazheve të realizmit

socialist. Në romanin “Ne të tre”, “Karuseli”, mund të thuhet se personazhet janë më të realizuara dhe ndërtohen me qëllim që ato të paraqesin karaktere letrare, por edhe jetësore.

Sigurisht në romanet e periudhës së dytë personazhi është shumë më kompleks dhe në përngjasim me “njeriun e gjallë”, në fakt të papërkufizueshëm. Prirja e Kongolit ka të bëjë me analizën e botës së brendshme të personazheve, duke u përqendruar sidomos në botën e brendshme të personazhit kryesor, apo të personazheve në një nivel me të. Në këtë analizë përfshihet gjithçka.

Romanet e Kongolit mund të thuhet se janë romane të personazheve.¹⁶⁶ Ai është qenia më e rëndësishme, mjeti më i rëndësishëm letrar. Ndaj shpesh monologu i personazheve është karakteristik, ai është një lloj mikrofonit në brendësi të unit të personazhit, qenies njerëzore. Shpesh dominon personazhi kryesor që njëherësh është edhe narrator, dhe dy personazhe të tjera që vendosen jo rrallë në të njëjtin nivel. Kjo mënyrë e ndërtimit të personazheve dhe e paraqitjes që botës së tyre të brendshme, mund të identifikohet që nga romani “I humburi”, deri te romani “Te Porta e shën Pjetrit”. Për individualitetin apo për komoditetin, kjo skemë është e pranishme në paraqitjen e personazheve. Natyrshëm apo rastësisht numri tre, është i preferueshëm për shkrimtarin. Tre personazhe, tre pikëvështrime të ndryshme, tre fate paralele dhe të ndryshme, tre histori, tre botë etj.

Edhe në paraqitjen e personazheve Kongoli duket se harmonizon mjete të romanit realist me ato të romanit modern, duke i shkruar ato me natyrshmëri krijuese. Kështu shpesh autori na jep detaje të rëndësishme për njohjen me personazhet si pamja e jashtme, mosha, të dhëna për profesionin, vendin ku jeton, ku shkon, ku udhëton, rrugën që bën, deri edhe tabelat e rrugëve, lokaleve që frekuenton, tipin që ka, shijet, formimin kulturor - fetar, shtresën që i përket, lidhjet familjare, farefisnore, të kaluarën e tij, - peripecitë, të tashmen, planet ose mungesën e tyre për të ardhmen. Këto ndërtojnë personazhin qenie konkrete, ndërsa analizat e botës së brendshme shpirtërore ndërtojnë personazhin/ qenie imagjinare.

Për nga aspekti social dhe moral i tij, personazhi në romanet e Kongolit është njeriu i zakonshëm, i përditshëm, që mund të ketë po ato vlera, virtyte dhe antivlera, të meta, që ka njeriu në realitetin e përditshëm. Mund të themi një personazh i deheroizuar në krahasim me personazhet e realizmit socialist, një “antihero”, në raport me realitetin shqiptar një njeri i

166 Term i përdorur nga Edvin Mjur, “Romani i ngjarjeve dhe romani i personazheve” në “Çështje të romanit”, Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 185.

rëndomtë, në raport me njeriun si qenie njerëzore, kemi njeriun bashkëkohor në një botë të mbushur me pikëpyetje, ankthe, tjetërsim. Nëse realiteti është i degraduar, personazhet janë pjesë e tij. Shpesh ata vuajnë nga kriza të personalitetit dhe identitetit të tyre, të dhunuar nga situatat sociale – politike nëpër të cilat ata kanë kaluar ose ato në të cilat ata jetojnë. Janë, jo rrallë viktima të traumave të shkaktuara prej këtyre përvojave jetësore, dhe e kanë të pamundur të gjejnë rrugëdalje nga humbja e identitetit dhe gjendja anarkike e njeriut bashkëkohor.

Veç kësaj personazhet e Kongolit përshkohen nga një “ankth ekzistencial”, që i rrezikon seriozisht ata deri në shndërrimin e tyre në vetmitarë, apatikë, pasivë, indiferentë, cinikë, të pushtuar nga kotësia e ekzistencës, që s’dinë çka të bëjnë me ekzistencën, ose për shkak të përvojës traumatike jetësore, ose edhe thjesht për arsye filozofike. Nën dhunën e këtij ankthi ekzistencial, personazhet herë janë të mjerë, herë fatkeqë, herë shpresëhumbur, herë vetëvrasës, herë të dështuar në jetë, herë të keqkuptuar, herë të palumtur, herë të dyzuar, me disa identitete, të lëkundur, të pakuptueshëm. Shkrimtari thotë për këto veçori të personazheve se “Në rastin tim është krejt përvoja ime që ma sugjeron këtë lëndë. Unë nuk mund të dal nga vetvetja, të shkruaj për ato që nuk m’i sugjeron përvoja ime, që nuk janë në natyrën e përjetimeve të mia.¹⁶⁷ Njeriu që kur lind është i dënuar me vdekje, në një pikëpamje, sepse është i përkohshëm. Gjithë jetën njeriu e shoqëron kjo frikë e natyrshme që i shkakton të gjitha makthet, gjithë çrregullimet, të gjitha ato që e bëjnë në fund të fundit që në mënyrë të arsyeshme të mos jetë euforik”.¹⁶⁸

2. 7. Koha dhe hapësira

Në tërësi në romanet e Kongolit marrëdhënia me realitetet njerëzore është shumë e ngushtë, aq e ngushtë sa ndonjëherë ata janë të “*rrezikuar*” nga realiteti, nga koha e tashme, e kaluara, por edhe e ardhmja. Ky realitet të cilin autori parapëlqen ta paraqesë konkret dhe faktik, ka të dhëna e

167 “Më në fund fakti se romansieri shkruan për jetën nuk është aq i çuditshëm, ajo është e vetmja gjë, që ai pakëz e njeh. – thotë teoriku i romanit Edvin Mjur. As që befason se ai kur shkruan doemos duhet ta pasqyrojë jetën në thurje të saj, pa marrë parasysh, ndoshta se ç’mendon për të. Ai vepron kështu se vë në dukje ndonjë konstatim, kurse jeta nuk e bën këtë. Në këtë pohim, ai mund të thotë se jeta është kaos, apo se jeta është sistem, por nëse nuk shkruan si zonja Gertrude Stajn, rrëfimi tij dosido do të jetë i qartë dhe më i qartë se jeta...është fakt i pamohueshëm se modeli i asnjë romani, sado që të jetë i zhveshur forme, kurrë nuk mund të jetë aq i patrajtë sikurse jeta që e shohim, sepse madje edhe Uliksi befason më pak se Dublini... Pikëpamjet e reja filozofike me siguri mund t’i shërbejnë romansierit; ato mund t’i ndihmojnë ta vështrojë botën në mënyrë më të plotë dhe marrë idealisht, duhet të jenë pjesë e diturisë së tij. Ndërkaq sado gjatë t’i dëgjojë, ato nuk do t’i tregojnë cilat janë ligjet e romanit. Ai mund të shkruajë një roman të mirë strukturalisht, duke e menduar botën si kaos dhe një roman strukturalisht të keq, duke e konsideruar botën si sistem”, - në “Çështje të romanit”,

Rilindja, Prishtinë, 1987, f. 177.

168 Intervistë nga Elsa Demo, marrë nga Gazeta “Shekulli”, Tiranë, 20/12/2004.

referenca reale kryesisht me të tashmen e autorit/ rrëfimtari. Ndërkaq më e lirshme është marrëdhënia me të kaluarën, e cila shpesh zë vendin kryesor në këto romane. Me gjithë referencat që autori jep për t'i vendosur veprimet, ngjarjet dhe personazhet, në mënyrë "konkrete" në kohë dhe hapësirë, shpesh në rrëfim mbizotëron një ndërthurje, një mbivendosje, mes kohës së tashme, të kaluarës, dhe të ardhmes, ku kohës dhe hapësirës objektive sigurisht ia zë vendin koha dhe hapësira subjektive; siç është në natyrën e romanit modern, postmodern.

Në romanet "I humburi", "Kufoma", "Dragoi i fildishtë", "Ëndrra e Damokleut "Lëkura e qenit", "Te porta e shën Pjetrit" Kongoli rimerr në shqyrtim të kaluarën, duke e përjetuar si të tanishme dhe si përpjekje ekzistenciale për t'iu kundërvënë kohës që rrënon dhe fshin shumë histori, drama, dhimbje. Vetë autori shprehet se këto romane janë pjesë e ciklit "Burgjet e Kujtesës", ndaj në to kërkon me ngulm t'i shpërthejë këto "burgje", në luftë me kohën e pamëshirshme, në kontradiktë me të shkuarën. Prej këtij buron edhe konceptimi i ndërlikuar i kohës që shpesh nuk është vetëm e tashme apo e kaluar, por diçka që sintetizon konceptin e një "mbikohe" që përfshin të gjitha kohët, si përjetim i thellë shpirtëror dhe si përvojë jetësore e personazheve. E kaluara vërtet synohet prej personazheve të zbërthehet nga vargojt e burgjeve të kujtesës, por jo rrallë ajo kthehet në një bishë të zgjidhur që kollofit gjithçka në barkun e saj përrallor, deri edhe të tashmen e të ardhmen e tyre. E kaluara është një peshë e rëndë, një pikë e vdekur, që shpesh u ka mbyllur perspektivën e kuptimit filozofik të jetës, personazheve që vetëm rrëfejnë e rrëfejnë, - si pacientët para psikiatrit,- me shpresë që përmes rrëfimit të çlirohen prej këtij mallkimi, "sëmundje", që jo rrallë ka vërtet shenjat e një sëmundjeje neurotike.

Kongoli shquhet për një përdorim prustian të kohës dhe hapësirës.¹⁶⁹ Si në romanet e Prustit "Në kërkim të kohës së humbur" edhe këtu luhet me konceptet e "kujtesës së vullnetshme" dhe "të pavullnetshme" të personazhit narrator. Në romanet e Kongolit i gjejmë këto dy koncepte, si koncepte bazë në ndërtimin e konceptit kohë në roman. Përmes kujtesës së vullnetshme kemi një organizim racional dhe logjik të kohës, ndërsa përmes kujtesës së pavullnetshme kemi një zhbërje të logjikes dhe racionales, një kapërcim në ndijimet e vërteta të pavetëdijes,

169 Koncepti i Prustit për kohën dhe hapësirën është në sintoni me filozofinë e Bergsonit, dhe me arritjet e fizikës moderne të Ajnshtajnit.

Konceptimi i një hapësire dinamike dhe ndryshim i vazhdueshëm i perspektivës në sintoni me kërkimet avangardiste futuriste dhe kubiste apo me kërkimet kinematografike. (Shënimi im.)

që ushtojnë nga e kaluara. Shpesh episodet që lidhen me kujtesën e pavullnetshme, bëhen edhe dominuese me çrregullsinë dhe vrullin e tyre të verbër e spontan, duke ndërruar kohën e tyre të brendshme. Personazhi narrator në këto romane në sajë të lojës me këto koncepte kalon lehtësisht rrëfimin e tij sa në të tanishmen në të kaluarën, nga një vend, në një tjetër, nga një gjendje emocionale në një tjetër. Mjet efikas dhe bazë në realizimin e këtyre efekteve në romanin e Kongolit paraqitet retrospektiva. (Në romanin “I humburi” narratori flet bilës tekstualisht për kujtesën si një “shirit”, magnetofoni, apo kasetë filmike, në cilën gjenden të regjistruara episode nga jeta e tij, shirit që mund ta kthesh dhe ta ridëgjosh ose ta rishohësh, sa herë të jetë e nevojshme. “...Kurse truri, diku në një dhomë, ruan shiritin e kujtesës. Në një dhomë të kredhur nën llumin e pesëmbëdhjetë, gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë apo më shumë vjetëve, një llum i trashë, viskoz, llumi i monotonisë kafshërore të jetës së mëpastajme... janë ngjarjet e fundit të kësaj pjese të jetës, të regjistruara në shiritin e kujtesës”.¹⁷⁰

Në sajë të përdorimit të “*dy kujtesave*” personazhi narrator arrin të çburgoset, nga “*burgjet e kujtesës*”, duke çburgosur, ngjarje, histori, fate njerëzore, dhjetë - pesëdhjetë vite më herët, apo duke kapërcyer lehtësisht vendet, kontinentet. Sigurisht kjo ka sjellë një shpërbërje të kohës dhe hapësirës dhe mundësinë e perspektivës së vështrimeve të ndryshme për personazhet, siç është në natyrën e romanit modern. Ky deformim i hapësirës dhe kohës varet nga ajo që percepton personazhi narrator, përmes dy “*kujtesave*”, apo të kujtesës së dëmtuar nga ndonjë goditje mekanike nga jashtë, (Profesori Platon, “Te Porta e Shën Pjetrit”¹⁷¹) apo ndonjë krisje nga brenda (si Sari, “I humburi”, apo Festimi “Kufoma”).

170 Kongoli, Fatos, “I humburi”, Dituria, **Tiranë**, 1992, f. 191.

171 “Gjithçka kishte ngrirë, edhe koha. Akrepat e orës së tij shënonin plot dymbëdhjetë, por ai s’mund të thoshte në ishte dymbëdhjetë e ditës apo dymbëdhjetë e natës. Nuk ishte as ditë, as natë, vështirë të përcaktoje nëse po ngrysej një ditë apo po ikte një natë. E vetmja lëvizje në atë univers të ngrirë ishin tingujt qiellorë të orkestrës që e depërtonin në thellësi dhe e bënin të mendonte se ai i përkiste një të kaluarë”. “*Te porta e Shën Pjetrit*”, Toena, Tiranë, 2005, f. 242-243.

The Romanesque of Kongoli between the realistic, modern and postmodern aesthetics

SUMMARY

In this project, the author emphasizes that after the '90s the Albanian contemporary novel came into a stylistic complex stage that compared with the Albanian novel story can be described as an avant-garde stage due to the presence of modern and postmodern, realistic and aesthetic elements.

Ultimate characteristic of Kongoli's Romanesque narrative, in the author's opinion of this work, is the narration weaving through three narrative perspectives and the alternation and unification between the narrator and the character.

We can notice the presence of the three poetics even in the development of the subject, which submits to some "operations" that break the realistic frame by enriching it with new elements, as far as this characterizes the modern and postmodern novel.

Alva DANI

KONOTACIONI DHE DENOTACIONI NË GJUHËN E CAMAJT NË PROCESIN E SHQIPËRIMIT TË DISA POEZIVE TË XHUZEPE UNGARETIT

Martin Camaj dhe Xhuzepe Ungareti janë dy emra të mëdhenj e shumë të njohur jo vetëm brenda kufijve të vendeve ku jetuan dhe krijuan, por edhe më gjerë. Poetikën e tyre krijuan pothuajse rryma më vete, me të cilat edhe u identifikuan, krijuan historinë e tyre brenda historisë së letërsisë duke i dhënë asaj artin e tyre të padiskutueshëm, shpirtin e ndjenjat e gërmëzuara në vargje të admirueshme, duke qenë shembull e mit për shumë nga poetët e rinj.

Jo rrallë herë kritikët dhe studiuesit kanë përafuar në momente të caktuara poetikën e tyre duke krijuar bindjen se Camaj e receptoi poezinë e Ungareti dhe i përngjatoi, duke sjellë shembuj konkretë nga tematikat apo teknikën e tij poetike. Por nga sa shohim Camaj jo vetëm e pëlqeu Ungaretin si poet, jo vetëm si profesorin e tij në universitetin e Romës, por edhe përktheu apo shqipëroi, po të përdorim një fjalë të dashur për Camajn, disa nga poezitë e Ungareti të viteve 1920 – 1930, me të cilat mbase identifikohet më mirë edhe shija e tij poetike. Poezitë e përkthyer i gjeta rastësisht nëpër faqet e revistës “Shenjzat”, revistë me vlera të mëdha letrare ku Camaj punoi si kryeredaktor. Kjo revistë ishte një tribunë e rëndësishme letrare për të cilën koha kishte një nevojë të ngutshme. “*Breznija jonë, – shprehet Camaj nëpër faqet e kësaj reviste, - duhet të jetë krenare sepse megjithë vështirësitë e vuajtjet që randojnë në këtë shekull të pamëshirshëm mbi botën shqiptare, po vepron gjallnisht me mirëdalje në laminën e kulturës së kombit*”¹⁷². Dhe përkthimi është pjesë e këtij misioni të rëndësishëm për të treguar se “...*gjuha jonë asht e dejë dhe asht e pjekun sa të flasin në të xhenit ma t’ mëdhaja botnore të artit të fjalës*”¹⁷³.

Për t’u përcjellë shqiptarëve poetin italian Camaj ka zgjedhur disa poezi nga pjesa e parë e veprës “Sentimento del tempo”, ku përshkruan peizazhe të ndryshme kryesisht të Romës siç janë poezitë: *Pamje vendi, Heshtje në Ligurje, Hyjt, Hije, Këngë beduine, dhe Ndjesia e kohës*. Janë

¹⁷² M. Camaj, Revista “Shenjzat” nr. 5 – 6, Via de Bresciani, 38, Roma, 1962, f. 149.

¹⁷³ Po aty.

poezi mjaft të ndjera, pasi lidhen me momente të caktuara që ai i përjetoi dhe me të cilat duket mjaft i lidhur. Kanë të bëjnë gjithashtu, me një fazë krijimtarie ku Ungareti ndjehet më i sigurt, më i lirë në kohë dhe hapësirë (nuk ndodhet nën presionin e luftës dhe të pasigurisë për jetën, siç ndodh në librin e parë *L'Allegria*). Në këtë fazë të krijimtarisë shfaqet me një tjetër stil më të lartë, më të përpunuar, duke u mbështetur tërësisht në metrikën klasike. Por Camaj është vetë poet dhe di ta përçojë mirë poezinë, dhe jo vetëm të tijën. Madje ai tregohet shumë i kujdesshëm edhe në përzgjedhjen e tyre, duke veçuar disa poezi që kanë të bëjnë me elementet e kohës dhe hapësirës dhe ndjesitë që shkaktojnë tek njeriu. Apo siç shprehet Ungareti “... *peizazhi është çështje shije të një çasti të caktuar që vihet në marrëdhënie, në kundërshti apo identitet me gjendje apo ndryshime psikologjike, me hyjnizime metafizike; përpjekje, përmes analogjisë, për të shkrirë karakterin metaforik dhe përrallor me ndjeshmërinë*”¹⁷⁴.

Mendoj se Camaj bën një sprovë të tillë përkthimi në mënyrë që ta njohë edhe më mirë poetin hermetik italian (për të cilin një pjesë e kritikës mendon se është hermetik, megjithëse ai vetë (Ungareti) mbështet të kundërtën), t’u afrohet edhe më shumë fjalëve, pasi siç e pohon edhe vetë Camaj “... *Krejt pesha e kujdesi i Ungaretit ndalet mbi fjalë e cila, tue përmbledhë në vehte masa rigorozë kuptimi dhe shpërthime të një muzikaliteti të rij, asht shumë e zgjedhun e tepër delikate.*”¹⁷⁵ Për këtë arsye përkthimi i tij është shumë i vështirë, Ungareti nuk mund të kuptohet aq lehtë. Ai u end nëpër botë duke njohur kulturat dhe ndjeshmëritë e popujve të ndryshëm, duke pasuruar shijen e tij artistike dhe njëkohësisht duke ndërlikuar anën kuptimore të poezisë. Prandaj Camaj duke parë se ky përkthim nuk është aspak i lehtë i lutet Koliqit që “...*t’u a lëshojë një sy këtyne vargjeve të shqipnueme për lexuesët e “Shenjzavet”...për të përmirësu këtë orvatje*”, pasi “... *përvoja e tij (Koliqit) në këtë lamë asht tashma e njoftun*”¹⁷⁶.

Duke analizuar konkretisht poezitë e shqipëruara shohim se Camaj është jo vetëm poeti që ne njohim, por edhe një përkthyes që duke njohur shumë mirë poetikën ungaretime, gjuhën e vendit ku punoi dhe jetoi, kulturën dhe qytetërimin e tij përkthen bukur vargjet që ka zgjedhur me shumë përkujdesje. Ajo që bie më shumë në sy në këto përkthime është

¹⁷⁴ G.Ungareti, *Risposta all’anonimo*, në *Vita d’un uomo*, saggi e interventi, Mondadori, Milano, 2001, f. 204.

¹⁷⁵ Martin Camaj, *Vjerrsha nga Giuseppe Ungaretti*, Revista “Shenjzat”, Zoja e Papërlyeme, Shkodër, f. 93.

¹⁷⁶ Po aty.

vendi që zë vetë *fjala*. Camaj i kushton një rëndësi shumë të madhe *fjalës* dhe e laton nga të gjitha anët duke i ruajtur formën, ngjyrën e ritmin, duke ruajtur kuptimin dhe shpesh herë, thellësinë. I tillë shfaqet përkthimi i poezisë “Canto beduino” – “**Kangë beduine**”:

Una donna s'alza e canta
La segue il vento e l'incanta
E sulla terra la stende
E il sogno vero la prende.

Nji grue çohet e këndon
E ndjek era e e zanon
E për dhe e shkapetë
Dh'e rmben andrra e vërtetë.

Questa terra è nuda
Questa donna è druda
Questo vento è forte
Questo sogno è morte.

Kjo tokë asht xhveshë
Kjo grue asht jaraneshë
Kjo frymë asht fuqi
jo andërr asht jaz' i zi.

Si nga paraqitja e jashtme, ashtu edhe nga struktura e brendshme kjo poezi vjen e njëjta edhe në gjuhën shqipe. Ruhen dy kartinat e origjinalit, ruhet edhe ndërtimi i tyre përmes tetërrokshit dhe gjashtërokshit. Edhe skema ritmike është e njëjta AABB, CCDD. Ashtu si edhe në poezitë e tjera që ka zgjedhur Camaj, edhe këtu kemi të bëjmë me një peizazh. Përkthyesi na i sjell të gjitha elementet e peizazhit beduin dhe mjeshtërisht na përçon të njëjtën ndjesi. Është kënga melankolike e një gruaje, e vetmja banore e asaj toke të zhveshur që rrihet nga erërat, e cila gjen prehje në *ëndrrën e vërtetë*, që është vdekja. Çdo fjalë vjen e përkthyer me shumë kujdes e saktësi si nga ana e përzgjedhjes së tyre ashtu edhe nga thellësia e kuptimit, kështu është bërë një gjetje shumë e bukur e fjalës *zanon*. Për foljen *incantare* të cilës i korrespondon, gjejmë shqipërimin *ysht, mahnit, lë pa mend, magjeps*, por jo *zanon*. Fjala me prejardhje mitologjike *zanon*, e përdorur në gjuhën shqipe, është një përzgjedhje shumë e bukur e përkthyesit. Apo edhe fjala tjetër *veshtoj*, që e gjejmë në poezinë “Ndjesia e kohës” është mjaft e veçantë dhe poetike, me një ngarkesë tjetër nga ajo e fjalës *dëgjoj*, e cila bën pjesë në fjalorin tonë të përditshëm:

Ogni mio palpito come usa il cuore
Ma ora l'ascolto,

Çdo rrahje, që zemrën e dridh
Tash veshtoj:

Edhe foljen *muore* e përkthen *treten* dhe jo *vdes*, duke e përshtatur më së miri me kontekstin poetik. Kështu, në fakt hijet *treten*, për të rilindur përsëri në një çast të caktuar të ditës tjetër:

L'ombra sommersa delle rocce muore.

Hijet e mbytuna të shkambijve
treten.

Po kështu “dall’ala alabastrina” Camaj e përkthen “ prej krahëve të bardhë të bardhë” duke parapëlqyer një përsëritje të mbiemrit *i bardhë*, në vend të fjalës *alabastër*, apo vargu i poezisë tjetër “**Paesaggio**” “... non è più che madreperla” e përkthen *nuk asht tjetër gja, veç kriri i thjeshtë*. Po te kjo poezi “svela per un momento” e përkthen *zbulon për një t’imt*, ku fjalën *momento* e përkthen me *t’imët* dhe jo *çast*, duke dhënë ndjesinë e një pjese kohore tepër, tepër të shkurtër. Fjalën *Paesaggio* e shqipëron *Pamje vendi*, duke anashkaluar fjalën *peizazh*, që e gjejmë në fjalorin e sotëm të shqipes, si fjalë e ardhur nga ndikimi i huaj. Është shumë nteresante të shikosh fjalët e gjetura nga Camaj për të shprehur fjalën tepër të përpunuar të Ungaretit. Një përkthyes i një pjese të mirë të poezive të Ungaretit, Sh. Këlmendi duke theksuar vështirësinë e përkthimit të këtyre poezive shkruan: “*Ungareti na rezulton kështu një xhongler i vërtetë që eksperimenton me guxim dhe asht kurdoherë i aftë për çfarëdolloj akrobacie poetike. Nga cilido profil që mund ta vëresh, poezia e tij paraqet vështirësi në ruajtjen e plotë të tipareve origjinale, gjatë procesit të kalimit nga italishtja në një gjuhë tjetër, aq ma tepër në shqipen tonë që ende nuk ka mbërrit nivele të tilla komunikimi poetik.*”¹⁷⁷

Martin Camaj është vetë një poet i madh e, siç dihet, kush më mirë se një poet mund të përkthejë poezi. Për më tepër ai e njohu vetë Ungaretin në Universitetin “La Sapienza” të Romës, ku e kishte profesorin e tij për dy vjet. Camaj përktheu pak, por megjithatë nga sa duket ai as nuk e mendoj sërish faktin të përkthente poezi të tjera të Ungaretit. Kemi vetëm këtë përkthim tek “Shenjzat” dhe nuk shohim më asnjë ribotim apo ndonjë titull të ri poezie t’i shtohet këtyre përkthimeve. Camaj siç duket mendonte mbi përkthimin e poezive ashtu si Ungareti, i cili shkruan në një nga esetë e tij “Poeta e uomini”: “*È a tal punto individuale e inimitabile la poesia ch’essa è intraducibile. La traduzione è la prova del fuoco di quanto essa sia individuale e inimitabile. Non è traducibile il ritmo... Non è traducibile la qualità sillabica... Non è traducibile il contenuto poiche ogni contenuto è animato e coinvolto nel segreto d’una personalità. Non sarebbe altrimenti personalità unica, com’è fatalmente ogni persona umana*”.¹⁷⁸ (Poezia është aq individuale dhe aq e paimitueshme sa nuk mund të përkthehet. Përkthimi është prova më e mirë e të kuptuarit se sa individuale dhe e paimitueshme

¹⁷⁷ Revista “Orana”, Giuseppe Ungaretti, nr 8, 1998, Tiranë, f. 6.

¹⁷⁸ G. Ungaretti, *Poeta e uomini*, në Ungaretti, vita d’un uomo. Saggi e interventi, Mondadori, Milano, 2001, f. 739.

është ajo. Nuk mund të përkthehet ritmi... Nuk mund të përkthehet cilësia e rrokjeve... Nuk mund të përkthehet kuptimi, pasi çdo kuptim është pjesë e pandarë e shpirtit dhe tërësisë së një personaliteti. Përndryshe nuk do të ishte një personalitet unik, siç është pashmangshmërisht çdo qenie njerëzore).

Si për Ungaretin, ashtu edhe për Camajn fjala ishte i vetmi mjet që kishte për të shpallur individualitetin e tij krijues si pjesë e sistemit të letërsisë shqipe, ai nuk e shpërdoroi asnjëherë as në krijimtari dhe as në përkthime, përkundrazi i dha forcë nga gjenialiteti i tij për të përmbushur qëllimin e vetëm; t'i drejtohej gjithnjë lexuesit shqiptar si lexuesi i parë dhe t'i bënte të njohur një poezi moderne perëndimore.

Meriggio

Le montagne si sono ridotte
a debolì fiumi e l'invadente
d'impazienze e anche il sonno
turba e anche le statue si turbano.

*Stelle*¹⁷⁹

Tornano in alto ad ardere le favole.
Cadranno colle foglie al primo vento.
Ma venga un altro soffio,
Ritornerà scintillamento nuovo.

Mjesdita

Malet u shëndrruen në lumej valë-pakët
e shkretija mbizotnuese grafullon e
padurueshme dhe gjumin prishë e
shqetson edhe shtatoret.
deserto formicola

Hyjt

Kthejnë nalt në qiell prrallat m'u ndezë
flakë.
Do të bijnë sa të fryjë era me dushk për
dhé.
Le të vijë një tjetër frymë,
Xixillimi i ri do të priret.

Ndërsa në vargjet e para kemi një përshkrim të mirëfilltë peizazhi natyror, në të dytën yjet që shfaqen në errësirë e pastaj zhduken të bëjnë të mendosh për shpresat e njerëzve që shuhen për t'u ndezur përsëri. Camaj i qëndron besnik mesazhit të autorit dhe trajtës së jashtme të poezisë, madje mundohet të përcaktojë më në detaje përshkrimet e bëra nga Ungareti. *Debolì fiumi* Camaj e shqipëron me tri fjalë dhe detyrimisht më të mirëpërcaktuar *lumej valë-pakët*, apo shohim se anashkalon përsëritjen e fjalës *turbare*, duke e sjellë herë në variantin *prishë* e herë *shqetson*. Përsëri në poezinë tjetër *Hyjt*, *cadranno* përkthehet *do të bien për dhé*, apo *in alto* në formën *nalt në qiell*, *ardere* në formën *me ndezë flakë*, duke insistuar në

¹⁷⁹ G.Ungaretti, *Vita d'un uomo. Tutte le poesie*, Mondadori, Milano, f. 143.

një zgjerim të kuptimit dhe duke e shpjeguar edhe me një tjetër detaj, në mënyrë që të jetë sa më e kuptueshme për lexuesin shqiptar.

*Ombra*¹⁸⁰

Uomo che spero senza pace,
Stanca ombra nella luce polverosa,
L'ultimo caldo se ne andrà a momenti
E vagherai indistinto...

Hije

Njeri, që pagjë shpreson
Hije e lodhun në dritën e pluhnueme,
E mbramja ngroftësi tashti po niset
Dhe ke me u endë pa u nda në shej.

Edhe në këtë poezi shohim se çdo fjalë është e shqipëruar me shumë kujdes, struktura sintaksore është pothuajse e njëjta (me përjashtim të vargut të fundit që zgjerohet më tej) dhe përçon të njëjtën ndjesi të njeriut që shndërrohet në hije, i destinuar të endet përherë, pa u dalluar. Gjuha mbështillet nga një sërë sugjestionesh të pakapshme dhe imazhesh analogjike që synojnë të evokojnë diçka që nuk shfaqet, që mungon dhe nuk emërtohet asnjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Paesaggio (Notte)

Tutto si è esteso, si è attenuato,
confuso.
Fischi di treni partiti.
Ecco appare, non essendoci
più testimoni,
Anche il mio vero viso,
stanco e deluso.

Pamje vendi (Natë)

Gjithëshkafja u përndar, rá në si è
fashë
e u përzi në nji, fishkëllime trenash së
nisun,
që, në vetmi pa dishmitarë
zbulohet dhe fytyra eme e vërtetë, plot
molisje e prishaqefas.

Silenzio in Liguria

Scade flessuosa la pianura d'acqua.
Nelle sue urne si scade
Ancora secreto si bagna.
Una carnagione lieve trascorre.

Heshtje në Ligurje

Dridhet luhatshtëm fushorja me ujë
Ndër lagjit e saja dielli,
Ende i mshefun shtatin lan,
Nji ngjyrë e lehtë kalon si mbi
lëkurë.

¹⁸⁰ G.Ungaretti, *Vita d'un uomo. Tutte le poesie*, Mondadori, Milano, f. 146.

Camaj vazhdon me poezitë që kanë në qendër peizazhet natyrore dhe lidhjen e ngushtë me botën e brendshme shpirtërore të njeriut, i cili duket si pjesë e pandarë, megjithëse gjithnjë e nënkuptueshme e këtij peizazhi. Tek *Heshtje në Ligurje* Ungareti ndodhet për disa ditë në bordin e anijes, duke qenë se nuk kishte vende të lira nëpër hotele dhe që aty frymëzohet nga pamja e bukur detare e Ligurjes. Duket se përkthyesi nuk e parapëlqen fjalën *peizazh* për *paesaggio* (në fakt nuk është një fjalë shqipe, është një fjalë e huazuar nga frëngjishtja), dhe e shqipëron me *pamje vendi*. Shohim se foljet shqipërohen gjerësisht dhe u jepet gjithë kuptimi i mundshëm që ofron konteksti. Formën e foljes *si è attenuato* që në fjalorë italisht – shqip e gjejmë *zbutet, shuhet, ulet* e sjell jo më me një folje por me një sintagmë, me formën *ra në fashë*. Kështu ndodh me foljen pasuese *si è confuso*, që e shqipëron *u përzi në nji*, apo *si bagna* që vjen me sintagmën *shtatin lan*. Si pasojë humbet trajta e jashtme e poezisë dhe nga katër vargje në shqip na vijnë gjashtë vargje, duke ruajtur gjithsesi një ritëm të saj të brendshëm. Por jo vetëm foljen e përkthen me një sintagmë, kështu bën edhe me mbiemrin si në rastin *stanco* (i lodhur), që e shohim në formën *plot molisje*. Përkthimi i poezive të Ungaretit është mjaft i vështirë si nga ana sintaksore, ashtu edhe nga leksiku, i cili është mjaft i pasur dhe i përpunuar. Camaj është një poet shumë i mirë dhe siç thotë A.Pipa “... një poet i mirë nuk mund të bëjë përkthime të këqija; sensi i artit e udhëheq atë kah gjetja e shprehjes së përshtatun. Poetvet të tillë është e kotë me u fol mbi teknikë: secili e ka at të veten deri sa asht poet”¹⁸¹. Ne besojmë se Camaj solli një variant përkthimi mjaft të mirë dhe jo vetëm për faktin se ishte poet, por nga sa duket edhe se e njihte shumë mirë gjuhën italiane dhe vetë konceptin e poetit italian mbi poezinë, natyrën dhe perceptimin e saj.

Një tjetër poezi që i jep titullin edhe veprës nga e cila janë marrë këto poezi është ajo me titull “Sentimento del tempo” (Ndjesia e kohës), ku ndjesia e kohës e përfshin autorin dhe e bën të përjetojë në mënyrë të vazhdueshme stinët, peizazhet, kujtimet e metamorfozat.

E per la luce giusta
 Cadendo solo un ombra viola
 Sopra il gioco meno alto,
 La lontananza aperta alla misura,
 Ogni mio palpito, come usa il cuore,
 Ma ora l’ascolto,

Për dritën e përshtatun
 Tue ra vetëm një hije vjollze
 Përmbi kreshtën ma t’ulun,
 Largësija e hapun masës,
 Çdo rrahje, që zemrën e dridh,
 Tash veshtoj:

¹⁸¹ A.Pipa, *Mbi përkthimet*, në *Kritika.Ese. 1940 – 1944*, Princi, Tiranë, 2008, f. 36.

T'affretta tempo, a pormi sulle labbra

Le tue labbra ultime.

Shpejto, ti kohë, të ndalsh mbi
buzët e mija

Buzët e sprasme të tua.

Këtu duket sikur Camaj ka transportuar në shqip të gjitha fjalët e origjinalit dhe ka ruajtur maksimalisht strukturat sintaksore. Kemi të bëjmë me një poezi mjaft të vështirë, ku e rëndësishme është përshtatja si me kohën e përjetshme ashtu edhe me atë njerëzore. Koha duhet të përshpejtojë dhe të fshijë tashmë membranën që ndan çastin me përjetësinë.

Si përfundim, mund të themi se Camaj është jo vetëm një poet i madh dhe një gjuhëtar i zoti, që e njeh gjuhën e tij në çdo drithërimë e në çdo ngjyrë, por edhe një përkthyer me vlera të veçanta. Pa diskutim është një kënaqësi e madhe shpirtërore të shohësh një variant tjetër të poezisë ungaretiene po aq të bukur, të përkthyer nga Martin Camaj, që flet dhe tingëllon mjeshtërisht shqip.

BIBLIOGRAFI:

1. M. CAMAJ, *Vjerrsha nga Giuseppe Ungaretti*, Revista "Shenjzat", Via de Bresciani, 38, Roma.
2. M.CAMAJ, "Ferri" e para kantikë e Komedis Hyjnore në gjuhën shqipe, Shenjzat nr. 5 – 6, Via de Bresciani, 38, Roma, 1962.
3. G. UNGARETTI, *Risposta all'anonimo*, në Vita d'un uomo, saggi e interventi, Mondadori, Milano, 2001.
4. G. UNGARETTI, *Poeta e uomini*, në Ungaretti, Vita d'un uomo. Saggi e interventi, Mondadori, Milano, 2001.
5. G. UNGARETTI, *Ragioni d'una poesia*, Vita d'un uomo. Tutte le poesie. Mondadori, Milano, 2005.
6. V. CAPELLI, *Ottocento e novecento. Un percorso di letteratura*, Jaka Book, Milano, 1998.
7. A. PIPA, *Mbi përkthimet*, në Kritika.Ese. 1940 – 1944, Princi, Tiranë, 2008.

SUMMARY

Connotation and denotation during the process of translating some poems from Camaj by the Italian poet Ungaretti

In this article are treated some of the problems which arise during the translation of some poems by the Italian poet Ungaretti G. from Martin Camaj. Albanian poet has translated only a few lyrics, however, managed to show not only mastery in translation, but also had the opportunities that the Albanian language realize these lyrics of Ungaretti, which are considered difficult to separate semantic density. Translations have been seen in several areas, it lexical, stylistic, syntactical, etc.. The word and its colors appear as the most powerful element of his literary art. Camaj showed once that he knew very well not only language and culture of the country where he studied, Italy, but knew so well the poets of her literature.

Gëzim PUKA

IRONI POSTMODERNE PËRMES NDËRTEKSTORËSISË DHE IMAZHEVE STERIOPIE NË DRAMËN “ÇMUROSJA” TË SERAFIN FANKOS

Drama “Çmurosja” e autorit Serafin Fanko u shkrua në vitin 1994. Teksti dramatik i këtij autori përpiqet të jetë sa më autonom. “S. Fanko është nga autorët regjisorë të paktë në Shqipëri, ku, jo rrallëherë, ka qenë njëkohësisht edhe dramaturg, edhe regjisor, edhe skenograf, edhe përgjegjës i muzikës, edhe koreograf i shfaqjes, duke krijuar kësisoj sa kohezion të brendshëm, po aq edhe një integritet stilistik tërësor.”¹⁸² Të gjitha tekstet nuk janë vërtetë të gjalla gjer në çastin kur i nënshtrohen një “leximi”. Leximi që i bëri Fanko regjisor tekstit të vet dramatik “Çmurosja”, i dha çmimin si **shfaqja më e mirë** në Festivalin e teatrove të vitit 1994.¹⁸³ Shfaqja u vu në skenë nga trupa e Teatrit “Migjeni”, Shkodër.¹⁸⁴

Kjo vepër nuk është botuar deri më sot. Duket sikur autori pasi përfundoi tekstin dramatik, sipas një qëllimi të saktë, ia besoi “leximin” po vetes si regjisor, por sipas një “leximi” që përmbushi dëshirat dhe bindjet e tij. Duke qenë përpara një teksti të pabotuar dhe disa fotografive të gjetura rastësisht në arkivin e Teatrit “Migjeni”, po përpiqemi të arrijmë “intentio operis”¹⁸⁵ (qëllimin e veprës), atë çfarë vepra shpreh në vetvete, jashtë qëllimeve të atij që i prodhoi dhe atij që “i lexoi”. Interpretimi ynë përpiqet të jetë në sinkroni me tekstin dhe ato pak materiale arkivore të mbetura nga shfaqja, për të ndërtuar kështu një ligjërim mbi domethënien legjitime të veprës. Jo shumë kohë më parë, autori i kësaj vepre u nda nga jeta. Mbase ky vëzhgim do të shërbejë si ogur i mbarë, që veprat dramatike të këtij autori të shohin dritën e botimit.

¹⁸² Papagjoni Josif: Enciklopedi teatri dhe kinematografia shqiptare, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2009, f. 125.

¹⁸³ Papagjoni Josif, Teatri i Shkodrës, Shkodër, 2009, f. 64.

¹⁸⁴ Po aty, f. 64.

¹⁸⁵ Eko Umberto, Për letërsinë, Tiranë, 200, f. 223.

Drama “Çmurosja” ka kombinuar në mënyrën e vet realizimin psikologjik të historikut të zhvillimit të intelektit, shpirtit, etnisë e gjithçkaje tjetër të njeriut të së kaluarës dhe të tanishmes. Tema e kësaj vepre dramatike shpreh këndvështrimin e autorit mbi botën që do të na përcjellë. Kjo botë paraqitet në formë indirekte përmes renditjes së disa ngjarjeve, imazheve ose simboleve. Siç shprehet studiuesi dhe dramaturgu Stefan Çapaliku “... *tema paraprin veprën individuale dhe rrethon arketipin ose madje mitin*”¹⁸⁶ Mbi këtë raport ndërtohet struktura e dramës. Kjo strukturë, që është dhe skeleti i dramës, përbëhet nga ngjarja, intriga, argumenti¹⁸⁷ dhe është lineare, si ajo e dramaturgjisë tradicionale. “Intensiteti i lidhjes ndërtekstore u afrohet vlerave maksimale kur një paratekst bëhet element strukturor i një teksti të tërë.”¹⁸⁸ Elementet e veprimit të teatrit antik duket sikur kombinohen me funksionet e karaktereve, që u ngjasojnë sa atyre të miteve dhe legjendave, aq edhe kategorizimeve morale dhe sociale. Struktura narrative e dramës ka një intensitet ndërtekstor të lartë, të mitit, të legjendës, apo të përrallës. Në kullën ku jeton Trimi, Nëna, Tre Djemtë dhe Vogëlushja ndodh gjëma. Trimi e ndien se “i erdhi ora”¹⁸⁹ dhe i lë amanet tre djemve, që të ruajnë zakonet e fisit. Këto zakone të lashta sa fisi janë të paprekshme. Tabuja thyhet dhe në skenën (përrallë) hyn një personazh i huaj, Vuku-Ujku (Lupus in fabula).¹⁹⁰ Ky është “heroi antagonist”¹⁹¹, keqbërësi, që kërkon të rrëmbëjë Vogëlushen dhe të dëmtojë “...*shtatoren-totem*”¹⁹² të etnisë, simboli dhe mbrojtësi i saj, geni dhe gjaku, kurmi dhe qumeshti”.¹⁹³ Heroi antagonist përpiket të mashtrijë viktimën e vet, Vogëlushen, me qëllim që të zotërojë atë dhe shtatoren e gurtë. Vogëlushja bie pre e mashtrimit, dashurohet dhe e ndihmon padashje Vukun. Kur Vuku merr turr dhe ngul

¹⁸⁶ Capaliku Stefan, Libri i vogël i dramatikës, Tiranë, 2010, f.19.

¹⁸⁷ Po aty, f.19

¹⁸⁸ Jorgo Kristaq, Letërsia e krahasuar. Teoria, metodologjia, metodika (ne proces hartimi).

¹⁸⁹ Fanko Serafin, “Çmurosja”, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1994, f. 13.

¹⁹⁰ “Lupus, i m. 1. ujk: -in fabula, ja behu ujku”shih Lacaj Henrik, Fishta Filip, Fjalor latinisht-shqip, Tiranë, 2004, f. 425.

¹⁹¹ Propp Vladimir, Morfologjia e përrallës, Tiranë, 2004, f.35.

¹⁹² Shih: “Ndër shumë popuj primitivë asht zakon për secilin fis a familje me e përvetësue ndonji send të familjes si simbol të veçantë të vetin ose totem. Ky farë totemi mundet me qenë kafshë ose bimë, ose trung a shkamb i gdhendun, dhe duhet me qenë gjoja mbrojtës për fisin që e mban”. Appignanesi Richard; Sardar Ziauddin; Curry Patrick: Postmodernizmi, Prishtinë, 2006, f. 67.

¹⁹³ Papagjoni Josif, Arta Marku: “Çmurosja: Vepër dramatike e karakterit dhe e dimensioneve filozofike”. -“Koha jonë”, 23 nëntor 1994.

sëpaten në zemrën e shtatores, lëshohet vikama e kushtimit nga kori dhe personazhet. Vuku me Vogëlushen zhduket. Këtu “përralla” i lëshon vendin katastrofës¹⁹⁴, element i tretë i veprimit sipas tragjedisë antike. Tre Djemtë dënohen nga kori dhe Nëna. Ata prangosen sepse nuk e mbrojtën dot shtatoren e gurtë.

Hendeku historik, që ndan veprën dramatike nga vështrimi kritik, duhet kapërcyer përmes rindërtimit historik nga njëra anë dhe aktit emocional nga ana tjetër. “*Një ndërthurje epokash, përballë lashtësia me aktualitetin dhe të ardhmen, vështrim retrospektiv dhe perspektiv. Këto botë të përfaqësuar nga personazhe konkrete dhe nga mentalitete abstrakte përplasen egërsisht duke e kërkuar domosdoshmërisht gjithsecila për vete fitoren*”¹⁹⁵. Duke vërejtur, bëhet analiza e çdo personazhi në raport me të tjerët, për të synuar një kuptim të modifikuar të veprës. Pjesët dhe e tëra janë të ndërvarura. Interpretimi ynë nuk mund të jetë kurrë të kuptuarit e diçkaje, pa patur asnjë njohuri paraprake. Horizonti ynë pritjes, për personazhet e dramës, shkrihet me horizontin e pritjes së veprës.¹⁹⁶ Po të sjellësh ndër mend ndërtekstorësinë strukturore¹⁹⁷ të teatrit antik, nuk mund të lësh pa përmendur personazhin e korit¹⁹⁸, i cili është imazhi i një realiteti të veçantë nga realiteti i përditshëm i personazheve, imazhi i stanjacionit të përjetshëm shoqëror. Elementi i Korifeut dhe korit në dramë na përfshin në brendësi të ligjit të maleve. Teksti i dramës së Fankos nxjerr në pah një

¹⁹⁴ Shih: “...sa për katastrofën, kjo është një veprim shkatërrimtar dhe dhembjeprurës si p. sh. vdekje mbi skenë, dhembje të forta, plagosje dhe të tjera si këto.”

Aristoteli, Poetika, Prishtinë, 1998, f. 76.

¹⁹⁵ Papagjoni Josif, Arta Marku: “Çmurosja: Vepër dramatike e karakterit dhe e dimensioneve filozofike”.-“Koha jonë”, 23 nëntor 1994.

¹⁹⁶ Shih: “Gadamer-i ofron supozimin se ne e “shkrijmë” horizontin tonë me atë të së kaluarës. Të kuptuarit është gjithmonë shkrija e horizonteve të shkuara dhe të tashme (Horizontverschmelzung)”. Jeferson Ann; Roby David: Teoria letrare moderne, Tiranë, 2006, f.194.

¹⁹⁷ Shih: “Në themel të konceptit të ndërtekstorësisë qëndron teza sipas së cilës, vepra letrare është në dialog me traditën, teksti një mozaik, ndërthurje tekstesh paraardhës. Analiza e ndërtekstorësisë ka për detyrë të zbulojë pikëtakimet (ndërteksti) e elementeve të veprave të tjera (parateksti) në veprën apo sistemin e veprave që shqyrtohen, të shpjegojë nga janë marrë këto elemente dhe pse janë marrë, të vlerësojnë dendurinë e shtrirjen e tyre në vepër, funksionin që luajnë, si janë modifikuar dhe si integrohen në strukturën e veprës së re”. Jorgo Kristaq, Letërsia e krahasuar. Teoria, metodologjia, metodika (ne proces hartimi).

¹⁹⁸ Shih: “Përsa i përket korit, ky duhet konsideruar si një nga personat dhe si një pjesë e së tërës, që duhet të bashkëpunojë në zhvillimin e tragjedisë...” Aristoteli, Poetika, Prishtinë, 1998, f. 99.

repertor të gjerë të traditës sonë kanunore. Personazhi i Korifeut dhe kori kanë të mishëruar elemente të qarta të kësaj tradite si në aspektin e përmbajtjes, ashtu edhe të formës. Lehtësisht markohen nene¹⁹⁹ të tëra nga Kanuni i Lekë Dukagjinit²⁰⁰, në fjalët e korit.

Për ne si lexues kori bëhet një personazh estetikisht dhe konvencionalisht mjaft i efektshëm. Kori në dramë i sjell në kujtesë lexuesit kodet e vjetra zakonore, që për shumë shekuj kanë rregulluar jetën e shqiptarëve. Në të njëjtën kohë, rreth korit dhe zakoneve të lashta që ai mbështet, organizohet i gjithë kuptimi i dramës. Në teksturën e dramës “Çmurosja” kemi një ndërtekstorësi të fortë kanunore, në funksion të ironisë. Nenet e kanunit i përcillen lexuesit nga kori, që është shumë i ngjashëm me atë të tragjeditive greke, si për të na thënë se koha është ndalur dhe që nga lashtësia e deri tani, pathuajse asgjë nuk ka ndryshuar.

“Dimensionet e karaktereve”²⁰¹ në këtë dramë janë mungesore, saqë më shumë ata paraqiten si imazhe karakteresh të letërsisë gojore. Lexojmë emrat që s’janë emra tipikë të përveçëm; Trimi, Nana, Vogëlushja, Djemtë. Kjo na ndihmon ne si lexues, që të konkretizojmë një nga format e veçanta dhe më të shpeshta të imazhit. Ky është imazhi steriotip.²⁰² Në dramën “Çmurosja” të Serafin Fankos eksplorohet bota e fqinjëve sllavë të Jugut dhe drama i drejtohet botës shqiptare nga mesjeta deri në kohët moderne. Interpretimi i imazhit implikon edhe historinë. Në vitin 1994 kur u shkrua drama në Ballkan ka filluar një konflikt i ri. Në qendër të këtij konflikti janë patjetër republikat shtetformuese të Jugosllavise, por rrezikon

¹⁹⁹ “Kori: Atij që miku iu pré në shtëpi

Çdo send i jepet me dorë të majtë

Me dor’ t’ majtë e për nën gju

Deri që miku t’ jet pagu...”. Fanko Serafin, “Çmurosja”, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1994, f. 28

²⁰⁰ Shih: “§ 645: Atij, qi i u pré miku, çdo send do ti epet me dorë të majtë e për nën gju mjé qi t’a paguej mikun”. Gjeçovi Shtjefën: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Botime Françeskane, Shkodër, 2010.

²⁰¹ Shih: “Fizionomia, sociologjia, psikologjia”. Çapaliku Stefan, Libri i vogël i dramatikës, Tiranë, 2010, f. 20.

²⁰² Shih: “Natyrën në vështrim të parë pak të përgjithshme apo të mjegullt të fjalës imazh na ndihmon ta qartësojmë e ta konkretizojmë një nga format e veçanta dhe më të shpeshta të tij, imazhi steriotip[...]. Steriotipi do të shfaqet jo si shenjë, por si një sinjal, që çon vetëm në një interpretim të vetëm të mundshëm. Steriotipi do të ishte tregues i një komunikimi univok, i një kulture në rrugën e bllokimit[...]. Do të ishte më e drejtë të thonim se steriotipi përçon, në fakt, një mesazh esencial”. Jorgo Kristaq, Letërsia e krahësuar. Teoria, metodologjia, metodika (ne proces hartimi).

dukshëm edhe popullsia shqiptare që jeton në këtë shtet federal.²⁰³ Atë kuptim që trashëgon nga e kaluara kultura shqiptare vështruese, për steriotipin **Vuk**²⁰⁴ të kulturës së vështruar sllave, e stantartizon më tepër në rrethanat e kësaj lufte të re në Ballkan, duke e kthyer atë në një steriotip të formës proverbiale. Vuku është përfaqësues i egërsisë sllave, përballë shqiptarit, i cili është një tjetër steriotip, që ushqehet nga miti i tij. Ujqit (sllavët) kanë rrethuar kullën e vendasve dhe njëri nga ata, Vuku, hyn në kullë si mik dhe pritet si mik. Vendasit (shqiptarët) vlerësojnë “mikun”, sepse kështu sipas zakoneve të tyre vlerësojnë veten. Koncepti për veten i Tre Djemve nuk përputhet me vetë qenien e tyre. “Uni” i Djemve është ndërtuar përmes identifikimit me një “*Unë ideal*”, që nuk përshtatet me dobësinë e këtyre burrave-fëmijë. Djemtë nuk janë përfaqësues të fuqisë, por viktimë e iluzionit të fuqisë.²⁰⁵ “*Prerja e planeve dhe shkapërcimi i vetjeve vepruese brenda një kohe tejet të shkurtuar, përbën një formë të re*”²⁰⁶, të cilën do e konsideronim postmoderne. Shtatorja e etnisë duket si e muruar përkohësisht aty. Në shfaqjen-dramë, lexuesi-spektator gjendet përballë shtatores, e cila është një imazh i privuar nga tensioni drejt Tjetrit, drejt dëshirës, drejt njohjes së Tjetrit. Lexuesi-spektator vëren një performancë vizive dhe fizike, që e përdor skenën si pasqyrë e errët dhe që nuk i mban karakteret imazhe-steriotipe. Skena na jepet si vetrinë, ku gjërat thjesht paraqiten dhe ku dukja paraqitëse e një diçkaje paralajmëron të qenët aty, për të mos qenë më. Është materializimi i udhës historike të etnisë sonë, i legjendave dhe i miteve, por edhe tjetërsimi i saj nga ndikimi

²⁰³ Shih: “Në fillim të vitit 1992 u pa qartë se federata jugosllave kishte marrë fund. Çështja nuk shtrohej t’u jepej njohja Kroacisë e Sllovenisë apo të mos u jepej; çështja shtrohej si dhe kur. Njohja e menjëhershme pa kushte e shtonte pa masë tensionin mbi Bosnjën, si dhe vultoste fatin e Serbëve të Krajinjës në plan afatgjatë. Përveç kësaj, ajo nuk merrte parasysh rrjedhojat për Kosovën dhe Maqedoninë”. Gleni Misha, Histori e Ballkanit 1804-1999, Tiranë, 2007, f. 638.

²⁰⁴ Vuk m. ujk” shih Çipuri Hasan, Fjalor serbisht-shqip (Srpsko-Albanski Rečnik), Tiranë 2003, f. 633

²⁰⁵ JEFERSON, Ann; ROBY, David: Teoria letrare moderne, Tiranë, 2006, f. 225

²⁰⁶ Shih: “Një formë e re moderne e aplikuar në dramën e tij (S.Fankos), është prerja e planeve dhe shkapërcimi i vetjeve vepruese, pra kalimi i një vetjeje te tjetra, nga njëra gjendje te tjetra, brenda një kohe tejet të shkurtuar” PAPAGJONI, Josif: “Sprova të modernizimit në rrjedhat e fundme të dramës shqipe”, në Fenomeni i avangardës në letërsinë shqiptare, Aktet e seminarit shkencor, Tiranë, 2004, 288 f.151

i faktorëve rrethues; luftërat, emigrimet, trysnitë. Shtatorja na kujton përpjekjen e stërmundimshme për të mbijetuar.

Në artikullin kritik me titull “Çmurosja: Vepër dramatike e karakterit dhe e dimensioneve filozofike”, që ka për autorë Josif Papagjonin dhe Arta Markun, botuar në gazetën “Koha jonë” të datës 23 nëntor 1994 ndër të tjera theksohet: “Nga drama, koncepti regjisorial dhe loja e aktorëve del veç një fjalë: respekt për traditën, mitin, genin tonë; respekt për zakonet dhe ligjin që rregulloi jetën tonë nëpër shekuj. Por jo imponim, jo dhunim kundrejt prirjeve dhe zhvillimeve historike! Jo mykjes, mbylljes në kulla të hekurta, izolimit! Jo prangave kanunore, jo të mbeturit në vend, jo konservatorizmit! Dhe pikërisht këtu lind konflikti, rezistenca. Drama dhe shfaqja, krahas kësaj, përcjellin edhe një mesazh të dytë, tragjik për kombin tonë: Nderim vërtet, por edhe kujdes nga dora që shtrihet për miqësi, besë, mikpritje, fisnikëri, por aspak naivitete dhe **humbje identiteti.**”

Paraqitja e Vukut si imazh steriotip përballë personazheve të tjera brenda strukturës ndërtekstësore, në leximin tonë rezulton një rast i veçantë, rast i një fobie të dyfishtë. Vuku si përfaqësues i kulturës sllave shihet në mënyrë tërësisht negative. Kultura vështruese që është ajo shqiptare, e përfaqësuar nga Korifeu, kori nuk shihet si më e mirë. Shtatorja e gurtë të cilin ndërhyjnë kori dhe Korifeu për ta interpretuar, për t’ia nënshtruar një kod, për t’i bërë parabola, tashmë është cënuar. Është ky momenti kur kjo statujë totemike bëhet simbol në kuptimin më të zvetënuar të fjalës. Kjo shtatore është aty për t’i thënë tre vëllezërve se ç’duhet të besojnë dhe ç’duhet të hedhin poshtë. Autori përmes Tre Djemve është në një marrëdhënie ideologjike konfliktuale me realitetin shqiptar. Vetëm duke veçuar në interpretimin tonë imazhin e Vukut, i cili është përcaktues në transformimin që ndodh brenda veprës, do të kuptojmë se cili është “miti” personal i autorit. Ky mit është thelbi i dëshirës së tij, që legjendën e vjetër vetësakrifikuese të murosjes, ta kthejë përmes “mitit” të tij “të frikshëm” të çmurosjes në një njëmendësi ironike universale. “Përdorimi i simboleve dhe alegorisë i japin dramës një natyrë filozofike. Nga ana tjetër, Serafin Fanko, me dramën e tij të bazuar në legjendën e të sakrifikuarit të njerëzve duke i murosur ato përçon mesazhin e përhershëm dhe shumë të rëndësishëm, që shqiptarët duhet të shokohen nga e kaluara e tyre (kane qenë “të murosur” në të kaluarën e tyre), në mënyrë që të ecin para”²⁰⁷.

²⁰⁷Shih: “The use of symbols and allegory give the play a philosophical nature. Serafin Fanko, on the other hand, with his play based on the legends of sacrificing people by building them into the foundation of walls, conveys the timely and important message that Albanians should be shocked by their past (they have been “walled-up” in their

Në gjykimin tonë “katastrofa” e Tre Djemve, nuk është gjë tjetër, veçse një finale ironike e stilit postmodern²⁰⁸. Citimi niçean²⁰⁹: **“Djemtë 1,2,3: Kthehu tek unë,o njeri! [...] Zoti im i panjohur! Dhembja ime! Fati im i fundit”²¹⁰**, rrit ndjeshëm ironinë ndërtekstësore filozofike, në fund të dramës. Sakrifikimi nuk i vlen **identitetit kombëtar dhe aq më pak dimensionit njerëzor.**

BIBLIOGRAFI:

1. ARISTOTELI: *Poetika*, Shtëpia botuese “GJON BUZUKU”, Kosovë, 1998, 132 f.
2. APPIGNANESI, Richard; SARDAR , Ziauddin; CURRY, Patrick: *Postmodernizmi*, Prishtinë, 2006, f. 67.
3. ÇAPALIKU, Stefan, *Libri i vogël i dramatikës*, Tiranë, 2010 (në proces hartimi).
4. ÇIPURI, Hasan: *Fjalor Serbisht-Shqip*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2003, 704 f.
5. DIBRA, Ridvan: *Një lojë me emrin postmodernizëm*, Shtëpia botuese “Albas”, Tiranë, 2007, 133 f.

past) in order to move forward”. Velça Kudret, “Introducing Albanian theater to the world” në Stefanova Kalina, Easter European theater after the iron curtain.

²⁰⁸Shih: “Stili postmodern shpeshherë karakterizohet nga disa tipare të veçanta, si për shembull: eklitizmi, relativizmi, digresioni, kolazhi, pastishi, **ironia**, etj.[...] Teoricienë të ndryshëm, akademikë e historianë, e përshkruajnë postmodernizmin si një rrymë e mendimit që i kundërvihet modernizmit. Mendimi modernist njihet dhe u jepte rëndësi të madhe idealeve të tilla, si racionaliteti (pushteti i arsyes), objektiviteti (në gjykim e vlerësim), progresi i shoqërisë (në të gjitha rrafshet) dhe ideve të tjera me orientim iluminist, ideale karakteristike këto për lëvizjet pozitiviste e realiste të shekullit të kaluar. Kurse postmodernizmi më e pakta i vë në dyshim këto ideale iluministe”. Dibra Ridvan, *Një lojë me emrin postmodernizëm*, Tiranë, 2007, f. 5-6.

²⁰⁹Shih: “ Filozofia e Nietzsches nis me trajtimin e filozofisë dhe artit të Greqisë Antike, në disfavor të klasicizmit, të cilin e vështronte si një afirmim të vizionit të arsyeshëm dhe për rrjedhimisht përfaqësues të dekadencës. Në veçanti tragjedia greke është interpretuar si një shprehje e impulsit jetësor, apo siç shprehet Nietzsche e ‘momentit dionisiak’. [...] Pra ndryshe nga keqinterpretimet e filozofisë së tij, mbinjeriu niçean nuk është një njeri i gjithëfuqishëm, por një qenie që duhet të zhvillohet lirshëm për të tejkaluar vetveten (“..njeriu është një urë dhe jo një qëllim.” – kjo është edhe ideja thelbësore e Zarathustrës”. Friedrich Nietzsche, Nga Wikipedia, Enciklopedia e Lirë.

²¹⁰ Fanko Serafin, “Çmurosjë”, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1994, f. 45.

6. EKO, Umberto: *Për letërsinë*, Shtëpia Botuese “Dituria”, Tiranë, 2007, 318 f.
7. FANKO, Serafin: “Çmurosja”, dramë, Teatri “Migjeni”, Shkodër, 1994, 45 f.
8. GJEÇOVI, Shtjefën: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Bot. i 3-të, Botime Françeskane, Shkodër, 2010, 280 f.
9. JEFERSON, Ann; ROBY, David: *Teoria letrare moderne*, Bot. i 2-të, Shtëpia botuese “Albas”, Tiranë, 2006, 340 f.
10. LACAJ, Henrik; FISHTA, Filip: *Fjalor latinisht-shqip*, Shtëpia botuese “Saraçi”, Tiranë, 2004, 821 f.
11. MISHA, Gleny: *Historia e Ballkanit 1804-1999 (Nacionalizmi, luftrat dhe Fuqitë e Mëdha)*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2007, 733 f.
12. PAPAGJONI, Josif: *Teatri i Shkodrës*, Shtëpia botuese “Gjergj Fishta”, Shkodër, 2009, 119 f.
13. PAPAGJONI, Josif: *Enciklopedi teatri dhe kinematografia shqiptare*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2009, 559 f.
14. PAPAGJONI, Josif: “*Sprova të modernizmit në rrjedhat e fundme të dramës shqipe*”, në fenomenin e avangardës në letërsinë shqiptare, Aktet e seminarit shkencor, botim i fondacionit SOROS, Tiranë, 2004, 288 f.
15. PAPAGJONI, Josif; MARKU, Arta: “*Çmurosja: Vepër dramatike e karakterit dhe e dimensioneve filozofike*”, Gazeta “Koha jonë”, 23 nëntor 1994.
16. PROPP, Vladimir: *Morfologjia e përrallës*, Shtëpia e librit dhe e komunikimit & Aleph, Tiranë, 2004, 192 f.
17. STEFANOVA, Kalina: *Eastern European theater after the iron curtain*, Overseas Publishers Association, 2000.
18. ZAVALANI, Tajar: *Histori e Shqipnis*, Bot. i 2-të, Shtëpia botuese “Phoenix”, 1998, 387 f.
19. WIKIPEDIA, Enciklopedia e Lirë, *Friedrich Nietzsche*.

Postmodern irony in the inter-textual and stereotypical images of the
drama "Çmurosja" by Serafin Fanko

SUMMARY

The play of Serafin Fanko "Çmurosja" was written and staged on 1994. This work has not been published till today. The play has combined in its own way the psychological realization of the development of the intellect, soul, ethnicity and everything else of the man of the past and of the present. The narrative structure of the play has a high intertextual intensity of the antique theatre, you cannot leave out the character of the chorus and other characters like stereotypical images which are an index of the eternal social stagnation. At the same time, the whole understanding of the play reposes on the chorus and the age-old habits. In the fabric of the play "Çmurosja" we have a strong intertextuality in the function of postmodern poetry.

Ardita REÇI (Hysa)**EFEKTI BINDËS I MEDIAS TEK PUBLIKU**

Vullneti për t'u bërë pjesëmarrës në mirëqenien e vet dhe të kolektivit, është ajo çfarë mediat e kohëve tona synojnë të kultivojnë tek publiku. Rregullat, kontrollet, kërcënimet dhe sanksionet, janë tashmë të paafta për të bindur publikun në mënyrë që ky i fundit të ndryshojë sjellje në një masë të gjerë. Kjo lloj bindjeje në kohët tona, sipas studiuesve Christian Bayler dhe Xavier Mignot arrihet përmes komunikimit shoqëror²¹¹. Kjo është një pikë shumë e rëndësishme nga e cila varet sukcesi ose dështimi i mediave të kohëve tona. Aktorët që e synojnë bindjen e publikut janë kryesisht politikë, dhe pas tyre edhe grupet e biznesit e më pak shoqëria civile. Arritja e qëllimeve të tyre është jetike për median, që mbizotëron në bazë të fondeve që këta parashikojnë për komunikimet publike, duke kontribuar që nga financimi i reklamave, sigurimi i mbështetjes institucionale, e deri tek (në shumë raste edhe pse në kundërshtim me rregullat e etikës) informacionet e pagueshme. Tashmë aktorët politikë që tentojnë të bindin publikun se ata janë kandidatura e ardhshme më e mirë (edhe jashtë periudhave zgjedhore), kanë filluar të ndryshojnë metodat komunikative përballë publikut. Të sigurt në mbështetjen profesionale të këshilltarëve të komunikimit dhe të medias, politikanët e sotëm i drejtohen audiencës me anë të mesazheve që tingëllojnë shumë të personalizuar.

Në fushatën e fundit zgjedhore në Shqipëri (qershor, 2009), u vunë në lëvizje shumë posta elektronike me anë të të cilave liderët partiakë, synonin të komunikomin individualisht dhe drejtpërdrejt me zgjedhësit e tyre. Gjithashtu, në shumë numra të telefonisë celulare u shpërndanë mesazhe zanore të personalizuar, si dhe jo radhë dhe letra të dërguara në adresën e shtëpive të zgjedhësve.

Në kohën kur teknologjia e zhvilluar e egërsoi së tepërmi konkurrencën në tregun mediatik, lindi edhe nevoja e përpunimit të teknikave komunikative të “kapjes” së publikut. Sipas Marshall

²¹¹ Bayler Ch., Mignot X., “La communication”, Nathan Universite 2003, 3-sieme edition

McLuhan²¹²: “*Ne jetojmë në atë “fshatin global”;* teknologjia na e ka mundësuar që me një klikim të jemi në çdo cep të botës aty ku lajmi ndodh. Ndaj edhe aktorëve të medias u është dashur të punojnë gradualisht për të përmirësuar imazhin e tyre përpara audiencës, si dhe për të bërë përshtatjen e gjuhës së re mediatike. Shumë studiues të fushave të komunikimit kanë vënë re fenomene të reja që u shfaqën vitet e fundit dhe kryesisht pas përdorimit masiv të televizionit dhe si pasojë e zhvillimit social dhe kulturor.

Por përse njerëzit ndikohen nga media? Për shkak të aftësisë që mediat kanë për përpunimin e mesazheve në mënyrë bindëse, apo se kanë frikë nga izolimi? A mos ndoshta vetë bindja është në fund të fundit orientimi që media ka për synim t’i bëjë publikut në mënyrën se si ai duhet të perceptojë realitetin që e rrethon, apo ka një tjetër qëllim të fshehtë në të? Autorë të ndryshëm mbajnë qëndrime të ndryshme lidhur me këtë temë.

Marshall McLuhan, mendon se *mediat, pavarësisht nga përmbajtjet që transmetojnë, kanë impakt tek individët dhe shoqëria.*²¹³ Ndërsa McCombs dhe Shaw nëpërmjet teorisë *Uses and Gratification* (përdorim dhe përmbushje), theksojnë se “*njerëzit nuk janë automatë që presin të programohen nga mediet*”. *Disa shikues janë më rezistentë ndaj prioritetëve politike të medias se disa të tjerë.*²¹⁴

Ch.Bayler, X. Mignot janë të mendimit se “*Në komunikimin shoqëror shtrëngesa përdoren nga organizmat shtetërore*”, pasi metoda e bindjes ka dështuar²¹⁵. Gebner, ndërkaq në teorinë e tij të kultivimit, trajton raportin midis teleshikuesve sistematikë dhe perceptimit që ato kanë për realitetin, duke u shprehur se *ekspozimi i ekzagjeruar ndaj dhunës simbolike në ekran, e kushtëzon teleshikuesin të krijojë një perceptim për botën si një vend i frikshëm dhe i rrezikshëm.*

I parë në aspektin makro, fenomenimi i bindjes së publikut nga media, së pari, ka të bëjë me *lidhjen midis medias dhe shoqërisë*, dhe mënyrën se si influencojnë njëra-tjetrën. Aspekti i dytë ka të bëjë me *grupet dhe individët që përdorin mediat*. Ky aspekt reflekton raportin midis medias dhe audiencës, aspekti mikro. Em Griffin në librin e tij *A first look at*

²¹² të cituar nga Em Griffin në librin e tij “*A first look at communication theory*”, published by McGrawHill, seventh edition (2009).

²¹³ Marshall McLuhan “*Instrumentet e komunikimit, media si një zgjatim i njeriut*”, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2008.

²¹⁴ Cituar nga Em Griffin tek “*A first look at communication theory*”, published by McGraw Hill, seventh edition (2009).

²¹⁵ Ch.Bayler, X. Mignot, “*La communication*”, Nathan Universite 2003, 3-sieme edition.

communication theory, botuar nga McGraw Hill, edicioni i nëntë (2009), citation *Teornë e Spirales së Heshtjes* (me autore Elisabeth Noelle-Neumann)²¹⁶, e cila sqaron rritjen dhe shpërndarjen e *opinionit publik*, duke theksuar se *spiralja e heshtjes* si term lidhet me presionin në rritje që ndjejnë njerëzit teksa përpiqen të fshehin pikëpamjet e tyre kur mendojnë se janë në minoritet.

Sipas kësaj teorie, televizori e përshpejton spiralen e heshtjes. Njerëzit kanë një “shqisë të gjashtë” – një *organ thuajse statistikor*, i cili mbledh informacion rreth asaj çka mendon dhe ndjen shoqëria në përgjithësi. Spiralja e heshtjes ka një motor që e vë në lëvizje i cili është: *Frika nga izolimi*, që është një forcë kryesore në formimin e opinionit individual. “*Frika nga izolimi duket se është forca që vë në lëvizje spiralen e heshtjes. Të jesh me shumicën është një gjendje relativisht e kënaqshme; por nëse nuk mundeni, sepse nuk mund ta ndani publikisht atë që pranohet si bindje universale, të paktën mund të heshtni...*”²¹⁷. Njerëzit mund të konformohen më tepër nga dëshira për t’u identifikuar me fituesin se sa për të shmangur izolimin.

Lidhur me këtë teori mund të themi se ka bazë të gjerë zbatimi në praktikë. Mjafton të bëjmë një studim të thjeshtë empirik dhe do të vërejmë se tek pjesa më e madhe njerëzve (edhe nëse nuk ndjekin telenovela për të gjetur veten në historitë e personazheve), gjendet një film apo roman me të cilin gjithsecili vetidentifikohet për një kohë të gjatë. Tashmë në shumë biseda familjare apo shoqërore gjejmë modele të huazuara nga këto transmetime televizive që përfliten si të ishin njerëz të njohur personalisht, si dhe shfaqje të prirjeve për t’iu ngjarë atyre, duke i imituar në të veshur, në të folur apo ndonjëherë edhe në mentalitet dhe stil jetese.

Njerëzit tashmë me anë të asaj “shqisë së gjashtë”, të Neumann e kanë mësuar se kur duhet të flasin dhe kur duhet të heshtin. Përderisa njerëzit e ndiejnë kur nuk janë në sinkron me opinionin publik dhe kanë frikën e të qenit të izoluar për pikëpamje që nuk janë të shumicës, mund të presim heshtje prej atyre që e shohin veten në minorancë. “*Individët që vërejnë se mendimi i tyre personal po përhapet dhe përvetësohet nga të tjerë, do t’i japin zë këtij opinionit në publik. Nga ana tjetër, individët që e kanë kuptuar se opinionet e tyre po humbasin terren, do të priren të*

²¹⁶ Griffin Em, *A first look at communication theory*, published by McGrawHill, seventh edition (2009).

²¹⁷ Griffin Em, *A first look at communication theory*, published by McGraw Hill, seventh edition (2009).

adaptojnë një qëndrim të rezervuar.” Grupi i fundit i individëve do të heqë dorë lehtësisht nga bindja e vet apo të ndryshojë mendje. Duke qenë se njëri grup shprehet lirisht dhe me vetëbesim në publik ndërsa tjetri hesht, grupi i parë shfaqet më i fortë në publik, ndërsa i dyti më i dobët, megjithëse jo numërikisht në disfavor. Kjo i inkurajon të tjerët të shprehen ose të heshtin dhe kështu, procesi i spirales vihet në lëvizje.

Tek Griffin gjejmë edhe *Teorinë e kultivimit* me autor George Gerbner²¹⁸, që thekson *se pasi kanë ndjekur skenat e dhunës televizive, shikuesit nuk kujtohen cilat ishin reale dhe cilat fiksione*. Interpretimi i kësaj teorie ka çuar në hipotezën se ndërmarrjet mediatike kanë në vetvete si qëllim të fshehtë *manipulimin*, pasi siç shprehet edhe autori i teorisë: *“njerëzit e frikësuar janë më të varur, më lehtësisht të manipulueshëm dhe të kontrollueshëm; ato mund ta pranojnë shtypjen nëse kjo u premtonte çlirimin nga pasiguritë e tyre. Ky është problemi kryesor i televizionit të mbarsur me dhunë”*. Lidhur me këtë problem jo pak herë në media janë trajtuar rastet e krimeve që janë shkaktuar të nxitur nga vetë transmetimet mediatike. Kohët e fundit organizmat që merren me monitorimin e transmetimeve televizive dhe të shtypit të shkruar, kanë shpallur qëndrimet e tyre lidhur me raportimin e lajmeve të kronikës së zezë dhe mënyrës së formulimit të tyre, duke propozuar uljen e numrit të këtyre lloj infomacioneve dhe zbutjen e gjuhës së tyre. Ndërkaq tashmë me vendim të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, të gjithë filmat që transmetohen nga televizionet kombëtare, përpara fillimit të tyre duhet të shoqëroren nga sigla që tregon se kush mund t’i shohë ato filma dhe nëse kanë elemente të dhunës apo të seksit.

Adoleshentët që ndërveprojnë me prindërit e tyre teksa shohin televizion, kanë më pak gjasa të ndikohen nga imazhet televizive në krahasim me ato adoleshentë që nuk flasin me prindërit e tyre mbi përmbajtjet televizive. Ekspozimi i ekzagjeruar ndaj dhunës simbolike në ekran, e kushtëzon teleshikuesin të krijojë një perceptim për botën si një vend i frikshëm dhe i rrezikshëm. Këta teleshikues pushtohen nga një frikë jorealiste dhe bëhen viktimë e saj. Dhuna në televizor, kultivon tek shikuesit sistematikë një paranojë sociale, e cila bie në kundërshtim me nocionet e njerëzve të besueshëm apo të zonave të sigurta. Bota kthehet në një vend të rrezikshëm e të pasigurtë. *Televizioni kthehet kështu në një forcë dominante në formësimin e shoqërisë moderne, sipas McLuhan, dhe*

²¹⁸ Griffin Em, *A first look at communication theory*, published by McGraw Hill, seventh edition (2009).

kjo fuqi e televizionit buron nga përmbajtja simbolike e dramave televizive të shfaqura orë pas ore, javë pas jave. Njerëzit sot shohin televizor sikur po ndjekin një meshë në kishë, veçse me ndryshimin se shumica e tyre e ndjekin televizorin me më devocion fetar.

Ndërsa sipas teorisë së *përdorimit dhe e shpërblimit* me autorë Elihu Katz, Jay G. Blumer & Michael Gurewitch²¹⁹, që fokusohet tek konsumuesi, si pjesëtar i audiencës dhe jo tek përmbajtja e mesazhit, audiencia konsiderohet si një masë aktive dhe me objektiva të qarta. Konsumuesit e medias kërkojnë të zgjedhin media specifike, me një përmbajtje specifike për të përmbushur nevojat, dëshirat e tyre. Pra mediat janë njëri nga faktorët që kontribuojnë në plotësimin e nevojave të konsumatorit, i cili i njej nevojat e tij dhe di si t'i kënaqë ato. Ndryshe nga teoritë mbi efektin që fokusohen tek ajo që bëjnë mediat me njerëzit, merret me atë që bëjnë njerëzit me mediat. *Njeriu bëhet i varur nga ato media që përmbushin disa nevoja (shpirtërore, kulturore e sociale), se sa nga ato që përmbushin një numër të pakët.* Burimi i dytë i varësisë është *stabiliteti social*. Kur ndryshimet shoqërore apo konfliktet janë në një nivel të lartë, besimet, vlerat dhe institucionet e stabilizuara sfidohen duke e detyruar publikun të rivlerësojë dhe të bëjë zgjedhje të reja. Në kohë të tilla, mbështetja e publikut në informacionin mediatik do të rritet. Në periudha më të qeta sociale, varësia ndaj medias bie ose merr formë më të moderuar. Në kohë lufte, p.sh., njerëzit bëhen jashtëzakonisht të varur nga programet informative. Natyrisht nevojat e individit nuk janë thjesht dhe vetëm personale, por mund të formohen nga kultura dhe kushte të tjera sociale.

Me fjalë të tjera, nevojat, motivet e individëve në përdorimin e mediave janë kontigjentë me faktorë të jashtëm, të cilat mund të mos jenë nën kontrollin e individëve. Faktorët e jashtëm kanë pra funksion detyrues në lidhje me mënyrën e përdorimit të medias.

Për shembull, një i moshuar që nuk nget makinën dhe ka pak shokë, mund të krijojë varësi nga televizori, ndryshe nga të tjerë që kanë një stil apo ritëm tjetër jetese.

Një adoleshent mund të krijojë varësi nga shkarkimi i këngëve në kompjuter, për shkak të disa normave në grupin social ku ai bën pjesë.

Sa më tepër alternativa që ka individit për përmbushjen e nevojave të tij, aq më e vogël varësia e tij nga një medium i veçantë. Megjithatë numri i alternativave funksionale nuk është vetëm çështje e zgjedhjes individuale,

²¹⁹ Griffin Em, *A first look at communication theory*, published by McGraw Hill, seventh edition (2009).

por kufizohet nga disponibiliteti i disa mediave. Aktualisht, p.sh. jo të gjithë kanë mundësi të përdorin I-phone, sepse është një teknologji relativisht e re dhe si tillë e disponueshme në një shkallë jo të lartë.

Ndërsa autori Marshall McLuhan, në librin e tij “Instrumentet e komunikimit, media si një zgjatim i njeriut”, trajton *Teorinë klasike të mediumit, sipas së cilës, nuk ka asnjë dyshim se produkti mediatik i përgjigjet zhvillimeve sociale dhe kulturore dhe, nga ana tjetër, influencon këto zhvillime.* McLuhan është ndoshta i pari që tërhoqi vëmendjen tonë ndaj rëndësisë së medias si media: *mediat, pavarësisht nga përmbajtjet që transmetojnë, kanë impakt tek individët dhe shoqëria. Të gjitha mediat kanë karakteristikat e veta, të cilat e angazhojnë njeriun në forma të ndryshme.*

Për shembull, një paragraf libri mund ta rilexosh nëse do, kurse një film në kinema duhet rishfaqur në tërësinë e tij, për të studiuar ndonjë pjesë të veçantë të tij.

Për ilustrim të idesë së tij “*the medium is the message*” McLuhan përdor llambën elektrike, e cila nuk ka një përmbajtje në vetvete, megjithëse shërben si media (ndërmjetës) për të lexuar. Një llambë elektrike ia mundëson njerëzve krijimin e hapësirave gjatë mbrëmjeve, të cilat përndryshe do të ishin mbështjellë nga errësira.

Kjo teori së bashku me të tjerat, të shtjelluara më sipër, na japin një panoramë rreth mundësive që kanë njerëzit për t’u ndikuar nga media si dhe arsyet e ndryshme pse e bëjnë këtë. Njerëzit u përkasin kategorive të ndryshme shoqërore dhe nuk kanë bërë të njëjtën lloj jetese, ndaj, ashtu siç kanë perceptime të ndryshme për jetën, kanë edhe aftësinë të krijojnë marrëdhënie të ndryshme me median. Si rrjedhojë e kësaj, secila prej teorive gjen vlerësim dh zbatueshmëri, sipas rastit duke bërë që gjithsecili prej nesh të gjejë veten në teorinë ku shëmbëllen më mirë. Ndërkaq edhe aktorët e medias, kanë perfeksionuar të folurën e tyre²²⁰, duke krijuar së bashku me komunikatorët e sektorëve të tjerë publikë dhe politikë atë që njihet gjerësisht si e folura bindëse, që ka për qëllim të arrijë maksimumin e audiencës.

²²⁰ Adler R., Rodman G, “Understanding human communication”, botimi i nëntë, Oxford University Press.

BIBLIOGRAFI:

1. Adler R., Rodman G., *Understanding human communication*, botimi i nëntë, Oxford University Press.
2. Ch.Bayler, X. Mignot, *La communication*, Nathan Universite 2003, 3-sieme edition.
3. Griffin Em, *A first look at the communication theory*, published by McGrawHill, seventh edition (2009).
4. McLuhan Marshall, *Instrumentet e komunikimit, media si një zgjatim i njeriu*, Instituti i Dialogut dhe Komunikimit, Tiranë, 2008.

The persuasive effect of media to the public***SUMMARY***

In this article are treated a part of the most known theories about the persuasive effect of media to the public in an analitic way.

People are perviuos to the media from various motives, and for that reason not every person belongs to the same social categorie and have not the same life style.

They have different perceptions and different abilities to get in relations with media.

Al the quoted theories are valuable and applicable, so everyone can find him self in a theory where is better reflected.

Pranvera SKANA

PROBLEMATIKA E PASQYRIMIT TË LAJMIT FETAR NË TË PËRDITSHMET TONA

ROLI HISTORIK I MEDIAS NË RUAJTJEN NË PROMOVIMIN E FESË

Media luan një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e klimës së dialogut ndërfetar e të tolerancës së trashëguar fetare. Veç trajtimit të gjerë të problemeve ekonomike, politike, sociale dhe kulturore, media shqiptare gjithashtu nuk ka lënë pas dore edhe çështjet e fesë, e në mënyrë të veçantë atë të harmonisë apo tolerancës fetare. Por veç aftësisë së medias për të dhënë kontribut pozitiv në promovimin e tolerancës, ajo njëkohësisht kontribuon pozitivisht edhe në luftën kundër intolerancës. Në këtë kontekst lind nevoja e një bashkëpunimi mes medias dhe religjioneve. Megjithëse institucionet mediatike që në thelb trajtonin çëshjen kombëtare, nuk mund të harrojmë se gazetat dhe revistat e viteve '20-'30 u krijuan përgjithësisht nga eksponentë fetarë, të cilët me këtë rast kërkonin të nxirrnin në pah edhe përshtatjen e doktrinave fetare me kushtet dhe situatën që po kalonte Shqipëria aso kohe. Në tetor të vitit 1923 fillon botimin revista e parë zyrtare e Islamit (sunit) shqiptar, "*Zani i Naltë*". Revista ka tone të spikatura patriotike dhe radhitet pa rezerva për një reformë të Islamit shqiptar në një drejtim modernizues. Në vitin 1939 kjo revistë zëvendësohet nga botimi i ri i saj me emrin "*Kultura Islame*". Ky periodik ndjek një vijë moderniste dhe të favorshme ndaj përkthimeve të Kuranit në shqip dhe përkrahësve të një kulture që pajtohet në mënyrë të përkryer me atë moderne në përgjithësi. Ndërsa dy revistat kryesore katolike të viteve '30, "*Hylli i Dritës*" dhe "*Leka*" të botuara përkatësisht nga Françeskanët dhe Jezuitët, tregojnë se si doktrina zyrtare e Kishës,

harmonizojë me kontekstin shqiptar dhe përpunojë brenda tij. Një çështje me rëndësi që ka të bëjë me sfidat kryesore të tolerancës fetare të

shqiptarët, është në integrimin e popullit shqiptar dhe roli i tij mbrojtës ndaj asimilimit. Fetë u kanë lejuar shqiptarëve identitetin e vet kombëtar...²²¹

Nëse do të flisnim për rolin e mediave gjatë sistemit komunist, mund të themi se edhe ajo u detyrua ashtu si çdo strukturë tjetër, të qëndronte brenda “kontureve të detyruara”. Gjatë kësaj kohe, media u përdor kryesisht si instrument propagande ateiste dhe antifetare. Kjo periudhë do të merrte fund në vitet '90 me vendosjen e sistemit demokratik, në themel të të cilit qëndron liria e individit për t’u menduar, për t’u shprehur, apo për të besuar. Fetë u rimëkëmbën sërish dhe përfaqësuesit e tyre nisën përpjekjet për të krijuar lidhjet e tyre me besimtarët në të gjithë vendin. Nga ana tjetër, media e ndihmuar edhe nga historia, nisi punën në rikonfirmimin e vlerës së vyer të tolerancës fetare, për pjesën tjetër të botës. Në kushtet ku Shqipëria po përpigjet të aderojë në Bashkimin Evropian, asaj i duhet që, si një vend me ekonomi të varfër, të konkurrojë dhe të vlerësohet për vlerat e saj si komb, ndër të cilat sigurisht që bën pjesë edhe toleranca fetare.

“PAPËRGJEGJSHMËRIA” E SHTYPIT NË TRAJTIMIN E ÇËSHTJET FETARE.

Fundi i një periudhe afro çerekshekullore ateizmi dhe kalimi në një rend demokratik, i cili liberalizoi edhe të drejtën e ushtrimit të besimit fetar, e gjeti median shqiptare të papërgatitur për trajtimin e problematikës fetare. Gjatë këtyre viteve shtypi shqiptar karakterizohet nga një lloj indiferentizmi lidhur me trajtimin e ngjarjeve me karakter fetar. Në organet mediatike vihet re se kryesisht u kushtohet vëmendje vetëm ditëve të shënuara apo festave fetare siç janë Krishtlindjet, Pashkët, Bajrami apo Festa e Hashures, etj. Por edhe mënyra se si trajtohen këto “ngjarje për shtyp”, duket shumë sipërfaqësore dhe në trajtën e përsëkrimit. Në pamje të parë duket sikur këto shkrime ose kronika janë më shumë deskriptive sesa raportime in depth, (në thellësi të ngjarjes)²²². Një mundësi justifikimi e mirë në këtë rast, do të ishte mungesa e eksperiencës së shtypit, i cili ishte detyruar që për vite me radhë “të mbyllte gojën ndaj çështjeve fetare”. Ky është një fakt

²²¹ Roberto Moroco dela Roka, *Feja dhe kombësia në Shqipëri 1920-1944*, Tiranë, 1994, f. 9-10.

²²² Luarasi, Iris. Suplementi “Mediat dhe problemet fetare”, Gazeta “Standard”, maj, 2006.

real që përbën një problem në vetvete, por jo të pariparueshëm. Mungesa e eksperiencës së të përditshmeve solli detyrimisht mungesë profesionalizmi në mbulimin e ngjarjes fetare. Por megjithëse ka kaluar më shumë se një dekadë, media ende nuk ka shfaqur një përmirësim të saj lidhur me këtë problem. Nëse media kërkon që për çdo sektor të veçantë apo fushë të caktuar siç mund të jetë politika, ekonomia, kultura, kronika, etj. të shkruajnë gazetarë të specializuar apo me eksperiencë në atë drejtim, një gjë e tillë nuk ndodh me gazetarët që mbulojnë çështjet fetare. Gjatë gjithë këtyre viteteve nuk pati dhe as nuk vazhdon të ketë ndonjë gazetar të specializuar vetëm për çështjet fetare. Përgjithësisht lajmi fetar sot pasqyrohet nga gazetarët që mbulojnë problemet sociale, apo ato kulturore. Për shkak të mungesës së eksperiencës së nevojshme, apo trajnimeve të veçanta për religjionet, raportimet dhe shkrimet e gazetarëve përveçse janë shumë sipërfaqësore përmbajnë gjithashtu edhe shumë pasaktësi.

Shpesh ngjarjet më problematike fetare, pas trajtimit të tyre nga gazetarët e terrenit janë pasuar edhe me mendime të opinionistëve, analistëve apo editorialistëve. Këta të fundit kanë reaguar ndaj këtyre ngjarjeve duke mbajtur qëndrime relative ndaj tyre. Kujtojmë, se polemika të shumta pati edhe lidhur me çështjen e restaurimit të kishës-xhami në Shkodër, botimin e katikaturave të profetit Muhamed, si dhe për vendosjen e bustit të Nënë Terezës në Shkodër. Nga seria e gjatë e këtyre përfaqësuesve të medias veçojmë disa opinione të botuara në gazetën “*Shekulli*” në harkun kohor mars 2005, mars 2006, si: “*Politika e thikës fetare*” nga Gjergj Buxhuku, “*Feja e të parëve apo feja e parave*”, nga Alban Bala, “*Liria e shprehjes apo e besimit*” nga Klodjan Rado dhe një tjetër opinion nga Luan Rama shkëputur po nga gazeta “*Shekulli*”, “*Të shqetësuar nga Moisiu, toleranca apo historia*”²²³.

ARGUMENTI FETAR NË SHËRBIM TË ARGUMENTIT POLITIK

Jo rrallë në Shqipëri, argumenti fetar vihet në përdorim të argumentit politik. Një rast të tillë e gjejmë edhe gjatë zgjedhjeve të përgjithshme, në korrik të vitit 2005. Në një takim elektorale në Shkodër, kryeministri i asaj kohe Fatos Nano shprehet para elektoratit se “*Evropa ka sot boll çështje për të zgjidhur dhe nuk ka kohë të humbasë me fundamentalistë ballkanas, të cilët në Shqipëri a në Serbi, kërkojnë të rikthehen në pushtet për të trazuar ujërat e paqes. Kjo opozitë nuk*

²²³ Tituj të marrë nga monitorimi i gazetës “*Shekulli*”, mars, 2005, mars, 2006.

garanton paqe dhe bashkëjetesë sociale, nuk ushqen mirëkuptim fetar, nuk siguron bashkëjetesë krahinash shqiptare dhe kërcënon fqinjësinë e mirë të shqiptarëve me vendet dhe popujt fqinj”²²⁴. Sigurisht, që deklarata e ish-kryeministrit Nano, e veçantë në llojin e vet, nuk kaloi pa u vënë re edhe nga opinionistët apo analistët e medias. Vetëm një ditë më pas gazeta “Shekulli” del me një opinion nga Mark Marku, i cili e cilëson deklaratën e Nanos si një rast të paprecedent dhe krejtësisht të pajustificueshëm për kushtet në të cilat ndodhet Shqipëria lidhur me besimet fetare. Sipas tij, kjo është hera e parë kur një fushatë politike ngrihet mbi argumente fetare, të cilat janë shmangur edhe në periudhat më të ndezura politike të historisë së Shqipërisë, siç janë vitet 1924, 1945, apo 1997. Sipas Markut, “ky element i ri (feja) lidhur me akuzat për fundamentalizëm fetar që Nano i drejton Berishës dhe forcës politike që ky përfaqëson, është i pajustificueshëm në një popull dhe në një vend me katër fe, ku mbështetja e fushatës politike në argumente fetare mund të shërbente vetëm si bazë për një konflikt civil mes popullsive të besimeve të ndryshme”²²⁵.

Në këtë menyrë, për të tërhequr sa më shumë vëmendjen e publikut, shpeshherë media ka arritur edhe të abuzojnë në kurriz të religjioneve. I ashtuquajtur, “Scoop-i”, me titujt e gazetave, është një nga mënyrat që përdor media për të bërë “boom” me lajmin fetar. Ja disa tituj të gazetave “Shekulli” dhe “Korrieri”,²²⁶ që kanë bërë “scoop” me titujt e kronikave fetare:

- Kërcënimi, 15 klerikë myslimanë në polici (Gazeta “Shekulli”, 14 qershor 2005).
- Thyhet dhe dhunohet xhamia e Tabakëve. (Gazeta “Shekulli”, 04 janar 2006).
- Prifti grek, “skandal homoseksual” (Gazeta “Korrieri”, 22 mars 2006).
- Prifti pedofil, “rrëfëhet hotelierja” (Gazeta “Korrieri”, 24 mars 2006).
- Në polici, “myslimanët ekstremistë” (Gazeta “Korrieri”, 14 qershor 2006), etj.

Siç vërehet, reporterët që mbulojnë ngjarjet fetare në Shqipëri, kanë një mungesë të theksuar të njohurive teologjike. Kur atyre u duhet të shkruajnë për këto çështje qoftë edhe për festat fetare, ata përpiqen të kontaktojnë me përfaqësuesit e komuniteteve fetare qoftë edhe për pyetje nga më përgjithësuese, apo nga ato të përsëritura vit pas viti nga çdo gazetar, që ka shkruar të paktën një herë për çështjet fetare. E megjithëse

²²⁴ Dushi, Anila. “Nano, PD nxit konflikte fetare”, gazeta “Shekulli”, dt. 24 maj 2006.

²²⁵ Mark, Marku, “Feja si shansi i fundit i Nanos”, gazeta “Shekulli”, dt. 25 maj 2006.

²²⁶ Titujt të shkëputur nga gazeta “Shekulli” dhe gazeta “Korrieri”, të monitoruar gjatë periudhës mars 2005-mars 2006.

këtë fakt real përfaqësuesit e feve kryesore e marrin si një fyerje të tërthortë, ata përsëri detyrohen të përsërisin të njëjtat gjëra thuajse çdo vit. Famullitari i Katedrales së Shën Palit në Tiranë, Dom Gjergj Meta, i intervistuar për këtë çështje shprehet: *“Nëse do të shihnit kasetat video të 5 viteve me radhë, ku janë regjistruar kronikat mbi ceremonitë e kremtimit të festës së Pashkës, do të dëgjoni dhe shikoni se si gjatë gjithë këtyre viteve gazetarët më kanë bërë të njëjtat pyetje si, çfarë është festa e Pashkës, cila është domethënia e ngjyrosjes së vezëve, etj. Mendoj se pyetje të këtij tipi tashmë jo vetëm që nuk duhet t’i bëjë një gazetar ndaj një përfaqësuesi fetar, por madje edhe ndërmjet besimtarëve me njëri-tjetrin”*²²⁷. Megjithëse çështjet fetare veçanërisht ato me përmbajtje problematike, filluan të zinin vend në hapësirën mediatike, ku deri më tani ende nuk kemi një gazetar të specializuar për mbulimin e kronikave, shkrimeve apo raporimeve me karakter fetar.

BIBLIOGRAFI:

1. Roberto Moroco dela Roka, Feja dhe kombësia në Shqipëri 1920-1944, Elena Gjika, Tiranë, 1994.
2. Luarasi, Iris. Suplementi “Mediat dhe problemet fetare”, gazeta “Standard”, maj, 2006.
3. Gazeta “Shekulli” dhe “Korrieri”, lajme dhe kronika të monitoruara jatë periudhës mars, 2005 – mars, 2006 .
4. Dushi, Anila. “Nano, PD nxit konflikte fetare”, gazeta “Shekulli”, dt. 24 maj 2006.
5. Mark, Marku. “Feja si shansi i fundit i Nanos”, gazeta “Shekulli”, dt. 25 maj 2006.
6. Intervistë me famullitarin e Katedrales së Shën Palit, Dom Gjergj Meta, qershor, 2006, Tiranë.

Issues of religious news coverage in our dailies

SUMMARY

²²⁷ Intervistë me famulltarin e Katedrales së Shën Palit, Dom Gjergj Meta, Tiranë, qershor, 2006.

Religious tolerance is the cultural value, historical and civilization of our society, where mass media perform a very important role in its cultivation. This article has a clear target, to provide the overview of how religious issues in Albania, are handled in the pages of our dailies. This material try to highlight the advantages and disadvantages of presenting ways of the religious problems in the nowadays press. Daily press has played an irreplaceable role, trying to highlight the tradition of harmony between religions in Albania. And yet, this article tries to evidence the shortcomings of media professionals, professionalism lack of journalists in the coverage of religious issues. "Chronology" in the explication of this subject, begins with a brief history, the birth and development of the four main religions in Albania, following further with the role of the media in covering religious activities. Mutual relations between media and representatives of religious communities, and also media deficiency due to lack of specialized journalists for the treatment of religious activities, are some points where this article of character study will reckon in.

Ardian HOTI

NJË VËSHTRIM GJUHËSOR PËR MEDIAN SHQIP NË MAL TË ZI

1. SHTYPI SHQIP NË MAL TË ZI

Në Mal të Zi botohen në gjuhën shqipe gazeta javore “Koha javore”, “Buzuku” (revistë e Shoqatës “Don Gjon Buzuku”), revista “Lemba” (revistë e Shoqatës “Art Club”), “Dija”, (revistë e Shoqatës “Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi”) dhe revista “Malësia”, (revistë e Shoqatës “Malësia”).

“Koha javore” është gazetë periodike e rregullt, ndërsa revistat e tjera dalin sipas mundësive financiare dhe iniciativave private. Në gjuhën shqipe botohen edhe gazeta “Elif” (gazetë e Bashkësisë Islame të Malit të Zi, që botohet në dy gjuhë, malazeze dhe shqip) dhe “Zani i Shna Ndout” (revistë e Kishës Katolike - vazhdim i Shna Ndout të dikurshëm në Shkodër). Titujt e gazetave dhe revistave në gjuhën shqipe kanë nisur të reduktohen. Vite më parë ka pasur më shumë tituj, si: revista “Koha”, “Kronika”, dikur gazeta “Ulcinjske novine”, “Fati” (Art Club), “Fati për fëmijë” (Art Club), “Zana” (revistë për fëmijë-Art Club), “Kraja”, “Shpresa” (revistë për refugjatë - Art Club), “Malësia e re”. Më parë janë botuar edhe shtojcat “Polis” dhe “Tribuna e Titogradit” (si shtojca-suplemente në gjuhën shqipe të revistave në fjalë në gjuhën malazeze). Po ashtu, për një periudhë të shkurtër kanë dalë revista politike “Unioni” (revistë e UDSH-së) dhe “Liberali” (gazetë e Lidhjes Liberale të Malit të Zi).

Për të parë nga afër problemet gjuhësore në median e shkruar shqipe në Mal të Zi, jemi ndalur tek gazeta e vetme periodike javore “Koha Javore”. Për studim kemi marrë gazeta të muajve mars-prill-maj-qershor të vitit 2010, si dhe botime të para 6 viteve të po kësaj gazete. Duke analizuar dy periudha të ndryshme kohore, kishim si qëllim të shihnim situatën aktuale, por edhe ta krahasonin realitetin e sotëm të gjuhës mediatike me situatën e para disa viteve. Ajo që bie menjëhere në sy,

ndërsa lexon “Koha javore” është dallimi shumë i madh mes gjuhës që përdor bashkësia shqipfolëse në këto zona në komunikimin e përditshëm dhe gjuhës mediatike. Dihet se mes gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar ka dallime, por në rastin konkret kemi të bëjmë me dy realitete gjuhësore krejt të ndryshme. Në zonat shqipfolëse flitet një shqipe dialektore me shumë ndikime sllave si në rrafshin leksikor ashtu dhe në atë morfo-sintaksor. Në shumë raste edhe vetë shqipfolësit përdorin gjuhën malazeze në komunikim. Ndërsa në mediat shqiptare në Mal të Zi, kemi një realitet gjuhësor krejt tjetër. Shihet qartë tendenca për të përdorur standardin e shqipes. Madje duke bërë krahasime mes gazetave të botuara gjatë 2010-tës me ato të botuara gjatë 2003-shit mund të shohim qartë një përmirësim të dukshëm të formës gjuhësore të përdorur.

Duke krahasuar gjuhën e gazetave të këtyre dy periudhave vërejmë:

1. nga njëra anë është zvogëluar numri i fjalëve sllave dhe nga ana tjetër kemi shtim të numrit të fjalëve të huaja kryesisht të ardhura nga anglishtja.
2. kemi përdorim më të saktë të formave gramatikore të standardit të shqipes dhe zvogëlim të përdorimit të formave dialektore.

Është për t’u vlerësuar dhe ndjeshmëria që kanë intelektualët shqiptarë të Malit të Zi ndaj rëndësisë së botimeve shqipe. Pak kohë më parë u hodh ideja që gazeta “Koha Javore” të mos dalë më si botim më vete, por të dalë një herë në javë me vetëm katër faqe, si shtojcë e botimeve të përditshme të gazetës “Pobjeda”. Ky propozim i Ministrisë së Financave të Qeverisë malazeze u justifikua me krizën ekonomike që po kalonte vendi. Ndërkohë intelektualët shqiptarë në Mal të Zi reagues fort me anë të takimeve dhe shkrimeve të veçanta duke e parë çështjen politikisht dhe duke e përfshirë në debatet e kohës edhe partitë politike, sepse kalimi i gazetës si shtojcë ishte rruga për të çuar në mbylljen e saj. Me të njëjtin pretext (“nuk ka para”) u mbyll revista “Koha”, e cila doli nga vitet 1979 deri më 1990 dhe shtojca në gjuhën shqipe në “Polis”. “Ju bëjmë thirrje që të reagoni në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me parimet në mbrojtjen e së drejtës themelore të shqiptarëve në Mal të Zi, siç është e drejta e informimit në gjuhën amtare, që është garantuar me Kushtetutë dhe me Ligjin mbi të drejtat e pakicave kombëtare. Bëhet fjalë për një vendim të ndjeshëm, i cili do të pasqyrohet negativisht në informimin e shqiptarëve në Mal të Zi”-shkruhet në faqet e shtypit të asaj kohe. Falë këtij reagimi, “Koha javore” vazhdon të botohet periodikisht.

2. SITUATA AKTUALE GJUHËSORE NË MEDIAN SHQIPTARE NË MAL TË ZI

Për të vënë në dukje problemet aktuale gjuhësore me të cilat ndeshet shtypi shqip në Mal të Zi, kemi analizuar gjuhën e përdorur në gazetën “Koha javore”(muajt mars, prill, maj, qershor, 2010).

2.1 Veçori leksikore

Gjuha gazetareske e mediave shqip në Mal të Zi ka veçoritë e veta në leksik, madje dallimi i parë i dukshëm është pikërisht fondi i fjalëve që përdoren, pasi ka shumë fjalë që në mediat shqiptare brenda kufijve nuk gjenden. Duke analizuar leksikun dallojmë:

1. Përdorimin e fjalëve dialektore të zonës që nuk gjenden në fjalorët e gjuhës shqipe.
2. Vihet re përdorimi i fjalëve të vjetra shqipe, të cilat ndonëse gjenden në fjalorët e gjuhës shqipe nuk gjejnë përdorim në Shqipëri.
3. Ndërtimin e fjalëve të reja nga fjalë dialektore duke përdorur elemente fjalëformuese të standardit të shqipes.
4. Përdorimin e sllavizmave, ndonëse është dukuri që po shkon drejt zvogëlimit.
5. Si dhe përdorimin e fjalëve të huaja kryesisht të marra nga gjuha angleze dhe mund të themi se përdorimi i këtyre fjalëve të huaja është dhe problemi kryesor i medias.

Më konkretisht ndalemi në disa raste të marra nga gazetatat:

- Kemi përdorimin e emrit **siujdhesë** që gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe, cilësohet si fjalë e vjetër dhe që realisht në median shqiptare brenda kufijve nuk përdoret.

Siujdhesa ballkanike në këtë dimension

Në “Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe” (2002) kemi sqarimet:

Siujdhes/ë,-a f.sh.-a,-at vjet. Gadishull

- Gjejmë të përdorur emrin ujdhesë.

Duhen parë potencialisht ujdhesat.....

Si fjalë është në fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (2002), por nuk ka përdorim në median shqipe

Ujdhes/ë-af.sh a,-at gjeografi ishull

- Gjejmë të përdorur sintagmën *kuvendi i komunës*

Përfaqësues të komunave dhe kuvendeve të disa komunave...

Kuvend,-i hist.mbledhje burrash për të shqyrtuar çështje të rëndësishm. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, 2002)

Ndërkohë që brenda kufijve ne kemi një tjetër sintagmë: *këshilli i komunës*

Këshill,-i 2. Emërtim i disa organeve të larta të qeverisjes që kanë të drejtë urdhërdhënëse. (Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, 2002)

- Forma të vjetra dialektore gjejmë edhe në fjalët shërbyese, p.sh.: *kësisoj, karshi, anipse*

- Gjejmë emrin udhëndjekës.

.....*duhet të kenë udhëndjekës të mire*.....

Udhëndjekës- nuk e gjejmë në fjalor këtë fjalë.

Ndërkohë që kemi fjalë të tilla në “Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe”, 2002:

udhërrëfyes,-i m.sh. Ai që i tregon rrugën dikujt a drejtimin nga të kalojë, si dhe udhëtregues, udheheqës, udhëçelës, udhëpërshkrues. *Udhëndjekës* nga ana tjetër nënkupton personin që ndjek një rrugë të caktuar.

- Ndalemi te një tjetër shembull:

Në varshmëri nga kushtet natyrore

Në fjalorin e gjuhës shqipe kemi formëm:

Varësi-a.f. Të qenët nën urdhërat e dikujt, të qenit në dorë të dikujt, të qenit i varur 2. Të qenit i kushtëzuar nga diçka. * Në varësi nga...libr. Në lidhje me ..., si rrjedhim....

Nuk kemi shprehjen ... *në varshmëri*.....

- Gjejmë emrin shitore

Në gati secilën shitore apo kioskë....

Shitore, emër nuk gjendet në fjalorin e gjuhës shqipe të 2002-shit. Në këtë fjalor gjejmë shpjegime për:

Shes kal. Shita, Shitur.1. I jap dikujt një mall duke marrë prej tij një shumë parash.

Shitës-i,m,sh-it Ai që shet diçka: punonjës i tregtisë –

- Kemi përdorim të gjerë të emrit garues

..*Garuesit e KK “ Ulqini” për çdo vjet i sollën dhe po i sjellin Ulqinit shumë trofe...*(Koha Javore, 17 qershor, f.18).

Në median e Kosovës dhe të Malit të Zi e gjejmë dendur këtë përdorim, ndërkohë që në Shqipëri jo. Këtë emër nuk e gjejmë as në fjalor, aty kemi shpjegimin për emrin *garë*:

Garë/ë,-a f. sh.-a.at 1. Përpyetje për të dalë i pari në një fushë të caktuar të veprimtarisë. Takim, ndeshje ndërmjet skuadrave.

- Gjejmë emrin buajtje

... të dhëna statistikore krahasuese mbi numrin e buajtjeve të turistëve të cilët tregojnë se në Ulqinaktualisht ka 30% më pak turistë.

Në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe, 2002, kemi foljen *buj*:

Buj jokal.,-ta,-tur. Kaloj natën ose rri disa ditë diku si mysafir, banjo, fle.

- Përdorimi i fjalëve të huaja në median shqipe në Mal të Zi, është një ndër problemet kryesore. Numri i fjalëve të huaja, kryesisht të marra nga anglishtja gjenden në çdo shkrim. Për të konkretizuar këtë pohim po japim fjalët e huaja që kemi gjetur brenda një shkrimi të vetëm:

Ridefinim, dimension, obligohen, implicite, eksplicite, presupozon, aplikimi, stabilitet, alternative, konsensus, transformim, konsociative, reciprokisht, konfirmon, kompetencë, konsideroj, transformë, impresion, fleksibël, tolerohet, integrim (“Jeta sipas modelit të shtetit jurik, Koha Javore, e enjte 17 qershor 2010, f. 6).

Nëse do të bënim një listë të të gjitha fjalëve të huaja të gjetura në gazetën shqipe në Mal të Zi, sigurisht që do të kishim fjalë pa fund.

2.2 Veçori morfosintaksore

- Fjalitë në median e shkruar duhet të jenë të shkurtra. Por ajo që bie në sy në shtypin që kemi analizuar janë fjalitë e gjata, kryesisht fraza të cilat kthehen të paqarta gjuhësisht. Brenda frazës kemi përdorim herë të njëjësit e herë të shumësit, ndonëse kemi të bëjmë me fjalë përcaktuese për të njëjtin subjekt. Gjithashtu brenda frazës ka probleme me kombinimet e kohëve të foljeve.....

“ Nëse në komunën e Tivarit në zgjedhje lokale nga subjektet nacionale shqiptare si deri më tash ka marrë pjesë vetëm LDMZ e cila fitoj 749 vota dhe një mandat të këshilltarit por pa ndikimin në formimin e qeverisjes lokale, sepse koalicioni ekzistues (DPS-SDP) fitoi bindshëm(20 këshilltarë), ndryshe është situata në Komunën e Plavës....”(Koha Javore , e enjte , 24 qershor 2010, f. 5).

.. *Habia më e madhe është, e që të shtie të mendosh, ku është shkaku i mospërkrahjes?* (Koha Javore, 17 qershor, f. 18).

- Kemi një përdorim në masë të kohës së kryer në vend të kohës së kryer të thjeshtë, dukuri që ndeshet shumë edhe në shtypin shqiptar: *...paradite ka nisur takimi shumëpalësh...* duhet *paradite nisi takimi shumëpalësh*

- kemi përdorime të gabura të formave të ndryshme kohore të foljeve: *nuk duhet t'i vëjnë faj*

..*përfundimi nxjerret lehtë...* duhet ...*përfundimi nxirret lehtë.....*

- Rendi i fjalëve në fjali nuk ndjek gjithmonë rregullat e gjuhës shqipe. Shihet qartë ndikimi i gjuhëve të tjera mbi të. Në shqip përemrat pronorë vendosen përpara mbiemrave dhe mbiemrat e nyjshëm duhen vendosur rregullisht përpara të panyjshmëve. Ky rregull shpeshherë nuk zbatohet :

...*Projektin më ambioz të saj*..... duhet*projektin e saj më abicioz ...*
 ...*Nga të gjitha subjektet politike të tjera të cilat*... duhet ...*Nga të gjitha subjektet e tjera politike të cilat ...*

- Trajta e shkurtër e përemrit vetor në rasën dhanore përshtatet me numrin që ka emri apo përemri. Por në median e shkruar gjejmë të përdorur dendur trajtën e shkurtër *i* në vend të *u*-së në shumës. Përdoret gabimisht njëjësi në vend të shumësit.

...*i besojnë premtimeve*... duhet *u besojnë premtimeve*

- Shihet qartë ndikimi i serbo-kroatishtes në raste kur në vend të kundrinorit të drejtë dhe të foljes veprorë, përdoret kundrinori i zhdrejtë me folje jo veprorë:

Në vend të formës *falenderon investitorët* kemi formën *u falenderohen investitorëve*

Në vend të *lajmëroj policinë* kemi *u lajmërohen policisë*

Në të gjitha rastet kemi formën: *u lind*..... në *Ulqin*. Këtë formë e ndeshim dendur edhe në shtypin shqiptar brenda kufijve. Në shqip folja *lind* zgjedhohet jo vetëm si kalimtare (ka lindur në kohë luftime), por edhe si jokalimatre zgjedhohet sipas zgjedhimit vepror (kur ka lindur dhe jo kur je lindur). Ndërsa në gjuhët e huaja folja *lind* zgjedhohet si vetvetore

Gjejmë mjaft përdorime të tilla:

I kontribuon zhvillimit të arsimit duhet *kontribuon për zhvillimin e arsimit*

- Në shumë raste emrat që mbarojnë me prapashtesën – je përdoren gabim. Në rasën gjinore dhe dhanore të pashquar përdoren më së shumti në formës e rasës emërore

Ai u cilësua shkaktari i një humbje politike - duhet - *ai u cilësuar shkaktari i një humbjeje politike*

- Fjalët lidhëse kanë në masë të gjerë përdorim të gabuar, kryesisht në përshtatjen e përemrit lidhor *i cila/e cila* në numër, gjini dhe rasë me fjalën me të cilën lidhet. Ndeshim dendur përdorim si të përemrit lidhor ashtu dhe të emrit që zëvendëson:

Kjo sinjalizon humbjen e vlerës dhe të harmonisë. Ky veprim i mekanizmit asocion me njeriun dhe shoqërinë, e cila harmoni duhet të jetë e pranishme si një vlerë....

- Kemi mospërputhje të numrit të përemrit me fjalën që zëvendëson apo dhe përdorim gabim të rasës, p.sh.:

Vetëm me një qasje e tillë profesionale dhe institucionale, liqeni do të ruante(Koha Javore , e enjte , 24 qershor 2010, f. 12)

- Ka probleme të shumta me përdorimin e emrave të përveçëm të huaj. Kemi pothuajse të njëjtat probleme si në shtypin shqiptar.

PËRFUNDIME:

Si përfundim mund të themi se media shqip në Mal të Zi ka mjaft punë për të bërë. Është detyrë e saj që:

- të sjellë para lexuesve shqipfolës një shqipe të pastër ;
- të bëhet pasqyrë e modelit gjuhësor që duhet të ndiqet;
- të shmangë ndikimet gjeopolitike në gjuhën shqipe.

Nga ana tjetër duhet të theksojmë dhe një meritë të medias shqipe në Mal të Zi: pasurimin që po i bën leksikut të sotëm të shqipes duke përdorur fjalë të vjetra shqipe, të cilat kanë dalë nga përdorimi.

Zhvillimi i gjuhës vjen gjithmonë si mjet i zhvillimit të shoqërisë njerëzore, i bashkësisë shoqërore përkatëse, ndaj dhe ndryshimet në gjuhë nuk mund të ndalen. E rëndësishme është që gjuha të lëvizë mbi shtratin e vet dhe të mos e humbasë identitetin. Prof. Eqerem Çabej është shprehur kështu për rëndësinë që ka gjuha për një komb. “*Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj Kulture.*”²²⁸

BIBLIOGRAFI:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe, 1&2*, Tiranë, 2002.
2. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Fjalor i Shqipes së sotme*, botimet “Toena”, Tiranë, 2002.
3. Çabej, E, *Për pastërtinë e gjuhës*, Gjuha Jonë, Tiranë, 1981.
4. “*Koha javore*”, gazetë javore për aktualitet, shkencë dhe kulturë, themelues: Kuvendi i Republikës së Malit të Zi (viti 2003 dhe viti 2010).
5. Shkurtaj, Gj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003.
6. Shkurtaj, Gj, *Kultura e Gjuhës*, Tiranë, 2006.

²²⁸ E.Çabej, për pastërtinë e gjuhës, në “Gjuha jonë” 1, 1981, f. 36-47.

7. Wolton. D, *Të shpëtojmë komunikimin*, Tiranë, 2009.

An overview of Albanian language media in Montenegro

SUMMARY

Communicating doesn't only mean producing and distributing information, it also means being sensitive to the conditions in which the receiver receives the message, means being sensitive to the linguistic form used to deliver this message, because the media affects directly the readers. Language evolves under the influence of the needs that people have to realize the communication between them and the media immediately reflect these impacts. Every political and economic change in one's life-speaking community is a "knock" for change in the respective language. Such a fact has prompted us to look closely what happens in particular with the Albanian language in such a situation. For this purpose we selected Albanian media in Montenegro, based on the geopolitical characteristics of this area.

Sokol AXHEMI

ASPEKTE TË ZHVILLIMIT TË POPULLSISË SË SHKODRËS

HYRJJE

Një ndër tematikat më të rëndësishme si nga pikëpamja shkencore ashtu edhe nga ajo praktike në kuadrin e një hapësire sociogjeografike, është popullsia dhe studimi i saj. Në këtë këndvështrim lidhur ngusht me rolin që ajo luan, jemi ndalur në një trajtim të përgjithshëm të disa aspekteve që lidhen me zhvillimin e popullsisë së Shkodrës në vite. Theksojmë se një tematikë e tillë është e gjerë dhe e shumanshme në trajtimin gjeografik studimor. Kjo lidhet me faktin jo vetëm të elementeve përbërës të zhvillimit dhe të evolucionit të popullsisë së Shkodrës në vite, faktorët e ndryshëm e të larmishëm që kanë ndikuar, popullimin e hershëm të tij, por njëkohësisht me rolin e këtij qyteti sa të lashtë e të vjetër në zhvillimet rajonale.

Vlerësojmë se në kuadrin e evidentimit të problematikave të ndryshme, pjesë përbërëse e zhvillimeve popullore të hapësirave të caktuara, në rastin e Shkodrës, kemi treguar kujdesin e duhur për të dhënë gjithnjë në varësi të informacionit të grumbulluar, vetëm pjesën që i takon qytetit dhe jo të emërtimeve të tjera administrative (në trajtën e rrethit apo të qarkut). Një gjë e tillë në disa raste paraqitet e vështirë, lidhur ngusht me faktin e evolucionit administrativ që ka kaluar në vite, në tërësinë e zhvillimit dhe evolucionit të saj qyteti i Shkodrës. Vështirësia shtohet edhe më tepër kur marrim në konsideratë shtrirjen gjeografike të emërtimeve Shkodër, dhënë e trajtuar përgjatë shekujve nga autorë vendas e të huaj. Gjithsesi studime më të detajuara dhe me tematika të veçanta, për elemente të veçantë të popullsisë në të ardhmen, do të ndihmojnë qartazi në daljen në pah të tipareve të popullsisë së Shkodrës.

POPULLSIA E SHKODRËS DERI NË FILLIMIN E VITEVE 1990

Siç e theksuam edhe më lart Shkodra ka qenë një nga rajonet më të populluara të vendit dhe njëkohësisht rajoni kryesor i Shqipërisë së veriut. Popullsia e saj ka qenë kryesisht e ndikuar nga tendencat rritëse, lidhur

ngusht me ndikimin që ka pasur lëvizja natyrore e popullsisë. Një gjë e tillë me sa duket shpjegohet me faktin e pranisë apo të ekzistencës së popullsisë së mbyllur, ku edhe pse kemi pasur zhvendosje popullsie, kjo ka qenë e limituar, dhe jo aq ndikuese në rritjen apo shtimin ose pakësimin e popullsisë. Legjislacioni i periudhës së shtetit të centralizuar nuk përfshinte lëvizjen e pakontrolluar të popullsisë, përkundrazi ishte e pranishme lëvizja e planifikuar e saj. Karakteri sporadik i migrimit të popullsisë, më tepër ka qenë i lidhur ngushtë me transferimet për efekte punësimi në sektorë të ndryshëm të administratës shtetërore të kohës.

Megjithatë ndryshime dhe lëvizje të ndryshme popullsie janë evidentuar në periudha të ndryshme. Një evidentim i tillë mund të dalë më në pah në kuadrin e një studimi më të gjerë e të detajuar, ku të përfshihen tërësia e ndryshimeve të popullsisë së Shkodrës, që nga krijimi i saj e deri në ditët tona. Një gjë e tillë do të kërkonte edhe njëfarë periodizimi demografiko-historik, aq i nevojshëm e i domosdoshëm në studime të tilla. Megjithatë, shkurtimisht po mundohemi të paraqesim një evolucion të tillë të popullsisë deri në fillimin e vitit 1990.

Duhet theksuar se materialet që lidhen me evolucionin e ndryshimit të popullsisë së Shkodrës kanë njohur në vite autorë e studiues të shumtë, politikanë e diplomatë të huaj, gjeografë e historianë nga më të ndryshëm. Ato janë të pasqyruara në një numër studimesh e botimesh. Ndër to vlen të theksohen një sërë materialesh burimore e arkivale, e një literature të gjerë studimore, që nga relacioni i Mariano Bolices i shekullit XVII, kronikanit turk Evlia Celebiu, e deri tek studiuesit e diplomatet e shekullit XVIII–XIX, si: Armao, Pukevil, Hekar, Degrand, etj. Po kështu kemi një numër studimesh e artikujsh të studiuesve vendas, si: Bushati, Anamali, Axhemi, Dema, etj. Vlejnë të përmenden gjithashtu edhe mjaft botime zyrtare të kohës siç ishte edhe salnamet e vilajetit të Shkodrës, vjetari orientali i tregtisë i viteve të fundit të shekullit XIX, si dhe regjistrimet e popullsisë, sidomos të fillim viteve të shekullit XX, statistika e publikime të INSTAT, vjetarët statistikorë të organeve të pushtetit lokal të Shkodrës, etj. Mbi bazën e tyre krijohen përshtypjet e para në lidhje me Shkodrën e periudhave të ndryshme, popullsinë që ka qenë e pranishme në të, shtrirjen dhe shpërndarjen gjeografike të saj.

Fakte interesante për popullsinë e Shkodrës paraqet relacioni i Mariano Bolices i 1614, i cili na jep informacione për Shkodrën deri në shekullin XVII. Ky relacion hedh dritë mbi mjaft të dhëna të hershme për popullsinë e qytetit, shtrirjen e tij dhe ndarjen që kishte ekzistuar më parë. Sipas Bolices qyteti i hershëm i Shkodrës përfshinte në vetvete rreth 400 shtëpi, si dhe rreth 1000 burra armet.

Informacione të tjera për Shkodrën e fundshekullit XVII e fillimshkullit XVIII vijnë nga një studiues tjetër i huaj, siç ishte F.Cordinjano. Ky studiues në punimin e tij të titulluar “*Catasto Veneto di Scutari*” na jep opinione mjaft të vlefshme për kohën mbi popullsinë e Shkodrës dhe ndarjet e saj administrative. Cordinjano thekson se Shkodra e kësaj periudhe përfshinte në numrin e saj të popullsisë rreth 20 mijë të banorëve. Theksojmë se sipas tij, 20 mijë banorët, popullonin Shkodrën, në çerekshkullin e tretë të shekullit XVII.

Tendencat rritëse të popullsisë së Shkodrës evidentohen edhe nga të dhëna të tjera të kohës së mëvonshme. Një kronikan i kohës, studiuesi e biografi turk Evlia Celebiu, vlerëson një rritje të popullsisë së Shkodrës, teksa në shënimet e tij vlerëson se Varoshi ka një numër të konsiderueshëm shtëpishë, afro 1800, si dhe numëron rreth 50 lagje. Gjithashtu një vlerësim i tillë i nxjerrë nga Celebiu mund të jetë një shtysë që mund të na çojë drejt një përfundimi ku Shkodra krahas rritjes së numrit të popullsisë, ajo vazhdonte të ishte e përqendruar drejt një qendre të vetme, që për kohën ishte kalaja e Shkodrës.

Një studiues tjetër Armao në shënimet e tij është përpjekur të japë argumentet e tij në lidhje me shtimin e shpejtë që ka pësuar popullsia e Shkodrës. Një nga argumentet kryesore mbështetës për rritjen e rëndësishme që po pësonte Shkodra, Armao e lidh me zhvendosjet në vazhdimësi që po ndodhnin nga popullsia në drejtim të territoreve veriore të qytetit, kryesisht në fushat që shtriheshin ndërmjet liqenit nga njëra anë dhe lumit të Kirit nga ana tjetër. Madje një argument tjetër, i cili shërben edhe si një dëshmitar i rëndësishëm për të vërtetuar një hipotezë të tillë është fakti se në disa prej shtëpive të ndërtuara në këto territore janë të ruajtura mbishkrime murale të kohës së ndërtimit të tyre, që i përkasin periudhave të fundshekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX.

Një studiues tjetër i huaj, është Pukevil, i cili në librin e tij “*Voyage de la Grece*”, vëllimi i parë, e vlerëson Shkodrën në rreth 24 mijë banorë. Të dhëna për popullsinë e Shkodrës në shekullin XIX jepen nga ana e Degrand dhe Hekar. Ish konsulli francez në Shkodër, në fund të shekullit të XIX, A.Degrand, në shënimet e tij se Shkodra përfshin në popullsinë e saj rreth 52 mijë persona. Një tjetër ish konsull francez në Shkodër, H.Hekar, tepër i interesuar për të gjetur e grumbulluar informacione kulturore, historike e gjeografike për Shqipërinë, ndër të tjera shkruan për Shkodrën, në një libër të botuar prej tij. Ky diplomat francez në librin “*La Haute Albanie*” jep numrin e rreth 38 mijë banorëve për Shkodrën e viteve 1850. Madje ajo çfarë duhet vlerësuar tek ky autor është se ai krahas aspekteve të

cilat lidhen me numrin e popullsisë, mundohet të paraqesë edhe të dhëna të grumbulluara për ndarjen administrative të asaj kohe, ku jep informacion për numrin e shtëpive, lagjet dhe rrethinat e Shkodrës. Kështu Hekar vlerëson se “...Shkodra numëron 4500 shtëpi, ndër të cilat 3000 myslimanë, 1400 katolikë, 100 shtëpi ortodokse....Asht e ndame (Shkodra) ndër 10 lagje: Tabaket, Tepeja, Ajasma, Qafa, Bahçalleku, Bërdica, Kuçi, Dobraçi, Golemi, Rusi...” (H.B., Shkodra dhe Motet,Vëllimi II, f. 39).

Ajo çka duhet vlerësuar në të dhënat për problematikat e popullsisë së Shkodrës nga autorë të ndryshëm, të cilët përmendëm më lart, duhet theksuar se krahas informacionit që ato sollën, që përbën realisht kontribut për njohjen e popullsisë së qytetit në vite, ato u munduan që herë pas here në punimet e tyre të paraqesin edhe shkaqet e tendencat e popullsisë së Shkodrës në vite. Në këtë mënyrë duke evidentuar faktorët përkatës, që ndikonin në ndryshimet e numrit të popullsisë, shpërndarjen dhe shtrirjen e saj në territoret e veçanta, zhvendosjet që pësonte popullsia nën efektet e ndryshme, në mënyrë të veçantë sëmundjet e ndryshme epidemike, si dhe zhvendosjet e popullsisë dhe të vendbanimeve nga ndryshimet e rrjedhjes së Drinit, janë treguesit kryesorë të faktit të rëndësisë shkencore dhe historike të dokumenteve të servitura nga ato.

Krahas autorëve të përmendur më sipër vlerë dokumentare për popullsinë e Shkodrës marrin kryesisht salnamet e vilajetit të Shkodrës, disa regjistra të përcaktuar apo emërtuar si “*Tahriri emlaqit*”, dokumente të komandës ushtarake turke që ishte e vendosur në Shkodër, si dhe vjetarët orientale të tregtisë. Kjo është e lidhur edhe me mungesën e një regjistrimi zyrtar të popullsisë deri në atë kohë. Kështu nga këto burime mund të citojmë vjetarin oriental të tregtisë së vitit 1895 që na jep Shkodrën me rreth 36 mijë banorë, salnamja e vitit 1892 e jep Shkodrën të ndarë në 12 lagje myslimane dhe 2 lagje katolike, etj.

Një situatë e ndryshme na paraqitet në fillimet e shekullit XX. Duket nga hulumtimet sporadike të realizuara në të dhënat e nxjerra nga studiuesit e ndryshëm se në dy apo tre dekadat e para të këtij shekulli popullsia e Shkodrës i nënshtrohet tendencave rënëse të popullsisë. Gjeografia Bresena Dema në punimin e saj mbi popullsinë e Shkodrës, informon për një situatë demografike të popullsisë në shifrat 21580 banorë në 1923, 25293 banorë në 1938 dhe 34300 banorë në 1945. Me sa duket shifra të tilla kanë të bëjnë me problematikën e pasur e të gjerë nga pikëpamja ekonomike e sociale që Shkodra e kësaj periudhe kishte kaluar në vetvete në tërësinë e zhvillimit të saj.

Periudha 1945 deri në fillimin e periudhës së tranzicionit shoqërohet me rritje graduale të popullsisë. Kështu nga rreth 33018 persona në 1950,

popullsia e 1960 arriti në rreth 42451 vetë, ndërsa në 1980 në 66396 persona, duke kulmuar në 1990 në 75104. Rritje të tilla të numrit të popullsisë evidentohen lidhur ngusht kryesisht me raportet pozitive të shtesës natyrore të popullsisë. Megjithatë tipari kryesor i zhvillimeve të popullsisë është i lidhur me praninë e popullsisë së mbyllur, ku lëvizjet migrative apo zhvendosëse të saj ishin të centralizuara dhe sporadike.

FAKTORËT NDIKUES NË ZHVILLIMIN E POPULLSISË SË SHKODRËS NË PERIUdhËN E TRANZICIONIT

Fillimi i viteve 1990 patjetër, ashtu si edhe në drejtime të tjera do të kishte ndikimin e vet edhe në popullsi dhe elementët e saj. Madje duhet vlerësuar fakti se situata të tilla demografike, përfshijnë në tërësinë e tyre mjaft prej vendeve që u bënë pjesë e zhvillimeve politiko-ekonomike, kryesisht të Evropës Lindore, pas rënies së murit të Berlinit. Proceset migrative, problematikat sociale që u shfaqën ndikuan në mënyrë “agresive” në zhvillimet e popullsisë të regjioneve të ndryshme që u përfshinë nga tranzicioni, ku padyshim përfshihet edhe Shqipëria. Në këtë këndvështrim edhe rajoni ynë në studim, Shkodra, paraqiti veçoritë e saj, lidhur ngushtë e ndikuar si nga faktorët e përgjithshëm kombëtare, ashtu edhe nga ato lokale.

Fenomeni i parë që u vu re në mënyrë të menjëhershme ishte i lidhur ngushtë me emigrimin masiv që u realizua nga një pjesë e popullsisë së Shkodrës. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim pati në mënyrë të veçantë migrimi i përgjithshëm i popullsisë shqiptare në këtë periudhë, ku edhe peshat specifike e migracionit të Shkodrës (lidhur ngusht me numrin e madh të popullsisë ku Shkodra ishte qyteti më i madh në veri të vendit), është e konsiderueshme. Vlerësojmë se destinacionet kryesore migrative nga ku largoheshin kishin të bënin edhe me faktin e largësisë së shkurtër nga Shkodra të “epiqendrave” migrave, siç ishin Tirana (në rastin e “ambasadave”, si dhe Durrësi e Shëngjini gjatë largimit me anije.

Duhet theksuar se sidomos peshë të konsiderueshme në kuadrin e strukturës moshore të popullsisë e zuri kryesisht moshat e rinisë. Ndërsa në drejtim të pranisë së fenomenit migrativ në kuadrin e strukturës gjinore të popullsisë mbizotëruese ishte gjinia mashkullore në raport me atë femërore. Regjistrimet e mëvonshme të popullsisë së Shkodrës janë treguesit kryesorë statistikorë që e vlerësojnë një situatë të tillë migrative, si në raportet e strukturës moshore, ashtu edhe të asaj gjinore.

Padyshim që situata të tilla të zhvillimit të popullsisë së një rajoni të caktuar u ndikuan nga faktorë të ndryshëm, të cilët në mënyra nga më të larmishmet shërbyen për të krijuar panorama të tilla demografike. Në këtë drejtim faktorët kryesorë ndikues ishin të lidhur ngushtë, kryesisht me tre elemente të rëndësishëm prezentë në këtë rajon: gjendjen e vështirë ekonomike në të cilën ndodhej Shkodra në këtë periudhë, numrin e madh të të rinjve të papunë, si dhe hapja e “*dyerve*” që deri atëherë konsideroheshin tabu për të gjithë popullsinë shqiptare.

Së pari, gjendja e vështirë ekonomike po shoqëronte Shkodrën, sidomos në periudhën e dhjetëvjeçarit 1980-1990. Ashtu siç janë shprehur ekonomistët e ndryshëm, studiues të politikave ekonomike të ndjekura në vendin tonë, edhe Shkodra nuk mund të bënte përjashtim nga kriza ekonomike në të cilën ishte zhytur ekonomia shqiptare para periudhës së tranzicionit. Një gjë e tillë rëndoi dukshëm edhe jetesën e mjaft prej familjeve të këtij qyteti.

Së dyti, këto zhvillime negative ekonomike ndikuan dukshëm edhe në shtimin e radhës së të papunëve në qytetin e Shkodrës. Edhe pse për shkak të regjimit politik ekzistues, papunësia nuk evidentohej, përsëri viheshin re prani teprica në kuadrin e forcave prodhuese të afta për punë. Në mënyrë direkte kjo evidentohej në radhët e pjesëtarëve të ndryshëm të familjeve të këtij qyteti. Ritmet e shtimit të popullsisë së Shkodrës gjatë kësaj periudhe u shoqëruan me prezencën e një popullsie, e cila paraqitej tepër vitale në drejtim të moshës. Moshja e re përbënte tiparin mbizotërues në popullsinë e Shkodrës, por vitaliteti i saj evidentonte faktin se po shkonte gjithnjë e më tepër përjashtim të zhdrejtë me hapjen e fronteve të reja të punës në qytet.

Theksojmë se edhe pse i përfshirë në një nga qytetet më të industrializuara të vendit, gradualisht në Shkodrën e periudhës së paratranzicionit, po vihej re gjithnjë e më shumë, një zhvillim ekonomik, i cili me përjashtim sporadik në disa industri, siç ishin ato të përpunimit të telave, cigareve, ushqimore apo përpunimit të drurit, degët e tjera të industrisë nuk po jepnin efektivitetin e duhur, e njëkohësisht nuk po zgjeroheshin. Një gjë e tillë nuk siguronte në mënyrë ritmike hapjen e fronteve të reja të punës dhe nuk krijonte mundësi për zënien me punë të forcave prodhuese, duke krijuar në këtë mënyrë edhe teprica të tyre në këtë drejtim.

I vetmi variant punësimi gjatë kësaj periudhe, që duhej konsideruar edhe si mundësi për shfryrjen e këtij problemi të rëndësishëm social evidentohej punësimi në sektorin bujqësor. Por theksojmë se një gjë e tillë pak u përkrah dhe u konsiderua si një profesion jo i pëlqyer nga ana e mjaft

të rinjve e moshave të tjera për punë, të pranishme në kuadrin e forcave prodhuese të Shkodrës së 1980-1990.

Fenomeni migrativ që përfshiu qytetin e Shkodrës me fillimin e periudhës së tranzicionit, është i lidhur ngushtësisht me dy faktorët e mësipërm. Problemet ekonomike dhe papunësia ndikuan në mënyrë të qartë dhe të shpejtë, që një pjesë e popullsisë së këtij qyteti, të gjejë rrugën e shpëtimit dhe plotësimit të nevojave individuale e familjare në destinacione të tjera, jashtë vendit. Njëkohësisht me këto dy faktorë ndikon dukshëm edhe faktori social e psikologjik, kur të çliruar mbase nga ajo ndjenjë e izolimit, mjaft të tjerë menduan braktisjen e tij dhe ndërtimin e një jete të lirë e të çliruar jashtë kufijve të vendit, në vende të tjera, destinacione të rëndësishme migrimi të popullsisë në Evropë apo jashtë saj.

Por theksojmë se krahas migrimit të jashtëm një ndikim të konsiderueshëm në zhvillimet e popullsisë së qytetit të Shkodrës paraqet edhe migrimi i brendshëm. Migrimi i brendshëm paraqitet mjaft interesant nga pikëpamja e studimit të tij, lidhur ngusht me veçoritë dhe tiparet karakteristike që ai shfaq në tërësinë e ecures së tij. Në mënyrë të veçantë evidentohet me mjaft vlera shkencore mënyra e realizimit të tij dhe drejtimet që ai u shfaq. Theksojmë se një dukuri e tillë migrative u shoqërua më pas edhe me mjaft pasoja të rëndësishme jo vetëm në drejtim të tipareve të zhvillimit të popullsisë së Shkodrës në periudhën e tranzicionit, por në mënyrë të veçantë në problematikat sociale që e shoqëruan atë.

Migrim i brendshëm në rajonin e Shkodrës u evidentua në dy kahje të rëndësishme të shprehjes së tij. Drejtimi i parë, i cili pati një vlerë të konsiderueshme në treguesit e zhvillimit të popullsisë, sidomos në qytetin e Shkodrës, i përket ardhjeve të shumta të popullsisë me destinacion vetë qytetin e Shkodrës dhe sidomos pjesët periferike të tij. Këto ardhje migrative kishin origjinën e tyre në mënyrë të veçantë nga zonat rurale të Shkodrës, dhe më pak nga qytetet e tjera veriore, që orientoheshin në drejtim të qytetit të Shkodrës.

Drejtimi i dytë është i lidhur ngushtë me faktin se krahas ardhjeve migrative në drejtim të Shkodrës edhe popullsia e Shkodrës nuk shërbeu vetëm si destinacion migrimi, përkundrazi në mjaft raste ajo u kthye në një origjinë të rëndësishme migrative për banorët e saj. Evidentohen gjatë kësaj periudhe zhvendosje të popullsisë nga qyteti i Shkodrës në drejtim të qyteveve të tjera të vendit, ku destinacioni kryesor mbetet kryeqyteti, Tirana.

TIPARE TË POPULLSISË SË SHKODRËS NË PERIUdhËN E TRANZICIONIT

Të gjithë këto faktorë të përmendur më sipër, diku në mënyrë të hapur e diku tjetër në mënyrë të fshehur, luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin e popullsisë së rajonit tonë në studim. Madje këto zhvillime ishin aq të rëndësishme saqë formësuan edhe panoramën e zhvillimit të popullsisë të qytetit të Shkodrës në periudhën e tranzicionit. Megjithatë vlerësojmë faktin se nën ndikimin e këtyre faktorëve edhe popullsia e Shkodrës rezultoi me disa tipare apo veçori karakteristike, të cilat po mundohemi t'i paraqesim më poshtë në varësi të informacionit të grumbulluar.

Kështu tipari kryesor mbizotërues i popullsisë së qytetit të Shkodrës është fakti se edhe pse ndodhen këto lëvizje migrative të dyanshme të popullsisë, përsëri popullsia e saj ka ardhur gjithnjë duke u rritur ndikuar nga mjaft faktorë të brendshëm. Kështu burimet zyrtare të Bashkisë Shkodër (referencë studimi i B.D), informon se popullsia e qytetit të Shkodrës në 1989 rezultoi në rreth 84.316 banorë, ndërsa në 2001 në 106.924 banorë dhe në 2005 në 112.440 banorë. Tregues të tillë, në të njëjtën kohë, shprehin faktin se popullsia e qytetit të Shkodrës ka shfaqur tendencë pozitive në drejtim të shtimit të popullsisë, duke ardhur nga viti në vit në rritje. Ndikimi në këtë drejtim me sa duket ka qenë i lidhur ngushtë me dy drejtime kryesore, nga njëra anë ritmet e shtimit natyror të popullsisë dhe nga ana tjetër migrimi.

Statistikat e nxjerra vlerësojnë se nën ndikimin e migrimit të brendshëm popullsia e këtij qyteti është shtuar nga viti në vit. Një gjë e tillë me sa duket ka shërbyer në dy drejtime të rëndësishme për të rekuperuar problematikat e zhvillimit të popullsisë, që lindën nën efektin e migrimit të jashtëm që prekën këtë qytet. Kështu së pari ato mbuluan në kuptimin fizik apo numerik largimet e realizuara, dhe së dyti rregulluan edhe shqetësimet demografike të shprehura në strukturën moshore, gjinore, lëvizjen natyrore, martesat, lindshmërinë, etj.

Së dyti, në drejtim të shtimit të popullsisë, ritmet ndonëse kanë ndryshuar nga viti në vit, përsëri në tregues janë pozitive. Rritjet më të mëdha të shtimit të popullsisë janë evidentuar në mënyrë të veçantë gjatë viteve 1996 dhe 1997, respektivisht në vlerat e 3.53% dhe 2.35%. Të shprehura në vlera absolute rritja e realizuar në qytetin e Shkodrës për secilin vit, respektivisht ka qenë 3305 banorë në vitin 1996 më shumë se

një vit më parë dhe 3276 banorë më shumë në 1997 se në 1996 (referencë studimi i B.D.). Theksojmë se një shtim i tillë i popullsisë i dedikohet të dy elementëve të përmendur më sipër, si efektit të shtimit natyror, ashtu edhe atij migrativ.

Së treti, në drejtim të shtimit natyror të popullsisë, popullsia e Shkodrës gjatë periudhës së tranzicionit është shfaqur me lëkundje serioze, si në drejtim të tendencës së kësaj shtese natyrore, ku duhen evidentuar luhatjet e shumta të saj gjatë këtyre viteve, ashtu edhe në drejtim të luhatjeve të evidentuara në elementët përbërës të kësaj shtese natyrore, që janë lindjet dhe vdekjet. Shtesa natyrore më e madhe sipas viteve është evidentuar në vitet 1994 dhe 1996, respektivisht e shprehur në vlera absolute 1023 banorë dhe 1034 banorë. Ndërsa shtesa më e ulët është evidentuar në vitet 1999 dhe 2005, respektivisht në vlerat absolute të 650 banorëve dhe 713 banorëve.

Megjithatë në vështrimin e përgjithshëm shtesa natyrore e popullsisë së Shkodrës ka shfaqur luhatje të tilla, ku në krahasimin ndërmjet viteve, në vite të veçanta evidentohen herë shtesa natyrore më të larta se një vit më parë dhe herë shtesa natyrore më të ulëta së një vit më parë. Në mënyrë konkrete shtesa natyrore e evidentuar në vitin 1992 është 923 banorë, ndërsa një vit më vonë, pikërisht në 1993 kjo shifër absolute zbret në 898 banorë, ndërsa në 1994 rritet në 1034 banorë.

Po kështu situata të tilla në lidhje me shtimin natyror të popullsisë vihen re edhe në vitet e tjera, të përfshira në periudhën e tranzicionit. Me sa duket situata të tilla të ndryshimit dhe të luhatjes së elementeve apo treguesve të ndryshëm të zhvillimit të popullsisë janë të lidhur ngushtë me faktin e zhvillimeve të ndodhura në vetë popullsinë e qytetit të Shkodrës. Në mënyrë të veçantë rol të rëndësishëm kanë luajtur faktorët migrativë, kryesisht të brendshëm, të cilët kanë ndikuar edhe në luhatjet e evidentuara. Në kuadrin e marrjes në konsideratë të një prej elementeve më të rëndësishëm, ndikues në shtesën natyrore të popullsisë, siç janë lindjet mund të evidentojmë tiparin kryesor që e ka shoqëruar një element të tillë gjatë gjithë viteve të periudhës së tranzicionit. Luhatja e tyre në trajtën e një kurbe rritëse në fillim të periudhës së tranzicionit, duke arritur kulmin e saj në vitin 1997, në të cilin është evidentuar edhe numri më i madh i lindjeve në rreth 1644, ndërsa në vitet e mëpasme tendenca shprehëse është rënia graduale e tyre duke arritur në numrin më të ulët të lindjeve të regjistruara në vitin 2005 në rreth 1291 banorë.

LITERATURA:

1. Axhemi, Sokol: Aspekte ekonomike, sociale e demografike të territoreve kufitare të rajonit të Shkodrës. Studime gjeografike nr.15, 2005.
2. Axhemi, Sokol: Disa konsiderata mbi evolucionin e popullsisë së Shkodrës. Studime gjeografike nr.18, 2007.
3. Bushati, Hamdi: Shkodra dhe Motet, Vëllimi I- II, Shkodër, 1998, 2000.
4. Dema, Bresena, Vështrim demografik dhe social ekonomik i qytetit të Shkodrës. Material dorëshkrim, studim master, Tiranë, 2007.

Aspects of development of the population of Shkodra

SUMMARY

There are some points where geography, as scientific disciplines play a role in practice aspects. In this article we try to give a role of social geography, especially in formulation of practice knowledges to the students. Especially, we give some examples that connection with the role of environment, society, role of the human activity, in the life of different social groups. It is very important the role of the human activity, social effects of this activity in the sociogeographic space, that we underline in this article.

Zemaida KASTRATI (Mozali)**PSE DUHET TA NJOHIM DHE STUDIOJMË
BASHKIMIN DHE INTEGRIMIN EVROPIAN**

Qasja që kemi sjellë në këtë artikull, synon t'i sjellë lexuesit një sintezë të kuptueshme dhe të qartë të këtij organizmi që quhet Bashkim Evropian, si dhe procesit që ka sjellë këtë organizëm. Pa harruar këtu impaktin që kanë direkt në jetën e përditshme të qytetarëve, qofshin ata evropianë, qofshin në procesin e pranimit në Evropë.

Debati që ka shoqëruar gjithnjë zhvillimet në Evropën e Bashkuar, ka pasur në bazë përplasjet mes sovranitetit shtetëror dhe nivelit mbikombëtar. Kur studiohen marrëdhëniet ndërkombëtare, mësojmë se kjo fushë ka të bëjë me marrëdhëniet midis qeverive të botës. Integrimi ndërkombëtar ka të bëjë me procesin nëpërmjet të cilit institucionet mbikombëtare fillojnë të zëvendësojnë ato kombëtare, pra me zhvendosjen dalëngadalë të sovranitetit shtetëror në drejtim të strukturave rajonale apo botërore. Këtu do doja të bëj një sqarim, pasi duhet ndarë integrimi ndërkombëtar nga ai evropian. Kuptohet se i dyti është pjesë e të parit, por ajo që i diferencon këto dy shkallë integrimi është niveli, pra nëse i pari është më i gjerë, pra në nivel ndërkombëtar, i dyti i referohet një niveli më të kufizuar, pra nivel që kufizohet brenda një kontinenti.

Është diçka që normalisht dhe me logjikë kërkon kohë dhe ndesh në vështirësi të mëdha. Kjo, pasi është shumë e vështirë për çdo shtet, për çdo politikan, të zhvendosë autoritetin dhe vendimmarrjen nga niveli kombëtar, në atë që quhet mbikombëtar apo sopranacional. Po kështu, një gjë e tillë mund të thuhet edhe për qytetarët, të cilët gradualisht duhet të spostojnë "shikimin" e tyre nga politikanët vendas në ato evropianë. Si proces, integrimi ka filluar pjesërisht si rezultat i dobësimit të njësive feudale të vogla, të cilat nuk mund ta mbanin më forcën politike dhe autonominë. Është një sistem evolues, të cilin, për efekte studimi, John Rourke e fillon ta trajtojë që në fillim të shek. XV.²²⁹ Ndërkohë që dinamika e sistemit

²²⁹ Shih për më tepër John Rourke, *International Politics on the World Stage*, ninth edition, University of Connecticut, 2003, f. 28, 41, 44, 45.

ndërkombëtar po përcaktohet gjithnjë e më shumë jo nga shtetet, si të vetmit aktorë të rëndësishëm në këtë sistem. E parë kjo në sistem global, sipas shumë analistëve, ka shumë forca politike, ekonomike dhe sociale, ”forcat e McWorld (Bota e Mek-ëve)”, të cilat po thejnë rëndësinë e autoritetit të shtetit dhe po e lëvizin botën drejt një shkalle më të lartë të integritimit politik, ekonomik dhe social. Integrimi politik, p.sh., është evident në një numër gjithnjë në rritje të organizatave ndërkombëtare. Integrimi ekonomik, ndërthurja e ekonomive kombëtare në ekonominë botërore do të thotë se vendet janë gjithnjë e më shumë të pazotët për të qenë të vetëmjaftueshëm (self-sufficient). Kjo ka sjellë atë që quhet ndërvarësi (interdependence) ekonomike. Duke mos harruar se, vjen një pikë në integrimin ekonomik kur ka presion për të ndërmarrë hapa drejt një integritimit politik. Kjo, po sipas teorisë së Rourke, pasi është e pamundur të arrihet një integrim i plotë ekonomik ndërmjet shteteve të pavarura, politika e jashtme apo e brendshme e të cilëve, mund të jetë ndonjëherë në konflikt. Për më tepër, ndërsa njerëzit bashkohen ekonomikisht, është më e thjeshtë të bëhet një gjë e tillë edhe politikisht.

Në qoftë se i referohemi historisë së krijimit të kombeve, do të shohim se, fillimisht kemi format primitive të organizimit të shoqërisë, duke kaluar pastaj nëpër fazat e ndryshme historike, kur lindën fillimisht qytet-shtetet dhe pastaj shtetet. Në shekullin XIX kemi krijimin e shteteve-kombe, kohë kur filloi të krijohet identiteti kombëtar, duke futur këtu kulturën, historinë, zakonet, gjuhën. Shtetet, gjatë historisë dhe raportet ndërmjet tyre kanë qenë bashkekzistente (qëndrimi i shteteve pranë njëritjetrit) e me kohë kalojnë në raporte bashkëpunimi (kooperimi mes shteteve) dhe sot, gjithnjë e më shumë, flitet dhe veprohet për integrim. Pra kemi një kalim gradual nga njëra fazë në tjetrën, pra një proces historik koekzistencë-kooperim-integrim të shteteve.

Me fillimet e Bashkimit të ”Shteteve të Evropës” fillon një lloj i ri integritimi, i cili shënon një prirje të re të zhvillimeve. Kështu në Evropë filloi një proces i ri i integritimit, më së pari ekonomik. Kuptohej që integritimi politik do të vinte si rezultat i integritimit ekonomik. Ky proces njihet si teoria (neo)-funktionaliste e integritimit. Kjo teori është e lidhur ngushtë me ndikimet e saj në rregullimet dhe raportet brendashtetërore. Shtetet e Bashkimit Evropian (Unioni Evropian) në fillim të procesit të integritimeve në Evropë, kanë mbartur më lehtë sovranitetin e tyre ekonomik në organet mbinacionale, ndërsa sa i përket sovranitetit politik, shtetet anëtare kanë ngurruar dhe ende ngurrojnë, që ky sovranitet përfundimisht të

mbartet në nivelet mbikombëtare. Sipas Joshua Goldshtein²³⁰, i cili studion dhe "zbulon" marrëdhëniet ndërkombëtare, shembulli më i suksesshëm i integritit deri tani, megjithëse edhe ky sukses është vetëm i pjesëshëm (duke pasur këtu parasysh sfidat dhe problematikat që e kanë shoqëruar gjithmonë), është Bashkimi Evropian. Kjo justifikohet me faktin se, me të drejtë shtetet e kanë të vështirë të lëshojnë nga autoriteti, identiteti i tyre, nga kompetencat e tyre.

Është interesant këndvështrimi tjetër, i cili sillet dhe trajtohet nga Fukujama, që lidh parimin e sovranitetit dhe gërryerjes se tij me qeverisjen e dobët. Sipas tij, problemet që krijojnë shtetet e dobëta për veten e tyre dhe për të tjerët rrisin konsiderueshëm mundësinë që dikush tjetër në sistemin ndërkombëtar të ndërhyjë në çështjet e tyre të brendshme, në kundërshtim me dëshirat e tyre. Fjala *i dobët* i referohet forcës së shtetit, pra mungesës së kapacitetit institucional për të zbatuar politikën, shpesh e shtyrë nga një mungesë themelore e legjitimitetit të të gjithë sistemit politik.²³¹ Këtij argumenti, po ky autor, i shton një tjetër po kaq interesant, atë të legjitimitetit demokratik në nivel ndërkombëtar, si edhe diferencën që ekziston mes Evropës dhe SHBA-së rreth këtij legjitimiteti. Kjo, pasi evropianët i shohin organizatat ndërkombëtare (BE-në) si rojtare të një të mire globale të përbashkët që mbizotëron ndaj dëshirave të kombeve-shtet individuale. Sipas kësaj teorie, ashtu si shteti në nivel kombëtar ruan autonomi të konsiderueshme në vendimmarrje në të mirë të publikut, po kështu edhe evropianët kanë tendencën t'u japin më shumë autoritet organeve ndërkombëtare në përcaktimin e interesave të përbashkëta globale. Ndërkohë që për SHBA-të, delegimi i autoritetit është shumë më i kufizuar. Kjo, pasi historia e krijimit të BE-së bazohet në synimin që t'i mishëronte sovranitetet në shtresa shumëfishe rregullash, normash dhe rregulloresh për të parandaluar daljen e tyre jashtë kontrollit, pasi ishte pikërisht ushtrimi i pafre i sovranitetit kombëtar që i futi ato në dy luftërat botërore.

Në literaturën tradicionale të marrëdhënieve ndërkombëtare, shtetet karakterizohen kryesisht me fuqinë, pra, me kapacitetin e tyre për të arritur dhe mbrojtur qëllimet e tyre. Ndërsa, për qëllime studimi dhe analitike, Kalevi Holsti²³², forcën e shtetit e gjen në "*kapacitetin e shtetit për të fituar*

²³⁰ Shih për më tepër: Joshua Goldshtein, Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Botimi i katërt, Përkthyes: Arian e Teuta Starova, Shtëpia Botuese DITURIA, 2001.

²³¹ Fukujama, Francis, NDËRTIMI I SHTETIT, Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shekullin e Njëzet e Një, Sunday Times, AHS, Tiranë, 2008, f. 144-165.

²³² Kalevi Holsti, Shteti, lufta dhe gjendja e luftës, ISN, Tiranë, 2008.

besimin - të drejtën për të qeverisur - të nxjerrë burimet e nevojshme për të qeverisur dhe të sigurojë shërbimet, të ruajë elementin themelor të sovranitetit...". Pra, sovraniteti është baza e forcës së shtetit. Pa dashur të përmendim këtu aspektin emocional të shtetit, i cili shton shton “*pengesën*” për cënimin e këtij sovraniteti dhe këmbënguljen për sovranitet kombëtar. Dhe, të mendosh se, është pikërisht ky sovranitet që është cënuar dhe po gërryhet! Kjo tregon se përplasja/et mes nacionalizmit dhe teorive mbikombëtare, teoria e integritit (apo rajonalizmi ose globalizmi), është një temë që përshkon si një fill çdo përpjekje për integrim, edhe në rastin më të suksesshëm të integritit që është Bashkimi Evropian.

Bashkimi Evropian është konsideruar si eksperiment në kuptimin se, për herë të parë në historinë moderne, një grup shtetesh-kombe, të pavarura, kanë kërkuar të integrojnë ekonomitë e tyre si dhe strukturat politike vendimmarrëse, për të siguruar paqe dhe për të përmirësuar kapacitetet e tyre për të përballuar sfidat e ndërvarësisë. Efekti i këtij eksperimenti ka qenë i tillë që, për pjesën më të madhe të jetës se vet, BE ka qenë në proces zgjerimi, i cili vazhdon i shoqëruar me sfida të reja. Pra, BE nuk ka qenë asnjëherë një klub përjashtues. Rruga ka qenë e hapur për çdo “*Shtet evropian, i cili mund të aplikojë të bëhet anëtar i Komunitetit*”.²³³

Është me interes për lexuesit të njohin atë që mund të konsiderohet si parahistoria e Bashkimit Evropian, për të kuptuar më mirë atë që vjen më vonë. Kjo, duke përfshirë të gjitha përpjekjet e bëra, që në shekullin XVIII, duke vazhduar me shekullin XIX, me krijimin e shteteve kombëtare dhe pastaj vjen gjysma e parë e shekullit XX. Secila periudhë u shoqërua me ide, përpjekje, me suksese dhe rënie. Pastaj vjen krijimi i këtij organizmi me problemet që e shoqërojnë në çdo hap.²³⁴ Rënia dramatike e komunizmit në Evropën Lindore dhe fundi i Luftës së Ftohtë kanë vënë përballë arkitektëve të BE-së një numër të pafund problemesh dhe sfidash. Që në 1989 transformimet politike sollën aplikimet e këtyre vendeve për anëtarësim në BE. Kjo Evropë e Bashkuar kishte një detyrim të pashmangshëm për t’iu përgjigjur pozitivisht këtyre kërkesave dhe për të kontribuar në zhvillimin e një rregulli politik dhe ekonomik të

²³³ Traktati i Romës.

²³⁴ Për një trajtim të hollësishëm të zgjerimeve, si dhe problemeve që i kanë shoqëruar, shih Liargovas, P. (1999) *The Enlargement of the EU: Prospects and Problems, Enlargement and the External Relations Dimension*, by Hellenic Foundation for European and Foreign Policy (ELIAMEP).

qëndrueshëm për të gjithë Evropën. Në një mënyrë, fundi i Luftës së Ftohtë gjithashtu do të thoshte fund i një periudhe paqeje dhe stabiliteti, që i ishte imponuar Evropës, pavarësisht nga kostot ekonomike dhe politike të konsiderueshme për të dyja palët. Fundi i Luftës së Ftohtë ka sjellë si rrjedhim kërkesën për rinovim të bazës institucionale për paqe dhe stabilitet për të zëvendësuar rregullin e vjetër bipolar dhe për të ngritur shpresën se BE-ja mund të shërbejë si një ankorim institucional për një Evropë të re, duke u bërë një pikë referimi për një rregull mbarevropian të demokracisë, ekonomisë, prosperitetit dhe sigurisë politike. Zgjerimi që ka pësuar së fundmi BE ka lidhje dhe përcaktohet nga ndryshimet epokale në Evropë pas përfundimit të Luftës së ftohtë dhe është unik në llojin e tij, në termat e qëllimit dhe diversitetit, gjë që e vinte BE-në para një sfide të re e të veçantë.

Ndërkohë, duke iu referuar si vendodhjes fizike, pra gjeografisë, ashtu edhe historisë, gjithmonë është menduar se “...*procesi i bashkimit të kontinentit tonë do të kompletohet vetëm kur vendet ballkanike të jenë pjesë e Bashkimit.*”²³⁵. Kjo gjë, ishte pranuar qëkur është krijuar ky bashkim, por asnjëherë nuk kishte patur rezultate konkrete. Ose më saktë, asnjë strategji, e cila do të përcaktonte qartë se kur, si, në çfarë mënyre këto vende do të kualifikoheshin për të shkuar tek standardet që kërkonte Bashkimi Evropian.²³⁶

Pa harruar të sjellim në vëmendje tendencën “evropiane” ose proevropiane të Ballkanit në përgjithësi dhe e Shqipërisë si pjesë e tij, por dhe si një rast më vete. Për këtë duhet të mbështetemi në fakte, në historinë e shkruar, si nga shqiptarët, ashtu edhe nga të huajt, të cilët e kanë parë, jetuar dhe shkruar vendin tonë. E nënvizon këtë fakt Romeo Gurakuqi kur shkruan për Shkodrën dhe Shqipërinë e pas Luftës së Parë Botërore, duke iu referuar të dërguarit special britanik Phillips, i cili në 1918 shprehej “*Shqiptarët që përherë kanë qenë të predispozuar ndaj Anglisë, e shprehin qartë edhe tani një gjë të tillë....Ata kanë një dyshim instinktiv rreth ndershmërisë së francezëve rreth interesave shqiptare, por për momentin ata duket se priren ndaj Francës...*”²³⁷

²³⁵ Romano Prodi, President i Komisionit European. Fjala e mbajtur në Parlamentin e Shqipërisë, janar 2003.

²³⁶ Kriteret e Kopenhagenit, për të cilat do flitet më gjatë në vazhdim.

²³⁷ Romeo Gurakuqi, Shkodra në Shqipërinë e pas Luftës së Parë Botërore (nëntor 1918-11 mars 1920), SEMINARI VI NDËRKOMBËTAR SHKODRA NË SHEKUJ, Nëntor, 2005, Vëllimi I, Shkodër, 2006, f. 150.

Kemi kohë që dëgjojmë “*integrimi evropian i Shqipërisë*” si një fakt apo sfidë që i përket një kohe të së ardhmes. Tani e ardhmja është bërë e tashme me ndryshimet historike në BE. Përplasjet rreth kohës së pranimit kanë qenë objekt debatesh të shumta në “*korridoret evropiane*” dhe jo vetëm. Pyetjet që dalin para çdo momenti të zhvillimeve historike, sa i takon integrimin evropian të vendit tonë, janë të shumta. Në fakt, jo vetëm të vendit tonë, të Ballkanit në përgjithësi. Ka mjaft që mendojnë apo perceptojnë integrimin në BE si një mundësi që do të ofrohet “*for granted*”, si diçka që do sjellë ndryshim brenda një nate, si një mrekulli që do na ofrohet nga Evropa.²³⁸ Këto keqperceptime janë edhe si pasojë e mos marrjes sa duhet informacion në lidhje me proceset integruese²³⁹, apo e mospërfshirjes së të gjithë aktorëve në reformat, politikat, veprimet, angazhimet, apo e thënë ndryshe, e marrjes përsipër të procesit vetëm nga disa struktura të caktuara, të cilat në një farë mënyrë kanë “*monopolizuar*”²⁴⁰ procesin.

Prandaj është e rëndësishme që të gjenden mënyra të ndryshme që sa më shumë të prodhojmë informacion, të marrim atë nga burimet e duhura, ta përpunojmë për nivelet e duhura, ta shpërndajmë atë, ta diskutojmë, të analizojmë, duke qenë dhe kritikë, por dhe konstruktivë në të njëjtën kohë, duke angazhuar sa më shumë struktura, ekspertë, individë, duke ia bërë të qartë se ky proces dhe kjo rrugë nuk i takon vetëm “*dikujt*”, qoftë si përgjegjësi, qoftë si privilegj. Në 2007, kur BE festonte 50- vjetorin e saj, Hose Manuel Barroso, President i Komisionit Evropian, komentonte këtë gjysmë shekulli BE: “*...Triumfi i 50 vjetëve të fundit ka qenë një triumf i këtyre vlerave në Evropë, i lirisë dhe solidaritetit, realizuar nëpërmjet ligjit. Sfidat janë për 50 vitet e ardhshme është t’i propozojmë dhe jo t’i imponojmë këto vlera përtej kufijve të Evropës. Kjo është sipërmarrja evropiane e papërfunduar. Realizimi i kësaj sipërmarrjeje nuk kërkon vetëm ekuilibër dhe vlera. Ajo kërkon diçka nga secili prej nesh si*

²³⁸ Shih Zemaida Mozali, Valuing the EU, www.db.agenziaisir.it/sir/dati/2008-11/28-5596/eur83ing.rtf

²³⁹ Një gjë të tillë e ka konstatuar dhe faktuar AIIS, Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë, i cili ka zhvilluar sondazhe në grupe të ndryshme të shoqërisë, nga viti në vit, i ka analizuar ato dhe në bazë të punës dhe vlerësimeve që kanë dalë nga të dhënat është arritur në këto konstatime në lidhje me mangësi në lidhje me informacionin që ka publiku i gjerë, shpesh edhe njerëzit e shkolluar apo edhe administrata, në lidhje me proceset integruese dhe implikimet që sjellin këto procese në jetën tonë. Shih: Rethinking EU Integration, Perception and Realities, AIIS, Tirana, 2007, ose PERCEPTIME, INTEGRIMI EUROPIAN, REALITETE, ISN, Tiranë, 2002, 2003, 2004, 2005.

²⁴⁰ Shënim i autores.

*udhëheqës. Vullnet politik. Sikurse e ka thënë edhe Robert Shuman “Kjo nuk është më çështje fjalësh boshe, por çështje veprimi, veprimesh të forta dhe konstruktive”*²⁴¹.

Për t’u kthyer tek pyetja që kemi drejtuar në fillim të kësaj pjese, është e qartë se çdo paragraf është një përgjigje e kësaj pyetje. Në çdo fjali ka një përgjigje, për atë çka do të trajtohet në vazhdim, pasi kjo ishte vetëm hyrja në tematikë. Në të gjithë këto që kemi përmendur, mendoj se gjëja më e rëndësishme që ka lidhje me temën që trajtohet, është domethënia e saj dhe sa ndikon kjo në jetën tonë të përditshme. Nëse ky bashkim shtetesh nën një “ombrellë” ka ndikuar, direkt apo indirekt, jetën e qytetarëve të Evropës, ai po ndikon prej vitesh edhe në përditshmërinë tonë, në jetën tonë, në politikë si dh në ekonomi. “*Mirëqenia e Evropës është e lidhur ngushtë me njohuritë dhe aftësitë e popujve të saj, çka është edhe çelësi i zhvillimit, punësimit dhe kohezionit social....Ne duam të zvogëlojmë varfërinë, urinë dhe sëmundjet në botë...*”, këto janë një pjesë e Deklaratës së Berlinit, me rastin e 50- vjetorit të nënshkrimit të Traktatit të Romës.²⁴² Duke shpresuar se kemi sjellë një analizë të qartë dhe rigoroze në çdo paragraf timin, i cili trajton shumë për “*pikën tonë të referimit*” (pra BE-në), do të ishte bukur të përdoret një mënyrë goliste të “*dhënies së përgjigjes nëpërmjet pyetjes*”²⁴³, duke qenë se jemi në një “*terren evropian*”. Kështu që pyetjes time të fillimit do t’i përgjigjeshim po me një pyetje: “*Pse të mos e studiojmë Bashkimin Evropian*”?

BIBLIOGRAFI:

1. Rourke John T. THE GOVERNMENT OF EUROPE, International Politics on the World Stage, Ninth Edition, University of Connecticut, 2003.

²⁴¹ Gazeta “EUROPA”, Volumi III, Nr. 3, 31 Mars 2007, ISN (AIIS), f. 3.

²⁴² Po aty.

²⁴³ Kam parasysh rastin kur Kryeministri britanik Makmilan i kishte propozuar De Golit që të tre, së bashku me Adenaurin të unifikonin Evropën, gjenerali i kishte kthyer përgjigje në formën e pyetjes: “*Nga pikëpamja historike, juve, britanikët,....a do të pranoni me të vërtetë një tarifë të jashtme të Komunitetit, që është ashpërsisht kundër tregtisë tuaj amerikane dhe që përjashton dominimet tuaja të vjetra dhe kolonitë tuaja të djeshme?*” Shih: Paskal Milo, Bashkimi Evropian, Ideja, Integrimi, Identiteti, E ardhmja, Tiranë, 2002, f. 71.

2. Goldshtein, Joshua, MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE, American University, Washington D.C, (Përkthyes: Arjan e Teuta Starova), Shtëpia Botuese “DITURIA”.
3. Fukujama, Francis, NDËRTIMI I SHTETIT, Qeverisja dhe Rendi Botëror në Shekullin e Njëzet e Një, Sunday Times, AIIS, Tiranë, 2008.
4. Kalevi Holsti, Shteti, lufta dhe gjendja e luftës, ISN, Tiranë, 2008.
5. Liargovas, P.,(1999), The Enlargement of the EU: Prospects and Problems, Enlargement and the External Relations Dimension, by Hellenic Foundation for European and Foreign Policy (ELIAMEP)
6. Romeo Gurakuqi, Shkodra në Shqipërinë e pas Luftës së Parë Botërore (nëntor 1918-11 mars 1920), SEMINARI VI NDËRKOMBËTAR SHKODRA NË SHEKUJ, Nëntor, 2005, Vëllimi I, Shkodër, 2006, f. 150
7. Shoup, P. (ed), HOFFMAN, G. (Project Director), PROBLEMS OF BALKAN SECURITY- SOUTHEASTERN EUROPE IN THE 1990s
8. Milo, Paskal BASHKIMI EUROPIAN, Albpaper (Tirana, 2002).

Why do I need to know and study the unification and European integration

SUMMARY

This article includes a wide range of topics related to “Europe” and the European integration and it might be a valuable source of information for students and the interested public and that it can help create a better understanding of Europe and European Integration.

A clear understanding of what European integration means is of utmost importance, considering that it will continue to have a direct impact on everyday lives of European and Will-be Europeans and the crucial impact it has on political, social and economic developments inside and outside its borders.

Sereta KOPERAJ

REAGIMET E VENDEVE TË BALLKANIT NDAJ PUSHTIMIT TË SHQIPËRISË NGA ITALIA (1939), NË DRITËN E DOKUMENTEVE BRITANIKE

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia, shënon një prej ngjarjeve më të rëndësishme në pragun e Luftës së Dytë Botërore, jo vetëm për shqiptarët, por edhe për zhvillimet e mëvonshme gjeopolitike që çuan drejt një konflikti të përgjithshëm të armatosur. Në këtë artikull synojmë të paraqesim reagimet e vendeve të ndryshme në lidhje me këtë ngjarje, të cilat i kemi nxjerrë kryesisht nga dokumentet e Foreign Office-t, të cilat krijojnë një tablo më të saktë sesa paraqitja disi indiferente ndaj aneksimit italian të Shqipërisë nga qarqet diplomatike ndërkombëtare, e sidomos ato ballkanike. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia, për vendet e Ballkanit ishte një ngjarje që çënoi rëndë ekuilibrat e brishtë gjeopolitikë në Ballkan. Hyrja e Italisë në Ballkan, jo vetëm që prishte *status quo*-në e shteteve të Gadishullit që kishin gati dy dekada pa konflikte të ashpra dhe me një situatë të përgjithshme të ekuilibruar, por edhe shtonte rrezikun e drejtpërdrejtë ndaj dy shteteve fqinje të Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Greqisë. Sjellja politike e këtyre dy shteteve që ishin edhe më të kërcënuarat, ndaj pushtimit të Shqipërisë nga Italia, ishte mjaft komplekse. Nga njëra anë ata paraqiten si miratues të aktit të pushtimit italian, madje kontaktet që kanë me autoritetet italiane, menjëherë pas ndërhyrjes ushtarake, mund të quhen akte servilizmi²⁴⁴. Nga ana tjetër tek ato mbizotëron frika dhe pasiguria ndaj politikës agresive të Italisë fashiste. Prandaj diplomatët ballkanas kontaktojnë menjëherë me qeveritë e Francës dhe të Britanisë së Madhe për të gjetur mbështetje.

Cili ka qenë qëndrimi i qeverisë jugosllave?

Nga dokumentet e Foreign Office del që qeveria jugosllave ka qenë tejet e interesuar që në fillim të vitit 1939 për ecurinë e marrëdhënieve italo-shqiptare, pasi dhe jugosllavët janë të parët me të cilët Çiano paraqiti

²⁴⁴ Jakomoni F. "Politika e Italisë në Shqipëri", Tiranë, 2005, f. 147, po ashtu dhe tek Çiano G. "Diario 1937-1943", Torino, 1993, f. 278-283, nga dt.5 prill deri më dt.14 prill.

skenarin e pushtimit të Shqipërisë (Marrëveshja Çiano-Stojadinoviç, që nuk u realizua). Në këtë periudhë politika jugosllave mbështetej në krijimin e marrëdhënieve sa më miqësore me Italinë, por nuk e donte këtë të fundit në Ballkan. Në rastin e një konflikti të ri evropian, i cili ndihej shumë pranë do ta vinte në dy fronte më Fuqitë e Boshtit, me Gjermaninë në veri dhe tani edhe me Italinë në jug. Prandaj prania ushtarake e Italisë në Shqipëri do të ishte një kërcënim shumë serioz ndaj shtetit jugosllav. Që më 1920, në Konferencën e Ambasadorëve, jugosllavët preferonin më shumë një shtet të pavarur shqiptar me administrim autonom, sesa një shtet shqiptar nën administrimin e italianëve²⁴⁵. Prandaj, në raportimet e javës së parë të muajit prill, ministri britanik në Beograd, R. Cambell paraqiste shqetësimin se pushtimi i Shqipërisë nga Italia ishte një skenar i mundshëm, por edhe një ankth i vërtetë për Jugosllavinë²⁴⁶. Për diplomatin britanik qëndrimi jugosllav ishte i qartë: *“Nëse italianët ndërhyjnë ushtarakisht, ata (jugosllavët shënim imi S.K.), nuk do të bëjnë gjë, pasi janë të pafuqishëm për të reaguar.”*²⁴⁷ Në numrin e dt. 6 prill të 1939, gazeta “Politika”, e njohur për qëndrimin e saj pro qeveritar, vinte theksin në mosarritjen e një marrëveshjeje mes dy qeverive, asaj italiane dhe asaj shqiptare. Tek kjo marrëveshje, sipas jugosllavëve, problemi qëndronte tek pala shqiptare, e cila nuk pranonte kushtet, *“gjë që nuk ishte e pazakonshme. Zërat për një ndërhyrje ushtarake nga ana italiane mbahen si të pabaza, pasi janë përgënjeshtuar nga qeveria italiane. Jugosllavia është duke ndjekur këto zhvillime me një interesim që mund të kuptohet nga miqësia me Italinë dhe me besimin që paqja do të mbizotërojë në Adriatik në përputhje me deklaratën e z. Musolini, vetë, me rastin XX vjetorit të themelimit të Partisë Fashiste.”*²⁴⁸

Por pas pushtimit, qeveria jugosllave filloi të mbante një qëndrim të një kujdesi ekstrem. Ekzistonte frika e një sulmi ndaj Jugosllavisë nga ana e Gjermanisë, e cila, siç besohej nga qeveria e Beogradit, do të vepronte në bashkëpunim me Italinë, për shpërbërjen e shtetit të ri jugosllav. Ndërkohë që në Sofie dhe Ankara, nga ana tjetër, dyshohej se qeveria jugosllave kishte miratuar ndërhyrjen ushtarake të Italisë kundër Shqipërisë. Informacionet e Foreign Office nuk e nxjerrin Jugosllavinë aktore në skenaret e italianëve për të sulmuar Shqipërinë, por fillimisht u dyshua për një aprovim jugosllav në hapin e ndërmarrë prej Çianos dhe Musolinit. Nga

²⁴⁵ Gurakuqi R. “Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore”, Shkodër. 2007, f. 73.

²⁴⁶ PRO FO.371. 23712 R 2519/1335/90 FO memo. Londër 4 prill 1939.

²⁴⁷ PRO FO.371. 23712 R 2519/1335/90 FO memo. Londër 4 prill 1939.

²⁴⁸ PRO FO.371. 23712 R 2519/1335/90 FO memo. Londër 4 prill 1939.

informacionet e marra prej një zyrtari të ministrisë së punëve të jashtme të Gjermanisë, në një raport të Foreign Office thuhet se çështja e pushtimit ka qenë e diskutuar më parë mes Romës dhe Beogradit dhe se mund të ekzistonte një marrëveshje sekrete²⁴⁹, por siç del edhe në ditarin e Çianos, si edhe nga zhvillimet e mëvonshme, Jugosllavia nuk ishte bashkëpunëtoare në pushtimin italian, por përpiquej të kishte sigurime prej Italisë që kjo e fundit të mos vazhdonte shtrirjen në Ballkan. Më 5 prill 1939, në një takim me ministrin e Jugosllavisë në Romë, Kristiç, Çiano e njuh me situatën e tensionuar të marrëdhënieve italo-shqiptare dhe *çuditet me qetësinë e Kristiç, pasi situata është shumë e rëndë edhe për Jugosllavinë*²⁵⁰. Ndërsa më 8 prill 1939, një ditë pas ndërhyrjes ushtarake italiane në Shqipëri, ministri Kristiç, e njoftonte ministrin e jashtëm italian, Çiano, se qëndrimi i qeverisë jugosllave vazhdonte të qëndronte si gjithmonë në përputhje me ndjenjat miqësore që kishin frymëzuar bisedimet e fundit italo-jugosllave. Ndërsa ministri jugosllav i Punëve të Jashtme, Markoviç arrin deri në atë pikë sa të shprehet se Italia duhet të kishte proceduar në pushtimin tërësor të Shqipërisë edhe më parë, që t'i kthente paqen atij vendi. Por, në sajë të komunikimit të bërë, i kërkohet qeverisë italiane, që kur rrethanat ta kërkonin, kjo të shmangte çuarjen e forcave të shumta në afërsi të kufirit shqiptaro-jugosllav. Qeveria jugosllave njoftonte se kishte bërë një përforcim të lehtë të garnizoneve në kufi, për të shmangur kalimin në Jugosllavi të elementeve turbullues shqiptar²⁵¹. Ndoshta nga frika se mos i jepte një pretekst Italisë, qeveria jugosllave ka paralajmëruar Zogun, që nuk do ta linte të kalonte kufirin me Jugosllavinë, nëse do të bënte qëndresë. Vendosija e trupave ushtarake pranë kufirit me Shqipërinë përforcon dëshminë e Mbretëreshës Geraldina, e cila këmbëngul, në një intervistë dhënë historianit J.B.Fischerit, se Zogu kishte planifikuar të tërhiqej në male dhe prej aty të vazhdonte qëndresën në formë guerrilesh, megjithë këshillën e qeveritarëve të tij, të cilët i thoshin se duhet të largohej për të shpëtuar kokën. Por, gjithnjë sipas Geraldinës, Mbreti hoqi dorë nga kjo ide, kur iu bë i qartë pozicioni jugosllav. Sipas Mbretëreshës, Beogradi e njoftoi Zogun se, në rast se tërhiqej maleve, Jugosllavia jo vetëm që do ta bllokonte tërheqjen e tij, por forcat jugosllave do të hynin madje në tokat

²⁴⁹ PRO FO.371. 23712 R 2564/1335/90 notë e qeverisë angleze për të gjithë ministrat e saj diplomatikë, dt. 8 prill 1939, për pushtimin e Shqipërisë nga Italia.

²⁵⁰ Ciano G. "Diario 1937-1943", Torino, 1993, f.279, dt.5 prill 1939.

²⁵¹ Jakomoni F. "Politika e Italisë në Shqipëri", Tiranë, 2005, f. 147, po ashtu dhe tek Ciano G. "Diario 1937-1943", Torino, 1993, f. 283.

shqiptare për të ndaluar trazirat e nacionalistëve në kufijtë e vet²⁵². Pas pushtimit të Shqipërisë, Jugosllavia kthehej në pikën më delikate për shkak se nuk dihej sesi do të zhvillohej më tej situata. Vetë qeveria jugosllave dyshonte se pushtimi i Shqipërisë nga Italia, ishte bërë nën dijeninë britanike. Qeveria britanike kishte “sakrifikuar” Shqipërinë nga njëra anë, që Italia të tërhiqte forcat e saj ushtarake nga Spanja²⁵³. Përfaqësuesi i qeverisë jugosllave në Londër, M.Milanoviç, në një takim të kërkuar nga ai vetë me zv.sekretarin e FO, O.Sargent, ka shprehur shqetësimin e qeverisë së tij për situatën e krijuar nga aksioni ushtarak i Italisë, por edhe ka marrë siguri nga ana e qeverisë britanike, se ndërhyrja ushtarake e italianëve ka qenë krejt e papritur për të. Milanoviç ka kërkuar të dijë mbi qëndrimin e Britanisë së Madhe për çështjen e mësipërme, pasi “*politika e Fuqive të vogla, në ngjarje të mëdha ndërkombëtare si kjo e Shqipërisë, është e varur nga veprimi i Fuqive të Mëdha. Gjithë ajo çfarë Fuqitë e vogla mund të bëjnë, është të adaptohen me situatën e krijuar nga Fuqitë e Mëdha. Prandaj edhe qeveria jugosllave pret me ankth reagimin e HMG dhe linjën e veprimit të saj në të ardhmen.*”²⁵⁴ Milanoviç i bën të qartë diplomatit anglez se fati i Shqipërisë dhe qëndrimi i qeverisë jugosllave përpara faktit të pushtimit varet nga reagimi britanik. “*Nëse gjërat do t’i lini të rrjedhin kështu siç kanë filluar, Italia do të ngrejë një qeveri kukull në Shqipëri, e cila do të legalizojë atë çfarë duhet për një protektorat italian dhe një pushtim ushtarak*”²⁵⁵. Këto kanë qenë fjalët e fundit të takimit të diplomatit jugosllav, i cili ka pritur më shumë garanci nga ana britanike. Përpilimi dhe shpallja e një deklarate mes Britanisë dhe Jugosllavisë, ashtu siç ishte vepruar me Poloninë dhe me Greqinë, për qeverinë angleze mbetej diçka e vështirë. “*Është e pamundur që ne të bëjmë hapa përpara në këtë pikë, më shumë se ç’mund të ndërmarrë vetë Jugosllavia*”²⁵⁶ - thuhet në notën e qeverisë britanike për ministrat e saj diplomatikë, përmes të cilës i njofton për qëndrimin që duhet mbajtur në lidhje me ndërhyrjen ushtarake të Italisë në Shqipëri.

Ngurrimi i Jugosllavisë është i kuptueshëm pas qëndrimit italian në lidhje me aleancat dhe paktet e vendeve të Evropës Qendrore dhe

²⁵² Fischer B. “Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945”, Tiranë, 2004, f. 296.

²⁵³ PRO FO.371. 23712 R 2521/1335/90 Conversation with Yugoslav charge d’affaires dt. 7 prill 1939.

²⁵⁴ PRO FO.371. 23712 R 2521/1335/90 Conversation with Yugoslav charge d’affaires dt. 7 prill 1939.

²⁵⁵ Po aty.

²⁵⁶ PRO FO.371. 23712 R 2564/1335/90 notë e qeverisë angleze për të gjithë ministrat e saj diplomatikë, dt. 8 prill 1939.

Juglindore me demokracitë perëndimore, të cilat sipas diplomacisë italiane i japin të drejtën vendeve të Boshtit të hedhin hapa përpara për mbrojtjen e pozicioneve të tyre. “*Popujt miq ne i shikojmë me një qëndrim miqësie, ndaj popujve armiq ne do të adoptojmë një qëndrim të qartë dhe të vendosur armiqësor*”- ishte shprehja e Musolinit²⁵⁷. Në një situatë të tillë, qeveria jugosllave nuk pritej të reagoje ndryshe ndaj pushtimit italian. Megjithëse ndjekëse e një politike të pamoralshme mbi çështjen e mësipërme përballë italianëve, qeveria jugosllave përpigjej të ruante një ekuilibër me një fasadë miqësie me Italisë, për të shmangur një konflikt të mundshëm me të, pasi besonte se mund të ishte viktima e radhës e agresionit të Shteteve të Boshtit.

NJË VËSHTRIM MBI QËNDRIMIN E GREQISË NDAJ PUSHTIMIT ITALIAN TË SHQIPËRISË

Një qëndrim i dyzuar shihet edhe nga qeveria greke ndaj pushtimit italian. Nga njëra anë, grekët vrapojnë të shprehin miratim të veprimit ushtarak të italianëve, nga ana tjetër nxitojnë të sigurojnë mbështetjen e Britanisë dhe Francës, pasi e ndjejnë kërcënimin italian shumë afër. Greqia ishte më konfuze në qëndrimin e saj edhe për shkak të një rrethane tjetër: Mbreti Zog pas largimit nga Shqipëria kishte hyrë në territorin grek. Që më 8 prill 1939, qeveria greke kishte njoftuar atë italiane se nuk kishte asnjë lidhje me vendimin e Zogut, ndërsa një ditë më pas, garantoj se nuk do t'i lejohej mbretit shqiptar asnjë veprim politik, për aq sa do të qëndronte në Greqi.²⁵⁸ Më 9 prill, pas shprehjes së kënaqësisë nga Musolini, për qëndrimin e Greqisë ndaj Zogut, kryeministri grek Metaksa deklaronte se *miqësia italo-greke, që kohët e fundit kishte pasur një farë ftohtësie, do të dilte e forcuar nga ngjarjet e fundit ndërkombëtare..Sh.T. Metaksai ka bindjen absolute se nuk mund të ketë asnjë ngjarje që do të mund të turbullojë në një farë mënyre miqësinë tradicionale që, në çdo kohë, i ka mbajtur bashkë të dy vendet, dhe ai sheh fillimin e një kohe të re të miqësisë së këtij bashkëpunimi paqësor*²⁵⁹. Madje, për të siguruar italianët në miqësinë e saj, qeveria greke deklaronte se i njihte Romës një rol të dorës së parë në pellgun e Mesdheut, prandaj Greqia “*synonte t'i*

²⁵⁷ PRO FO.371. 23712 R 2919/1335/90 From L.Perth, Rome, to L Halifax, FO. 14 prill 1939.

²⁵⁸ Jakomoni Fr. “Politika e Italisë në Shqipëri” Tiranë, 2005, f. 147.

²⁵⁹ Jakomoni Fr. “Politika e Italisë në Shqipëri” Tiranë, 2005, f. 148.

*vinte marrëdhëniet në themele të shëndosha*²⁶⁰. Por megjithë këtë përpjekje të diplomacisë greke për të shmangur konfliktin me Italinë, planet e qeverisë fashiste të Musolinit nuk do të ndryshonin. Ajo do të ishte viktima e radhës e politikës ekspansioniste italiane në Ballkan. Që me 26 maj, një muaj pas pushtimit të Shqipërisë, Çiano do të kërkonte që traktati italo-grek i miqësisë të mos ripërtërihej. Dhe pas dy vitesh ushtritë italiane do të sulmonin Greqinë. Pasi për Mussolinin, veprimi kundër Greqisë ishte i detyrueshëm, jo vetëm për t'i prerë rrugën e trysnisë së Hitlerit drejt Mesdheut lindor, por edhe nga kërkesa për të shmangur shndërrimin e Greqisë në një bazë sulmi detar dhe ajror britanik kundër Italisë, qoftë përmes marrëveshjes anglo-greke, qoftë edhe përmes një pushtimi ushtarak të drejtëpërdrejtë britanik.²⁶¹ Por nxitimi për të shprehur dhe forcuar miqësinë me Romën, shihet qartë që kanë qenë për shkak të frikës së një përballeje ushtarake me Italinë. Sipas raporteve që vijnë nga Athina në Foreign Office, në Greqi . . . *shkatërrimi i pavarësisë së Shqipërisë dhe rritja e mundësisë së italianëve për të krijuar më shumë turbullira në Ballkan është pritur me zymtësi dhe mosbesim. Nëse Greqia do të sulmohet, qeveria ka deklaruar se është e vendosur të rezistojë. Me nervozizëm shihet çështja e Korfuzit, pas përforcimeve të trupave italiane në Dodekaneze, por deri më tani, Greqia nuk ka marrë asnjë masë për të mbrojtur Kretën, për të mos u gjykuar si provokacion*²⁶².

Vazhdimi i përqendrimit të trupave italiane në Shqipëri edhe një muaj pas pushtimit shihej me shumë mosbesim nga shteti grek. Më 1 maj 1939, ministri diplomatik grek në Shqipëri, Skeferis, lajmëron Athinën se numri i forcave italiane është shumë më i madh seç nevojitet në Shqipëri, llogariten rreth 60 mijë ushtarë, të cilët janë të mjaftueshëm për të ndërmarrë një sulm kundër Greqisë. Por ky përqendrim trupash nuk shihet si një përpjekje për një sulm imediat kundër Greqisë, por për forcim të pozicionit ushtarak të Italisë në Shqipëri, dhe përdorimi i tyre në rast të një konflikti të përgjithshëm.²⁶³

Cili ka qenë qëndrimi i Bullgarisë?

Qeveria bullgare e ka parë plot dyshim aneksimin e Shqipërisë nga Italia. Një çështje shumë serioze dhe shqetësuese është quajtur prej saj ndërhyrja ushtarake e 7 prillit²⁶⁴. Por nga pushtimi i Shqipërisë prej Italisë, sipas diplomacisë britanike, edhe Bullgaria mund të kthehej në një aktore të

²⁶⁰ Puto A. "Shqipëria politike 1912-1939", Tiranë, 2009, f. 639.

²⁶¹ Jakomoni Fr. "Politika e Italisë në Shqipëri" Tiranë, 2005, f. 229.

²⁶² PRO FO.371. 23712 R 2470/1335/90 Foreign Office, minute. Dt. 8 prill 1939.

²⁶³ PRO FO.371. 23714 R3504/1335/90 From A.Ryan (Durazzo) dt.1 maj 1939.

²⁶⁴ PRO FO.371. 23712 R 2470/1335/90 Foreign Office, minute. Dt. 8 prill 1939.

zhvillimeve që mund të pasonin më vonë në gadishull. Duke qenë se Jugosllavia dhe Greqia, duke e pasur tashmë Italinë ngjitur, do të përqendronin vëmendjen tek kufijtë e ri me të, Bullgaria mund të synonte një dalje në Egje dhe territoret e Dobruxhës jugore, duke hapur një konflikt ndaj Greqisë dhe Rumanisë, mbase kjo edhe me një nxitje të italianëve.²⁶⁵ Edhe në Konferencën e Tretë Ballkanike, në të cilën u aprovua Pakti Ballkanik, ku aderuan të gjithë shtetet e gadishullit, Bullgaria nuk e pranoi, pasi pakti synonte në ruajtjen e status quo-së në Ballkan, dhe binte kështu ndesh me interesat e saj territoriale²⁶⁶. Megjithatë, për FO, ky ishte një dyshim spekulativ, por që në rastin e një konflikti të përgjithshëm mund të ishte një skenar që mund të luhej. Përfaqësuesi francez në Londër, Cambon, i përcjell opinionin e qeverisë bullgare një ditë pas pushtimit italian, dhënë Parisit. *“Pyesim veten nëse demokracitë do të reagojnë me veprime, apo vetëm me fjalë. Nëse do të vazhdohet kështu, ndoshta do të na duhet më vonë të rreshtohemi përkrah me më të fortin.”*²⁶⁷ Ishte mesazhi, i cili vinte nga Sofia, që tregonte se heshtja e zgjedhur nga Britania e Madhe dhe Franca, kishte vënë në pikëpyetje, jo vetëm prestigjin e tyre, si Fuqi të Mëdha që duhej të garantonin ruajtjen e ekuilibrave të vendosur pas Konferencës së Ambasadorëve, por edhe kishte krijuar përshtypjen se shtetet e Boshtit ishin shumë më të fuqishme ushtarakisht. Qëndrimi i Bullgarisë ishte më kompleks edhe prej raporteve të ngushta që përpiquej të vendoste Italia me këtë shtet ballkanik, madje menjëherë pas pushtimit të Shqipërisë, ministri diplomatik i deriatëhershëm i Bullgarisë në Tiranë, Peyeff, u dekurua me kryqin e madh dhe urdhërin e kurorës së Italisë²⁶⁸, ndoshta si një shenjë falënderimi për njohjen e shpejtë që shteti bullgar i bëri V.Emanuelit edhe si mbret i Shqipërisë.

Turqia, ishte i vetmi vend ballkanik që dënoi pushtimin italian të Shqipërisë. Megjithëse, ashtu siç i deklaronte ambasadori turk në Londër, dr.Aras, qeveria turke nuk kishte asnjë interes dhe as dëshirën të përzihej në këtë çështje²⁶⁹, Turqia nuk pranoi të njihte qeverinë e re shqiptare pro-

²⁶⁵ Po aty.

²⁶⁶ Duka, V. “Përpyekjet për integrim dhe bashkëpunim ballkanik gjatë gjysmës së parë të shek.XX”, në Çështje të Historisë bashkëkohore të shqiptarëve, SHBLU, Tiranë, 2003, f.156.

²⁶⁷ PRO FO.371. 23713 R 2579/1335/90 From M.Cambon(french Embassy) conversation dt.12 prill 1939.

²⁶⁸ PRO FO.371. 23717 R 6847/2066/90 From consul general Gamble, (Durazzo dt.23 gusht 1939).

²⁶⁹ PRO FO.371. 23712 R 2512/1335/90 From turkish ambassador conversation dt.5 prill 1939.

italiane të dalë pas 7 prillit, duke vazhduar të mbajë legatën shqiptare të qeverisë së Zogut²⁷⁰. Qeveria turke iu përmbajt pikëpamjes se qeverisja e Zogut vetëm ishte ndërprerë, sepse ai nuk kishte abdikuar.²⁷¹ Ndonëse nuk e njohu *de jure*, pushtimin italian, mbajtja e një konsulli deri në fund të vitit 1939, dëshmon se as Turqia nuk kishte ndërmend të bënte një kundërvënie më të gjatë, qoftë edhe deklarative kundër Italisë.

BIBLIOGRAFI:

1. **National Archives (Public Record Office), Foreign Office Archives** (FO), (PRO), London: **Viti 1939-** PRO. FO.371. 23710; FO.371. 23711; FO.371. 23712; FO.371. 23713; FO.371. 23714; FO.371. 23715; FO.371. 23716; FO.371. 23717.
2. **Biagini, A.** “Storia dell’ Albania”, Milano, 1998 (botimi shqip), Tiranë, 2000.
3. **Castellan G.** “Historia e Ballkanit”, Tiranë, 1996.
4. **Ciano, G.** “Diario 1937-1943”, Torino, 1998.
5. **Cici, A.** “Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934”, Tiranë, 2002.
6. **Della Rocca, R.M.** “Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944”, Tiranë, 1994.
7. **Dezhgiu, M.** “Shqipëria nën pushtimin Italian (1939-1943), Tiranë, 2005.
8. **Duka, V.** “Histori e Shqipërisë 1912-2000”, SHBLU, Tiranë, 2007.
9. **Fischer, B. J.** “Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945”, Tiranë, 2004.
10. **Fischer, B. J.** “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, Tiranë, 2004.
11. **Gurakuqi, R.** “Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore”, Shkodër, 2007.
12. **Giannini, A.** L’Albania dall-indipendenza all’unione con l’Italia(1913-1939), Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, Varese, 1940.
13. **Historia e Shqipërisë, Vëll.II,** Tiranë, 1965.
14. **Ivanaj, M.** “24 orët e fundit të Mbretërisë së Zogut”, Tiranë, 1997.
15. **Jacques, E.** “Shqiptarët”, Tiranë, 1994.
16. **Jakomoni, Fr.** “Politika e Italisë në Shqipëri”, Tiranë, 2005.
17. **Kissinger, H.** “Diplomacia”, Tiranë, 1999.

²⁷⁰ Puto A. “Shqipëria politike 1912-1939”, Tiranë, 2009, f. 640.

²⁷¹ Fischer B. “Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945”, Tiranë, 2004, f. 59.

18. **Pearson**, O. "Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy 1908-1939", London, 2004.
19. **Puto**, A. "Shqipëria politike 1912-1939", Tiranë, 2009.
20. **Puto**, A. "Nëpër analet e diplomacisë angleze", Tiranë, 2001.
21. **Teli(Dibra)**, P. "Shqipëria dhe Diplomacia angleze 1919-1927". Tiranë, 2005.

Reactions of the Balkan countries to the invasion of Albania by Italy (1939), in light of British documents

SUMMARY

This article is focused in the reaction and attitude of Balkan countries towards Italian invasion in Albania (1939). Yugoslavian government has displayed an attitude of extreme prudence and perplexity for fear of an attack upon Yugoslavia by Germany, whom they believed to be acting in concert with Italy. In Sofia and Ankara on the other hand, Yugoslav government was suspected of some degree of connivance in Italian attack upon Albania. The Greek opinion was gloom and misgiving at apparent destruction of Albanian independence and increase of Italian ability to make further trouble in the Balkans. But the Greek government had taken in diplomatic view steps apparently by a friendship and security of both sides, with Italy. And Bulgarian government viewed the Italian action against Albania with utmost misgiving, but was judged not so dangerous for other Balkan's countries. This view is founded as the result of opinion, that Mussolini regards the occupation of Albania more as an insurance against Germany than as a forward move in the Balkans.

R E C E N S I O N E**KOLEC TOPALLI, SISTEMI RASOR
I EMRAVE TË SHQIPES**

Pas përfundimit të studimeve në fushën e fonetikës historike të shqipes, prof. Kolec Topalli i ka hyrë tashmë prej disa vitesh një pune serioze për hulumtimin e morfologjisë historike të shqipes. Monografia për sistemin rasor të emrave të shqipes është e treta në këtë fushë dhe trajton një nga çështjet më të rëndësishme e të vështira të gramatikës historike të shqipes. Ajo vjen natyrshëm pas monografisë për nyjat e lidhet ngushtë me të. Problemi kryesor në studimin e sistemit rasor të shqipes është ndryshimi i madh që ka pësuar gjatë shekujve lakimi i emrave të shqipes në krahasim me sistemin e lashtë, duke krijuar një sistem të ri rasash. Këto ndryshime janë përfunduar në vijimësi të kohërave deri në shekujt e fundit të zhvillimit të shqipes, gjë që e ndërlikon hulumtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të trashëgimisë e të risive në sistemin rasor. Autori, me përvojën e madhe që ka fituar tashmë pas vitesh të tëra studimi në fushën e fonetikës e gramatikës historike të shqipes, me njohjen e mirë të rregullsive të zhvillimit fonetik të shqipes, e në mënyrë të veçantë me njohjen e thelluar të teksteve të vjetra të shqipes e të dialekteve të saj, ia ka dalë të përballojë me sukses edhe çështjet e mprehta që ka hasur gjatë rrugës së studimit të sistemit rasor. Madje studimi i imtë e i thelluar i autorëve të vjetër i ka dhënë mundësi që t'u japë zgjidhje disa problemeve të patrajtuara më parë apo të vështruara kalimthi në studimin historik të shqipes. Në këtë vështrim punimi sjell kontribute të reja në fushën e gramatikës historike të shqipes.

Me kërkimin sistematik të burimeve të dukurive morfologjike, me shqyrtimin e zhvillimeve fonetike që kanë çuar në përfundime të caktuara paradigmatisht, punimi ka lidhje të ngushtë dhe mbështetet në një shkallë të gjerë në fonetikën historike.

Autori e ka ndarë punimin sipas një grupimi kryesor në rasa të drejta e të zhdrejta dhe kjo i ka dhënë dorë për t'i studiuar dukuritë e përbashkëta në lidhje me njëra-tjetrën.

Monografia nisat nga gjendja e deritanishme të studimeve në problematikën e sistemit rasor të shqipes, me vlerësimet kritike përkatëse, për të kaluar më pas në ballafaqimin e sistemit rasor të indoeuropianishtes

me atë të shqipes. Me këtë rast vihen në dukje ndryshimet e mëdha që ka pësuar shqipja në krahasim me tipin e lashtë i.-e., dhe, pasi diskutohen dhe kapërcehen një numër vështirësish e kontradiktash lidhur me kriteret e përcaktimit të rasave në shqipe, arrihet në një përcaktim të numrit të tyre, duke llogaritur me të drejtë për shqipen e vjetër të dokumentuar edhe rasën kallëzore parafjalore.

Në një mënyrë mjaft sistematike janë përcaktuar dhe analizuar mjetet gramatikore të dallimit të formave rasore, sintetike apo analitike, të trashëguara apo të përfuara gjatë zhvillimit të brendshëm të shqipes. Autori ka evidentuar 13 mjete gramatikore të sistemit rasor, duke përcaktuar si të tilla edhe disa dukuri fonetike në temën e formave rasore, si rënia e fonemave, tingujt antihiatizues apo ndryshimi i gjatësisë së zanoreve e duke theksuar njëkohësisht karakterin heterogjen dhe dallimet e natyrës së ndryshme mes tyre. Secili nga mjetet gramatikore shqyrtohet për nga burimi, funksionet, mosha e tyre. Gjatë shpjegimit të burimit e shkaqeve të dukurive që lidhen me përdorimin e këtyre mjeteve gramatikore gjejmë zbërthime interesante e interpretime të reja etimologjike. I goditur duket shpjegimi i trajtës së rasës gjinore njëjës të emrit *atë* i shoqëruar nga nyja pronore *të* ose përemri pronor *tyt*: *t'et*, *tyt et*, me përbërjen fonetike të sintagmës ku shfaqet ky ndërrim: sekuenca fonetike përmban rrokjen *-tat*, e cila në shqipe del *-tet*, si të *qytet*, *shëndet* nga lat. *civitatem*, *sanitatem*. Po kështu me interes është shpjegimi i emrit topik *Kruja* si formim analogjik *krue-ja* përkundrejt së rregulltës *kro-i*.

Një punim për sistemin rasor të shqipes nuk mund t'u shmanget edhe tabelave paradigmatiche të lakimeve, me të cilat punimi merr pamjen edhe të një teksti të morfologjisë historike të shqipes. Në këtë pjesë të punimit bie në sy, në tabelat e lakimit të parë, një ndarje origjinale në klasa, sipas fundores së temës në trajtën e pashquar, në grupe brenda klasave, sipas tipit të bashkëtingëllores, dhe në nëngrupe brenda grupeve, ku merren parasysh gjatësia e zanoreve të brendshme të temës, tipari hundor/johundor i zanores, metri i temës – trokaike ose daktilike dhe shndërrimet fonetike *ua ~ o*, *ye ~ e* brenda temës. Për secilën nga këto klasa, grupe e nëngrupe jepen shpjegime analitike përshkruese, funksionale e historike. Në lakimin e tretë grupohen në një klasë paradigmatiche më vete emrat femërorë me temë në bashkëtingëllore si *përind-ja*, *shëndet,-ja*, *vërtyt,-ja*, *lot,-ja*. Sot kjo klasë është zhdukur nga gjuha, por dëshmohet te autorët e vjetër. Natyrisht kur flitet për shqipen historike nuk lihen mënjane emrat e gjinisë asnjane, dhe ndër ta asnjansit e mirëfilltë kryesisht shënjuet të lëndës, të dokumentuar përgjithësisht mirë te autorët e vjetër, të cilët përbëjnë një paradigmë më

vete lakimi, gjithashtu të ndarë në klasa, grupe e nëngrupe. Përfundimi që nxjerr autori nga shqyrtimi i lakimit të emrave, sipas të cilit formimi i trajtës së shquar ka qenë proces i hapur, pra trajta të shquara janë formuar në shkallë të ndryshme të evolucionit të emrave, është me rëndësi për të shpjeguar rastet e ndërrimit të gjinisë së emrave, p.sh. *sy* ~ *syni/syri* e *sy* ~ *syu*; *drā* ~ *drani* e *drā* ~ *draja*; *ujë* ~ *ujët*, *ujë* ~ *uji*, *ujë* ~ *uja*; *krye* ~ *kreu*, *krye* ~ *krei*, *krye* ~ *kryetë*; *qye* ~ *qeu*, *qye* ~ *qyeja*, *qye* ~ *qyet* etj.

Rasat e drejta, emërorja dhe kallëzorja, në gjininë mashkullore kanë ndikuar shumë të njëra-tjetra duke shkaktuar riorganizimin e unifikimin e mbaresave, prandaj janë vështuar së bashku. Në këtë pjesë të punimit autori sjell kontribute të reja sidomos në hetimin e zhvillimit historik të mbaresave të emrave mashkullorë. Pasi përcakton grupet e emrave mashkullorë sipas fundores së trajtës së pashquar, autori ndalet gjerësisht në kërkimin e burimit të këtyre fundoreve dhe rrugëve të krijimit të tyre. Një vend i rëndësishëm u kushtohet emrave mashkullorë që dalin me zanoren e patheksuar -ë. Në shqipen e sotme ekzistojnë ende një numër emrash mashkullorë me këtë fundore. Autori ka evidentuar 7 syresh me gjithë burimin e leksemës, për ligjen e gjinisë mashkullore të saj, paraqitjen e saj të autorët e vjetër ilustruar me shembuj. Ndërkaq, për shqipen e vjetër autori ka vënë re ekzistencën e një numri shumë më të madh të këtyre emrave mashkullorë me -ë, duke gjetur me një punë të imtë kërkimore në shkrimet e autorëve të vjetër 36 të tillë, e duke i paraqitur në punim në renditje alfabetike me gjithë të dhënat për prejardhjen e tyre, mënyrën e formimit dhe dokumentimin në shkrimet e vjetra.

Një persiatje e gjerë hulumtuese i është kushtuar burimit të kësaj zanoreje -ë fundore. Autori në thelb pajtohet me tezën e Joklit - me korrigjimet përkatëse - për prejardhjen e kësaj mbaresë nga mbaresat e lashtë e kallëzores indoeuropiane -om, që gjatë zhvillimit historik ka përfunduar në -ë. Duke vërejtur se emrat mashkullorë që dalin me fundore më -ë kanë një sonante para mbaresës, autori arrin në përfundimin se shkak i ruajtjes së zanores -ë pas sonanteve ka qenë nevoja për të ruajtur të paprishur temën e fjalës, që përndryshe “do t’i nënshtrohej rënies së tingujve fundorë”, siç ka ndodhur me ato fjalë ku sonantja ka rënë pas një zanoreje të theksuar (*zâ / zë* nga *zan-).

Duke hetuar gjurmët e rasës kallëzore të pashquar në emrat me temë në zanore e në ata me temë në -o, autori merr shkas të pasurojë listën e emrave me hundorësi të fituar gjatë zhvillimit të brendshëm nga mbaresat e kallëzores (*drā* ~ *drani*, *drû* ~ *druni*, *gjû* ~ *gjuni* etj.) duke dhënë kontribute etimologjike të reja në këtë fushë (psh. për leksemat *rê*, *gjâ / gjë*; *grua / grue*, *duaj / duej* etj.). Mbaresat -ë e kallëzores ka qenë për autorin çelësi i

shpjegimit edhe i disa dukurive të tjera që kanë ndodhur te disa emra që kanë pësuar ndërrime gjinie apo numri për shkak të ndryshimeve në temë si pasojë e ndikimit të rasës kallëzore, si: *dorë, derë, ditë, natë, vjet* etj., apo të rasteve kur ajo ka funksionuar si mbaresë e emërores (*gjarpënë, lepurë, mashkullë*) e ndonjëherë edhe si formant shumësi (*rrathë, thasë, flokë, shokë*). Me ndër këmbimin e anasjelltë të rasës kallëzore me emëroren autori shpjegon edhe një numër dubletesh që ekzistojnë qoftë në onomastikë qoftë në leksikun e përgjithshëm, si: *Shtjefënë* e *Çefë, Lazërë* e *Lacë, i vorfënë / i varfërë* e *Vorfë* (toponim), *i kërshtenë / i kërshterë* dhe *i kërshhtë*.

Mbaresat e trajtës së shquar të rasave emërore e kallëzore janë trajtuar në mënyrë sistematike, me variantet përkatëse me një dokumentim të gjerë të autorët e vjetër të shqipes.

Në trajtimin e lakimit III të emrave femërorë analizohen e shpjegohen etimologjikisht burimet e mbaresave të ndryshme të këtij lakimi, duke na dhënë një pasqyrë të plotë dhe zbërthime interesante sidomos të zhvillimeve brenda gjuhës. Metodë e punës së autorit është vështrimi i dukurive gjuhësore të shqipes në përhapjen e tyre dialektore dhe në zhvillim, dhe këtë metodë e përdor edhe për gjuhët huazuese. Zakonisht, si burim për huazimet nga latinishtja janë marrë shembuj nga latinishtja klasike, gjë që nganjëherë ka çuar në shpjegime të pasakta, por për shqipen e gjuhët ballkanike në radhë të parë vjen në vështrim latinishtja vulgare, vërtet e padokumentuar, por që mund të rindërtohet nga zhvillimet që kanë pësuar gjuhët neolatine. Me këtë metodë autori ka arritur të shpjegojë disa mbaresa të lakimit femëror, duke saktësuar kështu edhe etimologjinë e tyre, si *faqe* < **facia*, *zgjebe* < **scabia*, *qere* < **caria* të latinishtes vulgare.

Një ndihmesë të veçantë në lakimin e emrave femërorë përbën evidentimi dhe dokumentimi i gjerë i paradigmes, tashmë të dalë nga përdorimi, të emrave femërorë që në të pashquarën dalin me bashkëtingëllore, kurse në të shquarën marrin një shquese *-ja*, të tipit *end ~ endja, lot ~ lotja*. Në shqipen e sotme këta emra kanë kaluar në klasën e mashkullorëve. Nga kërkimet në shkrimet e vjetra shqipe autori ka dalluar 37 njësi që bëjnë pjesë në këtë paradigmë, ndër to edhe emra topikë, si: *Lesh ~ Lezhja, Mat ~ Matja, Mjet ~ Mjedja*.

Me paradigmen e emrave të mësipërm autori shpjegon edhe krijimin e nyjeve të përparme të mbiemrave të gjinisë femërore, në togfjalëshin **ete madhe*, me përsëritje të nyjes së prapme **ete e madhe*, nga e cila më pas u përhap me analogji edhe në paradigmën e tjera të gjinisë femërore, pra në togfjalëshat *fushë e gjerë* e *lule e bukur*.

Gjatë studimit të lakimit të emrave në shumës, pasi vihen në dukje veçoritë dalluese me numrin njëjës dhe shpjegohet formimi i temës së shumësit, shqyrtimi përqendrohet në formantet e shumta të temës së shumësit, duke u ndalur në secilin prej tyre për të hetuar përhapjen, mënyrën e formimit dhe burimin e tyre. Interesant është diskutimi i burimit të prapashtesës *-ën(ë) / -ër(ë)* ku kundërshtohet me argumente bindëse shpjegimi i mëparshëm i kësaj prapashtese nga shndërrimi i elementeve fundore të temës në mbaresë të shumësit, pra nga fundoret e shumësive të trajtave si **mbratërë, priftërë, drakënë*. Me këtë rast jepen interpretime të reja për vetë trajtën *mbret*, më parë e shpjeguar si shumës i singularizuar, por tani fare bukur e shtënë në hullinë e emrave me fundoren *-at* që në shqipe paraqitet *-et* (si *atë ~ etën / etër, qytet, vullëndet, shëndet*).

Në pjesën e tretë të monografisë trajtohen rasat e zhdrejta, duke marrë në shqyrtim së pari rasat gjinore e rrjedhore me mbaresa të njëjta. Në gjurmimin e burimit të këtyre mbaresave rasore autori i jep përgjigje pyetjes nëse sistemi i sotëm rasor i gjuhës shqipe është i trashëguar nga gjuha indoevropiane apo është rikrijuar në zhvillim të brendshëm të shqipes, çështje e diskutuar nga gjuhëtarët, të cilët janë ndarë në dy lagje që përfaqësojnë çdonjërin nga këto dy teza. Pasi mban qëndrim kritik ndaj secilës prej këtyre tezave, duke vënë në dukje sidomos vështirësitë e tezës së rikrijimit nga e para të sistemit të ri pas humbjes së të vjetrit, autori parashtron qëndrimin e tij duke pajtuar në thelb të dy tezat: nga njëra anë trashëgim i sistemit të vjetër, të përfaqësuar me mbaresën *-e* të femërores nga i.-e. *-i9ās*, që shpjegon vijimësinë e sistemit rasor sintetik të shqipes, dhe nga ana tjetër rikrijim me zhvillim të brendshëm për mbaresat e gjinisë mashkullore, me rrugë analogjike sipas modelit të gjinisë femërore.

Kreu për rasën rrjedhore është mjaft interesant, me pasuri të dhënash ilustruese mbi problematikën e kësaj rase, shndërrimet që ka pësuar me kohë, ngjashmëritë e dallimet me rasën dhanore, gjendjen e përdorimit të saj në gjuhën e autorëve të vjetër dhe rrudhjen në shqipen e sotme, në të cilën është parë si rasë mbeturinore. Në fakt është fjala për rrjedhoren e mirëfilltë historike, pasi në prirjet e sotme të zhvillimit të gjuhës rrjedhorja me parafjalë paraqitet si rasë në ekspansion, që po zëvendëson pjesërisht dhanoren si rasë sintetike, me ndërtime analitike të rrjedhores me parafjalën ndaj: *përgjigjem ndaj pyetjeve* në vend të *u përgjigjem pyetjeve* (ose *përgjigje ndaj pyetjeve të lexuesve* në vend të *përgjigje pyetjeve të lexuesve*), *premtimet që dhanë ndaj elektoratit* në vend të *premtimet që i dhanë el.*; *duke bërë presion ndaj qeverisë* në vend të *duke i bërë presion qeverisë, ndërprerjen e energjisë elektrike ndaj*

abonentëve debitorë (TVSH), e plot shembuj të tjerë ku parafjala *ndaj* + rrjedhore ka zëvendësuar dhanoren e thjeshtë.

Ndihmesa të reja sjell edhe kreu i rasës kallëzore parafjalore, e cila me të drejtë dhe në mënyrë të argumentuar trajtohet si rasë më vete. Argumentet që jepen për këtë përmbushin kriteret e përcaktimit si rasë e veçantë, pra kriterin morfologjik – ekzistencën e mbaresës së veçantë në trajtën e shquar (*në malt*), dhe kriterin sintaksor, parafjalët me të cilat shoqërohet. Përsa i përket burimit të mbaresës *-t* autori mendon se kjo është një formim i brendshëm i përzier me elemente të rasës kallëzore e rrjedhore. Më në fund edhe argumentimi i emërimit të kësaj rase si kallëzore parafjalore përballë zgjedhjeve të ndryshme emërtuese që kanë bërë gjuhëtarët gjatë kohëve është bindës, meqenëse përmbledh tiparet kryesore të saj.

Kjo monografi mbyll një kapitull të rëndësishëm të morfologjisë historike të shqipes në rrugën drejt përpilimit të një gramatike të re historike të shqipes nga autori, e cila tashmë ka përfunduar dhe është miratuar për botim nga Këshilli Shkencor i Institutit të Gjuhësisë.

Me idetë e reja që sjell, materialin e pasur të pavënë në dukje më parë e në përgjithësi me kontributet e rëndësishme që përmban, vepra shënon një arritje tjetër vetjake të prof. Kolec Topallit dhe një hap përpara në studimet tona historike të shqipes.

Anila Omari

PERSONALITETI DHE VEPRA E MJEDËS NË NJË SERIAL MONOGRAFIK

Për të gjithë ata që kanë ndjekur publikimet shkencore të Mentor Qukut, nisur rreth dyzet vite më parë për personalitetin dhe veprën e Mjedës, nuk përbënte ndonjë befasi projekti i shpallur prej tij në botimin Mjeda 1, Tiranë, 2004. Studiuesi aso kohe paralajmëronte botimin e shtatë vëllimeve kapitale duke i kushtuar thujse monografi më vete pesë njësisive kohore-biografike në të cilat rridhte dhe derdhej vrullshëm jeta aktive, por edhe vepra shumplanëshe e njërit prej përfaqësuesve më në zë të Rilindjes Kombëtare shqiptare, siç qe Ndre Mjeda. Nëse kjo gjë do të kërkonte një studim e gjurmim të pandërprerë të dokumenteve dhe materialeve autentike, të njohjes deri në hollësi të veprimtarisë, të zbulimit, të studimit krahasues e të thelluar interpretues të veprës së tij të gjithanshme jo vetëm gjuhësore e letrare, por edhe të veprimit të tij politik e kombëtar, social e pedagogjik e në shumë drejtime të tjera, studiuesi i apasionuar Mentor Quku do të ndjente dhe kuptonte se materia që ofronte ky personalitet do të thyente gjatë procesit të realizimit, çdo parashikim, çdo kufi në sistemin e këtij materiali. Dhe pas pesë vitesh nga publikimi i vëllimit të parë, ai ka arritur t'i japë lexuesit të gjerë, por sidomos studiuesve të fushave të ndryshme gjashtë vëllime me rreth katërmijë faqe, sadoqë ai është ende në udhë e sipër të përmbushjes së detyrimit të tij sa shkencor aq edhe etik e patriotik.

Dhe të gjithë ata që duan të dinë më shumë për historinë e kësaj vepre të vëllimshme, e cila kërkon një lexim të vëmendshëm dhe skrupuloz, studiuesi Mentor Quku nuk ka munguar të dëshmojë lirisht mbi historinë e ngacmimit të parë shkencor mbi këtë argument, për impenjimet e peripecitë jo të zakonshme për kohërat e turbullta dhe plot e përplot privime, çfarë e shumfishonte ngasjen e pashmangshme që i shkaktonte gjurmimi i veprës së këtij personaliteti sadoqë ai si argument nuk shkonte aq shumë me profilin e tij profesional. Kjo do të provonte se sa i patjetërsueshëm është përkushtimi, pasioni, si në çdo veprimtari kritike e krijuese, çfarë do të përbënte çelësin e rezultatit imponues të punës së tij të kualifikuar, serioze dhe pasionante që ruante qartësisht logjikën e flohtë edhe kur argumenti ishte ngazëllyes.

Në hyrjet, autori i studimit ka ngulmuar që përtej interesimit të tij të vërë në dukje se ndërmarrja e tij e pazakontë buron nga madhështia dhe gjenialiteti shumëplanësh i Ndre Mjedës, i lidhur aq shumë me Shqipërinë

atdheun e tij, me fatet dhe me rropamat e tij historike, çfarë e vendos atë në Panteonin e madh kombëtar të Rilindjes dhe të kohës Moderne.

Fakti që rilindasit nuk ishin as një as dy, por një plejadë e tërë personalitetesh njëri më unik se tjetri, njëri më universal e enciklopedik se tjetri, janë dëshmi e lartësive të panjohura dhe ndoshta ende të pakapërcyera deri në ditët tona që i dhanë përmasa të pazakonta spektrit të veprimtarive të tyre. Përkrah atë personaliteteve si Jeronim de Rada, D.D'Istria, Sami e Naim Frashëri, Pashko Vasa e shumë të tjerë, Ndre Mjeda do të provonte faktin se Rilindja Kombëtare kishte aguar në trojet shqiptare, që kur u shfaq zgjedha osmane. Shqiptarë evropianë, si Barleti, Buzuku e Bogdani e të tjerë në gjuhën e kulturës universale apo duke aplikuar poetikën e shkrimit evropian të gjuhës amtare u frymëzuan nga humanizmi rilindas që kishte përflakur edhe shpirtërat dhe mendjet shqiptare në ato shekuj që ndanin Rilindjen nga Mesjeta, kur kombësitë po konturonin përmes vetëdijes së tyre etnidentifikuese vlerat dhe kuptimet e atdheut kombëtar kudo në Evropë. Në këtë agim të hershëm kulturor shqiptar, të cilin rilindësit shqiptarë e adhuronin duhen kërkuar rrënjët e natyrshme të asaj lëvizjeje kombëtare që tronditi dhe trojet shqiptare.

Në përzgjedhjen e Mjedës nga ana e studiuesit Mentor Quku kanë ndikuar shumë faktorë, por edhe rastësia fatlume, që ai të shkelë në ato hapësira dhe vende ku kishte jetuar Mjeda, kujtimi i të cilit ishte ende gjallë, ndjehej dhe prekej ne jetën e banorëve të atyre anëve dhe sidomos të Kukëlit.

Duke e lexuar veprën seriale të Mentor Qukut, duke njohur historinë e lindjes dhe të hartimit të saj në dy kohë, në atë të diktaturës dhe të pasdiktaturës nuk mund të mos dallosh në këtë histori përpjekjesh nevojën e individit për të sfiduar kohën e ngurtësuar dhe në historinë e suksesshme të gjurmimit të lirë, që pasohet nga një histori e suksesshme e publikimit që mundëson liria dhe perspektivat e saj, nuk ke si të mos vesh re dhe një fenomen tjetër. Në Shkodër si në asnjë qytet tjetër, përveç Tiranës, edhe pse kishte ndodhur një persekutim politik i pashembullt ndaj personaliteteve shkencore, letrare e kulturore klerikë apo laikë që kishin shënuar zenitin kulturor të qytetit në vitet 30' të shekullit XX, do të mbahej gjallë një lëvizje mendore nga studiues klasi në disiplina humane dhe johumane, nga shkrimtarë të talentuar, artistë dhe krijues potencialë.

Kontributet e tyre do të ishin të pranishme edhe në institucionet e qendrës, në Tiranë. Nuk të habit ky fakt po të sjellim ndërmend se ky qytet ishte, sipas dokumenteve të hershëm, i selitur me ndjeshmëri dhe dije humaniste. Aty u lindën dhe u formuan Marin Beçikemi, Marin Barleti,

jetoi e punoi Pjetër Bogdani që veç të tjerash me vetëdijen e të qenit shqiptar do të mbeteshin gjatë në kujtesën e botës shqiptare dhe evropiane.

Ky qytet nga më të njohurit në Ballkan me relievin alpin që e rrethonte, që përshkohej nga tre lumenj që këndonin duke u derdhur në det, me liqenin mahnitës që mban emrin e tij, më të madhin liqen në Ballkan, kishte dhe ofronte mozaikun më të larmishëm natyror, çfarë i kishte sjellë ndër kohëra begati dhe jetë të gjallë ekonomike. Në fund të nëntëqintës në Shkodër jetonin dhe vepronin shumë Rilindës. Ndër to dhe Mjeda i vetëmjaftueshëm dhe i jashtëzakonshëm ose siç e cilëson Mentor Quku i veçantë nga më të veçantët.

Në Shkodër, jo rastësisht kishin shënuar historinë e tyre më të parat akademi filologjike shqiptare shoqëria “Bashkimi” (1899), shoqëria “Agimi” (1901) dhe “Komisia letrare” (1916).

Janë këto dhe mbi të gjitha shpirti kritik, kërkues dhe krijues i qytetarit të saj, që e bëjnë Shkodrën të qëndrojë e pashmangshme në jetën shkencore, kulturore e letrare me kontribute të spikatura.

Në këtë kontekst lindi nisma dhe u bë realitet ndërmarrja jo e zakonit të studiuesit të palodhur Mentor Quku, që i kushtoi zbulimit të personalitetit dhe veprimtarisë së Ndre Mjedës gjithë jetën e vet, duke i vënë studiuesve para një mal me libra.

Gjer tani ai ka botuar gjashtë vëllime duke mbuluar me një ose dy vëllime katër nga pesë njësitë biografike të rilindësit të madh. Ai ka botuar Mjeda 1, Rinia (1866-1988), me 639 faqe, botuar më 2004, Mjeda 2, Albanologu (1889-1899) me 641 faqe, botuar më 2006, Mjeda 3, Alfabeti (1899-1912) me 678 faqe, botuar më 2007, Mjeda 3, Liria (1899-1912) me 764 faqe, botuar më 2008, Mjeda 4 Identiteti (1912-1924) me 633 f, botuar më 2009, si dhe Mjeda 7, Bashkëkohësit për Mjedën, me 492 faqe, botuar më 2005. Përveç tyre ai ka në proces përgatitjeje edhe 4 vëllime të tjera.

Përkatesisht, vëllimin që mbyll veprimtarinë e tij jetësore Mjeda 5 (1924-1937), si dhe një vëllim me bibliografinë e veprës së Mjedës dhe mbi veprën e tij, si dhe me botimin kritik të plotë të veprës së tij në tre vëllime.

E përcaktuar si një monografi seriale alternative ajo jo vetëm që shënon një arritje të veçantë në mendimin shkencor, por qëndron nga përmasa dhe vëllimi i paparë përkrah arritjeve më të mira të këtij mendimi në fushën e shkencave humane.

Për disa dhjetëra vite studiuesi ka gjurmuar dokumente, fakte arkivore, vepra gjuhësore e letrare, historike e kulturore duke synuar të nxjerrë në dritë jo thjesht anën e dukshme të fakteve apo fenomeneve në të cilat u përfshi dhe kontribuoi Ndre Mjeda, si pak kush në kohën e tij, duke marrë pjesë gjallërisht me një ndjeshmëri dhe vetëdije të lartë duke spikatur

me përkushtimin politik, kombëtar, social, kulturor e letrar, duke u gjendur kudo ku e kërkonte koha për afirmimin e identitetit, lashtësisë, vitalitetit të shqiptarëve, shpirtit të tyre të lirë. Ashtu siç ndodhte me të gjithë njerëzit e shquar të kohës së tij, për të nuk kishte punë të mëdha apo të vogla, të rëndësishme dhe të dorës së dytë. Për të çdo gjë që i shërbente çështjes shqiptare ishte parësore. Por formati njerëzor, kulturor e dituror do ta vinin Mjedën në një rol të spikatur jo vetëm në planin politik kombëtar e fetar, por edhe social, kulturor e artistik. Mjafton të kujtojmë kontributet e tij në afirmimin e identitetit gjuhësor të shqiptarëve në betejën për njësimin e alfabetit, ose në studimin e shqipes, si gjuhë e veçantë në familjen indoevropiane.

Me dije, dashuri dhe përkushtim të lakmueshëm studiuesi Mentor Kuku, ka kërkuar parreshtur të zbulojë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, të shmangë deformimet apo gabimet që sjellin kohërat. Janë aq të shumta, të argumentuara dhe bindëse ballafaqimet, krahasimet, debatet e polemikat që ai sendërton në serialin e monografive të tij, për çështje të koklavitura e të ndërlikuara të Lëvizjes Kombëtare, si për çështjen e alfabetit, të lëvizjes demokratike në Shqipërinë e viteve '20 për historinë e shkollës shqipe, të letërsisë, etj., çfarë provon se argumentet e shumtë i kanë zhërvjellësuar edhe metodën dhe optikën e vlerësimit të dukurive, ose thënë ndryshe, kanë përcaktuar stilin e tij si studiues. Ai ka arritur të japë, duke tejkaluar nivelin e deritanishëm, mozaikun polivalent të Mjedës, që është jashtëzakonisht i pasur dhe i larmishëm. Në Mjeda 1 (Rinia) (1866-1888), studiuesi përmes një gjurmimi të kujdesshëm ka hedhur dritë dhe ka krijuar një ide të qartë për fazën e hershme të formimit të Mjedës, ku zënë fill rrënjët e tij në Alpet Mitike Shqiptare, në Shkodër dhe në aq qendra kulturore e arsimore të kohës në Evropë, që përbën sipas tij, atë që e quan më e errëta dhe në të njëjtën kohë më e bardha në jetën e rilindësit. Ndërsa në vëllimin Mjeda 2 (Albanologu) (1889-1899), ai ngulmon në ndriçimin e gjithanshëm të përgatitjes, formimit dhe performancës së rrallë që shfaqti Mjeda si dijetar në kontakte dhe marrëdhënie me albanologë evropianë nga më të mëdhenjtë që çmuan vlerat konkurruese të kontributit të tij. Pas përfaqësimit të Jeronim de Radës në një kongres orientalistësh mbajtur në Romë në fund të shek. XIX, përfaqësimi i Mjedës në kongresin e orientalistëve në Hamburg të Gjermanisë më 1902 shënonte vërtet ngjarje për dijetarët dhe filologët nga atdheu mëmë. Në këtë vështrim epistolari i pasur me albanologë të shquar i bërë i njohur për herë të parë në një masë të mirë, i shfrytëzuar nga studiuesi me rigorozitet dhe skrupoluzitet ka shumëfishuar objektivitetin e studimit.

Lënda e pasur faktike dhe problematika që përfshinte njësia e tretë biografike në harkun kohor 1899-1912 e ngjeshur me plot veprimtari jo vetëm të karakterit të mirëfilltë politik kombëtar, por edhe me veprimtari kulturore letrare që fitonin për kohën vlera të mirëfillta kombëtare politike si çështja e pavarësisë apo e alfabetit të njësuar të shqipes që do të shënonte në udhën e institucionalizimit të standardit gjuhësor hapin e parë e të pazëvendësueshëm. Kjo materie që ngërthen aq procese komplekse me ngritje dhe zbritje të shpjegueshme për vetë rëndësinë dhe peshën që mbart, i ka thyer kornizat e parashikimit të autorit, dhe ashtu ku me vetëdije dhe ku spontanisht u ka dhënë formë, dy vëllimeve që bartin dy procese që i takojnë harkut kohor 1899-1912, që autori me të drejtë i ka titulluar “Alfabeti” dhe “Liria”.

Pavarësisht nga veçoritë që paraqesin këto rrjedha, studiuesi i ka qëmtuar me kujdes deri në detaje. Në vëllimin e alfabetit ai ka ballafaquar teza dhe kundërteza lidhur me udhën e vështirë të shkronjave shqipe. Në çështjen e njësimit të alfabetit të shqipes, një personalitet me bindje të thella dhe qartësisht të dallueshme e shkencore siç ishte Mjeda, në momente të caktuara për hir të konsensusit do të pranonte edhe zgjidhje të tjera, pavarësisht se ata nuk shkonin në përputhje me mendimet e tij, të cilave ai vazhdonte t’u qëndronte konsekuent në disa botime. Veprimin e pasur deri në shpalljen e Pavarësisë ka edhe vëllimi që jo rastësisht është titulluar “Liria”.

Të njëjtin qëndrim mban edhe ndaj lëvizjes kombëtare, ku ka momente kur për hir të strategjisë ai bën lëshime taktike me një qartësi të lakmueshme. Në këtë vëllim studiuesi nënvizon vizionin universal që kishte për lirinë Mjeda si në kuptimin filozofik, politik, social, fetar, shkencor, kulturor e artistik.

I apasionuar pas së vërtetës studiuesi Mentor Quku ka bërë që monografia e tij alternative të ketë informacion të bollshëm deri në hollësi për rrethanat e arsytet e çdo veprimi politik, kombëtar, social dhe fetar të Mjedës. Me kërkimet e gjurmimet e tij ai jo vetëm ka zbuluar shumë nga epistolari i Mjedës, dhe kur ia ka dashur puna e ka riprodhuar të plotë duke e shoqëruar me kritikën përkatëse.

Ndërsa vepra albanologjike e letrare e Mjedës ka gjetur në këtë monografi, vendin që i takon në jetën tejet të pasur të rilindasit. Në qoftë se vepra e tij filologjike është parë si rrjedhim i formimit të tij shkencor, kulturor, vepra poetike në mënyrë të pandërprerë në monografi është vështuar si rezultat i ndjeshmërive të thella të brendshme të poetit, e prirjes dhe talentit të tij jo të zakonitë. Por përmes këtyre dimensioneve të veprës së Mjedës buron natyrshëm lidhja e pandarë e poetit me Shqipërinë dhe

shqiptarët, që nuk u tjetërsuan në asnjë rrethanë. Vlen të theksohet se ndonëse qe ndër më të arsimuarit dhe të kulturuarit të shekullit të artë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare ai mbeti i dalluar i pangatërrueshëm dhe i papërsëritshëm në identitetin e tij si njeri, si shqiptar, si krijues dhe erudit. Ndonëse ai ka hyrë e ka mbetur në kujtesën e kombit, veç të tjerave si poet i ndjeshmërive të thella, me një peshë fjale e mendimi poetik të rrallë, studiuesi e ka zbuluar veprën e tij letrare, ashtu siç ka ardhur ajo në kohë në stinë të ndryshme të jetës së poetit, ose e ndërthurur me aq shumë veprime në të cilat ai u përfshi. Por kjo nuk e ka penguar studiuesin që të hedhë edhe këtu dritë të vërtetë mbi historinë e frymëzimit të çdo vepre, historinë e botimit, historinë e receptimit (të pritjes) së saj në kohë, historinë e mendimit kritik apo studiues mbi të. Dhe kjo bëhet për të gjitha veprat që nga vjershat antologjike të Mjedës deri në poezitë e paharrueshme dhe me vlera emblematike të poetit e deri tek veprat e tij madhore klasike si poemat e njohura të autorit. Dhe ajo që ka rëndësi të theksohet është fakti se ai për çdo vepër artikulon një ide një fjalë të re që vjen e matur, e peshuar larg çdo rrëmbimi apo pasioni, që kërkimi aq këmbëngulës mund të prodhojë vetvetiu.

Tekstet autografe të Mjedës kanë qenë objekt studimi skrupuloz për të bërë krahasime dhe për t'i dhënë përgjigje edhe pasaktësive, deformimeve dhe keqinterpretimeve të rrjedhura më shumë nga mosnjohja ose transmetimi jo i saktë nga një studiues a botues tek tjetri.

Për lëndën e pasur, të shumanshme dhe funksionale që ofron ky botim serial monografik ndonëse ende në udhë të realizimit, pa u përfunduar, mund të thuhet dhe pranohet se vepra monografike e Mentor Qukut, qëndron tashmë si institucion apo burim i pashmangshëm dhe si një enciklopedi për autorin dhe epokën e artë të Rilindjes Kombëtare. Botimi në vazhdim dhe i veprës së tij ashtu siç është paralajmëruar do të formojë një komplet nga më interesantet dhe me vlerë, i krahasueshëm në vëllim dhe në synime me punën e një ekipi të tërë studimesh.

Kjo nismë dhe kjo veprimtari me pretendime shterruese me një mendim ndryshe e pasuron mendimin në përgjithësi dhe e nxit më tej debatin dhe polemikën shkencore aq shumë të kërkuar e të dobishme sa edhe të munguar.

Akribia, serioziteti, vijimsia e pandërprerë është shprehur edhe në gjithë aparatit shkencor, nga burimet arkivore, literatura e pasur, dokumentet, dëshmitë gojore, fotot, fotokopjet e dorëshkrimeve apo të dokumenteve, të letrave tek skicat e tabelat krahasuese, tek ilustrimet e

riprodhimet e shumta që përmban studimi, të cilët janë në vendin dhe funksionin e duhur.

Kontributet e jashtëzakonshme të Ndre Mjedës në historinë kombëtare e kulturore shqiptare kanë gjetur tek studiuesi Mentor Quku, njeriun e përkushtuar e këmbëngulës që një jetë të tërë punoi me devocion e dashuri për të ndriçuar njeriun, personalitetin dhe fenomenin Mjeda.

Vepra të tilla, jo thjesht për vëllimin, por edhe për nivelin dhe arritjen janë një investim me peshë në jetën tonë mendore e kulturore, që pamëdyshje u përcillet brezave të ardhshëm, sepse ato kanë vlera të krahasueshme me vlera të ngjashme në historinë kulturore evropiane, të denja për të fituar jo vetëm mirënjohjen, por edhe vlerësimin e merituar të bashkëkohësve. Ata kanë një vend të nderuar në visarin kulturor gjithëshqiptar.

Fatbardha Hoxha

**EDHE NJË ANTOLOGJI PËR ULQININ,
“ULQIN, TI KALA”**

Është e njohur lidhja e fortë, e brendshme dhe e përvetshme e çdo njeriu me vendlindjen e tij, e cila fillon tek zemra, tek pragu i shtëpisë për t'u shtrirë më pas në të gjithë hapësirën që i jep identitetin e patjetërsueshëm çdo individit. Në këtë vështrim e gjejmë fare të natyrshme nismën e nisur kohë më parë të shkrimtarit të mirënjohur Hajro Ulqinaku që t'i japë lexuesit përveç antologjive me shkrimtarët e vendlindjes për të rritur e fëmijë edhe antologji për këtë qytet shqiptar nga më të njohurit e Dalmacisë ilire me vazhdimësi jete e qytetërimi të pandërprerë ndër shekuj.

Nismën jo të zakonitë për nga vëllimi, të shkrimtarit për të sjellë gjithçka është shkruar për Ulqinin në folkun gojor, në poezi dhe së fundmi në prozë “*non fiction*” dhe “*fiction*” e shpjegon sakaq edhe një fakt tjetër që lidhet me Ulqinin dhe viset rreth tij. Janë të shumta e tejet të ndryshme arsyet që i japin Ulqinit atë fizionomi të veçantë të magjishme e tërheqëse.

Së pari duhet veçuar gjeokompleksi natyror që formon atë gji natyror në brigjet e Adriatikut, rilievi i butë mesdhetar dhe i ashpër malor, bjeshka e Rumisë, Lugina e Valdanosit, bregu dhe grykëderdhja e Bunës, Liqeni i Zogajt dhe i Shasit, qyteti shekullor me kalanë qindravjeçare me histori të lashtë e të bujshme, me qytetërim të hershëm, qendër e turizmit në kohët e reja, me mundësi dhe perspektiva pa fund zhvillimi dhe integrimi.

Por mbi të gjitha qyteti vezullon në shpirtin e qytetarëve të lidhur pazgjidhshmërisht me të kaluarën, të sotmen dhe të nesërmen e këtij qyteti.

Me intuitën e vetëdijën e krijuesit Hajro Ulqinaku ka dalluar edhe përmes titujve të antologjive Ulqin-“*Thesar popullor*”, “*Ulqin, ti det*” dhe “*Ulqin*”, *ti kala*” me një konotim të pasur poetik metaforik, rrënjët historike të këtij qyteti, mitet, legjendën, lirikën dhe epikën e tij.

Të hartosh antologji, jo vetëm që nuk është punë e lehtë e aq më pak një **r**ënditje formale e pasurisë letrare. Në vartësi nga qëllimi i saj për të hyrë në komunikimin letrar, ajo i nënshtrohet një laboratorit që mund ta përballojë vetëm një personalitet me njohje të mirëfilltë të vlerave letrare dhe me shije, që di të ndërtojë rendin e autorëve dhe të veprave në funksion të qëllimit, në këtë rast me epiqendër Ulqinin dhe viset rreth tij.

Padyshim si edhe në antologjitë e mëparshme autori ka ditur të qëmtojë, të përzgjedhë dhe të përkthejë ato vlera folklorike, poezie dhe proze së fundmi, që i përmbushin kërkesat tematike.

Në antologjinë “*Ulqin, ti kala*” ku fokusohet siç mund të kuptohet jeta qytetare në të gjitha pamjet e saj, ai e sjell materien letrare përmes dy pjesëve, pjesës së parë “*Gjurmë kohe*”, ku ka përfshirë prozë historike, publicistike dhe dokumentare, si dhe përmes pjesës së dytë, “*Kala jetike*” ku ka përfshirë prozë letrare ose “*fiction*”. Në pjesën e parë ka përfshirë 27 autorë dhe në pjesën e dytë 22 autorë.

I rëndësishëm është fakti se përveç 36 autorëve shqiptarë, antologjinë e plotëson edhe përfshirja e 11 autorëve të huaj, veprat e të cilëve autori i antologjisë i sjell të përkthyer në shqip, çfarë rrit dukshëm vlerat e këtij botimi, sepse reflektimet për këtë qytet kanë kapërcyer kufijtë e botës shqiptare.

Po kaq domethënës është fakti se shkrimet dokumentare e letrare të mirëfillta që vatërzojnë Ulqinin dhe viset rreth tij nuk kanë kufij kohorë e hapësinorë. Ato i takojnë sa letërsisë së traditës aq asaj moderne dhe bashkëkohore. Aty përfshihen përfaqësues nga e gjithë hapësira shqiptare nga Tirana, Durrësi, Shkodra, Elbasani, Saranda, Prishtina, Gjirokastra, Çamëria, etj.

Me shumë interes janë dëshmitë dhe vlerat që sjellin të huajt për Ulqinin, si: Kurt Hasert, Jozef Jan Svatek, Andrej Nikoladis, Dinko Franetoviq Bare, Erich Koch, etj.

Antologjinë e pasurojnë shkrime të personaliteteve të botës shqiptare, si: Ndoc Nikaj, Ramiz Kelmendi, Mehmet Kraja, Ruzhdi Ushaku, Moikom Zeqo, Hajro Ulqinaku, Vehbi Kikaj, Ibrahim Beriashi, Asllan Bisha, Bahri Brisku, Zuhdija Hoxhiq etj. Veçanërisht pjesa e parë e antologjisë “*Gjurmë kohe*” me të dhënat historike, ekonomike, politike dhe kulturore që përmban merr vlerën e një enciklopedie për Ulqinin.

Interesante janë pjesët për detarinë, ullishtarinë e të tjera pamje të veçanta të jetës qytetare në Ulqin.

Befasinë dhe magjinë natyrore të Ulqinit e kanë reflektuar edhe të huajt që kanë kërkuar dhe kanë gjetur me objektivitet të veçantën dhe të papërsëritshmen e këtij qyteti dhe viseve përreth duke zbuluar jo vetëm peizazhin e rrallë, larminë e pafund, historinë e hershme dhe të re të qytetërimit autokton.

Shkrimet e autorit çek Jozef Jan Svatek i japin aq vend Ulqinit, ku ndër të tjera autori shprehet: “*Kësaj foleje të çuditshme, të jashtëzakonshme ia kushtoj një kaptinë të veçantë, sepse Ulqini me të drejtë të plotë e meriton. Është një çerdhe e shqiponjave, çfarë mund ta hasin vetëm në krahinat e pashkelura të Dalmacisë dhe në bregun perëndimor të Shqipërisë. Por më i njohur nga ato është Ulqini*”.

Në shkrimet e autorëve shqiptarë dhe jo shqiptarë ku nuk mungojnë vëzhgimet me interes për historinë, për antropologjinë kulturore, për etnokulturën e banorëve, tërheq vëmendjen se ku spontanisht e ku me vetëdije të qartë njerëzit dinë të vendosin komunikimin e ndërsjellë njerëzor, çfarë flet për jetën e bashkësive sociale me përbërje të ndryshme, ku njerëzit me mendje të hapur bëhen bartës e protagonistë të tij.

Në shkrimin "*Mark Milani në Ulqin*" e Aleksandër Janinoviç sjell të dhëna nga jeta e luftëtarit dhe shkrimtarit malazes që flasin për mirëkuptim të ndërsjellë midis popujve, ku ndër të tjera thuhet: "*A po më thua Vojvodë, ku e ke mësuar gjuhën arbëreshe ?* Mark Milani përgjigjet: "*Në fisin tim flitet nashke dhe arbërisht. Të dy gjuhët janë të miat. Përveç kësaj në mes të fisit tim dhe atyre të veriut të Shqipërisë nuk ka kufi. Edhe unë dhe pjesëtarët e fisit tim shkojmë lirisht tek ata, unë flas shqip e ata gjuhën malazeze, kurse kur ata vijnë tek ne unë flas malazezçe e ata arbërisht*".

Në shënimet e tij Jozef Jan Svatek nuk reshtet të theksuari faktin se "*Romantikë më të madhe Ulqinit i jep Qyteti i vjetër (Kalaja), që është i mbrojtur me bedena në anën veriore të gjirit*". Autori i antologjisë Hajro Ulqinaku, jo rastësisht pjesën e dytë e ka quajtur kala jetike duke përzier si pa u ndjerë të jashtëzakonshmen me të zakonshmen e këtij qyteti magjepës. Pikërisht në këtë pjesë me vepra letrare të mirëfillta, autori ka ditur të përzgjedhë ato autorë dhe vepra që pranë vënë realen dhe imagjinaren, mjedise dhe karaktere interesante që bartin sa veti të së veçantës dhe të universale.

Të lexosh antologjitë e Hajro Ulqinakut është një veprim sa i dobishëm, tërheqës dhe i këndshëm. Ato të sjellin atë botë reale që përfaqëson Ulqini dhe viset rreth tij me identitetin qartësisht shqiptar të qytetërimit, por që të çon edhe në një botë virtuale të "*fiction-it*" ku realja merr jetë të re.

Ulqini është ndër qytetet e rrallë ku mbliidhen e konvergojnë aq shumë nuancea ngjyrash e tingujsh dhe ku përthyeret peizazhi nga pjesë disi në kontrast me njëra-tjetrën, e pikërisht për këtë edhe të lidhura së brendshmi, për t'i dhënë formë siluetës së magjishme të kalasë që ndrit nga rrahjet e valëve të shkumëzuara të detit. Falë peizazhit të veçantë e gjeokompleksit natyror atë e krahasojnë me vende tepër larg tij si Gjirokastrën (A. Kondo), me Çamërinë (N. Selmani). Ky relief i larmishëm dhe magjepës është projektuar në shpirtin e qytetarit shekullor të tij.

Pasi kthen faqet e fundit të antologjisë lexuesi mban gjatë në mendje historitë e bujshme të limanit ku qëmoti hynin dhe tregtoheshin

skllevër, ku kishte rënë rob, qe dashuruar dhe blerë, Servantesi, spanjoll i madh, i cili pas shumë gjasash në veprën e tij madhore provon se Ulqinin nuk e pat harruar asnjëherë, kalaja me gurët e saj të shenjuar që flisnin me gjuhën e simboleve të stërlashta, ku rronte në kujtesë historia e misterhme e çifutit Shabetai Zevi. E jeta rrjedh përmes legjendave, tregimit dhe përshkrimit, meditimit e dialogut, realitetit dhe trillit që i jep gjallëri kujtesës së qytetit, dramave dhe rropamave të përditshmërisë sepse edhe ato kanë bukurinë dhe veskun e tyre estetik.

Histori e dyerve të mëdha të mbretërve e princërve si ajo e Balshajve, të njerëzve të shquar e me emër të madh, histori dhe fate të njerëzve anonimë, të vajzave e djemve fatkeq e të lumtur, të nënave dhe baballarëve të tulatur nga dhimbjet e mbijetesës e të vdekjes, dashuri e pasione vrastare, miqësi njerëzore, dialog e mirëkuptim të ndërsjelltë, humanizëm dhe solidaritet i natyrshëm midis kombësive dhe racave të ndryshme, ndjenja dhe vetëdije etniidentifikuese, të gjitha këto i gjen tekta syri dhe mendja rrëshqet në rreshtat e prozës së antologjisë së fundit “*Ulqin, ti kala*” të Hajro Ulqinakut.

Mozaiku i Ulqinit, lëshon dritë edhe këtë herë në shpirtin shqiptar dhe e ngroh atë anë e kënd botës sepse i dërgon dhuratë “*pak Ulqin fantastik*” si sfidë ndaj vorbullave që shfaq jeta moderne, duke përmbushur një nga misionet më të rëndësishme e fisnike të letërsisë atë të dialogut dhe të ndërkomunikimit midis njerëzve. Për këtë autori i antologjisë meriton më shumë se mirënjohje. Dhe lexuesi e ndjen se pas kujtesës qytetare frymon, njerëzorja, universalja, përmes pjesës, e tëra, individualiteti shqiptar i realizuar përmes bukurisë së faktit real dhe hirit të artikullimit të fjalës artistike që shfaqet me veprën e Ramiz Kelmendit, Fadil Krajës, Moikom Zeqos, Hajro Ulqinakut, Mehmet Krajës, Ibrahim Beriashit, Vehbi Kikajt, Zuhdija Hoxhiq, Asllan Berishës, etj.

Larmia e lëndës së përzgjedhur, autorët e përfshirë në antologji flasin jo vetëm për interesimin e letërsisë për Ulqinin dhe viset rreth tij, por në një farë mënyre edhe për nivelet e kësaj letërsie dhe antologjitë në një kuptim janë forma të konkurrimit të vlerave.

Duke i uruar antologjisë më të re të Hajro Ulqinakut shtegtim të mbarë, përgëzojmë ngrohtësisht hartuesin e saj duke i dëshiruar arritje të reja në udhën e krijimtarisë.

Fatbardha Hoxha

KULTURAT SI URA KOMUNIKIMI

Alma Hafizi. "Letërsia e kufijve". (Përqasja Magris-Camaj). Botimet "Camaj-Pipa". Shkodër, 2008. 184 f.

Që në titullin e kësaj monografie dr. Alma Hafizi shkrep blicin e një fotoaparati të ndjeshëm për të fiksuar në pozë çift, dy shkrimtarët modernë të të njëjtit shekull (XX) dhe të të njëjtit det (Adriatik).

Fakti i parë, që shkrimtari italian dhe ai shqiptar nuk e njohën njëri-tjetrin; fakti i dytë, që Magris u përthith gradualisht nga lexuesi dhe kritika, ndërsa Camaj nga ferri jashtëletrar u ngrit në panteonin e merituar: pra këto dy fakte së bashku përbënin një pengesë jo të vogël për studiuesen e re dhe kërkonin një stërvitje relativisht të gjatë në paralelet dhe unazat e letërsisë së krahasuar.

Me një strukturë të qëndrueshme nga ana shkencore dhe të motivueshme nga shprehësia estetike parashtrihen kapitujt: Ç' kuptojmë me "Letërsi të kufijve"; Koncepti i kufijve politikë, kulturorë e letrarë; Pika takimi në problematikën e veprave të Kludjo Magrisit dhe të Martin Camajt.

Në këtë studim të thukët A. Hafizi ka zbatuar metodën e letërsisë së krahasuar, ku përqasja vë në marrëdhënie të ndërsjellta tekste nga letërsi dhe kultura të ndryshme, gjer në kuvendimin mes tyre.

Tek çështja "Kufij të humbur e të rigjetur" për portretizimin e Kludjo Magrasit, që u jep rëndësi primare kufijve të identitetit personal, studiuesja Hafizi funksionalizon një personazh të autorit:

"...gjithçka rreth meje është një kufi, edhe bluja e detit edhe horizonti i kuq i disa mbrëmjeve: kufij magjepsës që aq shumë i kam dashur që fëmijë dhe i dua akoma...por kufij edhe ato. Dhe unë ndihem i lodhur, do të të doja të dilja të shkoja në anën tjetër." (f.49).

Ndërsa tek çështja "Kundërvënie kulturash në botën shqiptare" postulatit e Martin Camajt "...edhe pse shpërthen prej një momenti personal, poezia u përket të gjithëve" (f.90), dr. Hafizi e fëillon se kjo thënie e tij duhet kuptuar në formimin e dyfishtë Lindje - Perëndim, që pasqyrohej në botën e shenjave dhe të simboleve shqiptare.

Tek çështja "Malli i kthimit në vendlindje" Alma Hafizi zbulon elemente të përbashkëta mes Magrasit dhe Camajt, si dedektivë të hapësirës, ku personazhet gjenden në rrethana të ngjashme veprimi. Motivi

i kthimit në vendlindje nxitet nga alarmi që bie në psikikën e shkrimtarëve kur ata bëhen të ndërgjegjshëm për humbjen e vetvetes.

Këtë shqetësim studiuesja e zbërthen thellë në kapitullin “*Përfundime*”. Rreziku i shpërbërjes i humbjes së identiteteve të vogla për Magrisin dhe Camajn është i përhershëm, përse kohë zgjat udhëtimi, largimi nga “*shtëpia*”, streha familjare. Parandalues i katastrofës është kthimi tek vendlindja, i cili në letërsi nuk shfaqet asnjëherë real, por gjithmonë metaforik. Në udhëtimin rrethor, që të risjell ku ishe apo në atë drejtvizor, që të largon përherë e më shumë nga ku ishe; janë të gjitha stacionet e jetës së dy shkrimtarëve...

Në studimin shkencor të znj. Almës analiza kritike vishet me stofë letrare, cilësi që ndikon në receptimin e veprës, nga lexuesi i specializuar dhe nga ai i zakonshëm.

Alfred Çapaliku

FLETËT E JETËS, HISTORI PEDAGOGJIKE NDËR VITE,

shkruar nga Fiqiri Hoxha, Shtëpia botuese "Camaj-Pipa,
Shkodër, 2010, 354 f.

Në këtë monografi autori Fiqiri Hoxha paraqet historinë e një shkolle me tradita të qytetit të Shkodrës në prag të 100-vjetorit të saj. *Fletët e jetës, histori pedagogjike ndër vite* është një vepër që pasqyron edhe punën e vullnetshme dhe të palodhur të arsimtarit veteran Fiqiri Hoxha.

Ndjej një kënaqësi të veçantë për të përgëzuar me gjithë zemër autorin për hartimin e kësaj vepre, një monografi e arrirë dhe e suksesshme, me interes shkencor dhe pedagogjik, që ndriçon këtë histori të pasur të njërës nga shkollat më të vjetra të qytetit tonë. Ai ka ditur të evidentojë, të zbërthejë dhe të sintetizojë me profesionalizëm çdo detaj të veprimtarisë arsimore të kësaj shkolle, shkruar me një gjuhë të rrjedhshme dhe të këndshme.

"Punimi "Fletët e jetës" që po paraqesim, shkruan autori në hyrje, synon të ndriçojë sadopak historinë e traditën e arsimit në trevën e Shkodrës e në veçanti në zonën e Rusit, të një shkolle që e nisi jetën e saj në fillimet e shekullit XX. Natyrisht të çelësh sot një shkollë është një dukuri e zakonshme, por në fillimet e shekullit XX problemi shtrohej ndryshe. Do të bëhej Shqipëria apo do të zhdukej në vorbullën e historisë duke u paraprirë nga fqinjët. Një komb kurrsesi nuk mund të bëhet, kur nuk ka gjuhën dhe kulturën e tij."

Njëkohësisht është për t'u vlerësuar edhe interesimi i drejtorisë arsimore rajonale të Shkodrës për këtë botim, duke e konsideruar edhe si nxitje që do t'u shërbejë edhe arsimtarëve të tjerë të qytetit tonë. Dhe nuk janë të shumtë ata mësues që shkruajnë, prandaj duhet të inkurajohen, pasi historia e arsimit të Shkodrës ka nevojë për njerëz të tillë me dëshirë, vullnet dhe këmbëngulës si autori i këtij botimi.

"Fletët e jetës" e F.Hoxhës, histori afërsisht njëshekullore e njërës nga tri shkollat më të para publike të hapura në qytetin e Shkodrës, pikërisht në agim të pavarësisë kombëtare, ka vlerë të veçantë për të parë këtë rrugëtim të arsimit tonë në këtë qytet, por njëkohësisht vlera e saj është e madhe se ka thithur në drejtimin dhe stafin e saj mësues të devotshëm, të paktë në numër për atë kohë, por patriotë të vërtetë në radhë të parë për t'i

dhënë dritën e arsimit qindra e qindra nxënësve të një zone të kufizuar, por të një rrethi të gjerë. Siç vërehet nga monografia, të cilat i ka vënë në dukje F.Hoxha, nga kjo shkollë kanë dalë personalitete të kulturës sonë kombëtare e në veçanti të arsimit kombëtar.

E gjithë kjo veprimtari e gjerë, gjithë ky arkiv i pasur, gjithë kjo veprimtari e larmishme e saj, e ka nxitur z. Fiqiri Hoxha të fillojë punën për hartimin e kësaj monografie, jo të lehtë për t'u shkruar, pasi do kulturë pedagogjike, historike dhe gjuhësore dhe, siç e theksuam, autori ia ka dalë në krye me sukses, prandaj kemi të drejtë ta falënderojmë për një vepër të tillë. Ishte një punë që donte durim, kërkime dhe hulumtime në arkiva, muzeume, shkolla dhe biblioteka e mbi të gjitha takime me familjarë, mësues e nxënës të vjetër dhe të rinj të kësaj shkolle. E mira nuk ka fund. Dikush në të ardhmen mund ta pasurojë me të dhëna të reja.

Z.Fiqiri Hoxha e nisi punën, shkroi një monografi prej 354 faqesh, ilustruar me foto të rralla, me vlera historike, por edhe nga koha e sotme. Me të drejtë ky është një nderim për gjithë ata mësues që kontribuan në këtë shkollë për arsimimin e një brezi të tërë. Dhe secili mësues apo nxënës kërkon të gjejë veten në atë foto, apo në atë listë emërore.

Vepra e botuar nga Shtëpia Camaj-Pipa, është konceptuar në njëmbëdhjetë krerë, duke trajtuar problemin sipas etapave të historisë së arsimit tonë të shek.XX. Kështu autori e fillon punën e tij me traditën e arsimit dhe të shkollës në Shkodër që përbën kreun e parë të kësaj monografie. Në kreun e dytë autori merret me Shkollat e Rusit (1913-1920), ku veçon: Programet e teksteve mësimore, rendet e shpejta të verës, përgatitja dhe kualifikimi i kuadrit mësimor etj. Kreun e tretë e ka titulluar *“Përpyekjet për demokratizimin dhe laicizimin e shkollës në vitet 1920-1924.”* Autori ndalet në këto çështje: Kongresi arsimor i Lushnjës (1920) - hap i rëndësishëm për demokratizimin dhe laicizimin e shkollës, Shkolla e Rusit në vitet 1920-1922, Kongresi arsimor i vitit 1922. Sistemi dhe programi i ri i shkollës fillore, Shkolla e Rusit në vitet 1922-1924 dhe vazhdon me kreun IV që i kushtohet arsimit në shkollat fillore të Rusit 1925-1939. Këtu autori trajton: Drejtime të veçanta të arsimit fillor 1925-1939, shkollat fillore të Rusit 1925-1928, ecuria e mëtejshme e shkollave 1929-1939. Kreu i pestë i kushtohet shkollave të Rusit në periudhën e pushtimit fashist 1939-1944, ndërsa në kreun e gjashtë autori është përqendruar në shkollat e Rusit në vitet 1944-1947, duke trajtuar në veçanti: Hapat e para për demokratizimin e shkollës, Ecuria e shkollave fillore të Rusit në vitet 1944-1947, Reforma arsimore. Në krerët e tjerë (krerët VII - XI) autori vazhdon me po ato kritere për këtë shkollë në vitet 1947-1956. Më pas F. Hoxha merret me riorganizimin e sistemit arsimor

gjatë viteve 1956-1990, zhvillimi dhe thellimi i reformave demokratike 1992-2008, portrete mësuesish, krenaria e shkollës ndër vite, bibliografia.

Dua të theksoj se lexuesi merr njohuri të sakta dhe të plota për zhvillimin e arsimit në rrethin tonë në përgjithësi e për një shkollë në veçanti.

Shembulli i Fiqiri Hoxhës duhet të përgjithësohet që edhe në të ardhmen të hartohen dhe të botohen vepra të tilla, që pasqyrojnë traditën arsimdashëse të popullit të Shkodrës, kur sot piramida arsimore e këtij qyteti mbulon tërë kategoritë e shkollave që nga çerdhet dhe kopshtet deri në Universitet dhe më tej.

Theksoj edhe njëherë se monografia “*Fletët e jetës, histori pedagogjike ndër vite*” e z. Fiqiri Hoxha është një ndihmesë e vlefshme për historinë e arsimit në të kaluarën, por edhe sot. Monografia na jep të dhëna të rëndësishme, një informacion të saktë, një dokumentacion shumë të pasur, një interpretim me interes, që do të vlerësohet nga studiuesit e kësaj fushe.

E përgëzojmë dhe e përshëndesim z. F. Hoxha, arsimtarin e zellshëm dhe punëtor, kolegun tonë të nderuar, për këtë monografi të lavdërueshme dhe të suksesshme, shkruar me nivel, një monografi e gjerë dhe e plotë për historikun e një shkolle, një sukses për autorin. Dhe ky botim le të shërbejë për të vazhduar në këtë fushë duke na dhënë edhe me vepra të tjera, pasi monografia e porsabotuar e nderon arsimtarin Fiqiri Hoxha.

Tomor Osmani

J E T A S H K E N C O R E

I. VEPRIMTARI DHE AKTIVITETE SHKENCORE

KONFERENCË SHKENCORE “PËR NIVELE E STANDARDE EVROPIANE NË VEPRIMTARINË KËRKIMORE, SHKENCORE, UNIVERSITARE”, Tiranë - Shkodër

Për dy ditë më radhë (8-9 qershor 2010) është zhvilluar konferenca shkencore “Për nivele e standarde evropiane në veprimtarinë kërkimore shkencore universitare”. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe UFO University ishin bashkorganizator të këtij aktiviteti shkencor. Konferenca u zhvillua në dy universitetet respektive, ditën e parë në ambientet e UFO University, ndërsa ditën e dytë në Bibliotekën shkencore të Universitetit të Shkodrës. Në fjalën e përshëndetjes zv/rektori, prof.as.dr Fatmir VADAHI theksoi se “Qëllimi i realizimit të kësaj Konference përkon drejtpërdrejt me prioritetet e dy universiteteve tona, zhvillimin e Arsimit të Lartë dhe përballjen sa më të denjë me sfidat e këtij zhvillimi. Për dy ditë me radhë organizojmë së bashku këtë konferencë shkencore shumë të rëndësishme me një pjesëmarrje të gjerë të pedagogëve dhe studiuesve jo vetëm të Universitetit të Shkodrës dhe UFO University, por edhe nga shumë Universitete partnere. Kjo pjesëmarrje na paraqet një larmi të gjerë në tematikë, metodologji, por edhe në risi mendimi dhe zgjidhje”. Sipas referuesve në këtë konferencë, investimi për arsimin dhe shkencën është një garanci e fuqishme për zhvillimin e vendit. Në konferencë u vu theksi në faktin se diplomat duhet të jenë efektive për një treg të hapur dhe në funksion të këtij procesi aktualisht në kuadrin e Deklaratës së Bolonjës, duhet të kemi një kombinim dykrahësh: mësim dhe kërkim shkencor. Si element pozitiv u cilësua interesimi gjithnjë në rritje për pjesëmarrje në projektet e kërkimit, si nga stafi akademik, ashtu dhe nga studentët, e gjithë kjo në funksion të përafrimit me sistemet e përparuara evropiane.

Në ditën e parë të zhvillimit të kësaj Konference shkencore nga Universiteti i Shkodrës u referuan këto tema:

- *“Stili i Lidërshiptit në Universitetin “Luigj Gurakuqi”*, Shkodër, prof. as. dr. Gëzim DIBRA, dr. Jozef BUSHATI, MA Lediana XHAKOLLARI, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, Ass. Profes. Violeta VIDAČEK-HAINŠ, Ph. D. Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Organizimit dhe Informatikës.
- *“Teknologjitë Multimediale në programin “Master”*”, prof. as. dr. Gëzim DIBRA; dr. Jozef BUSHATI; MA Lediana XHAKOLLARI, Univers. “Luigj Gurakuqi” Shkodër; Ass. Prof. Violeta VIDAČEK-HAINŠ, Ph. D. Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Organizimit & Informatikës.
- *“Aspekte të punës kërkimore – shkencore të Qendrës Kërkimore–Shkencore të albanologjisë të Universitetit të Shkodrës”*, prof. dr. Tomor OSMANI, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
- *“Problem në standardizimin e punës kërkimore – shkencore në nivel departamenti”*, prof. as. dr. Fatmir Vadahi; dr. Mehdi KRONI, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Në ditën e dytë të Konferencës nga Universiteti i Shkodrës ishin këto kumtesa:

- *“Kërkimi shkencor, pjesë integrale e strategjisë së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*”, prof. dr. Artan HAXHI, prof. as. dr. Fatmir VADAHI; prof. dr. Irakli Beka.
- *“Integrimi i studentëve në punën studimore kërkimore shkencore në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*, dr. Dhurata HOXHA; MA. Elinda DIBRA, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
- *“Përdorimi i teknologjisë së GiS-it nga studentët e gjeografisë në kërkimet e tyre”*, Ma. Ervis KRYMI, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër.
- *“Departamenti i gjuhësisë përballë sfidave të reja në fushën e kërkimit shkencor – faktor për një ngritje cilësore të mësimdhënies”*, dr. Mimoza PRIKU, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.
- *“Refleksione rreth disiplinës së kërkimit shkencor në Fakultetin e Edukimit”*, MA. Eranda BILALI, Ma Rina GERA, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.
- *“Puna kërkimore e Qendrës kërkimore të bioekologjisë së liqenit të Shkodrës si pjesë integrale e punës kërkimore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*, prof. as. dr. Marash RAKAJ, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Rr. Draçini

**MARTIN CAMAJ PËR KULTURËN SHQIPTARE.
SHKRIMTARI DHE ALBANOLOGU**

Qendra kërkimore-shkencore albanologjike, Departamenti i Letërsisë dhe Departamenti i Gjuhësisë i Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, më 26 korrik 2010 organizuan konferencën shkencore “*Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe albanologu*”, me rastin e 85-vjetorit të lindjes. Në konferencë morën pjesë studiues nga Shkodra, Tirana, Durrësi, Gjermania dhe Austria. Përveç autoriteteve vendore mori pjesë edhe bashkëshortja e M. Camajt dr. Erika CAMAJ.

E hapi konferencën prof.dr. Tomor Osmani, i cili në mes të tjerash tha: “*Është një nder i veçantë për Universitetin tonë që sot kremtojmë në një konferencë të veçantë 85 - vjetorin e lindjes së shkrimtarit dhe filologut, shkodranit nga Temali i Dukagjinit, Martin Camajn që në të kaluarën moniste emri i tij mbeste si legjendë, por shpejt pas viteve '90 emri dhe vepra e tij filloi të trokasë në dyert e shqiptarëve nga Veriu dhe nga Jugu, duke u bërë një personalitet i dashur, i nderuar dhe i respektuar. Martin Camajn e njohu Evropa dhe Amerika, por jo atdheu i tij, Shqipëria, e vlerësoi gjuhësia kontemporane evropiane, por jo gjuhësia shqiptare, botoi jashtë veprat e tij, por jo në Shqipëri...*”

Më pas përshëndetën: Zv. Rektori i Universitetit të Shkodrës, **prof. dr. Fatmir VADAH**I në emër të Rektoratit, **z. Ndue SANAJ**, kryetar i shoqatës “Atdhetare – Dukagjini”, **prof. dr. Gjovalin KOLOMBI**, kryetar i Këshillit të qarkut të Shkodrës, **prof. dr. Ardian MARASHI**, drejtor i Qendrës Studimore Albanologjike në Tiranë dhe bashkëshortja e M. Camajt **dr. Erika CAMAJ**, e cila falënderoi për këtë konferencë organizuesit dhe dhuroi dy kopje të vëllimit në gjermanisht të përmbledhjes për kontributin, kryesisht të M. Camajt me titull “*Ne jemi të tutë*”, përgatitur nga **prof. dr. Bardhyl DEMIRAJ**.

Referatin “*Martin Camaj - krijues dhe dijetar*” përgatitur nga **prof. as. dr. Ledri KURTI** dhe **dr. Mimoza PRIKU** e lexoi L. KURTI. Konferenca vazhdoi në dy seksione ku u mbajtën 34 kumtesa.

Në seksionin e letërsisë u lexuan këto kumtesa: **A. JAKLLARI** (Tiranë), *Poezia e Camajt midis simboleve mitike dhe synkopeve moderne*; **L. KURTI** (Shkodër), *Drama apo tekste të dramatizuar “Loja e mbasdrekes” dhe “Kandili argjandit”*; **Z. GJETJA** (Tiranë), *Trajtimi i vendlindjes në veprën e M. Camajt*; **B. GJOKA** (Tiranë), *Gegnishtja-*

mallkimi dhe lavdia e Camajt; **A. HAFIZI** (Shkodër), *Relativizmi i Camajt në novelen "Jesemina"*; **V. OSJA** (Tiranë), *Çështje të tipologjisë së llojit tek madrigalet "Dranja"*; **B. SHATRO** (Durrës), *Poezia si botëkrijim dhe estetika e ripërmasimi të kohë-hapësirës*; **Sh. SINANI** (Tiranë), *Ikja si dukuri në jetën dhe veprën e M. Camajt*; **V. KARAKAÇI** (Shkodër), *Qëndrimi i Camajt mbi letërsinë shqipe të Pasluftës*; **L. SMAQI** (Tiranë), *Camaj –shkrimtari ideal në vizionin e Koliqit*; **A. PRENDI** (Shkodër), *Marrëdhënie të poezisë së Camajt me folklorin dhe letërsinë gojore shqiptare*; **A. DANI - L. KAZAZI** (Shkodër), *Dimensioni përendimor i shkrimtarit dhe gjuhëtarit*; **E. ALIA** (Shkodër), *Camaj në këndvështrim pedagogjik*; **E. RAMADANI** (Shkodër), *Romani "Djella"- gërshetim intertekstual midis prozës dhe poezisë.*

Në seksionin e gjuhës u mbajtën këto kumtesa: **K. TOPALLI** (Tiranë), *M. Camaj dhe albanologjia e gjymtuar*; **T. OSMANI** (Shkodër), *Konsiderata gjuhësore të M. Camajt për gjuhën letrare shqipe dhe ndihmesa e tij për një afrim dialektor*; **E. ÇERPJA - E. LAFE** (Tiranë), *Sistemi foljor te vepra "Lehrebuch der albainischen Sprache dhe Albanian Grammar" të M. Camajt*; **Gj. SHKURTAJ** (Tiranë), *M. Camaj-figurë e shquar e albanologjisë dhe e letërsisë shqiptare*; **B. DEMIRAJ** (Gjermani), *Camaj në karrierën e tij akademike*; **M. PRIKU** (Shkodër), *Rreth disa ndërtimeve foljore në prozën e M. Camajt*; **T. TOPALLI** (Shkodër), *Kontribut gjuhësor i panjohur i M. Camajt*; **E. PACI** (Tiranë), *Pikëpamjet e Camajt për "Mesharin"* (Vështrim filologjik dhe tekstologjik mbi librin e parë të gjuhës shqipe); **I. ARAPI** (Austri), *Pasuri leksikore te "Njeriu më vete e me të tjerë"*; **Rr. DRAÇINI - E. HOTI** (Shkodër), *Vështrim psikolinguistik i veprës "Pishtari i natës"*; **M. PARLLAKU** (Tiranë), *Sintaksa e M. Camajt si pasuri gjuhësore e shqipe*; **A. KOSTERI** (Shkodër), *Disa veçori dialektore të romanit "Rrathët" të M. Camajt*; **A. URUÇI** (Shkodër), *Çështje të fjalëformimit të veprës "Drandja madrigale" e M. Camajt*; **O. DUSHI - T. ÇOKU** (Shkodër), *Konsiderata rreth sistemit foljor në një vepre letrare të Camajt*; **A. KRAJA - V. SAKEJ - A. KALOSHI** (Shkodër), *Fenomeni i mënjanimin të së ashtuquajturës një të përparme të veprës së Camajt*; **A. HOTI - A. OSMANI** (Shkodër), *Risitë në gramatikën shqipe të M. Camajt*; **M. BUSHI** (Shkodër), *Letërkëmbimi i M. Camajt me Gj. Sinishten.*

Konferencën e ndoqën një numër i madh intelektualësh e qytetarë nga Shkodra dhe Tirana dhe vlerësuan këtë aktivitet për nivelin shkencor të saj.

Konferenca u mbyll me promovimin e përmbledhjes studimore të vëllimshme prej 600 faqesh për M.Camajn “*Na jemi të tutë*”, përgatitur nga prof.dr. B. DEMIRAJ.

Ky aktivitet u mbështet nga Universiteti i Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” dhe Shoqata “*Atdhetare-Dukagjini*”.

T.Osmani

SHKODRA, ARBËRESHËT DHE LIDHJET ITALO-SHQIPTARE

Qendra kërkimore shkencore dhe Departamenti i Gjuhësisë i Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” në bashkëpunim me Universitetin e Kalabrisë dhe me mbështetjen e komunës së Vakaricit, organizuan me dt. 14 tetor 2010 konferencën shkencore “*Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare*”. Morën pjesë ambasadori italian në Shqipëri Saba D’ELIA, kryetari i komunës së Vakaricit z. Aldo MORINO si dhe studiues të ftuar nga Italia, Prishtina, Tirana, Gjirokastra. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre gjithashtu edhe prefekti z. Maxhid CUNGU dhe përfaqësues të tjerë nga pushteti vendor.

Fjalën e hapjes e mbajti drejtori i Qendrës kërkimore shkencore prof.dr. Tomor OSMANI. Në emër të qeverisë italiane përshëndeti ambasadori i Italisë së Shqipërisë z. Saba D’ELIA, i cili vuri në dukje rëndësinë e lidhjeve italo-shqiptare, si dhe theksoi forcimin e këtyre marrëdhënieve në kulturë e shkencë. Në emër të komunës së Vakaricit përshëndeti kryetari i saj z. Aldo MORINO. Më pas u mbajtën dy referate. Referati i parë me titull “*Kolegji i Shën Adrianit-vatër edukimi e dijeje*”, që u mbajt nga Rektori i Universitetit të Shkodrës prof.dr.Artan HAXHI, përgatitur në bashkëpunim me prof.as.dr.Tefë TOPALLIN. Referatin e dytë e mbajti prof.dr. Matteo MANDALÀ nga universiteti i Palermos “*Kolegjet arbëreshe në marrëdhëniet italo-shqiptare. Roli i Seminarit të Palermos*”. Më pas konferenca vazhdoi punën në dy seanca paralele. Në seancën e parë referuan: akademik Kolec TOPALLI nga Qendra Albanologjike në Tiranë me temën “*Të folmet arbëreshe në studimet dialektologjike të Martin Camajt*”. Nga universiteti i Kalabrisë Francesco ALTIMARI mbajti kumtesën me temë “*Kolegjet arbëreshe në marrëdhëniet italo-shqiptare. Roli i kolegjit të Shën Adrianit*”. Prof.dr. Tomor OSMANI referoi temën “*Studimet gjuhësore për arbëreshët të prof. Jup Kastriotit. Vlerësime dhe interpretime*”. Temën “*Fjalori i një gramatike në syrin e një leksikografi*” e

mbajti prof.dr. Jani THOMAJ. Nga Instituti i Kulturës Popullore referoi prof.dr. Miaser DIBRA me temën “*Mendimi kritik i studiuesve shkodranë për letërsinë arbëreshe të viteve 1939-1944*”. “*Fjalori Arbëreshët- Shqip i Kolë Kamsit si burim për vëzhgime gjuhësore*” u mbajt nga prof.dr. Emil LAFE. Prof.dr. Shaban SINANI nga Qendra e Studimeve Albanologjike mbajti temën “*Bota arbëreshe dhe vendlindja në dy vepra të Camajt*”. Studiuesi nga universiteti i Prishtinës prof.as.dr. Bardh RUGOVA mbajti kumtesën “*Studiuesit shkodranë të italo-arbërishtes sipas Eric Hampit*”. Prof.dr. Vehbi Hoti mbajti kumtesën “*Luigj Gurakuqi tek arbëreshët dhe për arbëreshët*”. Në seancën e dytë nga Universiteti i Tiranës Gjovalin SHKURTAJ referoi temën “*Dialektologët shkodranë për të folmet e ligjërimet arbëreshe*”. Nga Prishtina prof.dr. Imri BADALLAJ mbajti kumtesën “*Pikëpamjet e Kolë Kamsit mbi italo-arbëreshët dhe gjuhën e tyre*”. Nga Italia Francesco FABBRICATORE mbajti kumtesën “*Kontributi i arbëreshëve në çështjen shqiptare (fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek.XX)*”. Studiuesi kosovar **Begzad BALIU** referoi “*Tipologjia e kontributit të prof. Jup Kastratit në studimin e botës materiale dhe shpirtërore arbëreshe (studime, vepra, komunikime, imazhe, vlerësime, dokumente, dorëshkrime)*”. Nga Universiteti i Gjirokastrës prof.dr. Thoma DHIMA mbajti kumtesën “*Ndihmesa e prof. Gjovalin Shkurtaj për dialektologjinë dhe sociolinguistikën arbëreshe*”. “*Luigj Marleka dhe kontributet e tij në studimet arbëreshe*” ishte kumtesa e mbajtur nga dr. Mimoza PRIKU. Dr. Valbona KARAKAÇI mbajti kumtesën “*Ernest Koliqi dhe Kangjelet e Rilindjes, pikëtakim me botën arbëreshe dhe De Radën*”. “*Hylli i Dritës*” dhe “*Leka*” për arbëreshët” ishte kumtesa e përgatitur në bashkëpunim nga dr. Rrezarta DRAÇINI dhe Ma. Rezearta MURATI. Një tjetër bashkëpunim i dr. Orjeta BAJËS dhe Ma. Merita HYSËS mbante titullin “*Shtresa e huazuar në fjalorin e arbërishtes të Kolë Kamsit*”. Ma. Arben PRENDI mbajti kumtesën “*Kolë Kamsi për folklorin arbëresh në veprën “Shqiptarët e Italisë”*”.

Pasdreke në ambientet e Kinema Millenium u mbajt koncerti i grupit “Lule Bore” nga Ana STRATIGË.

M. Prik

**SEMINARI XXIX NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN,
LETËRSINË DHE KULTURËN KOMBËTARE, PRISHTINË**

Në datat 16 - 27. 8. 2010 zhvilloi punimet *Seminari XXIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën kombëtare*, organizuar nga Fakulteti i Filologjisë - Prishtinë dhe Fakulteti i Histori - Filologjisë - Tiranë.

Sesionet shkencore të Gjuhësisë dhe të Letërsisë u zhvilluan më 26-27 gusht paralelisht, me tema bosht: “*Kontaktet e sotme të shqipes*” për gjuhësinë dhe “*Poezia e sotme shqipe*” për letërsinë. Në secilin sesion, gjatë tri seancave u mbajtën nga 59 kumtesa.

Si çdo vit, morën pjesë edhe pedagogë nga Departamentet e Gjuhësisë e të Letërsisë të Universitetit të Shkodrës, me temat në vijim:

1. Tomor OSMANI: “*Shqipja në Mal të Zi në sfidat e kohës*”.
2. Mimoza PRIKU: “*Vëzhgime rreth disa ndikimeve semantike e morfologjike të shqipes në fokusin e gjuhësisë kontaktuale*”.
3. Merita HYSA - Orjeta BAJA: “*Asimetritë gjuhësore dhe përplasja e kodeve në situatën e bilinguizmit*”.
4. Rrezarta DRAÇINI - Ardian HOTI: “*E folmja e Ulqinit dhe ndikimi i kontakteve në këtë areal*”.
5. Ledri KURTI: “*Tipare të poezisë së Visar Zhitit*”.

Edhe në këtë vit pjesëmarrja ishte e gjerë, me kumtues nga brenda dhe jashtë trojeve shqiptare.

O. Baja

**KONFERENCË SHKENCORE “EPOSI I KRESHNIKËVE:
MONUMENTI TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE”,
PRISHTINË.**

Nga data 28-30 gusht 2010 u mbajt në Prishtinë Konferenca shkencore “*Eposi i kreshnikëve: monument i trashëgimisë kulturore shqiptare*”, organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë.

Nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës morën pjesë nga Departamenti i Letërsisë me kumtesat: Prof.as.dr.Ledri KURTI “*Kurti – Palaj si kodifikues të parë të eposit*”; Ma. Arben PRENDI “*Bota morale zakonore tipike shqiptare në eposin e kreshnikëve*”; Ma. Elinda RAMADANI “*Shtresa bizantine në eposin e kreshnikëve*”, si dhe studentët e ciklit të studimit DND: Ermira YMERAJ “*Ringjallja në epos si trashëgimi biblike*”, Eleonora NDRECA “*Elemente paramiologjike në*

epos dhe në ligjërimin etnozakonor, rendi fisnor në epos dhe në kanun";
Dea TEMALI " *Ajkuna nënë, motër dhe grua në epos*", Safina BORIÇI " *Një model i së bukurësnë krajli- vështrim i figurës së Tanushës në epos*;
Jolanda TRUMZA " *Rreth një fryme parrokiale në epos*"

A.Prendi

"MARTIN CAMAJ PËR KULTURËN SHQIPTARE", TIRANË

Me dt. 24 shtator 2010 Qendra e Studimeve Albanologjike organizoi konferencën shkencore "Martin Camaj për kulturën shqiptare" (në 85-vjetorin e lindjes). Në këtë konferencë morën pjesë studiues nga qendra të ndryshme shkencore e universitare, brenda e jashtë vendit, si: Kosovë, Itali, Gjermani, Austri etj. Në këtë organizim shkencor ishte prezente dhe bashkëshortja e shkrimtarit të madh, zj.Erica CAMAJ Konferenca i zhvilloi punimet në dy seksione.

Nga Universiteti ynë morën pjesë: prof.dr. Tomor OSMANI, i cili mbajti kumtesën "Vëzhgime mbi disa veçori gjuhësore në veprën e Camajt". Kumtesa "Rreth disa ndërtimeve e kuptimeve kohore e modale të paskajores në prozën e Camajt" u mbajt nga dr. Mimoza PRIKU. Ndërsa, Ma. Elinda RAMADANI lexoi kumtesën "Krijimtari letare dhe gjuhësore e Martin Camajt, botuar në revistën "Shejzat"

M. Priku

JAVA E ALBANOLOGJISË, PRISHTINË

Instituti Albanologjik i Prishtinës organizoi nga data 25-29 tetor 2010 Javën e Albanologjisë. Ky aktivitet ishte i ndarë në pesë sesione: Folkloristikë, Etnologji, Histori, Gjuhësi dhe Letërsi. U mbajtën gjithsej rreth 90 kumtesa. Sesioni i Gjuhësisë kishte si temë bosht "Gjuha shqipe dhe purizmi". Nga Universiteti ynë morën pjesë dy pedagogë. Prof.dr. Tomor OSMANI referoi temën "Prurjet e dialekteve-domosdoshmëri për pasurimin e gjuhës" ndërsa dr. Mimoza PRIKU në bashkëpunim me prof. as. dr. Tefë TOPALLIN mbajtën temën "Roli i reksteve parauniversitare për raportin e fjalëve të huaja, terminologjinë dhe leksikun e shqipes".

M. Priku

KONFERENCË SHKENCORE “JETA DHE VEpra E NËNË TEREZËS”, PRISHTINË

Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Nënë Terezës Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës dhe Instituti i Historisë Prishtinë, më dt. 7 shtator 2010 organizuan Konferencën shkencore “*Jeta dhe vepra e Nënë Terezës*”. Nga Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës mori pjesë Ma Arben PRENDI, që mbajti kumtesën “*Veçori poetike të lutjeve të Nënë Terezës.*”

A. Prendi

TAKIMI V I ALB – SHKENCËS, TIRANË

Më 2-5 shtator 2010 është zhvilluar në Tiranë takimi i pestë ndërkombëtar i Alb-Shkencës. Tema bosht e konferencës ndërkombëtare ka qenë “*Integrimi i Diasporës në shkencën, ekonominë dhe kulturën shqiptare*”. Nga Universiteti i Shkodrës kanë marrë pjesë në këtë konferencë pedagogët:

Dr. Rrezarta DRAÇINI me punimin “*Rëndësia e botimeve arbëreshe në fund të shekullit të 19-të*”.

Dr. Orjeta BAJA & Ma. Merita HYSA me punimin “*Arbërishtja–varietetet gjuhësor më vete nën ndikimin e italianizmave (referuar Fjalorit latinisht-shqip të Kolë Kamsit)*”

Ma.Irida HOTI me punimin: “*Larmia terminologjike në tekstet e gjuhës shqipe*”

R. Murati

TAKIMI V I ALB – SHKENCËS, PRISHTINË

Më dt. 1-2 tetor 2010 u zhvillua Konferenca Shkencore e organizuar nga Instituti Albanologjik Alb-Shkenca në Prishtinë. Tema e tryezës ishte: “*Shqiptarët dhe Evropa 2020 - gjendja dhe perspektiva (institucionet, shkenca dhe shoqëria)*”.

Në sesionin e gjuhësisë morën pjesë edhe dy pedagogë të Universitetit të Shkodrës, departamenti i gjuhësisë, Ma. Anisa KOSTERI me temë: *“Përshtatja gjuhësore e studentëve shqipfolës me gjuhën angleze në universitetet shqiptare”*, si dhe Ma. Aida URUÇI me temë *“Ligjërimi i Martin Camajt parë në këndvështrimin gjuhësor”*.

A. Kosteri

VEPRIMTARI SHKENCORE NË DURRËS

Në datat 14-15 maj 2010 nga Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu”, u organizua Konferenca e parë ndërkombëtare për edukimin dhe shkencat *“Sfidat e edukimit në një botë globale: dije, politika dhe praktika”*.

Në këtë konferencë nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore të Universitetit tonë morën pjesë: Ma. Merita HYSA me kumtesën *“Çfarë është PBL: përkufizimet, historia dhe përfitimet”*, dr. Rrezarta DRAÇINI, Ma. Elinda DIBRA me temën *“Çështje gjuhësore në përballjen “dialekt-standard” dhe roli i shkollës në këtë përballje”* dhe dr. Orjeta BAJA, Ma. Rezearta MURATI *“Mësimi multidisiplinar si çelës për një edukim të suksesshëm”*.

R. Murati

VEPRIMTARI SHKENCORE NË NIKSHIQ

Nga data 30 shtator deri në datën 2 tetor nga Fakulteti i Filozofisë të Universitetit të Nikshiqit në Mal të Zi u organizua Konferenca e gjashtë Ndërkombëtare për Studimet mbi Gjuhën dhe Letërsinë me temën *“Të përballesh me të tjerët në mungesë të teorisë”*. Në konferencë morën pjesë mbi 90 studiues nga universitete të ndryshme, si: Notingham, Beograd, Nish, Marok, Sarajevë, Hungari, Banja Luka, Bullgari, Tiranë e Vlorë. Nga Universiteti i Shkodrës në këtë konferencë morën pjesë dr. Rrezarta DRAÇINI dhe Ma. Rezearta MURATI me kumtesën *“Konflikti mes rregullës dhe përdorimit (Emrat anglisht në gjuhën shqipe)”*, Ma. Irida HOTI dhe dr. Orjeta BAJA *“Procesi i integritetit të teorisë dhe praktikës (Kurrikula shkollore)”*, Ma. Merita HYSA *“Kuptimi është veprim”*.

R. Murati

VEPRIMTARI SHKENCORE NË ITALI

Më 9-11 shtator është zhvilluar në Itali, Torino Konferenca ndërkombëtare shkencore me temë bosht “*Changing Gods. Between Religion and Everyday Life*”, organizuar nga Universiteti i Torinos, Fakulteti i Shkencave Politike, CESNUR, Italian Association of Sociology (AIS) – Sociology of Religions Section, and the School of Political Science – University of Torino. Në këtë konferencë nga Universiteti ynë ka qenë pjesëmarrëse dr. Rrezarta DRAÇINI me punimin: “*The religious differences lead to linguistic differences (Albanian Reality)*”.

R. Draçini

KONFERENCA SHKENCORE “*MEDIA NË TRANZICION*”

Më datën **18 nëntor 2010**, në **sallën e konferencave të Akademisë së Shkencave**, u mbajt Konferenca shkencore ndërkombëtare me titull “*Media në tranzicion*”, organizuar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Morën pjesë edhe katër pedagogët e universitetit tonë të degës Gazetari dhe Komunikim, me temat si më poshtë:

MA Ardita REÇI (HYSA): “*Roli dhe statusi i gazetarit në mediat shqiptare*”.

MA Ismet KALLABA: “*Mediat shqip në Mal të ZF*”.

MA Pranvera SKANA: “*Profili i gazetarit në mediat tona: Përjasje krahasuese*”.

MA Romira MUKA: “*Suplementi në shqypin e përditshëm*”.

A. Reçi

PROMOVIME LIBRASH

PROMOVIM I MONOGRAFIVE “NYJAT E SHQIPES” DHE “SISTEMI RASOR I EMRAVE TË SHQIPES” TË PROF. DR. KOLEC TOPALLIT

Departamenti i Gjuhësisë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” organizoi më datë 12. 2. 2010 promovimin e monografive “*Nyjat e shqipes*” dhe “*Sistemi rasor i emrave të shqipes*” të prof.dr. Kolec TOPALLIT.

Fjalën e hapjes në këtë takim e mbajti prof. dr. Tomor OSMANI, përgjegjës i Sektorit Shkencor të Albanologjisë.

Më pas, pedagogë të Departamentit të Gjuhësisë - Shkodër: Tomor OSMANI - Mimoza PRIKU, Artan HAXHI, David LUKA, Tefë TOPALLI - Rrezarta DRAÇINI, Merita HYSA, Erzen KOPERAJ, si dhe të ftuar nga Tirana: Anila OMARI e Evalda PACI, pasi ishin njohur në mënyrë të hollësishme me këto dy botime, dhanë vlerësimet e tyre nëpërmjet kumtesave të përgatitura, duke theksuar të gjithë faktin se studiuesi TOPALLI ka dhënë baza të rëndësishme gjuhësore. Sipas tyre, pas përfundimit të studimeve në fushën e fonetikës historike, prof. Kolec TOPALLI i ka hyrë tashmë prej vitesh një pune serioze e këmbëngulëse për hulumtimin e morfologjisë historike të shqipes.

Në fund, gjuhëtari TOPALLI falënderoi gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen, referuesit, e në veçanti kolegët e Departamentit të Gjuhësisë për organizimin e takimit.

O. Baja

* * *

Me dt. 28 prill 2009, Biblioteka “Marin Barleti” në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Albanologjike të Universitetit “Luigj Gurakuqi” me rastin e ditëve të librit organizuan promovimin e kolanës bibliografike të revistave “Albania”, “Hylli i Dritës”, “Leka” dhe “Shkëndija & Shejzat”, të përgatitura nga studiuesi Willy KAMSI. Pjesë e këtij tubimi ishte edhe promovimi i monografisë së Luigj Marlekajt “*Bogdani dhe Shqipnia e kohës së tij*”, sjellë në gjuhën shqipe po nga Willy KAMSI. Në këtë aktivitet referuan studiues, profesorë të Universiteti të Shkodrës. Prof. dr. Tomor OSMANI, në fjalën e tij theksoi vlerën shkencore dhe rëndësinë e

sjelljes në shqip të këtyre botimeve me rëndësi për kulturën shqiptare. Prof.as.dr. Tefë TOPALLI, dr. Mimoza PRIKU, dr. Rrezarta DRAÇINI dhe Ma. Erzen KOPERAJ vunë në dukje punën e palodhshme e të përkushtuar të studiuesit Willy KAMSI në përpilimin e një serie të tërë bibliografike aq të domosdoshme për studiuesit e albanologjisë, aq më tepër kur bëhet fjalë për revista pak ose aspak të njohura për brezin e ri, të cilat kontribuan për shumë probleme të albanologjisë, si njësimin të gjuhës letrare, historisë së popullit shqiptar, promovimit të arritjeve në shkencën e albanologjisë etj.

M. Prik

**PROF. DR. TOMOR OSMANI, ALBANOLOGU QË NDEROHET
ME “MIRËNJOHJA E QYTETIT”**

Universiteti i Shkodrës krenohet me trashëgiminë që ka krijuar dhe me emrat e profesorëve të nderuar që kanë punuar në të. Prof. dr Tomor OSMANI është një nga personalitetet që është pjesë e kësaj trashëgimie dhe tradite, pasi kontributi i dhënë prej tij në fushën e albanologjisë është i pazëvendësueshëm. Pas shumë titujsh dhe gradash shkencore të dhëna nga institucionet akademike dhe shkencore, prof. dr Tomor OSMANI nderohet dhe nga institucionet vendore. Këshilli i Bashkisë Shkodër e ka vlerësuar punën e bërë nga profesori duke i dhënë titullin “Mirënjohja e Qytetit”, me këtë motivacion: *“Për veprimtari dhe kontribut të shquar në përgatitjen e studentëve si mësues të ardhshëm të gjuhës amtare për një periudhë 50 vjeçare, një studiuesi i afirmuar i gjuhës shqipe dhe punonjës shkencor me një aktivitet shumë të pasur dhe me vlerë në fushën e kërkimeve dhe botimeve gjuhësore, hartues i disa librave dhe monografive me karakter shkencor për qytetin e Shkodrës, një drejtues i aftë i sektorit shkencor që drejton, një pedagog shumë i përgatitur i gjuhës shqipe dhe një qytetar i nderuar dhe i respektuar, një prind shembullor.”*

Ceremonia për dorëzimin e këtij titulli e organizuar nga Universiteti i Shkodrës dhe Bashkia e Shkodrës u zhvillua pikërisht më 7 mars 2010, Ditën e Mësuesit, në prani të të gjithë punonjësve të Universitetit të Shkodrës. Titullin e lartë profesor OSMANIT ia dorëzoi kryetari i Këshillit të Bashkisë Shkodër Z. Bardhyl LOHJA. *“Jemi këtu për të vlerësuar dhe falënderuar prof. Tomor Osmanin për punën e bërë ndër vite, për kontributin e tij në zhvillimin e arsimit në Shkodër dhe më gjerë, për rolin*

që ka luajtur në zhvillimin e albanologjisë shqiptare, për modelin e qytetarit, i cili duhet të ndiqet nga brezat e rinj,” ka pohuar kështu në fjalën e tij kryetari i Këshillit Bashkiak për Shkodrën Bardhyl LOHJA. Po sipas tij, votimi për të nderuar figurën e prof. OSMANIT me titullin “Mirënjohja e qytetit” nga anëtarët e Këshillit Bashkiak të Shkodrës kishte qenë unanimit, i njëzëshëm, pasi respekti që gëzon prof. OSMANI mes bashkëqytetarëve shkodranë është i padiskutueshëm. Në ceremoninë e dorëzimit të titullit foli dhe Rektori i Universitetit të Shkodrës prof. dr. Artan HAXHI, i cili dha këtë vlerësim: “Prof. Osmani veçohet jo vetëm si pedagog, por edhe si studiues i mirëfilltë me një aktivitet të konsiderueshëm në gjuhën shqipe. Janë breza të tërë studentësh nga Shkodra dhe e gjithë Shqipëria, që kanë studiuar në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, të cilëve u ka dhënë mësim profesori. Studimet e bëra nga profesor Osmani kryesisht në fushën e alfabetit, por jo vetëm, kanë një vend të rëndësishëm në fushën e Albanologjisë”.

Prof. dr. Tomor OSMANI është konsideruar nga emrat e njohur të gjuhësisë shqiptare si studiuesi më me emër i fushës së alfabetit të shqipes, varianteve dhe historisë së formimit të tij, si morfolog, kërkimtar i shtypit të traditës, hulumtues i përmbajtjes dhe trajtimit që u bënë problemeve gjuhësore gazetave dhe revistat e ndryshme që nga koha e Rilindjes Kombëtare e deri më sot. Ai është cilësuar si analist e vlerësues objektiv për ndihmesën e mjaft filologëve e gjuhëtarëve, të huaj dhe vendas, të cilët janë shquar në lëvrimin dhe pasqyrimin e vlerave të shqipes. E gjithë kjo punë e bërë, ky përkushtim ndaj shkencës dhe arsimit shqiptar kanë bërë që emri i profesor Tomor OSMANIT të jetë tashmë mes emrave që krijojnë traditën, një ndër figurat më të spikatura të inteligjencës shkodrane. Falë kontributit të tij në fushën e Gjuhësisë (ka botuar mbi 350 studime dhe artikuj në shtypin shkencor), profesori i njohur është nderuar disa herë. Më 24 tetor 2002 Presidenti i Republikës, Alfred MOISIU e nderoi prof. Tomor OSMANIN me medaljen “Mjeshtër i Madh”. Megjithëse Shkodra ka një numër intelektualësh dhe figurash të shquara në fushën e letrave, titulli në fjalë u është akorduar vetëm katër prej tyre: prof. dr. Jup Kastratit, shkrimtarit Fadil Kraja, përkthyesit Gjon Shllaku dhe prof.dr.Tomor OSMANIT. Arritjet e profesorit në fushën e Albanologjisë kanë bërë që emri i tij të jetë pjesë e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Tiranë, 2009.

Asgjë nuk ndodh rastësisht, pa pasur një taban ku të zhvillohet. Ndaj nuk është rastësi që prof. dr. Tomor OSMANI nderohet dhe

respektohet nga bashkëqytetarët. Si pjesë e një familjeje arsimdashëse që ka kontribuar për më shumë se dy shekuj në arsim, prof. dr. Tomor OSMANI, me të drejtë vlerësohet si krenaria e qytetit të Shkodrës. Rrjedh nga një familje e vjetër shkodrane, me tradita të veçanta në mësimdhënie. Babai i tij, Ethem Osmani dhe kunata, Urti Osmani, janë nderuar me titullin "Mësues i Popullit". Ndërsa vëllai, Shefik Osmani laurant i çmimit të Republikës, është nderuar me titullin "Mësues i Merituar". Bashkëshortja e profesorit Liri Osmani, ka punuar gjithë jetën mësuese dhe drejtuese në arsim duke mbetur për të gjithë ato që e kanë njohur modeli i njeriut në perfeksion. Sukseset që e kanë shoqëruar profesor Osmanin për dekada kanë pas, sigurisht, dhe përkushtimin e bashkëshortes, e cila nuk u lodh asnjëherë nga orët e gjatë të punës së profesorit, por, përkundrazi gjithnjë vetëm buzëqeshte. Fëmijët e profesorit vazhdojnë traditën e familjes. Vajza e madhe dhe djali kontribuojnë në fushën e arsimit, ndërsa vajza e dytë është mjeke e nderuar. Profesor Tomori është pjesë e trashgëmisë intelektuale të Shkodrës, sepse është pjesë e familjës së nderuar Osmani. Mbrujtur brenda këtij gjaku mësuesish, profesor OSMANI vijon përgatitjen e një brezi të talentuar mësuesish e studiuesish. *"Ndihem mirë kur dëgjoj se studentët që kemi përgatitur në brezi i pedagogëve të vjetër kanë ecur shumë përpara, kanë bërë emër në gjuhë, letërsi, gazetari dhe politikë"*, thotë prof. Tomor OSMANI. Ndërkohë ish- studentët e tij, edhe pse mund të kenë kaluar dekada ndihen krenarë që kanë pasur pedagog profesorin e nderuar. Dhe për një mësimdhënës ky fakt tregon shumë.

Prof. dr. Tomor OSMANI është një studiues dhe pedagog shumë aktiv, që vazhdon të shquhet për botimet e herëpashershme në shtypin shkencor dhe periodik. Veprën e tij e ndeshim në citimet nga autorë shqiptarë dhe të huaj. Për studiuesit e rinj dhe jo vetëm për ta, punimet shkencore që mbajnë firmën e prof. Tomor OSMANIT janë një udhëzues shumë i mirë dhe orientim për rrugën që duhet të ndiqet dhe një mundësi për të përfituar informacion të saktë shkencor. Si studiues i palodhur prof. Tomor OSMANI është një shembull për pedagogët e rinj, të cilët shohin tek ai modelin e studiuesit, pedagogut dhe qytetarit që duhet të ndiqet për të arritur në një nivel të lartë intelektual.

Rr. Draçini

**LIGJËRATA NË KATEDRËN E ALBANOLOGJISË
TË FAKULTETIT FILOLOGJIK TË UNIVERSITETIT
TË BEOGRADIT**

Gjatë muajit maj 2010, pedagogët e Universitetit “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, prof.dr. Alfred ÇAPALIKU, i Departamentit të Letërsisë dhe prof.as.dr. Tefë TOPALLI, i Departamentit të Gjuhësisë, janë aktivizuar për dhënie leksionesh e ligjëratash për gjuhën e letërsinë shqiptare në Katedrën e Albanologjisë të Universitetit të Beogradit, që është katedra më e vjetër e gjuhës shqipe në Evropë.

Gjatë punës atje, të dy pedagogët tanë u njohën me gjendjen e studimeve albanologjike në Fakultetin Filologjik, fondin e Bibliotekës dhe stafin mësimdhënës me kursin e gjuhës e të letërsisë shqiptare në 4 vitet e studimit nga studentë serbë dhe të etnive të tjera. Gjithashtu u morën të dhëna edhe për tekstet mësimore të gjuhës e të letërsisë, që kishin në përdorim prej kohësh pedagogët e asistentë / pedagogët. Në këtë periudhë, prof.ÇAPALIKU e TOPALLI vunë në jetë programet mësimore, të dërguara më parë në Universitetin e Shkodrës, për 4 vitet e letërsisë dhe të disiplinave të ndryshme gjuhësore nga fonetika, leksikologjia, morfologjia dhe sintaksa. Është vërejtur se studentët që ndiqnin degën e gjuhës e të letërsisë shqiptare, tregonin interes të veçantë për asimilimin e programit, për ta folur e për ta shkruar shqipen në nivel mjaft të mirë. Ata shfaqnin synime të qarta për të ardhmen, në fusha të ndryshme, si në diplomaci, përkthim, arkeologji, turizëm, tregti etj.. Një numër jo i vogël prej tyre ishin regjistruar dhe ndiqnin Shkollat verore për përditësimin e gjuhës shqipe në Universitetin e Prishtinës e të Tiranës.

Pedagogët tanë mbyllën vitin akademik 2009-2010, për degën e shqipes, duke kryer edhe provimet e radhës me studentë.

T. Topalli

LEKTORE NE RUMANI

Dr. Valbona KARAKAÇI është angazhuar si lektore pranë Universitetit “Babes-Bolyai”, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Fakulteti i Historisë dhe Filozofisë, Cluj, Rumani gjatë periudhës 22-31 Gusht, 2010 në kursin “*Rajonet dhe Identitet e Evropës*” (*Regions and*

Identities of Europe) me temën “*Identiteti Shqiptar si pjesë e Identitetit Evropian*” (Albanian Identity as part of European Identity).

V. Karakaçi

KONSULTË KOMBËTARE PËR LËNDËT E GJUHËS DHE TË LETËRSISË. TIRANË

QSA në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës organizuan në Tiranë, më 12 prill 2010 Konsultën kombëtare për lëndët e gjuhës dhe të letërsisë në Tiranë. Ishin të ftuar ku morën pjesë disa edhe me diskutime: A. HAXHI, T. OSMANI, M. PRIKU, L. KURTI, V. KARAKAÇI, E. ALIA...

Ndërsa Ma. Arben PRENDI mbajti kumtesën “*Vendi i folklorit dhe i letërsisë popullore në kulturën shqiptare e në programin shkollor.*”

A. Prendi

BOTIME TË REJA TË UNIVERSITETIT TONË

Ditë më parë në kolanën “Studime shqiptare” u botuan dy përmbledhje kumtesash e studimesh:

1. Identitete gjuhësore dhe kulturore, Studime shqiptare 15, Shkodër, 2010, 202 f.

2. Selman Riza – gjuhëtar i shquar, Studime shqiptare 16, Shkodër, 2010, 171 f.

“*Identitete gjuhësore dhe kulturore*” është botim i Universitetit të Shkodrës, Qendra Kërkimore-Shkencore Albanologjike dhe i Universitetit të Firences. Në këtë përmbledhje përfshihen kumtesat e mbajtura në veprimtarinë shkencore me temë “*Identitete gjuhësore dhe kulturore*”, organizuar nga Universiteti i Shkodrës.

Universiteti i Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” në bashkëpunim me Universitetin e Firences dhe Ministrinë Italiane të Arsimit Universitar dhe Kërkimit Shkencor. Veprimtaria shkencore u zhvillua në Shkodër, më 4 dhe 5 maj 2009. Në këtë botim përfshihen këto referate dhe kumtesa:

Artan HAXHI - Tomor OSMANI, *Reflekse për gegërishten në rrafshin e planifikimit gjuhësor të shqipes*; **Rita MANZINI - Leonardo SAVOIA**,

Rasa dhe veti treguese: fleksioni emëror në të folmet geqe; Françesko ALTIMARI, Selman Riza dhe çështja e paskajores; Alma HAFIZI, Përkthimi në gegërisht i romanit manxonian; Augusta BRETTONI, Reflektime për sprovën e Ismail Kadaresë “Dante i pashmangshëm”; Alfred ÇAPALIKU, Përkthimi i këngës XI të “Parajsës” së Dantes nën melosin poetik të Prennushit; Paolo DE SIMONIS, Peizazhe: Konventa evropiane, jo thjesht letrare; Mimoza PRIKU - Erzen KOPERAJ, Foljet ndihmëse në gegërisht dhe roli i tyre në ndërtimin e kohëve analitike të shqipes; Alberto MORINO, Paqe nuk gjej...Udhëtim mes shenjës dhe shënjuesit: një shembull përkthimi poetik; Ledri KURTI, Elemente të një teorie semiotike të përkthimit në mendimin teorik shqiptar & sprovë; Tefë TOPALLI - Anisa KOSTERI, Predikativiteti i formave të pashtjelluara foljore në dialektin e gegërishtes; Eliana LAÇEJ, Paskajorja e gegërishtes: këndvështrime dhe studime; Irena LAMA (Ndoci), Gabriele d’Annunzio në përkthimin e Ernest Koliqit; Flora KOLECI, Ndërtime të varura sintaksore të shqipes: Çështja e paskajores dhe ndërtimeve të tjera foljore të pashtjelluara; Evalda PACI, Rreth disa çështjeve të eptimit emëror në shqipen e vjetër; Lindita KAZAZI, Karakteristikat fonetike dhe fonologjike të gegërishtes. Hundorësia e zanoreve; Alva DANI, Mbi gegërishten letrare të disa përkthimeve të Ernest Koliqit; Aterda LIKA, Tipare dalluese në morfologjinë e dialektit gegë.

Botimi i dytë “Selman Riza - gjuhëtar i shquar” përmbledh materialet e Konferencës shkencore – përkujtimore, organizuar nga Qendra Kërkimore -Shkencore Albanologjike në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhësisë, me rastin e 100-vjetorit të lindjes të gjuhëtarit Riza. Konferenca i zhvilloi punimet me dt. 12 dhjetor 2009 në Shkodër, ku mori pjesë edhe i biri, prof. Emin RIZA. Në këtë botim janë përfshirë këto shkrime:

Paulina HOXHA, *Fjala e hyrjes*; **Ardian MARASHI**, *Selman Riza-model kulturor i punonjësit shkencor*, **Kolec TOPALLI**, *Vendi i S.Rizës në shkencat albanologjike*; **David LUKA**, *Sprovë për periodizimin e Historisë së gjuhës shqipe*; **Rrezarta DRAÇINI**, *Selman Riza-Jeta mes gjuhësisë e persekutimit*; **Merita HYSA**, *Pikëpamjet e Selman Rizës për formimin e gjuhës standard*; **Tomor OSMANI**, *Alfabeti i Kongresit të Manastirit në vështrimin e prof. Selman Rizës*; **Orjeta BAJA**, *prof. Selman Riza - një nga themelvënësit e gjuhësisë së re shqiptare*; **Erzen KOPERAJ**, *Mendimi i prof. Selman Rizës për nyjat e shqipes*; **Anisa KOSTERI** *Sistemi foljor i shqipes, parë nga Selman Riza*; **Rezearta MURATI**, *Një vështrim leksikor dhe semantik për veprën “Pesë autorët më të vjetërnë gjuhën shqipe”*; **Tefë TOPALLI**, *Selman Riza - studiues dhe hartues i sintaksës shqipe*; **Mimoza**

PRIKU, *Probleme të gjuhësisë së përgjithshme në veprën e gjuhëtarit Selman Riza*; **Fatbardha HOXHA (Fishta)**, *prof. Selman Riza mbi shkrimtarinë e autorëve më të hershëm të shqipes*; **Irida HOTI**, *Metodologjia e Selman Rizës dhe ndihmesa konkrete për mësuesit e gjuhës shqipe*.

T. Osmani

SHKRIME TË PEDAGOGËVE QË JANË BOTUAR JASHTË SHTETIT

Gjatë këtij viti ka vazhduar publikimi i artikujve shkencorë të pedagogëve të fakultetit tonë si në konferenca ndërkombëtare, ashtu edhe në organe shkencore të njohura.

Doli në botim përmbledhja e aktetve të Seminarit XXVIII Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë, 2010, në të cilën janë paraqitur këto shkrime:

T. TOPALLI – A. KOSTERI: “*Veçori të gjuhës së folur në disa vepra të fundit në prozë të I. Kadaresë*”.

M. PRIKU: “*Tipare me karakter morfologjik të shqipes së folur dhe kalimi i tyre në shqipen standarde*”.

Rr. DRAÇINI - R. MURATI: “*Varianti i folur përballë variantit të shkruar (areali i Shkodrës)*”.

M.HYSA - O.BAJA: “*Standardi dhe perspektivat pragmatike të variacionit gjuhësor*”.

Artikuj të botuar:

M. PRIKU: “*Vëzhgime rreth disa ndërtimeve semantike e morfologjike të shqipes në fokusin e gjuhësisë kontaktuale*”, në revistën **Gjuha shqipe**, organ i Institutit Albanologjik të Prishtinës, nr.3, Prishtinë, 2010.

M. PRIKU: “*Shqipja si gjuhë në kontakt sipas studiuesit Eric P. Hamp*” në *Scritti in onore di Eric Pratt Hamp*, botuar nga universiteti i Kalabrisë, Itali, 2010.

M. PRIKU (ba): “*About the trends development of the book*” The 4th. International Conference on Advences and System research, nëntor, 11-

13, Zagreb, Kroaci, 2010. Publisher, Faculty of teacher Education of the University of Zagreb.

O. BAJA - M. HYSA: “Ndikimi i italianizimeve në gjuhën e arbëreshëve të Italisë”, në revistën “*Jeta arbëreshe*”, nr. 67, IX, korrik-shtator, 2010, Itali.

Rr. DRAÇINI: “Ndikimi i kulturës arbëreshe në Shqipërinë e viteve 1878-1912”, në revistën “*Jeta arbëreshe*”, Itali, mars, 2010.

Rr. DRAÇINI: “Përpyjekjet e autorëve arbëreshë për një gjuhë shqipe të vetme”, në revistën “*Jeta arbëreshe*”, Itali, prill, 2010.

Rr. DRAÇINI: “Standardi dhe dialekti gegë në zonën e Shkodrës, realiteti i sotëm”, revista **Filologjia**, nr.17, botim i Universitetit të Prishtinës, Kosovë, 2010.

Rr. DRAÇINI: “*Shkodran researchers at Eric.P.Hamp’s work*”, në *Scritti in onore di Eric P. Hamp*, botuar nga Universiteti i Kalabrisë, Itali, 2010.

M. HYSA: “Organizimi i brendshëm i rrokjes në gjuhën shqipe”, revista **Filologjia**, nr. 17, Prishtinë, 2010.

T. OSMANI, Ch.Gut: “*Pashko Vasa*”, **Filologji**, 17, Prishtinë, 2010.

V. KARAKAÇI: “*Kultura, udhëtim i sigurtë në kohët globale, sprovë multikulturore dhe ndërkulturore*”, botuar në **Colloquia Journal of Central European History**, 2010, seria “**Identitetet kombëtare rajonale, etnike, nacionale në Evropën Qendrore dhe Lindore**”, Rumani, 2010.

M. Hysa

ISSN 2221 - 6855

*Doli nga shtypi në mars, 2011 – Tirazhi 110 kopje – Format
176x250 mm. Shtypur në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës
“Luigj Gurakuqi”*